MJETET EFEKTIVE PËR KOHËZGJATJEN E PROCESEVE GJYQËSORE



MBËSHTETJA E MJETEVE TË BRENDSHME EFEKTIVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË GJEDNJ-SË

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

Funded
by the European Union
and the Council of Europe

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

MJETET EFEKTIVE PËR

KOHËZGJATJEN E PROCESEVE GJYQËSORE

Zhvilluar nga:

Loredana Tassone

Blerina Bulica

Tiranë 2017

Ky botim mbetet në pronësi të Këshillit të Evropës.Te gjitha të drejtat e rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në asnjë formë dhe me asnjë mjet elektronik (CD-Rom), Internet, etj.

Ky manual trajnimi është zhvilluar në kuadër të projektit 'Mbështetja e mjeteve të brendshme efektive për zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së. Manuali bazohet mbi metodologjinë HELP (Edukimi mbi të Drejtat e Njeriut për Profesionistët në Fushën e Ligjit). Për zhvillimin e këtij manuali kanë punuar në bashkëpunim, një ekspert i huaj dhe një vendas. Mendimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjesi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Foto në kopertinë krijuar nga
Awesomecontent - Freepik.com

Përmbajtja e lëndës

SEKSIONI I – ZBATIMI I KONVENTËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (KEDNJ) NË NIVEL vendas..... 5
Objektivi i përgjithshëm..... 5
Objektivat e mësimit 5
Pjesa A. Kushtetuta e Shqipërisë dhe statusi i KEDNJ-së 6
Hyrja në fuqi e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri..... 6
Kushtetuta e Shqipërisë dhe renditja e KEDNJ-së në hierarkinë e ligjeve..... 6
Rasti studimor "Qufaj kundër Shqipërisë" (vendimi i parë për Shqipërinë) 8
Pjesa B. Detyrimet për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ –së 11
Përcaktimi i detyrimit për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së..... 12
Kompensimi i drejtë..... 15
Masat individuale jo-pasurore 18
Masat e përgjithshme 21
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Luli & të Tjerët kundër Shqipërisë*"; 23
Procedura e mbikëqyrjes dhe statistika me rëndësi 24
- Rast studimor "Kudla kundër Polonisë"..... 25
Pjesa C. Aktorë të tjerë të përfshirë në zbatimin e Konventës..... 28
Roli i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve të saj..... 28
Roli i autoriteteve vendase në ekzekutimin e vendimeve 31
Roli i gjykatave vendase dhe i gjyqtarëve në zbatimin e KEDNJ-së në nivelin vendas..... 33
Roli i Zyrës së Prokurorisë 36
Roli i institucioneve të trajnimit..... 39
Pjesa D. Efekti i Konventës mbi sistemin e brendshëm juridik..... 42
Koncepti i ndarjes së përgjegjësisë për zbatimin e Konventës 44
- Rast studimor "Von Hannover kundër Gjermanisë" (1) 45

SEKSIONI II – HYRJE NË NENIN 6(1) – E DREJTA PËR PROCES TË RREGULLT LIGJOR..... 48
Objektivi i përgjithshëm..... 48
Objektivat e mësimit 48
Hyrje në metodat e interpretimit, të përdorura nga GJEDNJ-ja 49
Metoda teleologjike e interpretimit..... 49
Parimi i mbrojtjes efektive 49
Kuptimi autonom i koncepteve të Nenit 6(1) (nënparimi i parë për mbrojtjen efektive) 50
Nocioni i koncepteve autonome..... 50
Shembuj të koncepteve autonome që përfshihen në Nenin 6§1 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile 51
Shembuj të koncepteve autonome në Nenin 6§1 për përcaktimin e akuzave 52
Detyrimet pozitive (parimi i dytë i mbrojtjes efektive) 54
Koncepti i detyrimeve pozitive..... 54
Detyrimet pozitive dhe negative 54
Llojet e detyrimeve pozitive..... 55
- Nenit 2 (shih *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*); 55
- Nenit 3 (shih *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*); 55
- Nenit 8 (shih *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*); 55

- Nenit 11 (shih Plattform "*Ärzte für das Leben" kundër Austrisë*). 55
Detyrimet pozitive në lidhje me garancitë procedurale 56
Subsidiariteti dhe doktrina e shkallës së katërt (nën-parimi i tretë i mbrojtjes efektive) 58
Parimi i shkallës së katërt 59
Shembuj të praktikës gjyqësore lidhur me doktrinën e shkallës së katërt 59
- Rast studimor "Mullai kundër Shqipërisë" 61
Parimi i interpretimit dinamik 63
Neni 6§1 dhe qasja teleologjike 65
- Rast studimor "Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar" 68
Parimi i balancimit të drejtë 70
Aspekti substancial (nën-parimi i parë për balancën e drejtë) 71
Doktrina e "pragut të vlerësimit" në kuadrin e Nenit 6(1) (nën-parimi i dytë i balancës së drejtë) 75
Përdorimi i doktrinës së pragut të vlerësimit në Nenin 6(1) 76
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar"*; 78
- Vendimi i GJEDNJ-së për "*Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës"*; 78
Kufizimet procedurale (nënparimi i tretë i balancës së drejtë) 79
- Rast studimor "Cani kundër Shqipërisë" 81
SEKSIONI III - E drejta për gjykim brenda afateve të arsyeshme dhe mjetet efektive në këtë aspekt 83
Objektivi i përgjithshëm 83
Objektivat e mësimit 83
Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore 84
A. Fusha penale 85
Objekti i së drejtës për t'u dëgjuar brenda afatit të arsyeshëm në procese me "akuza penale" 85
Përcaktimi i kohëzgjatjes së proceseve 88
Pika e fillimit të periudhës që duhet të merret parasysh: 88
Pika e fundit e periudhës 89
- Rasti studimor nr. 1 89
- Rasti studimor nr. 2 92
Kriteret që përcaktojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore 95
Kompleksiteti i çështjes 95
Sjellja e ankuesit 97
Sjellja e autoriteteve përkatëse 98
Çfarë është me risk për ankuesin 99
- Rasti studimor nr. 3 100
B. Fusha Civile 108
Fusha e veprimit të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme lidhur me "të drejtat dhe detyrimet civile" 108
Përcaktimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore 108
Pika e fillimit e periudhës që duhet të merret parasysh 111
Përfundimi i periudhës që duhet të merret parasysh 113
- Rast studimor 1 113
Kriteret që përcaktojnë arsyetimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore 115
Kompleksiteti i çështjes 115
Sjellja e ankuesit 116
Sjellja e autoriteteve kompetente 116

Çfarë është me risk në mosmarrëveshje 119
- Rasti studimor 2 120
Vonesat për zbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar të detyrueshëm ... 121
- Rasti studimor 3 123
Mjetet efektive për mbrojtjen e të drejtës për gjykim.....127
Mjetet e Konventës..... 128
Neni 13 i Konventës 128
Parimet kryesore të Nenit 13 128
Sistemi i brendshëm shqiptar mbi të drejtën për proces të rregullt brenda kohëzgjatjes së arsyeshme.....134
Detyrimi për respektim të procesit të rregullt ligjor brenda kohëzgjatjes së arsyeshme 134
Llojet e proceseve objekt i kërkesës për kohëzgjatje të arsyeshme 135
Vlerësimi i kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve (penale, civile, administrative) 135
Proceset penale 135
Proceset civile..... 136
Proceset administrative 137
Praktika Gjyqësore e GJEDNJ-së lidhur me Shqipërinë sa i takon kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore..... 138
Tejzgjatja e proceseve gjyqësore e shkaktuar nga mosekzekutimi i vendimeve përfundimtare gjyqësore ose quasi gjyqësore 141
- Rast studimor *"Hozee k. Holandës"* 143
Natyra e vonesave të proceseve gjyqësore sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së..... 144
Standardet e fazave procedurale dhe periudha e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së 146
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë"*.....148
Mjetet efektive për tejzgjatjen e pajustifikuar të procedurave në sistemin e brendshëm shqiptar..... 148
- Rasti studimor *"Scordino k. Italisë"*..... 150
Reforma në drejtësi në Shqipëri dhe mjetet e reja juridike për tejzgjatjen e proceseve gjyqësore 151
Përcaktimi i periudhës së përgjithshme në bazë të Ligjit të ri Nr.38/2017, datë 30.03.2017.....153
Ankesa kushtetuese në bazë të ligjit të ri..... 154
Aspektet procedurale të vonesave të pajustifikuara të përmirësuara në ndryshimet e Kodit të Procedurave Penale..... 155
Avokati i Popullit 156
Mjetet e brendshme juridike për proceset e tejzgjatura në mënyrë të paarsyeshme: praktikat europiane..... 159

SEKSIONI I – Zbatimi i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në nivel vendas

a) Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i këtij seksioni është t'u bëjë të mundur pjesëmarrësve që të përmirësojnë njohuritë dhe të kuptuarit mbi një sërë çështjesh që lidhen me zbatimin e KEDNJ-së në nivel vendas. Përveç kësaj, seksioni do t'i aftësojë pjesëmarrësit që të analizojnë dhe të vlerësojnë detyrimin e Palëve të Larta Kontraktuese që lind në baë të Konventës duke bërë dallimin nga detyrimi qe lind per shtetet anëtare për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Në shënjester të ketij trajnimi janë ato pjesëmarrës qe kanë njohuri të përgjithshme mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me Shqipërinë. Konkretisht, pjesëmarësit preferohet te kene background profesional të avokatëve, të gjyqtarëve, prokurorëve, agjentëve qeveritarë që merren me ekzekutimin e KEDNJ-së (zyra e Avokatit të Shtetit, Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit etj.). Ky seksion trajnimi mund të jetë mjaft mirë i vlefshëm edhe për të gjithë aktorët që merren me veprimtarinë shtetërore që lidhet me zbatimin e ligjit.

b) Objektivat e mësimit

Deri në fund të këtij seksioni prezantues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kujtojnë renditjen e KEDNJ-së në hierarkinë e ligjeve vendasvendase;
- Të ritheksojnë natyrën e detyrimit për zbatimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ-së në nivelin vendas;
- Të dallojnë qartë natyrën e detyrimit për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ-së;
- Të identifikojnë aktorët kryesorë që luajnë rol në procesin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së;
- Të shpjegojnë përgjegjësinë e përbashkët që lind ndaj aktorëve të ndryshëm për zbatimin e KEDNJ-së;
- Të vlerësojnë efektet e Konventës në niveli vendasvendas në Shqipëri.

c) Kohëzgjatja: 3 orë, 2 javë

d) Vlerësimi përfundimtar: rast studimor, portofol, dokument për debat

Pjesa A. Kushtetuta e Shqipërisë dhe statusi i KEDNJ-së

1. Hyrja në fuqi e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri

KEDNJ-ja është konventa e parë e miratuar nga Këshilli i Evropës, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1953. Ky instrument ndërkombëtar u nënshkrua nga shteti shqiptar më 13 korrik 1995 dhe u ratifikua më 2 tetor 1996.[1]Shqipëria ka aderuar në të gjitha protokollet e KEDNJ-së (1-16)[2], përveç protokollit 9, 10[3] dhe 14 bis.[4]Neni 117.3 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj shpallen dhe botohen sipas të njëjtave procedura që parashikohen për botimin e ligjeve. Sipas dispozitës 1 të këtij Neni, ligjet fitojnë forcë juridike vetëm pasi ato janë botuar në Fletoren Zyrtare. Prandaj, e njëjta procedurë është e zbatueshme edhe për shpalljen e marrëveshjeve ndërkombëtare, siç është KEDNJ-ja, e cila është ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 3.07.1996, të ndryshuar. Megjithatë, botimi i saj *de facto* është bërë vetëm në vitin 2008 (*12 vjet pas ratifikimit të saj*) në Fletoren Zyrtare nr. 28/2008 në serinë e akteve të pabotuara të vitit 1996.

2. Kushtetuta e Shqipërisë dhe renditja e KEDNJ-së në hierarkinë e ligjeve

Në kohën kur KEDNJ-ja u ratifikua, më 2 tetor 1996, Shqipëria nuk e kishte miratuar ende Kushtetutën e saj, por qeverisej me anë të ligjit nr.7491/1991 "Për dispozitat themelore kushtetuese", i cili shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1976. Dispozitat Themelore Kushtetuese shërbyen si bazë për transformimin e shtetit shqiptar pas vitit 1991, nga një shtet autoritar monist në një demokraci që respekton liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Vetëm 2 vjet pas ratifikimit të KEDNJ-së, Parlamenti Shqiptar miratoi më 21 tetor 1998 Kushtetutën e parë demokratike të Shqipërisë[5].

Sistemi ligjor shqiptar ndjek qasjen e opsionit kushtetues nacionalist të sistemit monist[6], sipas së cilës në hierarkinë e ligjeve të brëndshme i njeh KEDNJ-së vendin e dytë pas Kushtetutës Shqiptare, si dhe epërsinë e saj në raport me ligjet e zakonshme.

---

[1] *Ligji nr. 8137, datë 3.07.1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8431, datë 13.07.2000, ligjin nr. 9264, datë 29.07.2004, ligjin nr. 9453, datë 25.12.2005.*

[2] *Protokolli i Konventës (nënshkruar më 2 tetor 1996, ratifikuar të njëjtën ditë);Protokolli II (nënshkruar më 13 qershor 1995, ratifikuar më 2 tetor 1996); Protokolli III (nënshkruar më 13 korrik 1995, ratifikuar më 2 tetor 1996); Protokolli IV (nënshkruar më 2 tetor 1996, ratifikuar të njëjtën ditë); Protokolli V (nënshkruar më 13 korrik 1995, ratifikuar më 2 nëntor 1996); Protokolli VI (nënshkruar më 4 prill 2000, ratifikuar më 1 tetor 2000); Protokolli VII (nënshkruar më 2 tetor 1996, ratifikuar më 1 janar 1997); Protokolli VIII (nënshkruar më 13 korrik 1995, ratifikuar më 2 tetor 1996); Protokolli XI (nënshkruar më 13 korrik 1995, ratifikuar më 1 nëntor 1998)Protokolli XII (nënshkruar më 26 maj 2003, ratifikuar më 1 maj 2005); Protokolli XIII (nënshkruar më 26 maj 2003, ratifikuar më 1 qershor 2007); Protokolli XIV (ratifikuar më 10 nëntor 2004, nënshkruar më 3 shkurt 2006); Protokolli XV (nënshkruar më 11 shkurt 2014, ratifikuar më 12 nëntor 2015); Protokolli XVI (nënshkruar më 24 nëntor 2014, ratifikuar më 7 maj 2015)*

[3] *Këto 2 protokolle janë shfuqizuar që prej datës së hyrjes në fuqi të protokollit nr. 11 (ETS nr. 155) më 1 nëntor 1998, duke e humbur kështu përpjekjen e tyre.*

[4] *Ky protokoll është shfuqizuar, ose nuk zbatohet më përkohësisht, që prej 1 qershorit të vitit 2010, që është data e hyrjes në fuqi e protokollit nr. 14 të Konventës (CETS nr. 194).*

[5] *Që u votua dhe u miratua në referendumin popullor, datë 22 nëntor 1998 dhe u fut në fuqi më 28 nëntor 1998.*

[6] Luan Omari& Aurela Anastasi, "E drejta Kushtetuese", Tiranë 2010.

Neni 116 i Kushtetutës përcakton rendin e akteve normative që janë efektive në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtaree të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. Sipas kësaj qasje, një traktat ndërkombëtar, i nënshkruar dhe i ratifikuar, bëhet menjëherë pjesë e brendshme e së drejtës sapo ai të jetë botuar në Fletoren Zyrtare, pa qenë i nevojshëm ndonjë transpozim legjislativ. Në lidhje me këtë, Neni 5 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare që është e detyrueshme për të. Gjithashtu, Neni 122 i Kushtetutës parashikon që marrëveshjet ndërkombëtare vendase të ratifikuara me ligj që përmbajnë norma vetëzbatuese të zbatohen drejtpërdrejt (Neni 123/1). Ato gëzojnë përparësi në raport me ligjet vendase që nuk janë në përputhje me to (Neni 122/2). Gjithashtu, normat e nxjerra nga një organizatë ndërkombëtare, që parashikojnë shprehimisht zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë, kanë epërsi, në rast konflikti, ndaj ligjeve të brendshme (Neni 123/3). Në këtë kuptim KEDNJ gëzon zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm juridik shqiptar, mbi të gjitha pasi dispozitat e saj përbëjnë norma vetë-zbatuese sipas nenit 123/1 të Kushtetutes.

Shembull. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, me vendimin nr. 6/2006, përcaktoi për herë të parë pozicionimin dhe efektin e drejtpërdrejtë të Konventës në nivelin vendas, duke trajtuar: 1) vendin që zë Konventa në sistemin juridik; 2) interpretimin e Konventës dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së; 3) efektet ligjore të vendimeve të GJEDNJ-së.

Shembull. Më herët, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 655/1999[7], interpretoi Nenin 17 të Kushtetutës, i cili i referohet shprehimisht standardeve të KEDNJ-së, kur flitet për kufizimet e të drejtave dhe lirive individuale nga autoritetet shtetërore, duke deklaruar se "*... Këto kufizime nuk mund të cënojnë thelbin e të drejtave dhe lirive dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.*"

Shembull. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 29/2005, argumentoi se standardi minimal për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të KEDNJ-së është i detyrueshëm për autoritetet shtetërore. Megjithatë, kjo nuk e pengon legjislacionin vendas që të vendosë një standard më të lartë për mbrojtjen e të drejtave individuale. Më konkretisht, ajo ka pohuar se: *"E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është element i të drejtave individuale, por kjo e drejtë nuk është absolute. Ajo mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve ligjore. Pavarësisht nga kjo, Kushtetuta e Shqipërisë i ka tejkaluar masat mbrojtëse të dhëna nga KEDNJ-ja, duke shoqëruar masat e shkarkimit ndaj një gjyqtari me të drejtën për ankim në Gjykatën e Lartë. Gjithsesi, zgjerimi i këtij koncepti edhe ndaj masave të tjera disiplinore është në kundërshtim me Kushtetutën. Prandaj, Neni 147, pika 6 e Kushtetutës, e konceptuar si një dispozitë me natyrë të jashtëzakonshme, nuk mund të interpretohet në mënyrë shteruese."*

Në shtete të tjera njohja në nivel vendas e Konventës, merr forma të ndryshme. Në disa shtete,[8] Konventa konsiderohet si pjesë e legjislacionit të brendshëm. Në disa shtete të

[7] *Ky vendim merret me përputhshmërinë e dënimit me vdekje me standardet e Kushtetutës, duke shënjuar kështu rastin e parë të aplikimit të 17/2 në sistemin e brendshëm ligjor.*
[8] *Armenia, Azerbajxhani, Rumania, Sllovakia, Spanja, Suedia, Maqedonia, Ukraina.*

tjera,[9]Kushtetuta i njeh marrëveshjet ndërkombëtare vetëm duke u kufizuar në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Në rastin e fundit, Konventa dhe praktika gjyqësore e KEDNJ-së njihet si *lex specialis* nga një gjykatë e specializuar, përmes vendimeve të Gjykatës Kushtetuese[10], ose vendimit të një Gjykate të Lartë.[11]

Shembull: Vendimi i Gjykatës Supreme të Mbretërisë së Bashkuar për çështjen *Horncastle*[12] (2009) mund të konsiderohet si përgjigje e drejtpërdrejtë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *"Al-Khawaja kundër Mbretërisë së Bashkuar"* (2009)[13], rast i cili kishte fakte të ngjashme nga pikpamja ligjore. Në këtë rast, GJEDNJ-ja vendosi kundër shtetit dhe konstatoi se ndonëse deklarimet si provë mund të justifikohen në disa rrethana, nuk kishte asnjëherë të ngjarë që një dënim të bazohej vetëm, ose në mënyrë vendimtare, mbi prova të tilla. Dhoma e Lordëve në Gjykatën Supreme në *Horncastle* nuk e priti mirë këtë vendim të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, duke argumentuar se"edhe pse gjykatës vendase iu kërkua të merrte parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për zbatimin e parimeve të përcaktuara qartë, në disa raste rezulton sipas preokupimit të saj, se vendimi i Gjykatës Europiane nuk vlerëson ose trajton siç duhet aspekte të veçanta të procesit juridik vendas, çfarë e bën atë të mos e zbatojë këtë vendim të GJEDNJ-së. Më vonë, në një vendim tjetër për çështjen Ullah[14], Gjykata Supreme e ndryshoi qëndrimin e saj duke u shprehur se "detyra e gjykatave vendase është të ruajë të njëjtin hap me jurisprudencën e Strasburgut, gjatë procesit evolutiv: jo më shumë, por sigurisht jo më pak".

Rasti studimor "Qufaj kundër Shqipërisë" (vendimi i parë për Shqipërinë)[15]

Gjykata ia komunikoi aplikimin për këtë çështje Qeverisë së Shqipërisë në vitin 2003. Ankuesi, kompania shqiptare "Qufaj Co." sh.p.k.[16], pretendonte përpara GJEDNJ-së mospërmbushjen nga ana e autoriteteve shqiptare të një vendimi të formës së prerë dhe, për pasojë, shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Faktet. Bashkia e Tiranës, pasi i kishte dhënë kompanisë në fjalë një ***"leje planifikimi"*** për të ndërtuar pesëqind apartamente, mbi 15,788 metra katrorë tokë në një zonë

[9]Italia, Vendet e Ulëta, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Rusia, Sllovenia, Letonia, Danimarka.

[10]Gjermania e pranoi efektin e Konventës në emër të parimit të hapjes ndaj parimeve të së drejtës ndërvendasvendase vetëm pasi Gjykata Federale e Gjermanisë mori vendimin për çështjen Görgülü, datë 14 tetor 2004. Në Itali, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen Candela Soriano shënoi një kthesë për njohjen e epërsisë së dispozitave të Konventës në ligjet e brendshme.

[11] Në Estoni, jurisprudenca e Gjykatës filloi të konsiderohej si e detyrueshme dhe e zbatueshme vetëm pasi Gjykata Supreme nxori dekretin, datë 30 dhjetor 2008.

[12][2010] 2 AC 373, [2010] 2 WLR 47, [2010] 2 All ER 359

[13] Çështja nr. 26766/05 & 22228/06, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), Dhoma e Madhe, datë, 15 dhjetor 2011, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-108072

[14]Regina kundër Gjyqtarit të Posaçëm (Do k. Sekretarit të Shtetit të Departamentit të Brendshëm), [2004] UKHL 26 për apelimin nga [2002] EWCA Civ 1856

[15] Çështja nr. 54268/00, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 18 nëntor 2004, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-67514

[16]Përcaktuar me anë të vendimit nr. 5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 20 korrik 1992, me objektin e investimit në fushën e biznesit.

rezidenciale në Tiranë, më pas refuzoi ti jepte ankuesit ***"lejen e ndërtimit"***[17], pasi ai nuk i përmbushte kriteret e bazuara në dispozitat e reja të ligjit. Ankuesi kërkoi kompensim për humbjen e shkaktuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Në fazën e apelit, Gjykata e Apelit Tiranë e anuloi vendimin e shkallës së parë dhe e urdhëroi Bashkinë t'i paguajë ankuesit një shumë si kompensim për dëmin (vendimi nr. 1197, datë 23 shkurt 1996). Ky vendim u bë përfundimtar për t'u zbatuar nga përmbarimi. Edhe pse Zyra e Përmbarimit e njoftoi Bashkinë që ajo duhet të ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit, ajo vazhdimisht refuzonte zbatimin, duke argumentuar se nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Më pas çështja u paraqit përpara Gjykatës Kushtetuese dhe kjo e fundit e refuzoi ankimin e kompanisë Qufaj, duke deklaruar se "ankesa nuk mund të merret parasysh sepse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese". GJEDNJ-ja e dha vendimin për këtë çështje më 18 nëntor 2004, duke deklaruar se kishte gjetur shkelje për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia[18]. Komiteti i Ministrave mbi bazën e procedurave të zgjeruara të mbikëqyrjes e cilësoi rastin si një çështje "orientuese" për rastet e tjera të ngjashme. Më vonë, Komiteti i Ministrave miratoi një rezolutë për mbylljen e shqyrtimit të kësaj çështjeje, duke pasur parasysh se ishin shterur të gjitha masat për ekzekutimin e saj.

Lista e pyetjeve

- Diskutoni efektet e mundshme të këtij vendimi në sistemin e brendshëm juridik për parandalimin e shkeljeve të një natyre të ngjashme.
- Çfarë vendimesh do të merrnit si gjyqtar në rast se caktohet për shqyrtim një kërkesë për moszbatim të një vendimi të formës së prerë të Gjykatës?
- Çfarë interpretimi pritet nga gjyqtarët kur ato përballen me një konflikt normash ndërmjet legjislacionit vendas dhe Konventës gjatë shqyrtimit të një çështjeje?
- Çfarë pritet nga avokatët sa herë ato përballen me situata në të cilat legjislacioni i brendshëm bien ndesh me Konventën gjatë praktikës gjyqësore?
- Çfarë interpretimi pritet ne rastet kur e drejta e brendshme nuk përmban një dispozitë, e cilakonsiderohet e nevojshme për zbatimin e një të drejte individuale të parashikuar në KEDNJ? A është Konventa drejtpërdrejt e aplikueshme në një rast të tillë?
- Çfarë qasjeje duhet të ndiqet nga një avokat, gjyqtar, prokuror, oficer gjyqësor për zbatimin e ligjit dhe të Konventës në raste të tilla?
- Në veçanti, a duhet të përdorë gjyqtari një metodë të re-krijuese interpretimi të ligjit që lejon dhënien e efektit të drejtpërdrejtë për Konventën, apo të mjaftohet me interpretimin mekanik të së drejtës së brendshme?
- Çfarë qasjeje duhet të ndiqet nga një gjyqtar, në rast se përballet me shkeljen e një standardi të të drejtave të njeriut gjatë shqyrtimit të një çështjeje, e cila nuk është pretenduar në kërkesën e paraqitur nga pala paditëse, ose një palë e interesuar, sipas rastit?

[17] *Përpara fillimit të ndërtimit, kërkohet edhe marrja e lejes së ndërtimit, por Bashkia nuk arriti të vendoste për kërkesën për një kohë të gjatë, duke ndaluar kështu fillimin e punimeve të ndërtimit.*
[18] *Çështja Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë [Cm/Resdh(2011)86]*

Rekomandohet për lexim

- Vendimi për çështjen *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë)18/11/2004, vendimi përfundimtar, datë 30/03/2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22fulltext%22:[%22qufaj%22ç,%22documentcollectionid2%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22ç,%22itemid%22:[%22001-67514%22çÇ
- Rezoluta KM/RezDH(2011)86[1] Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen *Qufaj Co. sh.p.k kundër Shqipërisë* http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECIdentifier%22:[%22001-106810%22]çÇ}
- Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 6/2006
- Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr.65/1999
- Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 29/2005
- *Poitrimol kundër Francës*, vendim
- Gjykata Supreme e Mbretërisë së Bashkuar, vendimi Horncastle (2009)

Pjesa B. Detyrimet për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së

Respektimi i KEDNJ-së, përfshirë juridiksionin e detyrueshëm të GJEDNJ-së dhe vendimet e detyrueshme të saj, përbëjnë shtyllën kryesore të rendit publik europian. Neni 1 i Konventës i vesh Palët e Larta Nënshkruese me detyrimin që t'i sigurojë gjithsecilit brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë. Efektet e këtij detyrimi kanë një karakter të përgjithshëm, *erga omnes*, çfarë nënkupton se shtetet anëtare ftohen për një zbatim kolektiv të të drejtave të parashikuara në Konventë. Ndërsa, natyra dhe kufijtë e detyrimit të secilit shtet anëtar sipas Nenit 1 të Konventës diktohen nga kufijtë e juridiksionit të shteteve. Për shembull, në lidhje me këtë, Kushtetuta shqiptare parashikon në Nenin 15 se: "*Shteti shqiptar ka detyrimin të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke i konsideruar ato të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, dhe se ato qëndrojnë në themelin e të gjithë rendit juridik*".

Shembull. *Në çështjen "Mamatkulov kundër Turqisë"*[19] Gjykata u shpreh se "Treguesit e masave të ndërmjetme të dhëna nga Gjykata, si në rastin konkret, e lejojnë atë që jo vetëm të kryejë një shqyrtim efektiv të kërkesës, por edhe të sigurojë që mbrojtja që i është dhënë ankuesit nga Konventa të jetë efektive; tregues të tillë i lejojnë po ashtu Komitetit të Ministrave të mbikëqyrë ekzekutimin e vendimit përfundimtar, që është juridikisht i detyrueshëm sipas Nenit 46 të Konventës. Pra, masa të tilla të ndërmjetme ndaj një Shteti anëtar, në këtë rast shteti i paditur, duhet të shqyrtohen në bazë të detyrimeve që u imponohen shteteve palë nga nenet 1, 34 dhe 46 të Konventës."

Shënim. Masat e ndërmjetme*. Në bazë të Nenit 39 të rregullores së GjEDNJ-së, Gjykata mund të nxjerrë masa të ndërmjetme të cilat janë detyruese për shtetin përkatës. Masat e ndërmjetme zbatohen vetëm në raste të jashtëzakonshme. Gjykata nxjerr një masë të ndërmjetme kundër një shteti anëtar vetëm kur, pasi ka shqyrtuar të gjithë informacionin e duhur, është e mendimit se ankuesi përballet me një rrezik real dëmi serioz, të pakthyeshëm, nëse masa nuk zbatohet. Ankuesit, ose përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët bëjnë kërkesë për masë të ndërmjetme, në pajtim me Nenin 39 të rregullores së Gjykatës, duhet të përmbushin kërkesat e duhura.*

Shembull. *Në çështjen "Rrapo kundër Shqipërisë"*[20] Gjykata u shpreh se dështimi i autoriteteve shqiptare për të ekzekutuar masat e ndërmjetme të GJEDNJ-së çoi në shkeljen e Nenit 34 dhe, për pasojë, ka çuar në shkeljen e detyrimit të parashikuar në Nenin 1 të Konventës, duke deklaruar se: " ... dështimi nga një shtet i paditur për të përmbushur masat e ndërmjetme, cënon efektivitetin e të drejtës së ankimit individual të garantuar nga Neni 34 dhe marrjen formalisht përsipër të shtetit, të detyrimit që ka në bazë të Nenin 1 të Konventës, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë."

[19] *Çështja nr. 6827/99 46951/99, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), Dhoma e Madhe, datë 4 shkurt 2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-68183*

[20] *Çështja nr. 58555/10, vendim (meritat dhe kompensimi i drejtë), datë 25 shtator 2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-113328*

1. Përcaktimi i detyrimit për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së

Në çdo situatë konkrete kur Palët e Larta Kontraktuese nuk i përmbushin detyrimet parësore që rrjedhin nga Neni 1 i Konventës, ekziston mundësia të shkelet Konventa. Kurdoherë që GJEDNJ-ja gjen shkelje të të drejtave të njeriut të sanksionuara në Konventë në raste individuale, pala shtetërore e paditur mban përgjegjësinë sipas Nenit 1 dhe Nenit 46 të Konventës, të mara së bashku, për të ofruar korrigjim/kompensimin e duhur të situatës. Në këtë kontekst, Neni 46 i Konventës Europiane[21] parashikon detyrimin e shteteve palë që të zbatojnë një vendim përfundimtar të GJEDNJ-së. Ky detyrim është i trefishtë: së pari, detyrimi për t'i dhënë fund shkeljes; së dyti detyrimi për të dhënë kompensim për riparimin e shkeljes (për të eliminuar pasojat e kaluara të veprës që bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtarevendase) dhe, së fundi, detyrimi për të shmangur shkeljet e ngjashme (detyrimi për të mos përsëritur shkeljen Këto tri detyrime janë përcaktuar qartë nga rezolutat e Komitetit të Ministrave, të miratuara në lidhje me Nenin 46§2[22] nën rregullin 6(2). Përveç kësaj, Neni 46[23] i KEDNJ-së parashikon se është Komiteti i Ministrave organi përgjegjës që mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.Procesi i ekzekutimit përfshin gjithashtu të gjitha Palët e Larta Kontraktuese në Konventë, të cilat duhet të bashkëpunojnë nëpërmjet institucioneve të tyre publike, përfshirë edhe parlamentet përkatëse.

Shembull. ***Në çështjen "Scozzari dhe Giunta kundër Italisë,"***[24] Gjykata nënvizoi se "një vendim që konstaton një shkelje, "vendos mbi shtetin e paditur detyrimin që jo vetëm t'u paguhet palëve të prekura shuma që jepet me anë të kompensimit të drejtë, por edhe të përzgjedhin, duke u mbikëqyrur nga Komiteti i Ministrave, masat e të duhura të përgjithshme dhe/ose individuale që duhet të miratohen në rendin e tyre të brendshëm ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të dëmshpërblyer sa më shumë të jetë e mundur efektet."

Në rast se Komiteti i Ministrave vlerëson se mbikëqyrja e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës që të dalë me një vendim mbi çështjen e interpretimit. Gjithashtu, kur një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të pajtohet me një vendim të formës së prerë në një çështje në të cilën ajo është palë, Komiteti i Ministrave mund t'i drejtohet Gjykatës me pyetjen nëse kjo palë e ka përmbushur apo jo detyrimin sipas Nenit 46 paragrafit 1. Përveç kësaj, kur një Palë e Lartë Kontraktuese nuk e përmbush detyrimin e saj sipas Nenit 46 § 1, të kombinuar me Nenin 1 të Konventës, Gjykata ia

[21]Neni 46 i Konventës Evropiane: "Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve 1. Shtetet e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin përfundimtar të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë. 2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili bën mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve."

[22]Rregullat e miratuara nga Komiteti i Ministrave për zbatimin e Nenit 46, paragrafi 2, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave, datë 10 maj 2006, në takimin e 964-të të Zëvendësministrave.

[23]Vendimi i referimit kërkon votën e shumicës së dy të tretës të përfaqësuesve që kanë të drejtë të përfaqësohen në Komitet.

[24]Çështja Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 41963/98, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 13 korrik 2000.

referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë më tutje. Në lidhje me këtë, vlen të theksohet se detyrimi për Nenin 1 dhe Nenin 46 të Konventës mund të kufizohet vetëm në bazë të kritereve *ratione temporis*[25], të zbatueshme për të vendosur kufijtë e kompetencave të Konventës mbi shtetet.

Shembull. ***Në vendimin e çështjes "Loizidou kundër Turqisë"***[26]GJEDNJ-ja përcakton natyrën e kufizimeve mbi detyrimin, sipas Nenit 1 dhe Nenit 46 të Konventës:
"Gjykata rikujton se, edhe pse Neni 1 përcakton kufizime për shkeljen e Konventës, koncepti i "juridiksionit" sipas kësaj dispozite nuk kufizohet vetëm në territorin vendas të Palëve të Larta Kontraktuese. Për shembull, sipas jurisprudencës së krijuar, Gjykata është shprehur se ekstradimi, ose dëbimi i një personi nga një Shtet Kontraktues, mund të shkaktojë ngritjen e një çështjeje sipas Nenit 3 dhe, për pasojë, të çojë në angazhimin e përgjegjësisë së këtij shteti sipas Konventës. ... Duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e Konventës, përgjegjësia e një Pale Kontraktuese mund të shfaqet edhe kur, si pasojë e veprimeve ushtarake, të ligjshme apo të paligjshme qofshin, ai ushtron kontroll efektiv mbi një zonë jashtë territorit vendas. Detyrimi për të siguruar, në një zonë të tillë, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, rrjedh nga fakti i një kontrolli të tillë, nëse ai ushtrohet drejtpërdrejt, nëpërmjet forcave të saj të armatosura ose nëpërmjet një administrate lokale varësie.
Për ankuesin dhe qeverinë e Qipros, kur shtetet bëjnë deklarata sipas neneve 25 dhe 46 (Neni 25, Neni 46), përmes të cilave njohin kompetencën e Komisionit dhe të Gjykatës, të vetmet kushte të lejuara janë ato *ratione temporis*.

Ashtu siç u theksua në vendimin e Gjykatës "*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar"*, të datës 18 janar 1978 (seria A nr. 25, fq. 90, paragrafi 239), "Ndryshe nga traktatet ndërkombëtare të tipit klasik, Konventa përfshin më shumë sesa thjesht angazhime reciproke midis shteteve kontraktuese. Ajo krijon, përveç tyre, edhe një rrjet përgjegjësish të dyanshme dhe dypalëshe, detyrime objektive që, sipas tekstit të preambulës, përftohen nga "zbatimi kolektiv".

Në fakt Konventa është një instrument i gjallë që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të sotme, pavarrësisht se është rrënjosur fort në praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih, *inter alia*, vendimin *Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 25 prill 1978, seritë A, nr. 26, fq. 15-16, paragrafi 31). Një qasje e tillë, sipas mendimit të Gjykatës, nuk kufizohet vetëm te dispozitat thelbësore të Konventës, por zbatohet edhe për ato dispozita, të tilla si nenet 25 dhe 46 (Neni 25, Neni 46), të cilat rregullojnë funksionimin e mekanizmit së zbatimit të Konventës. Për pasojë, këto dispozita nuk mund të interpretohen vetëm në përputhje me qëllimet e autorëve të tyre, të shprehura më shumë se dyzet vjet më parë.

Duke marrë parasysh karakterin e Konventës, kuptimin e zakonshëm të Nenit 25 dhe 46 (Neni 25, Neni 46) në kontekstin e tyre dhe në dritën e objektit,e qëllimit të tyre, si dhe të praktikës së Palëve Kontraktuese, **Gjykata arrin në përfundimin se kufizimet *ratione loci* të lidhura me Nenin 25 dhe Nenin 46 të Turqisë (Neni 25, Neni 46) janë të pavlefshme.**"

[25] *Juridiksioni ratione temporis, ose juridiksioni i përkohshëm, i referohet juridiksionit të një gjykate mbi një masë të caktuar në lidhje me kalimin e kohës.*
[26] *Çështja nr. 15318/89, vendim (kundërshtimi paraprak), datë 23/03/1995, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57920*

Lista e pyetjeve

- Përkufizoni detyrimin e Palëve të Larta Kontraktuese, bazuar në Nenin 1 të KEDNJ-së.
- Përkufizoni detyrimin e shteteve anëtare, bazuar në Nenin 46 të Konventës.
- Identifikoni dhe diskutoni detyrimin e shtetit të paditur, të ngritur në bazë të 1 dhe Nenin 46 të Konventës, në shembujt e përmendur më sipër.

Rekomandohet për lexim

- Rezolutat
- Çështja "*Loizidou kundër Turkey"* [Dh(2003)174 (Rezolutë e ndërmjetme)]
- Çështja "Loizidou kundër Turkey" [Dh(2003)191]
- Çështja "Loizidou kundër Turkey" [Dh(2003)190]
- Çështja "Loizidou kundër Turkey" [Dh (2001) 80 (Rezolutë e ndërmjetme)]
- Çështja "Loizidou kundër Turkey" [Dh (2000) 105]

1.1. Kompensimi i drejtë

Detyrimet që rrjedhin nga vendimet e Gjykatës përmblidhen në tri kategori të mëdha: kompensimi i drejtë, masat individuale dhe masat e përgjithshme. Kompensimi i drejtë vendoset nga Gjykata në bazë të Nenit 41 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë: "Nëse Gjykata konstaton se ka shkelje të Konventës, ose të protokolleve të saj, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon vetëm kompensim të pjesshëm, Gjykata, nëse e sheh të nevojshme, siguron kompensim të drejtë për palën e dëmtuar". Kriteret për përcaktimin e shumës së kompensimit të drejtë varen shumë nga natyra e çështjes.[27]

Pas hyrjes në fuqi të Protokollit 14, datë 1 qershor 2010,[28] Komiteti i Ministrave mbikëqyr gjithashtu kushtet e zgjidhjeve me marrëveshje miqësore të përcaktuara nga Gjykata (Neni 39 i Konventës), duke përfshirë edhe shumat, për të cilat shteti ka rënë dakord t'i paguajë ankuesit, sipas kushteve të marrëveshjes përkatëse.

Megjithatë, Gjykata mund të caktojë një masë për kompensimin e drejtë vetëm kur ajo vendos se një masë e tillë është "e drejtë" në rrethanat përkatëse, duke marrë parasysh tiparet specifike të çështjes në shqyrtim. Pra e drejta për "kompensim të drejtë" nuk është pasojë automatike e një konstatimi të GJEDNJ-ja se ka shkelje të një të drejte të garantuar nga KEDNJ-ja, ose nga ndonjëri prej protokolleve të saj. Për caktimin e masave të tilla, Gjykata udhehiqet nga parimi i subsidiaritetit, i cili ka si qëllim kryesor përcaktimin e detyrimeve që rrjedhin nga Neni 46 i Konventës. Për rrjedhojë, qëllimi parësor i Gjykatës për zbatimin e dispozitave të Nenit 41 është të vërë në lëvizje fillimisht mjetet vendase në dispozicion. Gjykata vendos të përdorë metodat e veta për përcaktimin e kompensimit pasuror dhe jopasuror, vetëm atëherë kur legjislacioni i brendshëm nuk ofron mjetet ligjore për ndreqjen ose korrigjimin e shkeljes. Për pasojë, përllogaritja e kompensimit të drejtë ndryshon nga njëra çështje në tjetrën, në varësi të rrethanave përkatëse.

Shembull. ***Në çështjen "Bajrami kundër Shqipërisë"***[29] Gjykata nuk bën lidhje shkak-pasojë ndërmjet shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar. Për pasojë, ajo e rrëzon pretendimin. Për sa u përket dëmeve jo-pasurore, Gjykata nuk sheh arsye për të dyshuar nëse ankuesi ka vuajtur ndonjë pasojë si rezultat i moszbatimit të vendimit përfundimtar për këtë çështje dhe shprehet se nuk jepet kompensimi i drejtë, thjesht për faktin e vetëm se Gjykata mjaftohet me gjetjen e shkeljes.

Shembull. ***Në çështjen "Tomasic kundër Kroacisë"***[30] në lidhje me dëmin jopasuror të kërkuar, Gjykata theksoi se kur ankuesi i drejtohet një mekanizmi të brendshëm efektiv të disponueshëm dhe kur është konstatuar shkelje e i është dhënë kompensim nga gjykatat vendase, por pavarësisht këtyre zhvillimeve ankuesi vijon të pretendojë se është "viktimë", atëherë shuma e dhënë, bazuar në Nenin 41, mund të jetë më e ulët sesa shumat që mund të ketë dhënë Gjykata në çështje të ngjashme. Në këtë rast, ankuesi duhet të marrë diferencën

[27] *Tryezë e rrumbullakët mbi rekomandimin (2008)2 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për kapacitetin e brendshëm efektiv për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, 15 nëntor 2011, Tiranë, Shqipëri*

[28] *http://www.coe.int/en/web/conventions/search-on-treaties/-/conventions/treaty/194*

[29] *Çështja nr. 35853/04, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 12 dhjetor 2006, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-78425*

[30] *Çështja nr. 21753/02, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 19 tetor 2006, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-77565*

e shumës që do t'i ishte dhënë nga Gjykata Kushtetuese dhe një shumë që nuk do të ishte menduar si shprehimisht e paarsyeshme, krahasuar me shumat e dhëna nga Gjykata. Gjykata është e mendimit se, në mungesë të mjeteve të brendshme efektive, në çështjen në fjalë ajo do të kishte dhënë sasinë 4,000 euro. Ajo konstatoi se ankuesi kishte marrë 600 euro nga Gjykata Kushtetuese, çfarë përbën përafërsisht 15 % të shumës që do t'i kishte dhënë Gjykata.

Shembull. ***Në çështjen "Paudicio kundër Italisë"***[31]Gjykata vërejti se gjykatat penale kishin përcaktuar me siguri të mjaftueshme se ankuesi kishte vuajtur dëme pasurore, për shkak të ndërtimeve të paligjshme të realizuara nga fqinjët e tij. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin se, në përputhje me vendimin e këtyre gjykatave, ankuesi mund të ngrejë padi përpara gjykatave vendase për të marrë kompensim, Gjykata është e mendimit se nuk është me vend që të jepet një vendim për kompensim për dëme pasurore.

Shembull. *Në çështjen "Cochiarella kundër Italisë"*[32] Gjykata dëshmon se "sasia të cilën ajo mund të japë për kompensime jopasurore mund të jetë më pak sesa ajo që përcaktohet në praktikën e saj gjyqësore, sepse për ankuesin është marrë vendim nga një gjykatë vendase, që ka gjetur shkelje në nivelin vendas dhe ky (ankuesi) ka marrë kompensim përmes përdorimit të një mjeti efektiv të brendshëm. Prania e një mjeti të brëndshëm juridik përbën thelbin e parimit të subsidiaritetit, i mishëruar ky në Konventë, nisur nga fakti se ky mjet efektiv është më pranë dhe më i lehtë për t'u aksesuar sesa ankimi përpara Gjykatës, është proces më i shpejtë dhe realizohet në gjuhën amtare të ankuesit. Për pasojë, ai ofron përparësi, të cilat duhet të merren parasysh.

Megjithatë, Gjykata është e mendimit se kur ankuesi ende pretendon të jetë "viktimë", pas përdorimit të mjetit efektiv të brendshëm, ai ose ajo duhet të marrë diferencën ndërmjet shumës së marrë nga gjykata e apelit dhe shumës që do të ishte konsideruar si shprehimisht e paarsyeshme, krahasuar me shumën që jepet nga Gjykata, nëse shuma do të ishte dhënë nga gjykata e apelit dhe do të ishte dhënë pa vonesa.

Ankuesit duhet të marrin një shumë për kompensimin për të gjitha fazat e proceseve gjyqësore, të cilat mund të mos jenë marrë parasysh nga gjykatat vendase gjatë periudhës së referimit, kur ata nuk e kthejnë më dot mbrapsht çështjen përpara gjykatës së apelit, duke aplikuar ndryshimin e pozicionit të miratuar nga Gjykata e Kasacionit më 26 janar 2004, ose nëse kohëzgjatja e mbetur në vetvete nuk do të ishte e mjaftueshme për t'u konsideruar si veprim që çon në shkelje të dytë në lidhje me të njëjtat procese gjyqësore.

Së fundmi, fakti që ankuesit, i cili është përpjekur të përdorë mjetin e ri efektiv ligjor, përmes ankimit në gjykatën e apelit pas depozitimit të ankesës te Komisioni, më pas i është dashur të përballet me një vonesë të mëtejshme gjatë ushtrimit të mjetit të brëndshëm ligjor, ndërsa priste pagimin e një shume nga shteti, çon në një shkelje tjetër të dytë çfarë e bën qeverinë përgjegjëse para GJEDNJ-së, t'i paguajë ankuesit një sasi tjetër shume në lidhje me këto muaj frustrimi."

[31] *Çështja nr. 77606/01, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 24/05/2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-80618*

[32] *Çështja nr. 64886/01, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 29/03/2006, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-72929*

Lista e pyetjeve

- Identifikoni llojin e detyrimeve të palës paditëse, në bazë të Nenit 46.2 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përmes një shembulli.
- Përcaktoni detyrimin e Palës së Lartë Nënshkruese, në bazë të Nenit 41 të Konventës.
- Diskutoni kriteret për përcaktimin e vendimit për kompensim të drejtë në shembujt e përmendur më sipër.

Rekomandohet per lexim

- Vendimi "Bajrami kundër Shqipërisë";
- Vendimi "Tomasic kundër Kroacisë";
- Vendimi "Paudicio kundër Italisë";
- Vendimi "Cochiarella kundër Italisë";
- Rezolutat DH(1992)26, (1995)82 dhe (1994)26; rezolutat e ndërmjetme ResDH(2000)135, ResDH(2005)114ResDH(2007)2 dhe CM/ResDH(2009)42;
- Rezoluta e ndërmjetme CM/ResDH(2010)83 për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtve të Njeriut, Ben Khemais kundër Italisë;
- Rezoluta 1226 (2000) për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja, datë 28 shtator 2000;
- Konferenca e Nivelit të Lartë për të Ardhmen e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Deklarata e Interlaken-it, 19 shkurt, mund ta gjeni në adresën: 2010.www.eda.admin.ch/etc/medialib/downloads/edazen/topics/europa/euroc.Par.0133.File.tmp/final_en.pdfDoc. 12455 20 December 2010;
- Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, raporti nr. 1 i të drejtave të njeriut për çështjet ligjore dhe të drejtat e njeriut: Z. Christos POURGOURIDES, Qipro, Grupi i Partisë Popullore Europiane.

1.2. Masat individuale jo-pasurore

Nëse vendimi i GJEDNJ-së i ngarkon shtetit të paditur një detyrim ligjor, bazuar në Nenin 46 të Konventës, për t'i dhënë fund shkeljes, synohet të ofrohet kompensim për ankuesin, në mënyrë të tillë që ta rikthejë situatën në gjendjen përpara shkeljes, për aq sa është e mundur. Në këtë kuadër, Neni 41 i Konventës mbulon vetëm dhënien e kompensimit të drejtë, kur ligji vendas lejon kompensim të pjesshëm, ose jo. Për rrjedhojë, *inter alia*, rezulton se kur Gjykata konstaton në një vendim shkelje të Konventës, ose të protokolleve të saj, kjo e ngarkon shtetin e paditur me detyrimin ligjor që jo vetëm t'u paguajë personave të përfshirë shumat përkatëse për mbulimin e kompensimit të drejtë, por edhe të zgjedhë, subjekt i mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është e nevojshme, individuale që duhet të miratohen në rendin e saj të brendshëm ligjor. Këto masa synojnë t'u japin fund shkeljeve të konstatuara nga Gjykata dhe të ofrojnë kompensim të mundshëm për pasojat e tij, në mënyrë të tillë që të rikthehet situata që ekzistonte para shkeljes sa më shumë të jetë e mundur[33]. Në varësi të rrethanave të çështjes, Palëve të Larta Kontraktuese mund t'u kërkohet që të miratojnë masa individuale jo-pasurore për të korrigjuar situatën e shkaktuar nga shkelja, siç është rihapja e procedurave gjyqësore vendase. Nëse nuk mund të rihapen procedurat e brendshme, mund të jetë i mjaftueshëm rigjykimi i tyre. Zgjedhja për rigjykimin e çështjes varet nga sistemet e brendshme. Në të drejtën penale mund të miratohen një sërë masash individuale nga ana e shtetit përgjegjës për të ofruar kompensim. Këtu mund të përfshihen: një marrëveshje për të mos zbatuar masën e brendshme në fjalë, përfshirë këtu edhe gjykimin, korrigjimin e dosjeve penale, pezullimin e ekzekutimit të dënimit, mëshirimin dhe zvogëlimin e dënimit, faljen dhe lirimin e pakushtëzuar të personit të dënuar.

Shembull. ***(Neni 41 i Konventës) "Çështja Gjonboçari kundër Shqipërisë"***[34]ka të bëjë me një problem strukturor sa i takon mosekzekutimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave të brendshme si dhe vendimet administrative lidhur me të drejtën e ankuesve për kthim ose kompensim prone (qoftë pasuror, ose në natyrë) për pronat e shtetëzuara gjatë regjimit komunist (shkelje të Nenit 6§1 dhe Nenit 1 të Protokollit nr. 1). Në këtë aspekt u konstatua mungesa e mjeteve efektive (shkelje e Nenit 13 në lidhje me Nenin 6§1). Gjykata vëren se nuk vihet në diskutim detyrimi i mbetur pezull i shtetit për të zbatuar vendimin e datës 6 mars të vitit 2003. Për pasojë, ankuesit kanë ende të drejtë të ushtrojnë të drejtat e pronësisë mbi parcelën e tokës së përcaktuar në vendim. Gjykata rikujton se forma më e përshtatshme e kompensimit, lidhur me një shkelje të Nenit 6, është që ankuesit t'i sigurohet, për aq sa është e mundur, kthimi në pozitën e mëparshme nëse nuk do të ishin anashkaluar dispozitat e Nenit 6. E njëjta logjikë aplikohet edhe për çështjen në shqyrtim, veçanërisht në kuadrin e shkeljeve të konstatuara dhe të gjetjeve të Gjykatës në vendime të tjera të lidhura me Shqipërinë. **Për pasojë, ajo është e mendimit se qeveria duhet të sigurojë, përmes mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatave të brendshme. Në këtë respekt, si masë individuale jo-pasurore, është kërkuar informacion lidhur me realizimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.[35]**

[33] ShihIlaşcu and Others v. Moldova and Russia [GC], no. 48787/99, § 487, ECHR 2004-VII; Assanidze v. Georgia

[34] *Çështja nr.10508/02, ECtHR Judgment (Merits and Just Satisfaction),datë 23 tetor 2007,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-82863*

[35] *http://hudoc.exec.coe.int/ENG#{%22EXECIdentifier%22:[%22DH-DD(2012)1031E%22]}*

Shembull. ***(Neni 41 i Konventës) "Çështja Çaush Driza kundër Shqipërisë"***[36] ka të bëjë me dështimin e autoriteteve të brendshme për të zbatuar një vendim të brendshëm të formës së prerë, i cili i njohu ankuesit të drejtën për të marrë kompensim në natyrë. Kjo gjetje u konstatua si shkelje e Nenit 6§1 dhe Nenit 1 të Protokollit nr. 1, ashtu dhe në shkelje të Nenin 13 në lidhje me Nenin 6§1 të Konventës, për shkak të mungesës së mjeteve efektive. Bazuar në Nenin 41, Gjykata Europiane nuk dha as kompensim pasuror, dhe as kompensim jopasuror, për shkak të faktit se ankuesi nuk kishte arritur të respektonte afatet kohore të parashikuara në Nenin 60/2 të rregullores së Gjykatës. **Megjithatë, Gjykata urdhëroi, në bazë të Nenit 41, se ankuesi vazhdon të gëzojë të drejtën e kompensimit në natyrë, në përputhje me vendimin e Gjykatës së Apelit, në favor të tij dhe autoriteteve janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar zbatimin e këtij vendimi. Në këtë rast, si pjesë e masave individuale jo-pasurore, i është kërkuar autoriteteve informacion për datën e saktë kur ankuesi do të paisej me çertifikatën e pronësisë për truallin 1650 m²**[37]**.**

Në çështjet penale ***Xheraj, Caka, Berhani, Cani, Shkalla, Kaçiu & Kotorri, Haxhia kundër Shqipërisë***[38] Gjykata kërkoi si masa individuale jo-pasurore rihapjen e proceseve gjyqësore. Në këto çështje, Gjykata zbuloi një sërë parregullsish procedurale që mund t'i bënin proceset gjyqësore jo të rregullta. Në të njëjtën linjë me vendimin e Gjykatës së Lartë në rastin Xheraj, në shkurt dhe mars të vitit 2012, janë rihapur proceset gjyqësore në të gjitha çështjet e tjera të sipërcituara në bazë të gjetjeve të GJEDNJ-së, për shkelje të Konventës[39].

Shembull. ***(Neni 41 i Konventës) "Çështja Xheraj kundër Shqipërisë"***[40]ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së ankuesit për proces të rregullt ligjor dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të prishjes së vendimit përfundimtar që e shpallte ankuesin të pafajshëm për veprën e vrasjes (shkelje e Nenit 6§1). Në bazë të Nenit 41, Gjykata "nuk dallon asnjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar. Për sa u përket kërkesave për dëme jo-pasurore, Gjykata rikujtoi se shkelja e Konventës ishte shkaktuar nga shuarja e pafajësisë të ankuesit. Pavarësisht natyrës përfundimtare të vendimit që e deklaroi atë të pafajshëm, ai u dënua në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Gjykata u shpreh se ankuesit duhet t'i jetë shkaktuar shumë stres dhe frustrim si rezultat i shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit, të datës 14 dhjetor 1998. Megjithatë, Gjykata vë gjithashtu në dukje se ankuesi vazhdon t'u nënshtrohet pasojave të shfuqizimit të vendimit, të datës 14 dhjetor 1998. Ajo shprehet se forma më e përshtatshme e kompensimit për këtë situatë të vazhdueshme do të ishte konfirmimi nga autoritetet i vendimit përfundimtar të pafajësisë për ankuesin, (Vendimi datë 14 dhjetor 1998) dhe fshirja e efekteve të vendimit të dënimit të tij në shkelje të Konventës që nga kjo datë. Kjo ishte çështja e parë ku Gjykata vendosi rihapjen e proceseve gjyqësore për një çështje penale për Shqipërinë. Si pjesë e masave individuale jo-pasurore, dënimi i ankuesit u pezullua dhe, pas një ndryshimi të praktikës

[36] *Çështja nr.0810/05, vendimi (Merits and Just Satisfaction), datë 15 mars 2011, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-103927*

[37] *http://hudoc.exec.coe.int/ENG#{%22EXECDocumentTypeCollection%22:%22CEC%22],%22EXECIdentifier%22:[%222004-1%22]}*

[38] *Çështja nr.34783/06, vendim i GJEDNJ-së, datë 5.11.2013, i bërë përfundimtar më 5.02.2014*

[39] "Takimi i 1265-të (20-22 shtator 2016) (DH) – Plani i përditësuar i veprimit (06/07/2016) – Komunikimi nga Shqipëria për grupin e çështjeve ***Cakakundër Shqipërisë*** (Çështja nr. 44023/02) "*Anglais uniquement*".

[40] *Çështja nr.37959/02, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 29/07/2008, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-87964*

gjyqësore me vendim të Gjykatës Kushtetuese, u rihapën edhe procedurat penale nga Gjykata e Lartë. Si pjesë e procesit, Gjykata e Lartë e deklaroi të pafajshëm ankuesin nga çdo akuzë dhe fshiu dosjen e tij penale nga regjistri i dënimeve duke marë vendimin të datës 7 mars 2012. Si pjesë e masave individuale jo-pasurore, autoritetet shqiptare tërhoqën gjithashtu edhe kërkesën për ekstradimin e ankuesit në Itali.

a. Lista e pyetjeve

- Përkufizoni detyrimin e shteteve anëtare për marrjen e masave individuale pasurorjo-pasurore, në bazë të Nenit 41 të Konventës.
- Bëni dallimin midis masave individuale pasurorjo-pasurore të rekomanduara nga Gjykata në shembujt e përmendur më sipër.

b. Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Gjonboçari kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Çaush Driza kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Xheraj kundër Shqipërisë*";
- Takimi i 1265-të (20-22 shtator 2016) (DH) – Plani i përditësuar i veprimit (06/07/2016) – Komunikimi nga Shqipëria për grupin e çështjeve *Caka kundër Shqipërisë* (Çështja nr. 44023/02) [*Anglais uniquement*]
- Takimi/*réunion* i 1128-të (DH), datë 29 nëntor -2 dhjetor *2011* – vendimi i çështjes nr. 2 / *Vendim i çështje37959/02s -Xheraj kundër Shqipërisë* /

1.3. Masat e përgjithshme

Detyrimi për parandalimin e përsëritjes së një shkeljeje është thelbësor për sistemin europian dhe dikton ndaj autoriteteve shtetërore detyrimin për të caktuar ndërmarjen e masave të përgjithshme. Masat e përgjithshme mund të nënkuptojnë ndryshime të legjislacionit të brendshëm ose ndryshime në praktikën gjyqësore vendase. Kjo ndodh kur Gjykata, në mënyrë të shprehur, ose të nënkuptuar, vë në pikëpyetje një dispozitë të caktuar të përgjithshme legjislative, ose kur shkeljet e një lloji të ngjashëm nuk mund të shmangen në të ardhmen pa u prezantuar më parë një ndryshim i tillë ligjor. Përveç kësaj, ka situata kur vetëm prania ose ekzistenca e legjislacionit të përgjithshëm në vetvete përbën shkelje të të drejtave individuale të ankuesit. Detyrimi në fjalë ka pasoja të menjëhershme, duke filluar që nga dita kur shpallet vendimi, dhe ka efekt të drejtpërdrejtë ndaj gjykatave si dhe dikton miratimin e masave të përkohshme për të shmangur gjetjet e reja të shkeljeve derisa reforma në legjislacionin e brëndshëm të ketë marrë efekt. Duhet gjithashtu të theksohet se çështja e masave të përgjithshme shpesh ngrihet kryesisht apo *ex officio* nga Komiteti i Ministrave, pavarësisht asaj që është shprehur në vendim. Çdo shtet anëtar ftohet të japë informacion lidhur me mënyrën sesi praktikohet në vendin e tij në lidhje me shkeljen e gjetur dhe masave të ndërmara për adresimin e saj përmes informimit të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Ky i fundit, nga ana e tij, i informon në mënyrë periodike të gjitha shtetet anëtare për praninë e praktikave të mira ekzistuese. Shpesh, thjesht vetëm përkthimi dhe shpërndarja e vendimeve të Gjykatës mund të shërbejë si masë e mjaftueshme për ekzekutimin e vendimeve.

Shembuj të praktikave të mira për ekzekutimin e masave të përgjithshme

a. Botimi, përkthimi dhe shpërndarja e materialeve mbi sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe trajnimi mbi sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut përmes mjeteve elektronike dhe në gjuhën (gjuhët) e vendit përkatës, si dhe zhvillimi i programeve të arsimit të lartë dhe trajnimit profesional në të drejtat e njeriut.

b. *Verifikimi i projektligjeve* të hartuara si në nivel ekzekutiv, ashtu edhe në nivel parlamentar. Ky proces mund të përfshijë, gjithashtu, edhe organe të pavarura për konsultim (ministrinë që e ka iniciuar projektligjin, Kancelarin, Ministrinë e Drejtësisë dhe/ose Ministrinë e Punëve të Jashtme). Në disa shtete anëtare, kur një projektligj i përcillet Parlamentit, ai duhet të shoqërohet me një relacion shpjegues të gjerë, shoqëruar nga një deklaratë formale përputhshmërie me Konventën. Përveç verifikimit nga ana e ekzekutivit, ekzaminimi kryhet edhe nga shërbimet ligjore të Parlamentit dhe/ose komisionet e ndryshme parlamentare. Këto konsultime mund të parashikohen në faza të ndryshme përgjatë procesit legjislativ. Po ashtu, shpesh parashikohet konsultimi opsional, ose i detyrueshëm, i organeve jogjyqësore, përgjegjëse në fushën e të drejtave të njeriut (Avokatët e Popullit, ose organizatat joqeveritare vendase ose ndërkombetare, institutet ose qendrat për të drejtat e njeriut, ose Dhoma e Avokatisë etj.). Ndonjëherë, "Komisionit të Venecias" mund t'i kërkohet të japë një mendim për përputhshmërinë e projektligjit me Konventën në lidhje me të drejtat e njeriut. Megjithatë, ky proces nuk e zëvendëson shqyrtimin e brendshëm të përputhshmërisë së legjislacionit me Konventën.

c. Verifikimi i ligjeve ekzistuese dhe praktikës administrative si rezultat i përvojës vendase në zbatimin e një ligji, ose rregulloreje, ose pas një gjykimi të ri të Gjykatës[41] (që zakonisht kryhet nga ministria që e inicion legjislacionin, agjencitë qeveritare, institucionet trajnuese, organet përgjegjëse të shtetit etj., në kuadër të debateve parlamentare, Avokatit të Popullit). Verifikimi mund të bëhet edhe në kuadrin e proceseve gjyqësore të paraqitura nga individë me kapacitet juridik për të vepruar, ose madje edhe nga organet shtetërore, personat ose organet që nuk preken drejtpërdrejt prej tyre (si, për shembull, para Gjykatës Kushtetuese).

Duke pasur parasysh statusin e mbikëqyrjes për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së në shtetet europiane, përgjithësisht problemet kryesore vazhdojnë të jenë: tejzgjatja e proceseve gjyqësore, moszbatimi në vazhdimësi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të brendshme (i përhapur në veçanti në Rusi dhe Ukrainë), shkaktimi keqtrajtimeve përfshirë ato me pasojë vdekjen nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe mungesa e hetimeve efektive për to (veçanërisht të dukshme në Rusi dhe Moldavi), si edhe ndalimi i paligjshëm ose i jashtëligjshëm (problem shqetësues veçanërisht në Moldavi, Poloni, Rusi dhe Ukrainë. Në disa shtete të tjera, *inter alia*, në Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgjia dhe Serbia, ka ende çështje që lidhen me mosrespektimin e standardeve të Konventës që kërkojnë adresim të plotë.

Shembull. *Në çështjen "Luli & të Tjerët kundër Shqipërisë"*[42] Gjykata kritikoi në veçanti dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhet proceset gjyqësore paralele përpara gjykatave të ndryshme për të njëjtën çështje dhe referimin e përsëritur të një çështjeje tek një nivel më i ulët juridiksioni (shkelje e Nenit 6 § 1). Në rastin konkret, Gjykata vërejti se kjo lloj shkeljeje po bëhej mangësi serioze në sistemin e brendshëm juridik në Shqipëri, gjë e cila kërkonte prezantimin e mjeteve të reja efektive.[43] Në përgjigje, autoritetet shqiptare ndërmorën reformën në drejtësi (për të cilën ishte përgjegjës një komitet i ekspertëve të nivelit të lartë, nën monitorimin e Komisionit Parlamentar për Reformën në Drejtësi), e cila ndër të tjera, konsistonte në një sërë ndryshimesh ligjore në[44] Kodin Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale si dhe të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.[45] Si rezultat i këtyre ndryshimeve ligjore janë rregulluar: (1) afatet ligjore dhe mjetet efektive për pretendimin e tejzgjatjes së proceseve gjyqësore, përfshirë edhe të drejtën për "të kërkuar kompensim" në rastet e shkeljeve, dhe (2) masa ndëshkuese për ata zyrtarë ose gjyqtarë, të cilët e shkelin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë këtë parim.

[41] *Në rastin e vendimit që ka të bëjë me të në mënyrë të drejtpërdrejtë, bazuar në Nenin 46, shteti është nën detyrimin e marrjes së masave të nevojshme për respektimin e vendimit.*

[42] *Çështja nr. 64480/09 64482/09 12874/10, vendim i GJEDNJ-së (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 1 prill 2014, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-142305*

[43] *"Takimi i 1273-të (dhjetor 2016) (DH) - H46-1 Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë (çështja nr. 64480/09) / 1273e réunion (décembre 2016) - Luli et autres c. Albanie (Requête n° 64480/09)"; "Takimi i 1273-të(6-8 dhjetor 2016) (DH) – plani i përditësuar i veprimit (20/10/2016) – Komunikimi nga Shqipëria në lidhje me grupin e çështjeve Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë (Çështja nr. 64480/09) [Anglais uniquement] "*

[44] *Ligji nr. 10052, datë 29.12.2008*

[45] *Ndryshimi i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese në Nenin 74, me synimin e bërjes më fleksibël të procedurave për arritjen e shumicës së kërkuar për panelin prej 9 anëtarësh për marrjen e vendimit në mbrojtje të së drejtës për t'ju drejtuar Gjykatës, në bazë të Nenit 6 të Konventës.*

Lista e pyetjeve

- Identifikoni masat e përgjithshme që duhet të ndërmarrë shteti shqiptar për parandalimin e shkeljes së konstatuar në vendimin "*Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*".
- Tregoni llojin e masave individuale të kërkuara për këtë çështje.
- Diskutoni efektet e mundshme që ka pasur ky gjykim në sistemin e brendshëm ligjor për parandalimin e shkeljeve të ngjashme.

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Luli & të Tjerët kundër Shqipërisë*";
- **(**CM/Rec(2004)5 Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për **verifikimin e përputhshmërisë** së projektligjeve**,** ligjeve ekzistuese dhe praktikës administrative me standardet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave**,** datë 12 maj 2004**,** në sesionin e 114-të)**;**

1.4. Procedura e mbikëqyrjes dhe statistika me rëndësi

Në varësi të rrethanave të çështjes, Komiteti i Ministrave (KM) kryen dy forma procedurash për mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, procedurën e zgjeruar ose procedurën standarde të monitorimit. Procedura e mbikëqyrjes së zgjeruar zbatohet në lloje të caktuara çështjesh, kur nevojitet marrja e masave urgjente individuale, ose të cilat mendohet se shkaktojnë probleme të mëdha strukturore, ose probleme komplekse, qoftë kur këto probleme janë vënë në dukje nga Gjykata, qoftë nga vetë KM-ja. Vendimet pilote kalojnë automatikisht nën procedurën me mbikëqyrje të zgjeruar. E njëjta gjë ndodh edhe me çështjet ndërshtetërore. Të gjitha çështjet e tjera ndjekin procedurën standarde të mbikëqyrjes. Kur mbikëqyrja e zgjeruar nuk konsiderohet më e nevojshme, çështjet transferohen tek kategoria e mbikëqyrjes standarde. Anasjelltas, çështjet nën mbikëqyrje standarde mund të transferohen për mbikëqyrje të zgjeruar, nëse kjo gjë konsiderohet e përshtatshme në varësi të rrethanave dhe zhvillimeve përkatëse.[46]

Sipas statistikave,[47] Shqipëria, si Palë e Lartë Kontraktuese, është nën procedurë mbikëqyrjeje për ekzekutimin e 52 vendimeve, 28[48] prej të cilave janë duke iu nënshtruar monitorimit me procedurë të zgjeruar dhe 22 po monitorohen sipas procedurës standarde. Përveç tyre, ka edhe dy çështje të reja që do t'i nënshtrohen procedurës së monitorimit. Numri i total i vendimeve mbi Shqipërinë, përfshirë çështjet e mbyllura, si dhe çështjet që janë aktualisht në procedurë mbikqyrje, është 65. Prej tyre, 11 vendime janë vendime për çështje të rëndësishme, ndërsa 38 janë vendime për çështje të përsëritura. Gjithashtu, ka pasur 9 çështje, të cilat janë mbyllur me anë të marrëveshjeve miqësore. Përpos të gjithave, Komiteti i Ministrave ka miratuar 13 rezoluta për mbylljen e procedurave të mbikqyrjes ndaj vendimeve për Shqipërinë.

Kryesisht, gjykimet nën mbikëqyrje për Shqipërinë ndahen në 5 kategori: (1) grupi Caka, i cili ka të bëjë me parregullsinë e proceseve gjyqësore; (2) grupi Driza dhe vendimi pilot për *Manushaqe Puton*, të cilat kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë që njohin kthimin e pronave; (3) grupi Dybeku dhe Grori, i cili ka të bëjë me kushtet e varfra dhe të paligjshme të vendeve të burgimit dhe/apo paraburgimit; (4) grupi *Luli dhe të Tjerët*, i cili ka të bëjë me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe mungesën e mjeteve efektive; (5) grupi Puto, i cili ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore në përgjithësi[49].

---

[46] *Çështja e parë që shpalos një problem të tillë strukturor, pavarësisht nëse është problem i rëndësishëm apo jo, quhet "çështje drejtuese". Çështjet e tjera që trajtojnë të njëjtin problem quhen "çështje të përsëritura".*

[47] *Raporti i 10-të vjetor i Komitetit të Ministrave mbi mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 2016.*

[48] *Gjonbocari dhe të Tjerët kundër Shqipërisë; Driza kundër Shqipërisë; Caka kundër Shqipërisë; Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Topallaj kundër Shqipërisë; Bushati dhe të Tjerët kundër Shqipërisë; Nuri kundër Shqipërisë; Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr. 1); Caush Driza kundër Shqipërisë; Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Cani kundër Shqipërisë; Eltari kundër Shqipërisë; Karagjozi dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Izet Haxhia kundër Shqipërisë; Delvina kundër Shqipërisë; Manushaqe Puto kundër Shqipërisë; Bici kundër Shqipërisë; Sharra kundër Shqipërisë; Luli kundër Shqipërisë; Metalla kundër Shqipërisë; Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë; Rista kundër Shqipërisë; Qerimi kundër Shqipërisë; Karagjozi dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Alicka dhe Vasha kundër Shqipërisë; Halimi dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë; Vrioni kundër Shqipërisë.*

[49] *Çështjet prekin Nenin 6(49), Nenin 6/1(43), Nenin13 (27), P1/1 (22)*

➢ Rast studimor "Kudla kundër Polonisë"[50]

Ankuesi në këtë çështje, shtetas polak, pretendonte, në mënyrë të veçantë, se: paraburgimi i tij ishte i paarsyeshëm; se nuk i ishte respektuar e drejta për "t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme"; se nuk ishte respektuar dhe se nuk kishte pasur asnjë mjet ligjor efektiv vendas për t'u ankuar për tejzgjatjen e procesit penal kundër tij.

Faktet. Ankuesi u arrestua në gusht të vitit 1991. Pasi iu refuzuan shumë kërkesa për lirim, urdhri i ndalimit u prish në qershor të vitit 1992, në bazë të një raporti psikiatrik, i cili deklaronte se ankuesi shfaqte tendenca të vazhdueshme vetëvrasëse. Ankuesi, më pas, nuk arriti të merrte pjesë në një seancë dëgjimore të çështjes kundër tij, në shkurt të vitit 1993, dhe nuk e dorëzoi brenda afatit të përcaktuar nga gjykata certifikatën mjekësore. Në këto rrethana, për të u lëshua një urdhër arresti. Ankuesi u arrestua në lidhje me veprën penale të trafikimit në tetor të vitit 1993 dhe u vendos në paraburgim. Megjithatë, kërkesa për lirim ishte refuzuar nga Gjykata e Rrethit në bazë të një raporti të zyrtarëve të burgjeve. Bashkë me të ishin refuzuar edhe disa kërkesa të mëtejshme, përpara se ai të dënohej në qershor të vitit 1995. Vendimi i vitit 1996 rrëzoi dënimin dhe urdhëroi rihapjen e çështjes në shkurt të vitit 1996. Në maj të vitit 1996 urdhri i paraburgimit u prish, me kusht që të paguhej garancia prej 10,000 zlotësh. Ankimet e tij në lidhje me shumën, në të cilat i referohej edhe rrezikut për vetëvrasje, rezultuan të pasuksesshme. Ai u lirua më në fund në tetor të vitit 1996, pasi u pagua garancia. Ai u dënua sërish në dhjetor të vitit 1998, dënimi i dhënë u zvogëlua në apel në tetor të vitit 1999, ndërsa në kohën e depozitimit të çështjes ishte ende në pritje të shqyrtimit të një ankimi kasacioni në Gjykatën e Lartë.

Neni 6 § 1 – Kohëzgjatja e apelimit apo rekursit duhen vlerësuar duke pasur parasysh tërësinë procedurave, dhe në mungesë të çdo prove që Gjykata e lartë ka dalë me një vendim, procedurat rezultojne se kanë zgjatur mbi 9 vjet, përfshirë edhe 7 vjet dhe 5 muaj nga data e njohjes të së drejtës për ankim nga Polonia. Kjo periudhë nuk mund të konsiderohet e arsyeshme.

Neni 13 – Në lidhje me këtë çështje, Gjykata u shpreh për herë të parë se ishte e nevojshme të shqyrtoheshin pretendimet sipas Nenit 13, kur ishin gjetur shkelje të Nenit 6. Karakteri subsidiar i mekanizmit së Konventës është shprehur qartësisht në Nenin 13 dhe Nenin 35 § 1, ku Neni 13 i referohet shprehimisht detyrimit të drejtpërdrejtë të shteteve për të mbrojtur të drejtat e njeriut, kryesisht brenda sistemeve të tyre ligjore. Përderisa nuk ka një model mbizotërues, brenda Shteteve Kontraktuese, të mjeteve juridike për tejzgjatjen e procedurave, gjithsesi ekzistojnë shembuj që tregojnë se këto lloj mjetesh juridike mund të krijohen dhe të veprojnë në mënyrë efektive. Interpretimi i saktë i Nenit 13 është se ai garanton një mjet efektiv për një shkelje të supozuar të së drejtës për të marrë vendim për një çështje gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme. Në lidhje me rastin konkret, Qeveria parashtroi se tërësia e disa mjeteve juridike i plotësonte kërkesat e Nenit 13, por nuk dëshmoi sesi ankuesi mund të përfitonte duke u mbështetur në ato mjete. Nuk sugjerohej përshpejtimi i procesit kundër tij apo që ankuesi do të mund të siguronte kompensim të

[50]Po aty.

drejtë për vonesat e shkaktuara. Rrjedhimisht, masat e përmendura nuk plotësojnë standardin e "efektivitetit".

Vendimi i GJEDNJ-së. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte ndonjë mjet specifik ligjor, me anë të të cilit ankuesi mund të ankohej për kohëzgjatjen e procedurës. Megjithëse u parashtruan disa mjete juridike që mund të konsideroheshin në tërësi si një zgjidhje e përshtatshme, nuk u arrit të dëshmohej sesi ankuesi mund të kompensohej me anë të ushtrimit të tyre, qofshin këto mjetet parandaluese, apo kompensuese. Nuk sugjerohej se qoftë ndonjëri nga mjetet e përmendura, ose ndonjë kombinim i tyre, të përshpejtonte përcaktimin e akuzave kundër ankuesit, apo t'i siguronte atij kompensim të drejtë për vonesat e ndodhura. Për më tepër, nuk ishte sjellë asnjë shembull nga praktika e brëndshme ligjore për të dëshmuar se ushtrimi i ketyre mjeteve mund të sillte nje adresim të situatës për ankuesin.

Lista e pyetjeve

- Diskutoni natyrën e sugjerimeve të bëra nga Gjykata në gjykimin *Kudla kundër Polonisë*, cili është detyrimi i qeverisë polake bazuar në Nenin 46 të Konventës?
- Çfarë vendimi do të merrnit po të ishit gjyqtarë, nëse do të gjendeshit në situata të ngjashme ligjore?
- Identifikoni kriteret e aplikuara nga Gjykata për përcaktimin e shumës së kompensimit të drejtë (pasuror dhe jopasuror) në vendimet *Bajrami kundër Shqipërisë, Tomasic kundër Kroacisë, Paudicio kundër Italisë.*
- Diskutoni dallimet në kriteret e aplikuara për secilën çështje.
- Si i lexoni statistikat e prodhuara për Shqipërinë gjatë viteve 2001-2017?
- Çfarë tregon numri i Rezolutës së Komitetit të Ministrave për mbylljen e mbikëqyrjes në 13 çështje sa i përket aspektit të zbatimit të Konventës nga Shqipëria (a tregon ai për një nivel të mirë të zbatimit të KEDNJ-së në nivelin e brendshëm?

Rekomandohet per tu lexuar:

- Vendimet për çështjes *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, vendim (themel dhe kompensimi i drejtë)18/11/2004, ka marrë formë të prerë më 30/03/ 2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22fulltext%22:[%22qufaj%22ç,%22documentcollectionid2%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22itemid%22:[%22001-67514%22]}
- Rezoluta CM/ResDH(2011)86[1] Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen *Qufaj Co. sh.p.k kundër Shqipërisë**http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECIdentifier%22:[%22001-106810%22çÇ***
- CM/Rec(2008)2, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi **kapacitetin e brendshëm efektiv për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve** të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 6 shkurt 2008 në sesionin e 1017-të të tij)

- CM/Rec(2004)6Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për **përmirësimin e mjeteve të brendshme juridike** (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 maj 2004 në sesionin e 114-të të tij)
- GT-Ref.ECHR(2013)2 rev2, Masat për përmirësimin e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe vendimeve të Gjykatës, në diskutim në kuadër të grupit *ad hoc* të punës për reformën e sistemit të Konventës mbi të Drejtat e Njeriut, datës 2 maj 2013;
- CM/Res(2002)59, Rezoluta e Komitetit të Ministrave në lidhje me praktikën sa i përket zgjidhjeve miqësore (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 18 dhjetor 2002 në mbledhjen e 822-të të Zëvendësministrave);
- CM/Res(2002)58, Rezoluta e Komitetit të Ministrave për botimin dhe shpërndarjen e jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 18 dhjetor 2002 në mbledhjen e 822-të të Zëvendësministrave)
- CM/Rec(2010)12, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010 në mbledhjen e 1098-të të Zëvendësministrave)
- CM/Rec(2003)16, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 2003 në mbledhjen e 851 të Zëvendësministrave)
- CM/Rec(2003)17, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi zbatimin (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 2003 në mbledhjen e 851 të Zëvendësministrave) Komisioni Europian për Efikasitetin e Drejtësisë (website), A good practice guide on Structural measures to improve the functioning of civil and administrative justice

Pjesa C. Aktorë të tjerë të përfshirë në zbatimin e Konventës

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së është proces i komplikuar, i cili përfshin, përveç Komitetit të Ministrave, edhe aktorë të tjerë, të cilët luajnë rol të rëndësishëm, të tillë si: Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, autoritetet vendase, gjykatat vendase, duke mos përjashtuar as ndikimin e ndërsjellë me gjykatat e tjera europiane, siç është Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED-ja) në Luksemburg. Megjithatë, roli bazë për mbikëqyrjen e procesit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së i është caktuar Komitetit të Ministrave.

Shembull. Në çështjen "*Von Hannover kundër Gjermanisë"(2)*,[51] Gjykata konstatoi qysh në fillim se nuk është detyrë e saj, në çështjen në fjalë, të shqyrtojë nëse Gjermania i ka përmbushur ose jo detyrimet e saj, bazuar në Nenin 46 të Konventës lidhur me ekzekutimin e vendimit *Von Hannover* (1), të dhënë nga Gjykata në vitin 2004, pasi kjo detyrë i përket Komitetit të Ministrave.

1. Roli i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve të saj

Komiteti i Ministrave, nga ana tjetër, e ka miratuar rolin e GJEDNJ-së lidhur me procesin e ekzekutimit, duke e konsideruar praktikën gjyqësore të Gjykatës si një mjet udhëzues për shtetet. Konkretisht, Komiteti i Ministrave, në rezolutën Res (2004)3[52], e ftoi GJEDNJ-në "të identifikojë, në vendimet që konstatojnë shkelje të Konventës, çfarë konsiderohet si problem sistematik themelor dhe burimin e këtij problemi, sidomos kur ky problem ka të ngjarë të shkaktojë aplikime të shumta, duke synuar të ndihmojë shtetet në gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe Komitetin e Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve". Përveç kësaj, më vonë, Komiteti i Ministrave theksoi se "praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ..., veçanërisht gjykimet e saj pilot, sigurojnë një guidë të rëndësishme dhe përftojnë udhëzime të rëndësishme për shtetet anëtare në këtë drejtim".[53]Mbi të gjitha, Neni 46, i ndryshuar me Protokollin nr. 14[54], shprehimisht pranon faktin se Gjykata ka një rol të caktuar në procesin e ekzekutimit.

Antônio Augusto Cançado Trindade thotë:[55]

"... Juridiksioni përfshin autoritetin për të administruar drejtësinë; ai nuk kufizohet vetëm tek deklarimi i ligjit, por përfshin edhe monitorimin se sa është pranuar në lidhje me atë që është vendosur. ... Monitorimi i zbatimit të vendimeve nga ana e shteteve në përputhje të plotë me atë cfarë është vendosur përbën njërin prej elementeve që lidhet me juridiksionin. ... Adresimi i situatave në përputhje me atë cfarë ka urdhëruar Gjykata në vendimet e saj përbën materializim të drejtësisë për çështjen specifike dhe, në fund të fundit, të juridiksionit.

[51] *Çështja nr.40660/08 60641/08, vendimi (themeli dhe kompensimi i drejtë) i datës 7 shkurt 02/2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-109029,*

[52] *Rezoluta Res(2004)3 e Komitetit të Ministrave për vendime të cilat identifikojnë një problem sistematik kryesor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 maj 2004, në sesionin e tij të 114-të);*

[53] *Rekomandimi Rec(2010)3 mbi "mjetet efektive për tejzgjatjen e proceseve".*

[54] *http://www.echr.coe.int/Documents/Library_Collection_P14_ETS194E_ENG.pdf*

[55] "Dialog ndërmjet gjyqtarëve, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, 2014".

Vetë Gjykata e ka pranuar juridiksionin e vet për të nxjerrë rekomandime për shtetet e paditura në vendimet e saj, duke u mbështetur në Nenin 46 dhe Nenin 32 të Konventës[56]. Me fjalë të tjera, ekziston një bazë e shëndoshë ligjore, (*një bazë e Konventës dhe një bazë zakonore*), për sa i përket juridiksionit të Gjykatës për t'u parashtruar shteteve përgjegjëse masat që duhet të ndërmarrin për të siguruar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës.

Shembull. N*ë çështjen "Manushaqe Puto kundër Shqipërisë"*[57] GJEDNJ-ja pati rastin të theksonte se, "Bazuar në Nenin 19[58] të Konventës, ajo ka juridiksion për të "siguruar" mbikqyrjen e angazhimeve të ndërmarra nga shtetet në bazë të Konventës. Në përputhje me doktrinën e "kompetencave të nënkuptuara", kjo nënkupton që Gjykata e ka kompetencën për të treguar masat e përgjithshme në funksion të këtij roli, nëse ajo e shikon të nevojshme."

Megjithatë, në varësi të llojit të vendimit, Gjykata angazhohet në mënyra të ndryshme në identifikimin e masave individuale, ose të përgjithshme, të nevojshme për ekzekutimin.

- Së pari, në disa vendime, Gjykata mjaftohet vetëm me identifikimin e llojit të masës së kërkuar për ekzekutimin e duhur të vendimeve të saj, të cilat zakonisht janë masa të përgjithshme, të një natyre legjislative, administrative ose tjetër.
- Së dyti, në disa vendime, Gjykata i lë shtetit të paditur disa opsione, duke i siguruar atij materiale mbi të drejtën krahasuese që mund të shërbejnë si udhëzues për zgjidhjen që do të bëjë.
- Së treti, në vendimet të tjera Gjykata diskuton dhe analizon politikat e brendshme, të kushteve të paraburgimit, etj.
- Së katërti, në disa vendime Gjykata mund të kërkojë ndërmarrjen e masave individuale.
- Së fundi, në disa raste të tjera Gjykata kërkon si ndërmarjen e masave individuale ashtu dhe masave të përgjithshme.

[56] *Neni 32–"Juridiksioni i Gjykatës 1. Juridiksioni i Gjykatës shtrihet në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe aplikimin e Konventës dhe protokolleve të saj, të cilat i referohen asaj siç parashikohet në nenet 33, 34, 46 dhe 47.2. Në rast të një mosmarrëveshje lidhur me faktin nëse ka juridiksion Gjykata, është Gjykata ajo që vendos.*

[57] *Çështja nr.604/07 34770/09 43628/07, vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), më 31/07/2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-112529*

[58] *Neni 19 –"për të siguruar respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga Shtetet e Larta Kontraktuese në Konventë dhe në protokollet e tyre, do të ngrihet një Gjykatë Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më poshtë "Gjykata". Ajo do të funksionojë në baza të përhershme."*

Shembull. ***Në grupin e çështjeve Caka***[59]*kundër Shqipërisë*, miratimi i një mase individuale për rihapjen e procesit penal në nivel vendas, kërkoi së pari miratimin e një mase legjislative, në mënyrë që të sigurohej baza ligjore për një veprim të tillë në ligjin e brendshëm. Në këtë drejtim, Gjykata bëri rekomandime "të buta", të cilat i lanë shtetit të paditur hapësirë të konsiderueshme për të zgjedhur masat që duheshin marrë. Në raste të tilla shtetet gëzojnë një prag të gjerë vlerësimi për zgjidhjen praktike. Këtu, subsidiariteti hyn në lojë në dy aspekte. Nga njëra anë, subsidiariteti e dekurajon Gjykatën që t'u tregojë gjykatave vendase një rrugëdalje nga ky problem. Anasjelltas, subsidiariteti kërkon që Gjykata të analizojë dhe të kuptojë se si lindin shkeljet e të drejtave të njeriut në kuadrin e legjislacionit vendas.

Shembull. Gjykimi pilot në çështjen "Manushaqe Puto kundër Shqipërisë"[60] shërben si shëmbull për të shpjeguar natyrën detyruese të rekomandimeve të GJEDNJ-së, të cilat "synojnë" për marjen e masa konkrete dhe janë relativisht preçize. Në këtë rast, Gjykata rekomandoi masat e përgjithshme dhe/ose individuale që duheshin marë nga autoritetet shqiptare, të cilat paraqiten në pjesën operative si veçanërisht detyruese[61]. Në këtë rast, autoritetet shqiptare përgjegjëse kishin pak ose aspak liri zgjedhjeje për zgjidhjet praktike të situatës së evidentuar.

Gjykata duhet të jetë e informuar mbi kompleksitetin që ekziston në raportin në mes gjykatave të brendshme dhe ligjit vendas, në mënyrë që të vlerësojë dhe interpretojë në mënyrë racionale Konventën në vendimet e saj. Gjithsesi, detyra e vetme e Gjykatës është të interpretojë dhe të zbatojë Konventën, duke qenë kompetente për nxjerrjen e rekomandimeve sipas Nenit 46, por jo të japë udhëzime. Nga ana tjetër, është në interes të vetë gjykatave vendase që GJEDNJ-ja të sugjerojë rekomandime në vendimet e saj dhe ta zgjerojë këtë praktikë, në vend që ta reduktojë atë.

Duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, rezulton se mbi 150 vendime i referohen Nenit 46 të Konventës dhe kanë të bëjnë me procesin e ekzekutimit. Njëzet e tre prej këtyre gjykimeve janë gjykimet e ashtuquajtura "pilote", ose "gjysmëpilote", të cilat lidhen me probleme strukturore. Ekzistojnë gjithashtu dhjetëra gjykime "të zakonshme" që tregojnë masat e ekzekutimit të cilat bazohen shprehimisht në Nenin 46 të Konventës, dhe që evidentojnë probleme që nuk janë thjesht strukturore, por janë dhe sistematike.

Lista e pyetjeve

- Diskutoni juridiksionin e Gjykatës për bërjen e rekomandimeve për shtetin e paditur në vendimet e tij mbi mënyrën e korrigjimit të shkeljes.
- Dalloni 4 format e qasjes së ndërmarrë nga GJEDNJ-ja për nxjerrjen e rekomandimeve të saj në vendime, duke përdorur si shembull vendimin e Gjykatës në çështjen "*Caka kundër Shqipërisë"* dhe "*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë"*.

[59] *Çështja nr.44023/02,vendimi (themeli dhe kompensimi i drejtë), i datës 8 dhjetor 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-96033*
[60] *Shih shënimin 63.*
[61] *Shih shënimin 63.*

Rekomandohet per lexim

- Rezoluta *Res(2004)3* e Komitetit të Ministrave për vendimet që nxjerrin në pah një problem sistematik të rëndësishëm *(miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 maj 2004, në sesionin e tij të 114-të);*
- CM/Rec(2010)3, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi mjetet efektive për tejzgjatjen e proceseve gjyqësore (miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 24 shkurt 2010, në sesionin e 1077-të të tij);
- Dialogu ndërmjet gjyqtarëve, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, 2014";
- Vendimi pilot i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen *Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*.

2. Roli i autoriteteve vendase në ekzekutimin e vendimeve

Qeveritë luajnë një *rol parësor* në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Janë Qeveritë që i raportojnë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës rreth masave që ndermerren në këtë respekt. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës kërkon një vlerësim gjithëpërfshirës, si të doktrinës ekzistuese kushtetuese ashtu dhe precedentin, jurisprudencën dhe marrëdhëniet me drejtuesit ekzekutivë, ligjvënësit dhe gjyqtarët e tjerë. Mund të ndodhë po ashtu që edhe individët, avokatët dhe grupet t'i drejtohen Konventës në çështje përpara gjykatave vendasë si pjesë e një strategjie për të ndryshuar ligjin dhe politikën vendase.

Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1787 (2011) "Mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut" i nxit fuqishëm parlamentet vendase që të prezantojnë mekanizma dhe procedura specifike për mbikëqyrjen efektive parlamentare të zbatimit të vendimeve të Gjykatës.

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec (2008)2 mbi kapacitetin e brendshëm efikas për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i fton shtetet anëtare të sigurojnë që një organ vendimmarrës në nivelin më të lartë politik të marrë përgjegjësi të plota për bashkërendimin e të gjitha aspekteve të procesit të zbatimit të brendshëm. Ky rekomandim i është drejtuar autoriteteve shtetërore në përgjithësi por edhe kryetarëve të delegacioneve parlamentare vendase, së bashku, nëse do të jetë e nevojshme, me ministrat përkatës të shteteve për zgjidhjen e problemeve thelbësore të theksuara.
Shembull. Në Shqipëri, procesi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së ka përfshirë, ndër të tjera, Parlamentin e Republikës së Shqipërisë[62], Prokurorinë, Avokatin e Popullit dhe organet e tjera ekzekutive që luajnë rol për zbatimin e Konventës në nivel vendas.

a. Lista e pyetjeve

- Diskutoni se si mund të përfshihet qeveria dhe autoritetet shtetërore në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së.
- Cili mund të jetë mekanizmi më i mirë që mund të prezantohet për të siguruar zbatimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës?

b. Rekomandohet per lexim

- Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1787 (2011) për Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut
- Rekomandimi CM / Rec (2008) 2 për kapacitetin e brendshëm efikas për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

[62] *Shih pikën 82.*

[62] *Duke iu referuar vendimit të GJEDNJ-së për çështjen "Mullai kundër Shqipërisë", dhe vendimit nr. 29, datë 12.06.2006, të marrë për qartësimin e procedurave për miratimin dhe anulimin e lejeve të ndërtimit sipas planifikimit urban të territorit. Parlamenti ka miratuar një ligj të ri, i cili ka hyrë në fuqi më 30.09.2011, duke zëvendësuar ligjin Nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, i cili ka shfuqizuar tërësisht ligjin nr. 8405 "Për planifikimin urban", duke synuar modifikimin e procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit, etj.*

3. Roli i gjykatave vendase dhe i gjyqtarëve në zbatimin e KEDNJ-së në nivelin vendas

Bazuar në të drejtën ndërkombëtare, njohja e juridiksionit të GJEDNJ-së nënkupton ekzekutimin spontan, në mirëbesim, të vendimeve të saj. Pikërisht për këtë arsye, nenet 41 dhe 46.1 synojnë të kontrollojnë ato situata kur një shtet nuk është në gjendje t'i japë fuqi një vendimi për arsye praktike apo për arsye të diktuara nga ligji i brendshëm. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e Konventës dhe vendimeve GJEDNJ-së i takon qeverive, ndërsa gjykatat vendase kontribuojnë vetëm *në mënyrë të indirekte*. Në këtë aspekt, roli i gjykatave vendase është i domosdoshëm, me kusht që: (a) individët të kenë mundësi të depozitojnë ankime në gjykatat vendase kundër çdo akti të autoritetit publik; (b) gjyqtarët të jenë të detyruar të identifikojnë ligjet parlamentare që bien ndesh me të drejtat dhe t'i interpretojnë ato në dritën e Konventës, me qëllim që të shmangin konfliktet sa herë që të jetë e mundur; (c) gjyqtarët të refuzojnë zbatimin e ligjeve që janë të papajtueshme me KEDNJ-në. Si rrjedhim, gjykatat vendase janë përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërkesave për mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut dhe për të shmangur penalizimin e Palës së Lartë Kontraktuese.

Shembull. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë (GJK) dhe Gjykata e Lartë luajnë rol për zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës dhe jurisprudencës së Gjykatës. Bazuar në gjetjet e Gjykatës në çështjen "*Qufaj kundër Shqipërisë*", GJK-ja e modifikoi praktikën e saj gjatë shqyrtimit të pretendimeve për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore. Në rastin Qufaj,[63] Gjykata konstatoi se:" *... Gjykata Kushtetuese e refuzoi ankesën e shoqërisë ankuese, duke deklaruar se "ankesa [nuk mund të merret parasysh sepse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore bie jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese]. Gjykata vëren se sistemi juridik shqiptar siguron një mjet juridik, në formën e ankimit për shkelje të procesit të rregullt ligjor, që është në teori në dispozicion të kompanisë kërkuese. Gjykata shprehet se rregullat për proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhej të ishin interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonin përdorimin e një mjeti efektiv për shkeljen e pretenduar, bazuar në Nenin 6§1 të Konventës. Prandaj, sipas mendimit të Gjykatës, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për trajtimin e ankimit të shoqërisë ankuese lidhur me mospërputhjen me vendimin përfundimtar, si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për proces të rregullt juridik".* Pas këtij vendimi, GJK-ja ka ndjekur një qasje të re në trajtimin e pretendimeve të kësaj natyre në çështjen "*Memishaj kundër Bashkisë së Tiranës*", ku ajo u shpreh se: "*organet shtetërore janë të detyruara të zbatojnë vendimet e gjykatës, të cilat janë të detyrueshme jo vetëm për palët, por edhe për trashëgimtarët e tyre, palët që i kanë hequr të drejtat e palëve, gjykatën që e ka lëshuar vendimin, dhe të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera."*

Parimet e mirëbesimit dhe të njohjes së ndërsjellë përbëjnë gurët e themelit të ndërtimit të një rendi juridik europian. Detyrimet që lindin ndaj një Palë të Lartë Kontraktuese, sipas Nenit 46 të Konventës, diktojnë jo vetëm detyrimin për të ndërmarrë masa individuale me efekt *inter-partes*, por gjithashtu për të ndërmarrë masa të përgjithshme që kanë efekt *erga omnes*. Në këtë aspekt, vendimet përmbajnë në tekstet e tyre parime të përgjithshme të cilat zbatohen *in concreto* për të gjitha palët dhe shtetet anëtare kërkohen të ndërmarrin një qasje pro-aktive dhe të përshtatin

[63] *Shih shënimin 53.*

legjislacionin dhe praktikën e tyre të brëndshme në përputhje me to. Si rrjedhojë, megjithëse vendimet e GJEDNJ-së nuk kanë në mënyrë *strictu sensu*, efekt *erga omnes*, shtetet nuk mund gjithsesi t'i shpërfillin parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Thënë shkurt, gjykatat vendase shqiptare duhet të respektojnë jo vetëm vendimet e GJEDNJ-së në lidhje me Shqipërinë, por edhe vendimet e tjera të GJEDNJ-së të lidhura me shtetet e tjera anëtare.

CM/Rec(2002)13 Rekomandimi i Komitetit të Ministrave i fton shtetet anëtare të botojnë dhe të shpërndajnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim që të sigurojnë që ato vendime që përbëjnë zhvillime konkrete në jurisprudencë, apo ato që kërkojnë masa të veçanta zbatimi nga ana e tyre si shtete të paditura, të botohen gjerësisht, nëpërmjet iniciativave shtetërore ose private, të plota, të përmbledhura, ose fragmente të tyre (së bashku me referencat përkatëse në tekstet origjinale) në gjuhën (gjuhët) e vendit, veçanërisht në fletoret zyrtare, buletinet e informacionit nga ministritë kompetente, revistat ligjore dhe mediat e tjera të përdorura në përgjithësi nga komuniteti ligjor, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, edhe faqet e internetit.

Deklarata e Konferencës së Interlakenit i fton shprehimisht shtetet "të marrin parasysh praktikën evolutive gjyqësore të Gjykatës, duke synuar gjithashtu nënvizimin e konkluzioneve që dalin nga një vendim që gjen një shkelje të Konventës nga një shtet tjetër, ku i njëjti problem parimisht ekziston edhe brenda sistemit të tyre ligjor".[64]

Rrjedhimisht, është e domosdoshme për shtetet që të rrisin shkëmbimet ndërmjet profesionistëve të së drejtës me anë të rrjeteve të ndryshme, nisur nga nevoja për njohjen e ndërsjellë të pasojave të vendimeve të dhëna nga gjykatat e brëndshme në nivelin vendas. Gjyqtarët vendas pritet të përmbushin rolet e tyre: a) për të siguruar përputhshmërinë e ligjeve vendase dhe praktikës gjyqësore me Konventën në shtetet përkatëse; b) për të ulur numrin e çështjeve të ndryshme të lidhura me Konventën në shtetet anëtare të detyruara prej saj; c) për të siguruar që legjislacioni dhe jurisprudenca e brendshme të respektojnë jurisprudencën e GJEDNJ-së; d) për të marrë parasysh siç duhet rekomandimet e Këshillit të Ministrave.[65]

Shembuj të vendime të gjykatave të brendshme shqiptare që i referohen praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në shtete të tjera anëtare:
(a) Gjykata Kushtetuese
- Vendimi nr. 38/2010 (barazia e armëve në proceset penale)
- Vendimi nr. 16/2006 (shkelja e barazisë së armëve në proceset gjyqësore të lidhura me rishikimin e rekursit vetëm në prani të prokurorit);
- Vendimi nr. 30/2010 (e drejta për t'u dëgjuar në gjykatë, lidhur me gjykimin në mungesë të të padituri);
- Vendimi nr.11/2009 (e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, lidhur me mungesën e juridiksionit të gjykatës për krimet e rënda);

[64] *Shih parimin e subsidiaritetit – pas Interlaken-it – Shënim nga Jurisconsult, f. 8 : http://www.echr.coe.int/Documents/2010_Interlaken_Follow-up_ENG.pdf*
[65] *Opinioni nr. 9 (2006) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE) për vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi rolin e gjyqtarëve vendasë për sigurimin e aplikimit efektiv të së drejtës ndërvendasvendase dhe evropiane.*

- Vendimi nr. 1/2017 (rishikimi i aktit të pronësisë);
- Vendimi nr. 43/2011 (rishikimi i aktit të pronësisë);
- Vendimi nr. 33/2005 (arsyetimi i vendimit lidhur me shkaqet e vendimit);
(b) Gjykata e Lartë: vendimi nr. 4, datë 6.12.2013;
(d) Gjykata e Rrethit Mirditë: vendimi nr.17, datë 23.01.2007 (përmendur në vendimin për çështjen *Ceka kundër Shqipërisë*);

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se zbatimi i KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës në nivelin vendas sugjeron që gjykatat e brendshme pritet të marrin një qasje pro-aktive. Kjo qasje nënkupton vlerësimin e nevojës për t'iu referuar praktikës gjyqësore të vendeve të tjera, bazuar në: (a) vlerën e interpretimit *res interpretata*; (b) ngjashmërinë e një problemi; (c) finalitetin dhe nivelin e autorizimit të një vendimi (vendimet e seksioneve të Gjykatës, vendimet e Dhomës së Madhe); (d) parandalimin e shkeljeve të ngjashme; (e) detyrimin e përgjithshëm për t'u pajtuar me Konventën (siç interpretohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së).

Shembull. ***Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 21/2013[66] i Federatës Ruse*** u kujton të gjitha gjykatave ruse për detyrimin që kanë për të ndjekur praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë edhe praktikën gjyqësore kundër shteteve të tjera palë në Konventë, gjë e cila, në këtë mënyrë, mishëron parimin e vlerës *erga omnes* të praktikës gjyqësore të Gjykatës. Në paragrafin 25, vendimi parashikon që: "*në mënyrë që të lexohen tekstet e vendimeve në gjuhën ruse të dhëna nga Gjykata Europiane si në lidhje me Federatën Ruse, edhe nga shtetet e tjera, të cilat janë palë në Konventë, gjykatat rekomandohen të përdorin, ndërmjet burimeve të tjera, sistemin e referimit të informacionit* Mezhdunarodnoye Pravo *(E drejta ndërkombëtare), të zhvilluar nga Gjykata e Lartë e Federatës Ruse e të instaluar në profilin e departamentit të sistemit automatik shtetëror* Pravosudiye *(Drejtësia), si dhe në bazën e të dhënave HUDOC të Gjykatës Europiane: http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng."*

Lista e pyetjeve

- Çfarë pritet nga gjykatat vendasvendase për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore?
- Si luajnë ato rol për zbatimin e KEDNJ-së?
- Çfarë qasjeje duhet të marrë një gjyqtar drejt një gjykimi të Gjykatës në një çështje për Shqipërinë?
- Çfarë qasjeje duhet të marrë një gjyqtar në lidhje me vendimet e gjykatave për vendet e tjera?
- Si do të vendosnit për shqyrtimin e një çështjeje nëse shihni se e gjeni përgjigjen në një vendim tjetër të gjykatës ndaj një shteti tjetër?
- Diskutoni qasjen e Gjykatës Kushtetuese drejt praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së kundër shteteve të tjera.

[66] *Vendim jogjyqësor i dhënë më 27 qershor 2013 në seancë plenare.*

Rekomandohet per lexim

- Vendimi *"Qufaj kundër Shqipërisë"*
- Vendimi *"Marini kundër Shqipërisë*"
- Vendimi "*Xheraj kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJK-së nr.6 / 2006 *"Memishaj kundër Bashkisë";*
- Vendimi i GJK-së nr. 12/2012 për çështjen Koliqi;
- Vendimi i GJK-së nr.20/2011;
- Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 21/2013[67] i Federatës Ruse
- Deklarata e Konferencës së Interlakenit
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për **botimin dhe shpërndarjen** në shtetet anëtare të tekstit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 18 dhjetor 2002 në sesionin e tij të 822-të);

[67] *Bëhet fjalë për vendim jogjyqësor, i dhënë më 27 qershor 2013, në panel plenar.*

4. Roli i Zyrës së Prokurorisë

Zyra e Prokurorit Publik luan rol qendror dhe thelbësor për ofrimin e sigurisë dhe të lirisë në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropë.[68] Kjo ritheksohet edhe nga sistemet vendase, megjithëse ato ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin, duke përfshirë vendndodhjen dhe marrëdhëniet e zyrës në lidhje me degët e tjera të qeverisjes, përgjegjësitë dhe kompetencat e saj brenda sistemit të drejtësisë penale (duke përfshirë funksionin e rojtarit, komponentin filtrues, d.m.th. përcaktimin e çështjeve që vijojnë më tej në sistemin e drejtësisë dhe që ndiqen penalisht me shpenzime publike), dhe rolin e saj në lidhje me gjykatat dhe sferat e tjera të administratës publike. Prokurorët luajnë rol të rëndësishëm në respektimin dhe përligjjen e të drejtave të njeriut, si të të dyshuarve, ashtu edhe të të akuzuarve dhe të viktimave.

Rekomandimi (2000)19 përcakton përgjegjësitë që kanë prokurorët gjatë kryerjes së detyrave të tyre: "Prokurorët duhet t'i kryejnë funksionet që u janë ngarkuar në mënyrë të rregullt, të paanshme dhe objektive; duhet të respektojnë dhe të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në KEDNJ; dhe duhet të kërkojnë të sigurojnë që sistemi i drejtësisë penale të veprojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ata kanë për detyrë të sigurojnë barazinë para ligjit dhe të jenë të vetëdijshëm për të gjitha rrethanat përkatëse përfshirë edhe ato që prekin të dyshuarin, pavarësisht nëse janë në avantazh apo në disavantazh të këtij të fundit. Dëshmia kundër të dyshuarve nuk duhet të parashtrohet nëse prokurorët e dinë, apo besojnë në baza të arsyeshme, sepse ajo është marrë nëpërmjet përdorimit të metodave që janë në kundërshtim me ligjin. Në rastet e dyshimit, prokurorët publikë duhet t'i kërkojnë gjykatës të vendosë për pranueshmërinë e provave të tilla. "

Përsa u përket proceseve penale, prokurorët kanë përgjegjësinë të sigurojnë që çdo proces penal, përfshirë edhe aspektet procedurale të tij, të jetë i natyrës akuzatore dhe të sigurojë barazinë e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes. Ky është një aspekt themelor i së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, Neni 6(1) i KEDNJ-së kërkon që autoritetet e prokurorisë t'i japin mbrojtjes, gjatë fazës së gjykimit, të gjitha provat përkatëse që kanë në posedim lidhur me çështjen, në favor ose kundër personit të akuzuar.

E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin parimin e barazisë së armëve, si edhe supozon parimin e procedurës akuzatore (kundërshtare). Ajo përfshin të drejtën për dhënien e plotë, në kohën e duhur, të të gjitha materialeve përkatëse që ka në posedim prokurori. Kjo nënkupton disponueshmërinë e të gjitha elementeve të provës dhe detyrimin nga prokurori, ose ndonjë autoriteti tjetër hetues, për të kërkuar dëshmi si për fajin, ashtu edhe për pafajësinë.

Prokurorët, pavarësisht rolit në hetime, duhet të sigurojnë që veprimet që kryejnë të jenë në përputhje me ligjin dhe, në veçanti, të respektojnë parimet e mëposhtme:

[68] Çështja është objekt i rekomandimit (2000)19 mbi rolin e prokurorisë në sistemin e drejtësisë penale. Më shumë informacion mund të gjendet në adresën: https://rm.coe.int/16804be55a, opinionit nr. 12 (2009) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE), dhe opinionit nr. 4 (2009) të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, i disponueshëm në adresën: https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1542177&Site=COE&direct=true and Opinion No.10 (2015) of the Consultative Council of European Prosecutors to the Committee of Ministers of the Council of Europe on the role of prosecutors in criminal investigations available at XXX

- barazinë përpara ligjit;
- paanshmërinë dhe pavarësinë e prokurorëve;
- të drejtën për t'iu drejtuar një avokati;
- të drejtën e mbrojtjes për marrjen e plotë të të gjithë materialeve përkatëse;
- prezumimin e pafajësisë;
- barazinë e palëve (armëve);
- pavarësinë e gjykatave;
- të drejtën e të pandehurit për proces të rregullt ligjor;

Respektimi i *prezumimit të pafajësisë* është i detyrueshëm jo vetëm për gjykatat, por edhe për të gjitha organet e tjera shtetërore. Prokurorët dhe organet hetuese duhet të shmangin dhënien e ndonjë deklarate, apo qëndrimi, që do të kontribuonte në shkeljen e këtij parimi.

Parimi *i barazisë së palëve* kërkon, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, që personi i cili është objekt hetimi, duhet të jetë në gjendje ta paraqesë çështjen e tij para një gjykate pa u vendosur në disavantazh substancial kundrejt palës kundërshtare. Për këtë arsye duhet të ruhet një ekuilibër i drejtë mes palëve, duke u lejuar atyre të diskutojnë çdo element të hetimit.

Respektimi *i parimit akuzator* në çështjet penale kërkon bërjen e dallimit midis fazës së hetimit dhe fazës së gjykimit. Lidhur me fazën e parë të hetimit, parimi akuzator nuk është absolut. Përkundrazi, është parashikimi i tij: ai përbëhet nga kërkesa për dëshmi, për të përcaktuar nëse ka arsye të mjaftueshme për të vazhduar me një aktakuzë dhe, gjatë kësaj faze, procedura mund të jetë konfidenciale[7].

Detyrimi për të kërkuar dhe për të mbajtur provat e fajësisë, ose të pafajësisë, duhet të interpretohet realisht bazuar në faktet e secilës çështje, si edhe duhet të vlerësohet rëndësia e provave. Dëshmitë relevante për fajin ose pafajësinë duhet, për aq sa është e nevojshme dhe praktike, të mbahen në përputhje me ligjin vendas, të paktën deri në përfundimin e procedurës. Fakti që provat nuk duhet të përdoren nga prokuroria, nuk e justifikojnë shkatërrimin ose mosdispo-nueshmërinë e tyre, ose shkatërrimin e shënimeve apo të dhënave në lidhje me to. Kur dëshmitë çojnë në krijimin e një mundësie të arsyeshme për kundërshtimin e çështjes së prokurorisë, ato duhet të ruhen.

Kur prokurori është në dijeni të materialeve që lidhen me çështjen e pafajësisë së të akuzuarit dhe/ose që mund ta ndihmojë materialisht mbrojtjen, ai duhet ta paraqesë këtë material. Nëse prokurori refuzon, ose nuk është në gjendje ta bëjë këtë, kjo mund të rezultojë në pafajësi ose në ndërprerjen e ndjekjes penale.

Shembull. ***Në çështjen "Laska & Lika kundër Shqipërisë"***[69] Gjykata vëren se "ankuesit u gjetën fajtorë, kryesisht mbështetur në fuqinë e dëshmive të dëshmitarëve okularë, të marra gjatë paradës së identifikimit. Ajo vëren se dëshmitë e dëshmitarëve okularë

[69] Çështja nr. 12315/04 17605/04 , Judgment (Merits and Just Satisfaction), 20/04/2010, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-98349

që vijnë nga identifikimi ishin provat kryesore ku u mbështet pozicioni i prokurorisë kundër ankuesve. Fillimisht, ankuesve dhe B. L-së iu kërkua të qëndronin në rresht, ndërsa kishin veshur balaklava (veshje që mbulon kokën dhe qafën) me ngjyrë bardhë e blu, ngjyrë e ngjashme me ato të balaklavave të autorëve të krimit. Dy personat e tjerë në rresht kishin veshur balaklava të zeza, që ishin në kontrast të thellë me balaklavat bardhë e blu, të veshura nga ankuesit dhe B.L-ja, të cilët ishin akuzuar për kryerjen e veprës penale. Ndryshimi i pozicionit të personave në rresht nuk çoi në ndryshim të rezultatit për ankuesit, pasi atyre u kërkohej vazhdimisht të mbanin veshur të njëjtë balaklavë (bardhë e blu). Gjykata konstaton se parada e identifikimit është një ftesë e hapur për dëshmitarët që ato t'u vinin gishtin dy kërkuesve dhe B.L-së si autorë të veprës penale. Për më tepër, parada e identifikimit u mbajt në mungesë të avokatëve të ankuesve. Nga dosja e çështjes nuk rezulton që ankuesit të kenë hequr dorë me vullnetin e tyre të lirë, qoftë shprehimisht apo në heshtje, nga e drejta për ndihmë juridike në kohën e paradës së identifikimit. Gjykata vëren në lidhje me këtë pikë se, edhe pse Gjykata e Rrethit ka pranuar se ka pasur parregullsi në fazën e hetimit, për dënimin e ankuesve ajo është mbështetur kryesisht në identifikimin pozitiv të ankuesve nga dëshmitarët okularë në paradën e identifikimit. Sidoqoftë, as asistenca e ofruar më vonë nga një avokat, as natyra akuzatore e proceseve pasuese nuk mund t'i riparojë të metat e ndeshura gjatë hetimit penal".

5. Roli i institucioneve të trajnimit

Garantimi i efektivitetit afatgjatë të sistemit të Konventës përbën përparësi dhe nevoja për zbatim më të mirë të Konventës në nivel vendas është jetike. Në këtë mënyrë, duket e domosdoshme që të gjitha shtetet anëtare të sigurojnë një edukim të mjaftueshëm mbi Konventën, në veçanti në lidhje me profesionet ligjore dhe ato ligj-zbatuese.

Rekomandimi Rec (2004)4[70] mbi KEDNJ-në në arsimin universitar dhe trajnimin profesional, u bën thirrje shteteve anëtare "të sigurojnë trajnime të përshtatshme profesionale në lidhje me Konventën dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës në nivel vendas, në veçanti: 1) si komponent i programeve përgatitore që u paraprijnë provimeve për t'u bërë pjesë e profesioneve të ndryshme ligjore ose 2) për trajnimet fillestare dhe në vazhdim për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët; 3) për personelin në sektorë të tjerë përgjegjës për zbatimin e ligjit; 4) dhe/ose për personelin që merret me personat e privuar nga të drejtat e tyre (për shembull, pjesëtarët e policisë dhe të forcave të sigurisë, personeli i institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe ai i spitaleve) ..."

Trajnimet të veçanta mbi Konventën dhe standardet e saj mund të përfshijnë edhe organizimin e seminareve, si pjesë e trajnimit profesional për gjyqtarët. Më konkretisht, trajnimi i gjyqtarëve synon përfshirjen e standardeve të Konventës dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. KKGJE-ja[71] u rekomandon shteteve që të mundësojnë qasjen e gjyqtarëve në informacionet

[70] *https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805dd13a*

[71] *Opinioni nr. 9 (2006) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE) për vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi rolin e gjyqtarëve vendorë për sigurimin e aplikimit efektiv të së drejtës ndërkombëtaredhe evropiane.*

përkatëse, kurset e gjuhëve të huaja, dhe aksesin në materiale të përkthyera, veçanërisht:

- njohuri paraprake mbi të drejtën ndërkombetare dhe europiane dhe mbi praktikën gjyqësore[72];
- njohuri të përshtatshme mbi të drejtën ndërkombetare dhe europiane[73];
- luajtjen e një roli të rëndësishëm në trajnimin fillestar dhe gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarëve[74];
- vënia në dispozicion e informacionit mbi të drejtën ndërkombetare dhe europiane, përfshirë vendimet e gjykatave ndërkombetare dhe europiane[75];
- përvetësim shumë i mirë i gjuhëve të huaja nga gjyqtarët[76];

Shembull. Në Shqipëri Shkolla e Magjistraturës është institucioni përgjegjës për trajnimin fillestar dhe trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në funksion të rekrutimit dhe vlerësimit të performancës. Programi i trajnimit për periudhën 2012-2015 mbuloi gjërësisht problemet e evidentuara në pah në vendimet e GJEDNJ-së. Në kuadër të masave implementuese për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së për grupin e çështjeve *Caka*, çështjet *Grori, Dybeku* dhe *Rrapo,* Shkolla e Magjistraturës ka përfshirë në kurikulat e trajnimit fillestar dhe atij vazhdues disa tema specifike për çështje që kanë të bëjnë me këto raste lidhur me zbatimi i Nenit 6 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, ajo ka organizuar shumë seminare, tryeza të rrumbullakëta për identifikimin e çështjeve kyçe kryesore që duhet të shqyrtohen nga gjyqtarët ose prokurorët gjatë aktiviteteve të tyre, si, për shembull, prania e të pandehurit para gjyqit ka qënë një ndër temat e përfshira në program .

Gjithashtu, trajnime të veçanta mbi Konventën dhe standardet e saj shihen si të nevojshme edhe për avokatët. Njohja e mirë e Konventës nga avokatët ka ndikim në parandalimin e çështjeve të cilat nuk i përmbushin shprehimisht kërkesat për pranueshmërinë e aplikimit. Mund të organizohen edhe seminare mbi rregulloren e Gjykatës dhe praktikën e proceseve ligjore, si edhe për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Në disa vende botohen rregullisht botime mbi jurisprudencën e Gjykatës për gjyqtarët dhe avokatët.

Shembull. Në Shqipëri, ligji nr. 9015/2012 parashikon rregullat për trajnimin fillestar dhe në vazhdim të avokatëve. Shkolla Kombëtare e Avokatisë (SHKA) është organi përgjegjës për ofrimin e trajnimeve (Neni 25§1, pika 4). Këshilli i përgjithshëm i SHKA-së miraton statusin e themelimit të Shkollës dhe rregullat e trajnimit, siç propozohen

[72] Duhet të sigurohet përmes përfshirjes së këtyre temave në kurrikulën e fakulteteve juridike.
[73] Duhet të jetë njëri prej kushteve që duhet të përmbushen nga të emëruarit në poste gjyqësore, përpara se të marrin pozicionet.
[74] Trajnimi gjyqësor në këtë fushë do të përfitonte nga bashkëpunimi ndërvendas ndërmjet institucioneve vendasvendase të trajnimit gjyqësor.
[75] Me bashkëpunimin e shërbimeve të dokumentacionit të gjykatës, bibliotekave dhe ndihmësgjyqtarëve, gjyqtarit duhet t'i garantohet aksesi në informacionin e indeksuar dhe të shënjuar siç duhet; informacioni i ofruar duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i disponueshëm menjëherë.
[76] Përveç kësaj, gjykatat duhet të kenë shërbime cilësore të përkthimit dhe interpretimit, plus kostos së zakonshme për funksionimin e gjykatave.

nga Shkolla. Ligji parashikon (1) detyrimin për trajnimin fillestar të ndihmës-avokatëve dhe trajnimin në vazhdim të avokatëve (Neni 16/1); (2) trajnime të cilat përbëhen nga çështje ligjore, teorike dhe praktike; (3) mosfrekuentimi i trajnimit mund të përbëjë shkak ligjor për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të avokatit; (4) kushti për përfundimin e programit të Shkollës Kombëtare të Avokatëve shërben si kriter për të marrë licencën për ushtrimin e profesionit të avokatit. Gjatë periudhës 2014-2015, shkolla mbulonte vetëm trajnimin fillestar në 6 dhomat vendore (Vlorë, Durrës, Fier, Korçë, Shkodër dhe Tiranë). Trajnimi vazhdues për këtë periudhë është mbuluar nga një projekt pilot i SHKA-së në bashkëpunim me projektin JUST të USAID-it. Pas këtij projekti pilot, trajnimi në vazhdim duhet të mbulohet nga Shkolla e Avokatisë, bazuar në planin e veprimit për programin e trajnimit në vazhdim të detyrueshëm (2013-2016).

Përveç kësaj, trajnimet të veçanta mbi Konventën dhe standardet e saj janë të nevojshme për profesionistët e së drejtës që merren me zbatimin e ligjit dhe vendet e paraburgimit, të tillë si forcat e sigurisë, të policisë dhe stafi i burgjeve, por edhe për shërbimet e migracionit, të spitaleve etj. Duke pasur parasysh natyrën evoluese të interpretimit dhe të zbatimit të këtyre standardeve në praktikën gjyqësore të Gjykatës, trajnimi vazhdues mbi standardet e Konventës merr peshë të rëndësishme.

Shembull. Në Shqipëri, ekzekutimi i çështjes **"Dybeku kundër Shqipërisë"**[77] kërkonte trajnimin profesional të personelit mjekësor në spitalet e burgjeve, me qëllim përmirësimin e trajtimit të të burgosurve që vuajnë nga çrregullime mendore.

Shembull. Në Armeni zhvillohen trajnime për agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit dhe zyrtarët e sistemit gjyqësor lidhur me mënyrën se si ata të përmbushin kërkesat sipas Konventës, pas dhënies së çdo vendimi në lidhje me Armeninë nga Gjykata.

Shembull. Në Belgjikë Policia Federale organizon një trajnim specifik të quajtur *"Maîtrise de la violence"* (Kontrolli ndaj dhunës), me qëllim pengimin e përdorimit të dhunës së shtrëngimit në profesion.

Shembull. Në Finlandë materiali trajnues për policinë përfshin rekomandimin Rec (2001)10 të Komitetit të Ministrave për Kodin Europian të Etikës në Polici.

[77] *Çështja nr.41153/06, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 18 dhjetor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-84028*

Lista e pyetjeve

- Diskutoni mbi trajnimin profesional të nevojshëm për gjyqtarët, duke u përqendruar veçanërisht në çështjet e identifikuara në vendimet e Gjykatës për Shqipërinë.
- Diskutoni mbi trajnimin profesional të nevojshëm për avokatët, prokurorët dhe oficerët e tjerë të zbatimit të ligjit, duke u përqendruar veçanërisht në çështjet e identifikuara në vendimet e Gjykatës për Shqipërinë (referojuni vendimeve të GJEDNJ-së *"Laska Lika kundër Shqipërisë"*, *"Grori kundër Shqipërisë"* *"Cani kundër Shqipërisë"*)

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Dybeku kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Laska Lika kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Grori kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Cani kundër Shqipërisë";*
- Opinioni nr. 9 (2006) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGjE) drejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi rolin e gjyqtarëve vendasë në sigurimin e zbatimit efektiv të së drejtës ndërkombëtarevendase dhe europiane;
- CM/Rec(2004)5, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me verifikimin e pajtueshmërisë së projektligjeve, ligjeve ekzistuese dhe praktikës administrative me standardet e përcaktuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 maj 2004 në sesionin e 114-të)
- CM/Rec (2004)4, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me arsimin universitar dhe trajnimin profesional (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 maj 2004 në sesionin e 114).

Pjesa D. Efekti i Konventës mbi sistemin e brendshëm juridik

Rëndësi themelore merr fakti se "Konventa nuk përbën më kryesisht një produkt të së drejtës ndërkombëtare: në të vërtetë ajo përbën vetë "*të drejtën e brëndshme*" dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme nga gjyqtarët vendas".[78]Sot, çdo Palë Kontraktuese e ka bërë Konventën pjesë të sistemit të vet juridik. Me futjen e Konventës në sistemin e brendshëm, ajo bëhet e detyrueshme për çdo zyrtar shtetëror që ushtron autoritet publik, si çështje e së drejtës së brëndshme. Një ndër arsyet që ekzistojnë standarde të ndryshme të zbatimit të Konventës në shtetet anëtare, lidhet me faktin se shtetet kanë përdorur qasje të ndryshme për përfshirjen e Konventës në sistemet e brendshme ligjore.

Shembull. *Në çështjen "Von Hannover kundër Gjermanisë"* (2)[79]**,** e cila është kërkesa e dytë para Gjykatës nga i njëjti ankues në çështjen "*Von Hannover kundër Gjermanisë*" (1)[80], Gjykata vëren se: *"Në përputhje me praktikën e tyre gjyqësore, **gjykatat vendase e kanë balancuar me kujdes të drejtën e kompanive botuese për lirinë e shprehjes kundrejt të drejtës së ankuesve për respektimin e jetës së tyre private.** Duke vepruar kështu, ato i kushtuan rëndësi thelbësore pyetjes nëse fotot, të shqyrtuara në kuadrin e artikujve shoqërues, kishin kontribuar për një debat me interes të përgjithshëm, apo jo. Ato shqyrtuan edhe rrethanat në të cilat ishin marrë fotografitë. Gjykata vëren gjithashtu se gjykatat vendase kanë marrë shprehimisht parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës. Ndërkohë që Gjykata Federale e Drejtësisë e ka ndryshuar qëndrimin e saj pas vendimit për çështjen "Von Hannover", **Gjykata Kushtetuese Federale, nga ana e saj, jo vetëm që e ka konfirmuar këtë qasje, por ka ndërmarrë edhe një analizë të hollësishme të praktikës gjyqësore të Gjykatës në përgjigje të kërkesës së ankuesve, sipas së cilës Gjykata Federale e Drejtësisë e ka shpërfillur Konventën dhe praktikën e Gjykatës**".*

Shembull. *Pas vendimit në çështjen "Doronin kundër Ukrainës"*[81]*,* në Ukrainë u depozituan një grup prej 192 çështjesh, ku pretendohej shkelja e Nenit 5 të Konventës për ndalim të paligjshëm dhe afate të tejzgjatura të paraburgimit që rridhnin nga: ndalimi (paraburgimi) pa vendim gjyqësor dhe/ose zbatimi prapaveprues i vendimeve për paraburgim; mosdhënia e arsyeve dhe mosvendosja e afateve kohore për paraburgim; moszbatimi e masave alternative parandaluese për paraburgim; dhe mungesa e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së paraburgimit. Për rrjedhojë, u morën masa për të ndryshuar Kodin ekzistues të Procedurës Penale, në veçanti për të siguruar që koha që i nevojitet të paraburgosurit për t'u njohur me dosjen e çështjes të merret parasysh gjatë llogaritjes së periudhës së paraburgimit.

Shembull. *Në vijim të vendimit për çështjen **"Dauti kundër Shqipërisë"***[82]**,** në Shqipëri, përmes ndryshimeve të duhura ligjore Komisioni i Apelimit të Shqyrtimit Mjekësor për Kapacitetin për Punë (KMCAP – i cili është organ administrativ apeli)[83] u riorganizua në përputhje me standardet e kërkuara për mjetet efektive ligjore, në bazë të Nenin 13 të Konventës Europiane.

Ndërsa në vijim të urdhërimeve të bëra në vendimin për çështjen ***"Marini kundër Shqipërisë",*** janë ndërmarë reforma ligjore që kanë përshtatur ankimin përpara

[78]Shih shënimin nr. 82 në fund të faqes.
[79] *Shih shënimin nr. 57 në fund të faqes.*
[80] *Shih shënimin nr. 87 në fund të faqes.*
[81]*Raporti i Raportuesit për Komitetin për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut: Z. Christos POURGOURIDES, Qipro, Grupi i Partisë Popullore Evropiane.*
[82]*Çështja nr. 19206/05, ECtHR vendim i datës 3 shkurt 2009, i cili mori formë të prerë më 3 mars 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-91103*
[83]*Ndryshimet e ligjit nr.7703, date 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore", me ligjin nr. /2013, i cili synon modifikimin e procedurave të rekrutimit dhe metodave të vlerësimit nga anëtarët e KMCAP-së.*

Gjykatës Kushtetuese në në mjet efektiv në përputhje me Nenin 13 të Konventës[84];

Në vijim të urdhërimeve të bëra në vendimin për çështjen ***"Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë"[85],*** është amenduar me ligjin nr. 38/2017 (Neni 399/6) Kodi i Procedurave Civile, *i ndryshuar* me qëllim krijimin e mjeteve juridike për palët në procese civile, administrative dhe penale për kërkesa për kompensim të dëmit për shkak së tejzgjatjes së proceseve gjyqësore dhe për të krijuar mjete juridike për mosekzekutimin e vendimeve të gjykatës.

1. Koncepti i ndarjes së përgjegjësisë për zbatimin e Konventës

Protokolli nr.11[86] i Konventës dhe brëndësimi i Konventës në rendin juridik vendas, të kombinuara, kanë çuar në lindjen e një sistemi të ri ligjor. Ky sistem bazohet në mbrojtjen kolektive të të drejtave të njeriut nga të gjitha vendet anëtare, ku Gjykata Europiane mban statusin e "të parës midis të barabartëve". Sistemi funksionon në bazë të parimit të përgjegjësisë së përbashkët midis shteteve anëtare dhe parimit të dialogut të hapur midis gjykatave vendase me GJEDNJ-së. Ky dimension i dyfishtë e bën sistemin e Konventës pluralist.

Protokolli nr. 15[87] i Konventës, edhe pse nuk ka hyrë ende në fuqi,[88] thekson rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, që qëndron në rrënjët e marrëdhënies ndërmjet Gjykatës dhe shteteve anëtare. Ky parim vendos për shtetet dhe gjykatat e tyre detyrimet e nevojshme, duke iu lënë në të njëjtën kohë një diskrecion të gjerë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës.

Për ilustrim, mund të ketë raste kur GJEDNJ-së i duhet të peshojë dy të drejta substanciale që janë në marrëdhënie të tensionuara me njëra-tjetrën, për pasojë Gjykatës i duhet të aplikojë standarde mbojtje më të larta për njërën të drejtë, krahasuar me të drejtën tjetër. Në raste të tilla, edhe pse gjykatat vendase kanë ndjekur qasje të ndryshme nga ajo e GJEDNJ-së, është e rëndësishme që secila prej tyre t'i zgjidhë këto çështje "të vështira" *në mirëbesim*.

Për shkak të këtyre situatave, GJEDNJ-ja dhe gjykatat e brendshme duhet të vazhdojnë të angazhohen në dialog të rregullt me njëra-tjetrën për të kuptuar qëndrimet, vështirësitë dhe ndjeshmëritë përkatëse në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës në rendet juridike vendase. Pas miratimit të Deklaratës së Brighton-it[89], është miratuar protokolli nr.16 i Konventës (që nuk ka hyrë ende në fuqi)[90]. Ky protokoll synon të rrisë mjetet e dialogut dhe të ndërveprimit ndërmjet Gjykatës dhe autoriteteve vendase, si, për shembull zgjerimin e kompetencave të Gjykatës për të dhënë opinione këshillimore bazuar në kërkesat e gjykatave vendase më të larta.

---

[84] Ndryshimi i Kushtetutës së Shqipërisë (2016) dhe miratimi i ligjit nr. 99/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" parashikon që vendimet e GjK-së janë ligjshmërisht të detyrueshme dhe që GJK-ja do të investohet për gjykimin e kërkesave të lidhura me procesin e rregullt juridik si për shkaqe procedural dhe për shkaqe pasuror.

[85] Ndryshimi i Kodit të Procedurës Civile me anë të ligjit 34/2017, [85] në Nenin 399.

[86] https://rm.coe.int/168007cda9

[87] http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_15_ENG.pdf

[88] http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list

[89] Për lehtësimin e këtij dialogu janë organizuar disa konferenca të nivelit të lartë, të cilat janë zhvilluar përkatësisht në Interlaken (shkurt 2010), İzmir (prill 2011) Brighton (prill 2012), dhe Bruksel (2014).

[90] http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list

***Neni 1 i protokollit 16 të Konventës parashikon sa vijon**: "Gjykatat dhe tribunalet më të larta të një Pale të Lartë Kontraktuese, siç janë përcaktuar në pajtim me Nenin 10, mund t'i kërkojnë Gjykatës të japë opinione këshillimore mbi çështjet e parimit që kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë, ose në protokollet e saj. Gjykata ose tribunali kërkues mund të kërkojë opinion këshillues vetëm në kuadrin e një çështjeje në pritje të gjykimit para saj. Gjykata ose tribunali kërkues duhet të japë arsyet për kërkesën e parashtruar dhe duhet të citojë bazën përkatëse ligjor dhe faktike të çështjes në pritje të gjykimit"*

Thënë shkurt, Protokolli nr. 16 do t'u mundësojë gjykatave më të larta vendase t'i drejtohen Gjykatës për opinione këshillimore për çështje parimore në lidhje me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga Konventa. Këto kërkesa do të bëhen në kuadrin e çështjeve që janë ende në fazën e shqyrtimit përpara gjykatës vendase. Opinioni këshillues i Gjykatës do të ofrojë thjesht arsyetim dhe nuk do të jetë detyrues. Nëse gjykatat vendase e kritikojnë qasjen e Gjykatës, ajo mund të përgjigjet duke e modifikuar ose ndryshuar praktikën e saj gjyqësore. Nga ana tjetër, nëse gjykatat vendase janë në mëdyshje, sa i përket përputhshmërisë së një linje të caktuar të praktikës së tyre gjyqësore me Konventën, ato mund t'i kërkojnë Gjykatës që të pajtohet ose jo me mënyrën se si ata e lexojnë Konventën.

Përfitimi i përmirësimit të dialogut midis GJEDNJ-së dhe gjykatave vendase konsiderohet i dyfishtë: nëse gjykatat vendase e zbatojnë Konventën në mënyrë konsekuente, çështjet e prapambetura para Gjykatës së Strasburgut do të zvogëloheshin ndjeshëm në numër. Në të njëjtën kohë, do ulej ndjeshëm rreziku i penalizimit të shteteve anëtare përpara GJEDNJ-së. Përveç kësaj, Gjykata do të gjente një mënyrë për t'iu përgjigjur kritikave nga gjykatat vendase dhe do të kishte mundësinë që t'u komunikonte këtyre udhëzime praktike mbi kritere të përgjithshme që mund të zbatohen për interpretimin evolutiv dhe autonom të Konventës. Njëkohësisht, gjykatat vendase mund të balancojnë fuqinë e Gjykatës për të interpretuar Konventën në mënyrë autonome dhe evolutive.

- **Rast studimor "Von Hannover kundër Gjermanisë" (1)**[91]

***Vendimi për çështjen "Von Hannover kundër Gjermanisë"** ka të bëjë me pozicionin e ndryshëm të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë në bazë të ligjit vendas, krahasuar me vendimin e GJEDNJ-së mbi çështjen*.
Ankuesja, vajza e madhe e Princit Rainier III të Monakos (Princesha Carolinë e Monakos), depozitoi një ankesë në GJEDNJ, ku pretendonte shkeljen e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8 i Konventës). Më konkretisht, ajo pretendonte që gjykatat e brendshme nuk kishin marrë vendim për mbrojtjen e të drejtës së saj për të ndaluar botimin e fotove rreth jetës së saj private në shtypin e shkruar. **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë (në vendimin historik, datë 15 dhjetorit 1999)** pohoi se pajtohet me kriterin e *"interesit të komunitetit"* të aplikuar nga gjykatat më të ulëta, duke theksuar rëndësinë e lirisë së shtypit. Formimi i lirë i opinioneve kërkon që shtypi të ketë, brenda kufijve ligjorë, një hapësirë të mjaftueshme manovrimi për të vendosur të botojë atë çfarë kërkon interesi publik dhe çfarë ka të

[91] *Çështja nr.59320/00, vendim (për themelin), datë 24 qershor 2004, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-61853*

bëjë me një çështje me interes publik. Po ashtu, edhe koncepti i figurës *"par excellence"* në shoqërinë bashkëkohore përcakton njerëzit, imazhi i të cilëve konsiderohet nga publiku si i denjë për t'u respektuar për arsye të interesit të publikut. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese pohoi gjithashtu se kriteret nga pikëpamja teorike nuk përkojnë me të drejtën kushtetuese për të përcaktuar konceptin e "interesit të ligjshëm", duke mbajtur qëndrimin që: *"Duke pasur parasysh funksionin që i atribuohet kësaj privatësie sipas së drejtës kushtetuese dhe faktin që zakonisht është e pamundur të përcaktohet nga një foto nëse personi është fotografuar fshehurazi, ose është kapur pa dashje, ekzistenca e ndërhyrjes së paligjshme ndaj kësaj privatësie nuk mundet në asnjë rast të përcaktohet thjesht për shkak se fotografia është marrë në këto kushte ".* ***Gjykata Kushtetuese Federale (në vendimin datë 13 prill 2000),*** pas rimarrjes së çështjes nga Gjykata Federale të Drejtësisë në një set të dytë procedurash gjyqësore, konstatoi se gjykatat e zakonshme e kishin përcaktuar siç duhet konceptin e jetës private dhe theksoi se ky parim shtrihej ndaj aspekteve që lidhen me identitetin personal, siç është emri i një personi.

Gjykimi përfundimtar i GJEDNJ-së në çështjen "Von Hannover kundër Gjermanisë" (1), i vitit 2004, gjatë shqyrtimit të kërkesës, bën vlerësimin e mbrojtjes që duhet të jepet për: 1) të drejtën e individit për jetën private (Neni 8), dhe 2) lirinë e shtypit (Neni 10). Gjykata theksoi ekuilibrin e drejtë që duhet të arrihet midis interesave konkurrues të individit dhe të komunitetit në tërësi, ku në të dyja kontekstet shteti gëzon një prag të caktuar vlerësimi. Në kuadër të Nenit 8 këto detyrime mund të përfshijnë marjen e masave për të siguruar respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet tyre. Ndërsa, në lidhje me qëllimin e Nenit 10 të së drejtës për lirinë e shtypit, ajo theksoi detyrën e shtypit për të mos tejkaluar kufijtë e caktuar në lidhje me reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve. Detyra e shtypit është vetëm të japë informacion dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik. Pra, Gjykata argumentoi se vetëm klasifikimi i ankuesit si figurë *"par excellence"* e shoqërisë bashkëkohore nuk mjafton për të justifikuar një ndërhyrje të tillë në jetën private[92] të saj. Për më tepër, Gjykata u shpreh se publiku nuk ka interes të ligjshëm për të ditur se ku është kërkuesja dhe se si sillet ajo përgjithësisht në jetën private. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Lista e pyetjeve

- Cilat të drejta janë në rrezik në çështjen ***"Hann Hannover kundër Gjermanisë"***?
- Cili ishte qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin e vitin 1999 dhe pozicioni i Gjykatës Kushtetuese Federale i vitit 2000?
- Çfarë interpretimi ka ndjekur GJEDNJ-ja në lidhje me Nenin 10 dhe Nenin 8?
- Nëse, si gjyqtarë, do t'ju duhet të zgjidhni një çështje me bazë të ngjashme ligjore (në lidhje me interpretimin e Nenit 10 kundrejt Nenit 8 të Konventës), çfarë vendimi do të merrni?

[92] *Ajo sugjeroi, në këtë pikëpamje se autoritetet shtetërore duhej të bënin dallimin e qartë dhe të dukshëm midis figurave "par excellence" të shoqërisë bashkëkohore, dhe figurave "relative" publike, në mënyrë që individi të ketë indikacione të sakta për sjelljen që ai ose ajo duhet të ketë. Mbi të gjitha, individët duhet të dinë saktësisht se kur dhe ku janë në një sferë të mbrojtur, ose, në të kundërt, në një sferë ku duhet të presin ndërhyrje nga të tjerët, sidomos nga shtypin i shkruar.*

Situatë hipotetike: *Duke prezumuar një situatë ku gjykatat vendase janë në pozicionin kur duhet të vendosin mbi një çështje, në të cilën faktet dhe ligji i zbatueshëm shfaqin një konflikt ndërmjet dy të drejtave themelore, të cilat janë njësoj të rëndësishme në raport me Konventën dhe Kushtetutën e Shqipërisë. Për shembull, le të marrim kërkesën e një individi që pretendon shkelje të së drejtës për mjedis të shëndetshëm si pjese integrale brenda së drejtës për jetë familjare dhe private (Neni 8 i Konventës), e cila i është cenuar nga ndotja e ajrit dhe lumenjve dhe furnizimeve me ujë nga fabrikat, të cilat, çfarë nga ana tjetër, ka ndikim negativ mbi të drejtën e pronarit për gëzimin e pronës private (Neni 1 i protokollit të Konventës). Në pozicionin e gjyqtarit, çfarë qasjeje do të ndiqnit për të vendosur mbi çështjen sa i takon mbrojtjes së të dyja të drejtave paralele që janë në konflikt me njëra-tjetrën?*

Rekomandohet per lexim:

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Von Hannover kundër Gjermanisë"*(1)
- Protokolli nr. 11 i KEDNJ-së
- Protokolli nr. 15 i GJEDNJ-së
- Protokolli nr. 16 i GJEDNJ-së
- Deklarata e Konferencës së Interlakenit
- Deklarata e Sonferencës së Brighton-it
- Deklarata e Konferencës së Bruksel-it
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Von Hannover kundër Gjermanisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Doronin kundër Ukrainës"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Gjonbocari kundër Shqipërisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë"*
- Raporti 1 i Raportuesit të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut Z. Christos POURGOURIDES, Qipro, Grupi i Partisë Popullore Europiane.

SEKSIONI II – HYRJE NË NENIN 6(1) – E DREJTA PËR PROCES TË RREGULLUT LIGJOR

a) Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i këtij seksioni është të sigurojë përmirësimin e njohurive dhe të kuptuarit për një sërë çështjesh që lidhen me metodat e interpretimit, të përdorura nga GJEDNJ-ja, për gjykimin e pretendimeve që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas Nenit 6.1 të Konventës. Më konkretisht, ky seksion do të mundësojë pjesëmarrësit të analizojnë dhe të vlerësojnë zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, duke iu referuar praktikës gjyqësore përkatëse dhe duke përdorur teste të ndryshme mbi situata hipotetike. Ky seksion synohet për pjesëmarrës që kanë njohuri të përgjithshme mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Më konkretisht, kërkohet që pjesëmarrësit të vijnë nga profesioni i gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve, nga pikepamja e backgroundit profesional.

b) Objektivat e mësimit

Në fund të këtij seksionit prezantues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të kuptojnë metodat e interpretimit, të përdorura nga GJEDNJ-ja gjatë shqyrtimeve për proces të rregullt ligjor, në përputhje me Nenin 6.1 të Konventës;
- të përcaktojnë parimet për interpretimin e Nenit 6.1 të Konventës;
- të zbatojnë parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
- të analizojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e mbrojtjes efektive;
- të bëjnë dallimin midis 3 nën-parimeve të zbatueshme për standardin e mbrojtjes efektive dhe të diskutojnë rreth praktikës gjyqësore përkatëse;
- të analizojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e interpretimit dinamik;
- të analizojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e balancimit të drejtë;
- të bëjnë dallimin midis nën-parimeve të zbatueshme për balancimin e drejtë dhe të diskutojnë mbi praktikën gjyqësore përkatëse;
- të testojnë njohuritë lidhur me zbatimin e të tria parimeve.

c) Kohëzgjatja: 3 orë, 2 javë

d) Vlerësimi përfundimtar: rast studimor, portofol, dokument për diskutime

1. Hyrje në metodat e interpretimit, të përdorura nga GJEDNJ-ja

1.1. Metoda teleologjike e interpretimit

Metoda interpretuese e zhvilluar nga Gjykata e Strasburgut përmbledh si qasjen tekstuale, ashtu edhe atë teleologjike. Qasja teleologjike realizohet duke u përqendruar në tri parime themelore interpretuese të zhvilluara nga Gjykata. Këto janë: parimet e mbrojtjes efektive, të interpretimit dinamik dhe të balancimit të drejtë. Vendosja në preambulë e theksit tek objekti dhe qëllimi kryesor i KEDNJ-së, në përgjithësi, tregon rëndësinë e madhe të tyre, krahasuar me qëllimet e ndryshme specifike të shprehura në *Travaux Preparatoires*. Parimi i parë nënkupton se një dispozitë e Konventës duhet të interpretohet, në mënyrë që të drejtat e parashikuara në të, të bëhen praktike dhe efektive, çfarë përbën parimin e mbrojtjes efektive. Parimi i dytë nënkupton se një dispozitë e KEDNJ-së duhet të interpretohet në mënyrë dinamike dhe evolutive në kuadrin e kushteve të sotme, çfarë përbën parimin e interpretimit dinamik. Parimi i tretë nënkupton se një dispozitë e GJEDNJ-së duhet të interpretohet në kuadrin e nevojës për të arritur një "balancim të drejtë" midis të drejtës individuale në fjalë, nga njëra anë, dhe të drejtave të tjera të GJEDNJ-së dhe interesave legjitimë publikë, nga ana tjetër, çfarë përbën parimin e balancimit të drejtë. Ky parim i fundit lidhet gjithashtu me parimin e subsidiaritetit.[93]

A. Parimi i mbrojtjes efektive

Objekti dhe qëllimi i KEDNJ-së është mbrojtja e të drejtave që nuk janë iluzive ose hipotetike. Ky konstatim është shprehur madje dhe në qëllimin e Preambulës sëKEDNJ-së: "Njohja universale dhe efektive e të drejtave të njeriut", duke theksuar rëndësinë e "ruajtjes dhe të përmbushjes së mëtejshme të të drejtave të njeriut". Parimi i mbrojtjes efektive nënkupton se të gjitha të drejtat e mishëruara në Konventë duhet të interpretohen, në mënyrë të atillë që qëllimi dhe vlerat morale që , qëndrojnë në themelin e saj, të mund të mbrohen dhe promovohen në mënyrë sa më efektive. Kjo mbrojtje përfshin jo vetëm të drejtat që janë parashikuar shprehimisht në Konventë por edhe të drejtat e nënkuptuara prej tyre, si p.sh. e drejta për "proces të rregullt ligjor"

---

[93] *Vendosja nëpreambul e theksit tek objekti dhe qëllimi kryesor i KEDNJ-së, në përgjithësi, ka më tepërrëndësi sesa qëllimet e ndryshme specifike të shprehura në Travaux Preparatoires.*

- *Parimi i parë është se një dispozitë e KEDNJ-së duhet të interpretohet në mënyrë që të drejtat e numëruara në të jenë praktike dhe efektive, domethënë ne kemi një parim të mbrojtjes efektive.*
- *Parimi i dytë është se një dispozitë e KEDNJ-së duhet të interpretohet në mënyrë dinamike dhe evolutive në dritën e kushteve të sotme, domethënë kemi një parim të interpretimit dinamik.*
- *Parimi i tretë është se një dispozitë e KEDNJ-së duhet të interpretohet në dritën e nevojës për të arritur një "balancë të drejtë" midis të drejtës individuale në fjalë, nga njëra anë, dhe të drejtave të tjera të GJEDNJ-së dhe interesave legjitimë publikë, nga ana tjetër, domethënë, ne kemi një parim të balancës së drejtë. Parimi i fundit lidhet me parimin e subsidiaritetit.*

përpara një "gjykate të pavarur dhe të paanshme" nënkupton, pikë së pari, të drejtën e aksesit për t'iu drejtuar gjykatës. Më konkretisht, parimi i mbrojtjes efektive kuptohet duke pasur parasysh tri aspekte:

- "Interpretimin autonom" (i cili nënkupton që norma duhet të konceptohet se funksion si standard minimal si për sistemin procedural akuzator, ashtu edhe për sistemin procedural inkuizitor);
- "Detyrimet pozitive" (nënkupton angazhimin e shteteve kontraktuese në realitet, për të vënë në dispozicion burime të mjaftueshme, në funksion të krijimit dhe menaxhimit të një sistemi të gjykatave civile)
- E drejta për "rigjykim" (nënkupton se veprimet dhe mosveprimet e shtetit të paditur që cënojnë të drejtat e Konventës, duhet të rigjykohen në mënyrë intensive dhe jo thjesht të mjaftohen me vlerësimet e autoriteteve vendase).

1. Kuptimi autonom i koncepteve të Nenit 6(1) (nënparimi i parë për mbrojtjen efektive)

Neni 6 (1) i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) parashikon:

Çdo person ka të drejtë që cështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

1.1. Nocioni i koncepteve autonome

Parimi.Standardi i procesit të rregullt ligjor, sipas Nenit 6§1, lidhet me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, ose të një akuze penale kundrejt një individi i cili ka pretendime të bazuara lidhur me praninë e një mosmarrëveshje të debatueshme. Duke pasur parasysh se shtetet anëtare kanë sisteme të ndryshme për përcaktimin e çështjeve në sferën civile dhe penale, KEDNJ-ja vendos standardet procedurale minimale që duhet të respektohen nga të gjitha shtetet anëtare për: (1) përcaktimin e të drejtave civile; dhe (b) përcaktimin e akuzave penale.

Shembull. ***Në çështjen "König kundër Gjermanisë"***[94], që ka të bëjë me një sërë procesesh gjyqësore në lidhje me tërheqjen e autorizimit për ushtrimin e profesionit të një mjeku për shkak të sjelljes së tij të padenjë, Gjykata vendosi në seancë plenare se "si Komisioni edhe Qeveria bien dakord se koncepti i "të drejtave dhe detyrimeve civile" nuk mund të interpretohet vetëm duke iu referuar të drejtës së brendshme të shtetit të paditur ... Prandaj, ajo është e mendimit se i njëjti parim i autonomisë vlen edhe për konceptin në fjalë; çdo zgjidhje tjetër mund të çojë në rezultate të papajtueshme me

[94] *Çështja nr. 6232/73, vendim i datës 28 qershor 1978, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57512*

objektin dhe qëllimin e Konventës ... '(§ 88). Megjithatë, legjislacioni vendas luan rol ndihmës në përcaktimin e koncepteve të parashikuara në Nenin 6. Edhe pse Gjykata arrin në përfundimin se koncepti "i të drejtave dhe detyrimeve civile" është autonom, ajo gjithsesi është e mendimit se në këtë kontekst legjislacioni i shtetit përkatës është i rëndësishëm (§89). "

1.2. Shembuj të koncepteve autonome që përfshihen në Nenin 6§1 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile

Shembull. ***Në çështjen Ringeisen kundër Austrisë,***[95] Gjykata Europiane u shpreh se: "të gjitha proceset gjyqësore, rezultati i të cilave është vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private'(*§94)* përbëjnë përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile. Në të njëjtën çështje, Gjykata vendosi që: "Karakteri i legjislacionit, i cili rregullon mënyrën sesi përcaktohet çështja (bazuar në të drejtën civile, tregtare, administrative, etj.) dhe organin e ngarkuar me juridiksion mbi gjykimin e çështjes (gjykatë e zakonshme, organ administrativ, etj.), për pasojë, ka pak ndikim."

Për të vendosur nëse bëhet fjalë për të drejtat dhe detyrimet civile të një personi, Dhoma Plenare është shprehur se "vetëm karakteri i së drejtës në fjalë është i rëndësishëm" (*König k. Gjermanisë,* §90). Dhoma e Madhe e Gjykatës është shprehur gjithashtu se është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje, në mënyrë që të zbatohet Neni 6§1: 'Gjykata rithekson se në mënyrë që të jetë i zbatueshëm Neni 6§1, në aspektin e tij "civil", duhet të ketë një mosmarrëveshje (të kontestueshme) mbi një "të drejtë", për të cilën mund të argumentohet mbi baza të mjaftueshmese është një e drejtë e parashikuar në legjislacionin vendas.,. Mosmarrëveshja duhet të jetë e vërtetë dhe serioze. Ajo mund të lidhet jo vetëm me ekzistencën e një të drejte, si nga pikepamja e qëllimit por dhe e formës që ndjek ekzistenca e saj.. Për më tepër, rezultati që vjen nga procesi gjyqësor në lidhje me përcaktimin e kësaj të drejtë duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë. Pra duhet të demonstrohet se gjykimi i mosmarrëveshjes në lidhje me përcaktimin e të drejtave apo detyrimeve civile, ose me fjale të tjera rezultati i ardhur prej tij, është "vendimtar" për ekzistencën e një të drejtë të tillë. Duhet theksuar se Neni 6§1 zbatohet vetëm për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile, të cilat duhet të jenë, "të pretendueshme mbi baza të mjaftueshme të së drejtës së brëndshme;; pavarësisht kësaj, nuk garantohet se ka një përmbajtje të vecantë për "të drejtat dhe detyrimet" në të drejtën substanciale të Shteteve Kontraktuese."

Shembull. Në çështjen *"Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës"*[96] Dhoma e Madhe ripërkufizoi kriteret e mëparshme funksionale që ishin përcaktuar në rastin *Pellegrin kundër Francës* [GC][97]duke konstatuar se një shtet mund të përjashtojë zbatimin e Nenit 6 mbi nëpunësit publikë vetëm nëse plotësohen dy kushte: Së pari, shteti në ligjin e tij vendas duhet ta ketë përjashtuar shprehimisht të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për pozitën ose kategorinë e personelit në fjalë dhe, së dyti, përjashtimi duhet të justifikohet në baza objektive në interes të shtetit "(§ 62). Në çështjen *Ferrazzini kundër Italisë*[98], Dhoma e Madhe konfirmoi se detyrimet tatimore bien jashtë fushës së veprimit të të drejtave dhe detyrimeve civile (/§29). Në çështjen

[95] *Çështja nr. 2614/65, vendim i datës 16 korrik 1971, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57565*
[96] *Çështja nr. 63235/00, vendim i datës 19 prill 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-80249*
[97] *Çështja nr. 28541/95, vendim i datës 8 dhjetor 1999, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-58402*
[98] *Çështja nr. 44759/98), vendim i datës 12 korrik 2001,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-59589*

"*Micallef kundër Maltës*"[99], Dhoma e Madhe rishikoi praktikën e mëparshme të saj dhe vendosi që masat e ndërmjetme të lëshuara nga gjykatat civile mund të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet civile për shkak të vonesave në shqyrtimin e plotë të një çështjeje.

Shembull*. Në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë"*[100] Gjykata konstatoi sa i takon zbatimit të Nenit 6§1 të Konventës se "asgjë nuk është argumentuar, apo sugjeruar për të kundershtuar se pretendimet e ankuesit për përfitimet e aftësisë së kufizuar përbëjnë një mosmarrëveshje (kontestim) mbi një "të drejtë", e cila mund të thuhet mbi baza mjaftueshmërisht të argumentuara se njihet nga ligji vendas. Në veçanti, mund të pohohet se pretendimet e ankuesit nuk janë të pa mbështetura, apo hapur të pabazuara. Nuk ka diskutim dhe Gjykata është e mëse e bindur se e drejta në fjalë kishte karakter "civil", në kuptimin autonom të Nenit 6§1 të Konventës. Gjykata ripërsërit atë çfarë është vendosur më parë në lidhje me përfitimet nga asistenca sociale dhe të drejtat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë "të drejta civile" në kuptim të Nenit 6§1 të Konventës, që janë të zbatueshme dhe në proceset ligjore në lidhje me to. Çështja në fjalë ka të bëjë me të drejtën e ankuesit për asistencë, ose më specifikisht me një pagesë paaftësie që lind për shkak të paaftësisë së tij për punë.

1.3. Shembuj të koncepteve autonome në Nenin 6§1 për përcaktimin e akuzave

Gjykata Europiane ka theksuar vazhdimisht përbërjen autonome të nocionit të "akuzës" për qëllime të Nenit 6§1 (*Neumeister kundër Austrisë*, § 18[101]). Në ndërtimin e fjalës "penale", Gjykata Europiane ka konstatuar se një shtet është i lirë të caktojë si vepër penale një veprim apo mosveprim i cili nuk mishëron ushtrimin e natyrshëm të një prej të drejtave që mbrohet nga Konventa. Sidoqoftë, Gjykata ka vendosur që, në një situatë të kundërt, ajo ruan juridiksionin për të gjykuar se si një shtet klasifikon një veprim apo mosveprim si akt disiplinor në vend të kualifikimit të saj si vepër penale (*Engel kundër Holandës*, § 81[102]).

**Shembull*. Në çështjen "Engel kundër Holandës"*[103]Gjykata, në seancë plenare përcaktoi tri kritere për të vendosur nëse proceset gjyqësore bien në kategorinë e akuzave "penale":
- klasifikimin e veprave sipas ligjit të brendshëm ;
- natyrën e akuzave; dhe
- natyrën dhe shkallën e ndëshkueshmërisë së dënimit.

Shembull*. Në çështjen "Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar"*[104] Dhoma e Madhe duhej të përcaktonte nëse dhënia e ditëve shtesë të dënimit për të burgosurit për shkelje të disiplinës së burgut mund të çonte në klasifikimin e procedurës së ndjekur nën kategorizimin e "procedurës penale" duke zbatuar kriteret e Engel-it. Ajo u shpreh se "përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, nënkuptohet se zbatimi i kriteri tëdytë dhe të tretë të parashtruar në rastin ***Engel* , mbeten thjesht alternative jo

[99] Çështja nr. 17056/06, vendim i datës 15 tetor 2009,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-95031
[100] Shih shënimin 93.
[101] Çështja nr.1936/63, vendim i datës 27 qershor 1968, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57543
[102] Çështja nr. 5370/72), vendim i datës 8 qershor 1976, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57479
[103] Po aty.
[104] Çështja nr. 39665/98 dhe 40086/98, vendim i datës 9 tetor 2003, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-61333

domosdoshmërisht kumulative: në mënyrë që të zbatohet Neni 6, mjafton që vepra në fjalë në vështrim të Konventës të mundtë konsiderohet "penale" nisur nga natyra e saj, ose mjafton që vepra e vesh personin me përgjegjësi ndaj një sanksioni, i cili për nga natyra dhe shkalla e ashpërsisë bën pjesë në sferën "penale" ... Kjo nuk përjashton zbatimin e një qasjeje kumulative, sa herë që analizat e ndara për secilin kriter nuk çojnë në arritjen e një përfundimi të qartë sa i takon ekzistencës së një akuze penale ...(§86)."

Shembull. ***Në çështjen "Mulosmani kundër Shqipërisë"***[105] Gjykata argumentoi se "akuza" për qëllimet e Nenit 6, mund të përkufizohet si "komunikimi zyrtar që behet një individi nga autoriteti përgjegjës se dushohet që ai ka kryer një vepër penale", përkufizim ky i cili përkon edhe me testin nëse "situata [e të dyshuarit] është cënuar në thelb."

Lista e pyetjeve

- Shpjegoni konceptin e kuptimit autonom.
- Diskutoni nocionin e kuptimit autonom në përcaktimin e të drejtave civile.
- Diskutoni nocionin e kuptimit autonom në përcaktimin e të drejtave penale.

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"König kundër Gjermanisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Ringeisen kundër Austrisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Engel kundër Holandës";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Mulosmani kundër Shqipërisë".*

[105] *Çështja nr. 29864/03, vendim i datës 8 tetor 2013, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-126793*

2. Detyrimet pozitive (parimi i dytë i mbrojtjes efektive)

2.1. Koncepti i detyrimeve pozitive

Garantimi i të drejtave të Konventës, kërkon në situata të caktuara, që një shtet të detyrohet për marjen e masave pozitive që garantojnë individet nën juridiksionin e saj për gëzimin efektiv të këtyre të drejtave. Gjykata Europiane mbështetet në Nenin 1 të Konventës, i cili kërkon që një shtet t'i "sigurojë çdokujt brenda juridiksionit të tij të drejtat dhe liritë e përcaktuara në seksionin 1 të kësaj Konvente", si bazë juridike për vendosjen e disa detyrimeve të nënkuptuara pozitive për shtetet palë në Konventë.[106] Nisur nga vështrimi i praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, karakteristika kryesore e detyrimeve pozitive është se ato në praktikë kërkojnë angazhimin e autoriteteve vendase për të ndërmarrë masa të nevojshme për mbrojtjen e një të drejtë ose, më konkretisht, të miratojnë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave të individit[107].

2.2. Detyrimet pozitive dhe negative

Detyrimet pozitive duhet të dallohen nga detyrimet negative.[108] Një detyrim negativ kërkon që një shtet të tërhiqet nga çdo veprim që do të përbënte ndërhyrje të pajustifikuar në të drejtat e mbrojtura sipas Konventës. Për shumë nga të drejtat e Konventës, detyrimi negativ është absolut, si p.sh. ndalimi i torturës sipas Nenit 3 të Konventës. Për të drejta të tjera të Konventës, ndërhyrja e shtetit lejohet vetëm nëse realizohen disa kushte të caktuara, siç mund të jetë rasti për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10 apo e drejta e privatësisë dhe të drejtave familjare sipas Nenit 8 të Konventës. Dallimi midis detyrimeve pozitive dhe atyre negative nuk është gjithmonë i thjeshtë për tu bërë.

Shembull. ***Në çështjen "Keegan kundër Irlandës"***[109] Gjykata Europiane deklaroi se "objekti kryesor i Nenit 8 është mbrojtja e individit ndaj veprimeve arbitrare nga ana e autoriteteve publike. Por gjithashtu ekziston mundësia që brënda detyrimit për "respektimin" efektiv të jetës familjare të mishërohen edhe detyrime pozitive, përveç atyre negative. Megjithatë, nuk është e mundur të bëhet një përkufizim i saktë, nisur nga përcaktimi i kufijve që duhen vendosur ndërmjet detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit, bazuar në këtë dispozitë.. Megjithatë, parimet që zbatohen janë të njëjta. Në të dyja kontekstet, i duhet dhënë rëndësi balancimit të drejtë që duhet të arrihet ndërmjet interesave konkurruese të individit nga njëra anë dhe interesave të komunitetit në tërësi. Dhe, në të dyja rastet, shteti gëzon një prag të mjaftueshëm vlerësimi."

[106] *A. Mowbray, Çështje, pasurore dhe komente mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, edicioni i 3-të., (OUP, 2012) f. 82.*

[107] *Steven Greer, Pragu i vlerësimit: interpretimi dhe diskrecioni bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Botimet mbi të drejtat e njeriut, nr. 7, Këshilli i Evropës (2000), f. 7. http://www.echr.coe.int/LibraryDocs/DG2/HRFILES/DG2-EN-HRFILES-17(2000).pdf*

[108] *Shih për një diskutim të detajuar të dallimit midis detyrimeve pozitive dhe negative, Laurens Lavrysen, Të drejtat e njeriut në një shtet pozitiv (Intersentia:2016) http://intersentia.com/en/human-rights-in-a-positive-state.html*

[109] *Çështja nr.16969/90, vendim i datës 26 maj 1994, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57881*

2.3. Llojet e detyrimeve pozitive

Natyra dhe shtrirja e detyrimeve pozitive ndryshojnë ndërmjet neneve të ndryshme të Konventës. Gjykata ka konstatuar se këto detyrime mund të lindin nga zbatimi i :

- Nenit 2 (shih *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*);
- Nenit 3 (shih *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*);
- Nenit 8 (shih *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*);
- Nenit 11 (shih Plattform "*Ärzte für das Leben" kundër Austrisë*).

Në këtë kontekst, shtetet duhet të tregojnë kujdes që në ndërhyrjen e tyre për mbrojtjen e të drejtave të respektojnë një balancim i drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesave të individit. Objekti i detyrimit pozitiv në raport me të drejtat e Konventës ndryshon nga një shtet në tjetrin, duke pasur parasysh diversitetin e situatave në shtetet kontraktuese, vështirësitë që hasen me politikat e shoqërive moderne dhe burimet që ato kanë. Në çdo rast, mbrojtja efektive e një të drejte të caktuar nënkupton që autoritetet mund të ndërmarin masa të atilla që nuk i ngarkojnë individët me një barrë të vështirë apo joproporcionale.

Shembull. ***Në çështjen "Marckx kundër Belgjikës"***[110] në seancë plenare, Gjykata vendosi se Neni 8 vendos detyrime pozitive mbi shtetin që të adoptojë ligje të brendshme, të cilat do t'i lejojnë një gruaje të pamartuar dhe fëmijës së saj të gëzojnë një jetë familjare normale dhe t'i lejojnë fëmijës të integrohet në familje duke filluar që nga momenti ilindjes.

Shembull. ***Në çështjen "X dhe Y kundër Holandës"***[111] Gjykata vendosi se Neni 8 i vendoste shtetit një detyrim pozitiv që të krijonte një dispozitë ligjore në fushën e të drejtës penale në lidhje me dënimin për veprimet që shkelnin aspekte thelbësore të integritetit të një individi.

Shembull. ***Në çështjen "Airey kundër Irlandës"***[112] ankuesi kundërshtoi mungesën e ndihmës juridike për proceset gjyqësore të ndarjes. GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të Nenit 6§1 duke theksuar se "Gjykata pajtohet me qëndimin se pranimi se një detyrim i tillë gjithpërfshirës ekziston bie në kundërshtim me faktin se se Konventa nuk përmban asnjë dispozitë për ndihmën juridike në lidhje me këto lloj mosmarrëveshje; Neni 6 paragrafi 3 (c) (Neni 6-3-c) kanë të bëjnë vetëm me proceset penale. Megjithatë, pavarësisht mungesës së një klauzole të ngjashme për proceset gjyqësore civile, Neni 6 paragrafi 1 (Neni 6-1) ndonjëherë mund ta detyrojë shtetin të sigurojë ndihmën e një avokati kur kjo ndihmë rezulton e domosdoshme për sigurimin e aksesit efektiv në gjykatë, ose për shkak se përfaqësimi ligjor është i detyrueshëm, siç është përcaktuar në legjislacionin e brendshëm të disa Shteteve Kontraktuese për lloje të ndryshme të proceseve gjyqësore, ose për shkak të kompleksitetit të procedurës së një rasti të caktuar".

[110] *Çështja nr. 6833/74, vendim i datës 13 qershor 1979, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57534*
[111] *Çështja nr. 8978/80, vendim i datës 26 mars 1985, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57603*
[112] *Çështja nr. 6289/73, vendim i datës 9 tetor 1979, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57420*

Shembull. *Në çështjen "Bushati kundër Shqipërisë"*[113] Gjykata thekson se "faza e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, i dhënë nga çdo gjykatë, duhet të konsiderohet si pjesë integrale e "gjykimit" për qëllimet e Nenit 6 të Konventës (shih *Hornsby kundër Greqisë*). Shteti ka detyrimin pozitiv që të organizojë një sistem për ekzekutimin e vendimeve që është efektiv si nga pikapamja e ligjit ashtu dhe e praktikës, si dhe siguron zbatimin e tyre pa asnjë vonesë të papërshtatshme (shih *Ruianu kundër Rumanisë*). Në rastet kur autoritetet janë të detyruara të ndërmarrin veprime të caktuara për ekzekutimin e një vendimi, por nuk arrijnë dot, paaftësia e tij për ndërmarjen e veprimeve të duhura mund të lindë përgjegjësisë e shtetit, bazuar në Nenin 6§1 të Konventës."

Shembull. *Në çështjen "Bajrami kundër Shqipërisë"*[114]Gjykata rithekson që "objekti kryesor i Nenit 8 është mbrojtja e individit kundër veprimeve arbitrare nga autoritetet publike. Në detyrimin për "respektimin" efektiv të jetës familjare ekzistojnë gjithashtu dhe detyrime pozitive të qenësishme të mishëruara në të.. Në të dyja kontekstet duhet t'i kushtohet rëndësi balancimit të drejtë që duhet të arrihet midis interesave konkurruese të individit dhe interesave të komunitetit në tërësi; dhe, në të dyja kontekstet shteti gëzon një prag të caktuar vlerësimi (shih *Keegan kundër Irlandës*). Në lidhje me detyrimin e shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka përsëritur se Neni 8 përfshin të drejtën që ka prindi që autoritetet të ndërmarin masa për ribashkimin me fëmijën e tij dhe detyrimin e autoriteteve vendase për ta lehtësuar këtë ribashkim."

2.4. Detyrimet pozitive në lidhje me garancitë procedurale

Gjykata Europiane është shprehur se një shtet mund të ketë një detyrim procedural pozitiv për të siguruar mbrojtje efektive të një të drejte të Konventës. Ndërsa praktika gjyqësore ka bërë dallimin e detyrimeve pozitive me natyrë procedurale nga detyrimet pozitive substanciale. Ndërkohë "praktika më e fundit pasqyron një tendencë të re në të cilën Gjykata duket se sistematikisht i bazon detyrimet pozitive, qofshin ato substanciale apo procedurale, duke kombinuar dispozita që vendosin standarte në tekstin europian të Konventës, si dhe Nenit 1 të këtij teksti".[115]

Shembull. N*ë çështjen "Bijelić kundër Malit të Zi dhe Serbisë"*[116] Gjykata konstatoi se në bazë të Nenit 1 të Konventës, çdo Palë Kontraktuese "i siguron çdokujt brenda juridiksionit të vet, të drejtat dhe kompetencat e përcaktuara në [Konventë]". Zbatimi i kësaj detyre të përgjithshme mund të sjellë detyrime pozitive që lidhen me sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të garantuara nga Konventa. Në kontekstin e Nenit 1 të Protokollit nr. 1, këto detyrime pozitive mund të kërkojnë nga shteti marrjen e masave të nevojshme për të mbrojtur të drejtën e pronës ... veçanërisht kur ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis masave që një ankues mund të presë që të ndërmerren në mënyrë legjitime nga autoritetet dhe gëzimit efektiv të pronës së tij ... Prandaj, është përgjegjësia e shtetit të përdorë të gjitha mjetet juridike në dispozicion për të zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, pavarësisht faktit se vendimi është dhënë kundër një pale private, si dhe të sigurojë përmbushjen e rregullt të gjitha procedurave të brendshme ...(§81-83)."

[113] *Çështja nr.6397/04, vendim i datës 14 shkurt 2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-96025*
[114] *Shih shënimin 32*
[115] *Steven Greer, The Margin of Appreciation: Interpretation and Discretion under The European Convention on Human Rights, Human Rights Doracaku nr. 7, Këshilli i Evropës (2000), f.8-9.http://www.echr.coe.int/LibraryDocs/DG2/HRFILES/DG2-EN-HRFILES-17(2000).pdf*
[116] *Çështja nr.11890/05), vendim i datës 28 prill 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-92484*

Lista e pyetjeve

- Shpjegoni nocionin e detyrimeve pozitive dhe detyrimeve negative.
- Cilat të drejta të parashikuara në Konventë mbështesin detyrimin pozitiv të Palëve të Larta Kontraktuese?
- Çfarë fushëveprimi duhet të ndjekin detyrimet pozitive dhe cilat kritere duhen pasur parasysh kur identifikohen ato?
- Çfarë është detyrimi pozitiv procedural?

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Keegan kundër Irlandës";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Marckx kundër Belgjikës"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*X dhe Y kundër Holandës*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Airey kundër Irlandës*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Bushati kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Bajrami kundër Shqipërisë"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Bijelić kundër Malit të Zi dhe Serbisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Plattform "Ärzte für das Leben" kundër Austrisë".*

3. Subsidiariteti dhe doktrina e shkallës së katërt (nën-parimi i tretë i mbrojtjes efektive)

Parimi i subsidiaritetit. Sipas parimit të subsidiaritetit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa është e ndërvarur nga përgjegjësia kryesore e autoriteteve vendase për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka për qëllim t'u vijë në ndihmë sistemeve vendase që të mbrojnë të drejtat e njeriut. Në fakt është me vend që gjykatat vendase duhet të anagazhohen fillimisht për përcaktimin e çështjeve të pajtueshmërisë së ligjit të brendshëm me Konventën. Kështu nëse, një aplikim do të paraqitet më pas në Strasburg, Gjykata Europiane do të ketë të paktën mundësinë të konsiderojë dhe pikëpamjet e gjykatave vendase, çfarë është e rëndësishme, pasi janë ato që kanë kontakt të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me subjektet e vendeve të tyre.

Shembull. *Në çështjen "Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar"*[117] Gjykata Europiane e ka bazuar parimin e subsidiaritetit në Nenin 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe Nenin 35 të Konventës (kriteret e pranueshmërisë), të cilat parashikojnë që Gjykata Europiane mund të merret me një çështje vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet e brendshme juridike.'[118]

Shembull. *Në çështjen "Bajrami kundër Shqipërisë"*[119] Gjykata vëren se "qëllimi i Nenit 35 është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë për të parandaluar ose për të vënë në vend shkeljen e pretenduar kundër tyre përpara se këto pretendime të depozitohen para asaj.[120]" Si rezultat, cdo ankesë e paraqitur në Gjykatë duhet së pari të depozitohet në gjykatat përkatëse vendase, të paktën në thelb, në përputhje me kërkesat formale të ligjit të brendshëm dhe brenda afateve të përcaktuara me ligj. Megjithatë, bëhet fjalë vetëm për ushtrimin e atyre mjeteve të brëndshme që lidhen direkt me shkeljet e pretenduara, dhe në të njëjtën kohë janë të mundshme dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e mjeteve të tilla të brendshme duhet të jetë mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, në të kundërt, ato nuk ofrojnë as aksesin dhe as efikasitetin e duhur. Në këtë kuadër, i takon shtetit përkatës që të provojë përmbushjen e këtyre kushteve të ndryshme."

Shembull. *Në çështjen "Grori kundër Shqipërisë"*[121] Gjykata përsëriti se "rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme i detyron ata që kërkojnë të ngrenë një çështje kundër një shteti në një organ ndërkombëtar gjyqësor, ose në arbitrazh, të përdorin, së pari, mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor vendas. Rregulli bazohet në prezumimin se ekzistojnë mjete efektive juridike në lidhje me një shkelje të brendshme të pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë pjesë ose jo në ligjin e brendshëm. Në këtë mënyrë, ky është një aspekt i rëndësishëm i parimit që mekanizmi mbrojtës i ngritur në zbatim tëKonventës mbetet komplementar ndaj sistemeve vendase që sigurojnë ruajtjen e të drejtave të njeriut. Në të njëjtën kohë, është detyrimi i qeverisë të sigurojë një mjet efektiv i cili të jetë i aksesueshëm si në teori ashtu dhe në praktikë, për Gjykatën, në kohën materiale, një mjet juridik që është i pakontestueshëm,, i aftë për të ofruar zgjidhje ndaj pretendimeve të ankuesit dhe për të përftuar mundësi të arsyeshme."

[117] *Çështja nr. 13378/05, vendim i datës 29 prill 2008, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-86146*
[118] *Shih Nicholas Bamforth, nenet 13 dhe 35 të Konventës në të drejtën e brendshme (2016) European Human Rights Law Review, No.5, 501-507.*
[119] *Shih shënimin 32.*
[120] *Si në rastin e Hentrich k. Francës, vendim i datës 22 shtator 1994, seritë A nr. 296-A, f. 18, § 33, dhe Remli k. Francës, Vendim i datës 23 prill 1996, Raporte mbi aktgjykimet dhe aktvendimet 1996-II, f. 33).*
[121] Çështja nr.25336/04, vendim i datës 7 korrik 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-93410

3.1. Parimi i shkallës së katërt

Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, GJEDNJ-ja është shprehur se Neni 6§1 i Konventës nuk lejon që Gjykata të veprojë si shkallë e katërt ankimimi. Pa dyshim që nuk është detyrë e Gjykatës që të japë vlerësimin e vet lidhur me faktet dhe provat, pra të mos zëvendësojë qëndrimin e gjykatave vendase dhe, si rregull i përgjithshëm, u takon këtyre gjykatave që të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e Gjykatës është thjesht të konstatojë nëse proceset gjyqësore, të shqyrtuara në tërësinë e tyre, përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, janë ose s'janë të drejta. (*Bernard kundër Francës*, § 37)[122].

Shembull. ***Në çështjen "Balliu kundër Shqipërisë"***[123] Gjykata rithekson se "pranueshmëria e provave kryesisht duhet rregulluar sipas së drejtës së brendshme dhe se, si rezultat, janë gjykatat vendase ato që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e institucioneve të Konventës është që të sigurojnë së proceset gjyqësore në tërësinë e tyre, përfshirë edhe mënyrën në të cilën merren provat, janë ose jo të drejta. Si rregull, këto të drejta kërkojnë që palës së paditur t'i jepet mundësia e duhur dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe për të pyetur një dëshmitar kundër tij qoftë kur ai jep dëshminë, qoftë në një fazë të mëvonshme të procedurave gjyqësore."

I. Shembuj të praktikës gjyqësore lidhur me doktrinën e shkallës së katërt

Në pjesën vijuese ofrohen disa shembuj të praktikës gjyqësore të zbatimit të doktrinës së shkallës së katërt në tri situata, ku pretendimet për shkelje të Nenit 6(1) të Konventës janë gjykuar nga Gjykata Europiane: (*i) vendimet vendase jo-konsistente dhe parimi i sigurisë juridike; (ii) gabimet e faktit, ose të së drejtës; dhe (iii) mungesa e arsyetimit ose bazës ligjore.*

a. Vendimet vendase jo konsistente dhe parimi i sigurisë juridike

Shembull. ***Në çështjen "Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi"***[124] Gjykata përsëriti se nuk i përket asaj të vërë në pikëpyetje interpretimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat vendase. Gjithashtu, në parim, nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendase, edhe nëse ato jepen në procese dukshëm të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave vendase... Gjithashtu, është vlerësuar se disa dallime në interpretim mund të pranohen si tipar i pandashëm i çdo sistemi gjyqësor, i cili, ashtu si sistemi malazez, bazohet në një rrjet gjykatash të shkalës së parë dhe gjykatash apeli me autoritet mbi një territor të caktuar ... Megjithatë, dallimet të thella dhe afatgjata në praktikën e gjykatave më të larta vendase mund të jenë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, një parim ky që nënkuptohet në Konventë dhe që përbën një ndër elementet bazë të sundimi i ligjit ...Për vlerësimin nëse ka cënim të parimit të sigurisë juridike sipas kërkesave të së drejtës për proces të rregullt ligjor në baze të Nenit 6 të Konventës si pasojë e vendimeve të kundërta të gjykatavemë të larta vendaseNeniduhen zbatuar kriteret që përcaktojnë nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të

[122] Çështja nr.22885/93, vendim i datës 23 prill 1998,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-58161
[123] Çështja nr.74727/01, vendim i datës 16 qershor 2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-69401
[124]Çështjanr. 18650/09, 18676/09, 18679/09, 38855/09, 38859/09, 38883/09, 39589/09, 39592/09, 65365/09dhe7316/10, vendim i datës 22 tetor 2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-110384

një gjykate të lartë, si dhe nëse ligji i brendshëm ka krijuar një mekanizëm për zgjidhjen e këtyre kundërshtive, nëse po, si është zbatuar ky mekanizëm në praktikë dhe cfarë efektesh ka sjellur ... Së fundmi, është pranuar se trajtimi i ndryshëm i dy mosmarrëveshjeve nuk mund të konsiderohet se shkakton konflikt në praktikën gjyqësore, kur kjo justifikohet nga një ndryshim në situatat faktike në fjalë ... "

Shembull. ***Në çështjen "Stanković dhe Trajković kundër Serbisë"***[125] Gjykata u shpreh se "parimi i sigurisë juridike garanton, *inter alia*, një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon për rritjen e besimit të publikut në gjykatat. Nga ana tjetër, nëse vendimet gjyqësore kontradiktore vijojnë kjo gjë mund të krijojë gjendjen e pasigurisë juridike, e cila ka gjasa të zvogëlojë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, ndërkohë që një besim i tillë përbën një ndër komponentët themelorë të një shteti të bazuar në sundimin e ligjit... (vi) Sidoqoftë, kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtja e besimit të ligjshëm të publikut nuk lindin të drejat për të fituar njëjtësimin e praktikës, pasi nga ana tjetër, nëse nuk ndiqet një qasje dinamike dhe evolutive do të pengonte reformimin apo përmirësimin e mëtejshëm të praktikës gjyqësore".

b. Gabimet e faktit ose të ligjit

Shembull. ***Në çështjen "Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi"***[126]Gjykata thekson se "në përputhje me Nenin 19 të Konventës, detyra e saj është që të sigurojë respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga Palët Kontraktuese në Konventë. Përveç kësaj, nuk është funksioni i Gjykatës që të merret me trajtimin e gabimeve të faktit, ose të ligjit, që pretendohen të jenë bërë nga një gjykatë vendase, vetëm me përjashtim të rasteve kur gabime të tilla mund të kenë cuar në cënimin e të drejtave apo lirive që mbrohen nga Konventa."

c. Mungesa e arsyetimit ose bazës ligjore

Shembull. ***Në çështjen "Barać dhe të tjerët kundër Malit të Zi"***[127] Gjykata vendosi se " parimi i procesit të rregullt ligjor nuk përmbushet kur arsyeja e dhënë në vendimin e gjykatave vendase, nuk nuk gjen parashikim në ligjin e brendshëm dhe, për rrjedhojë, nuk është juridikisht e vlefshme ... kur organi kompetente refuzojnë të regjistrojnë ankuesin në listën e "kandidatëve për avokatë" duke u mbështetur në një arsye që nuk është e parashikuar fare në legjislacionin përkatës ... Duke iu kthyer çështjes nën shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë kundër ankuesve është mbështetur vetëm në një akt, i cili më parë ishte shpallur jokushtetues dhe vendimi përkatës për këtë qëllim kishte qënë botuar në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë, Ligji "Për ndryshimet e punës", i vitit 2004 e ka humbur fuqinë dhe, si i tillë, nuk është i zbatueshëm në rastin e ankuesve, siç parashikohet me Nenin 69§1 të Kushtetutës në fuqi në atë kohë (shih paragrafin 13 më sipër). Prandaj, baza e vetme ligjore për mbështetjen e vendimittë Gjykatës së Lartë nuk ishte e vlefshme në kohën e shqyrtimit të çështjes. Në këtë pikë nuk është e rëndësishme të diskutohet nëse

[125] *Çështja nr. 37194/08 dhe 37260/08, vendim i datës 22 dhjetor 2015, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-159376*
[126] *Shih shënimin 128.*
[127] *Çështja nr. 47974/06, vendim i datës 13 dhjetor 2011, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-107943*

legjislacioni i kundërshtuar është shpallur jokushtetues për arsye formale, apo substanciale (shih paragrafët 15 dhe 31 më sipër) ".

Shembull. ***Në çështjen "Milojević dhe të tjerët kundër Serbisë"***[128] Gjykata rithekson se "sipas praktikës gjyqësore të saj, që trajtojnë parimin mbi administrimin e drejtë të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunalëve duhet të shprehin në mënyrë të përshtatshme arsyet mbi të cilat ato bazohen. Shkalla e zbatimit në praktikë për parimin në fjalë dhe detyrimin për të shprehur arsyet e vendimmarrjes mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit dhe rrethanave të çështjes ... Edhe pse Neni 6/1 i detyron gjykatat të japin arsyet për vendimet e dhëna prej tyre, kjo nuk duhet kuptuar se kërkohet përgjigje e hollësishme për çdo argument të ngritur nga palët e përfshira ... Megjithatë, kur gjykatat duhet të zbatojnë rregulla ligjore të cilat kanë përmbajtje të paqartë, ato thjesht duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të dhënë arsye të mjaftueshme se përse është zbatuar specifikisht ky rregull, nisur nga rrethanat e rasteve specifike.Mjaftimi thjesht nëcitimin e formulimit të dispozitës së paqartë nuk përbën standart të mjaftueshëm arsyetimi.

- **Rast studimor "Mullai kundër Shqipërisë"**[129]

Ankuesi në këtë çështje, kompania "Tekno-Project sh.pk", pretendon që autoritetet shtetërore i kanë vonuar pa arsye, për thuajse 9 vjet, zbatimin e vendimit nr. 766, datë 22.12.1998 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, në shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor (Neni 6.1 i Konventës) dhe së drejtës për gëzimin e pronës (Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës). Më specifikisht, ankuesi pretendon për:
(1) shkelje të parimit të sigurisë juridike të garantuar nga Neni 6.1 i Konventës në lidhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit, datë 14.12.2005,Neni;
(2) mosekzekutimin e vendimit nr. 66, datë 22.12.1998, për miratimin e lejes së ndërtimit gjatë periudhës së pezullimit të punimeve përmes aktit të Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit të Tiranës (DPNT);
(3) shkelje të së drejtës për gëzim paqësor të të drejtave të pronësisë, brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit nr.1 në lidhje me pezullimin e punimeve.

Faktet. Autoritetet shqiptare kanë njohur të drejtat e pronësisë për pronarët Mullai, mbi një parcelë toke prej 1,515 m^2, përkatësisht me vendimin nr. 1039, datë 30.12.1994 dhe vendimin nr. 100, datë 8.8.2002, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Gjithashtu, Bashkia e Tiranës miratoi truallin e ndërtimit për dy objekte (16-katëshe), në favor të tyre, me vendimin nr. 670, datë 23.10.1998 të KRT-së. Më pas, pronarët Mullai arritën me vullnetin e tyre në nënshkrimin e një kontrate me kompaninë "Tekno-Projekt", për kryerjen e ndërtimeve. Me vendimin nr. 766, datë 22.12.1998, KRT-ja miratoi lejen e ndërtimit në favor të kompanisë "Tekno-Project". Në fillim, zbatimi i vendimit të sipërpërmendur për lejen e ndërtimit u pezullua nga Drejtoria e Policisë së Ndërtimit, në zbatim të një vendimi të prefektit të Tiranës (dhe më pas

[128] *Çshtja nr. 43519/07, 43524/07 dhe 45247/07, vendim i datës 12 janar 2016, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-159880*
[129] *Çështja nr.9074/07, vendim (themeli), datë 23 mars 2010, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-97882*

të Ministrit të Punëve të Brendshme), me arsyetimin se leja e ndërtimit ishte e pavlefshme, pasi ishte lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për planifikimin urban". Urdhri i pezullimit parashikonte edhe se ligjshmëria e lejes së ndërtimit duhet të vlerësohet nga KRT-ja. Pezullimi i punimeve të ndërtimit u hodh në gjyq në Gjykatën e Rrethit Tiranë nga kompania "Tekno-Project". Në fund të procesit gjyqësor, gjykata u shpreh se e konsideronte pezullimin të ligjshëm deri sa KRT-ja të shprehej përfundimisht për këtë çështje. Më 19 mars 2001, Ambasada Zvicerane, si palë e interesuar, për shkak se ndërtesa i zinte pjesën perëndimore të selisë së saj, ngriti padi kundër kompanisë "Tekno-Project" në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me objekt shpalljen të pavlefshme të lejes së ndërtimit. Mbi këtë objekt janë organizuar tri procese gjyqësore, të cilat kanë zgjatur gjithsej për më shumë se 9 vjet.

Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "Mullai kundër Shqipërisë". Gjykata konstatoi se arsyetimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 29 mars 2001 është i parregullt, pasi në të thuhet se vendimi i datës 12 janar 2000 i prefektit të Tiranës ishte *ultra vires* për shkak të mosshterimit të mjeteve të brendshme juridike në lidhje me vlefshmërinë e lejes së ndërtimit për objektin. Në të njëjtin vendim, Gjykata e Lartë e ka kundërshtuar këtë përfundim duke e deklaruar të vlefshme lejen e ndërtimit. Gjykata Europiane është e mendimit që kundërshtime të tilla brenda të njëjtit vendim nuk janë në përputhje me funksionin gjyqësor dhe rolin që duhet të ketë Gjykata e Lartë në zgjidhjen e konflikteve dhe shmangien e divergjencave (e cila duhet të jetë uniforme në vendimet që merr). Vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë gjithashtu burim për pasiguri juridike, duke ushtruar ndikim mbi besimin e publikut të individëve në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit. Si rezultat, proceset gjyqësore kanë ushtruar ndikim të ndjeshëm në klimën e përgjithshme të pasigurisë juridike. Mënyra se si kanë proceduar autoritetet vendase, ka shkelur të drejtën e ankuesve për të kërkuar zgjidhje ndajkërkesavetë tyre në mënyrë të qartë, koherente dhe me qëndrueshmërinë e duhur. Gjykata vëren më tej se proceset e brendshme, veçanërisht mënyra në të cilën është zhvilluar procesi gjyqësor, kanë shkelur parimin e sigurisë juridike në kuptimin e Nenit 6§1 të Konventës për shkak të interpretimit jokonsistent të Gjykatës së Lartë. *Për rrjedhojë*, Gjykata vlerësoi se shtyrja e vlefshmëria e lejes së ndërtimit për dy vjet dhe rifillimi i punimeve do të ishte forma më e përshtatshme e kompensimit për ankuesit[130]. *Prandaj*, palët u ftuan të negociojnë dhe të arrijnë një marrëveshje për përcaktimin e shumës së kompensimit për kompaninë ankuese, si edhe për anëtarët e familjes Mullai.[131]

Lista e pyetjeve

- Diskutoni rreth çështjes *"Mullai kundër Shqipërisë"* dhe parimeve të aplikuara nga Gjykata për përcaktimin e çështjes.
- Shpjegoni se çfarë është parimi i subsidiaritetit.
- Shpjegoni parimin e doktrinës së shkallës së katërt.
- Cili është parimi themelor i përdorur nga Gjykata për të bërë përcaktimin e çështjeve që kanë të bëjnë me: (1) vendimet vendasvendase jokonsistente dhe parimin e sigurisë juridike; (2) gabimet e faktit dhe të ligjit; (3) mungesën e arsyeve, ose bazës ligjore?

[130] Takimi i 1250-të (8-10 mars 2016) (DH) – Raport për masat (25/09/2015) – Komunikim nga Shqipëria në lidhje me çështjen Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë(Çështja Nr. 9074/07) [Anglais uniquement]
[131] Si ish-pronari i një vile trikatëshe, objekt apeli.

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Bajrami kundër Shqipërisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Grori kundër Shqipërisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Balliu kundër Shqipërisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Stanković dhe Trajkovič kundër Serbisë"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "Barać dhe të tjerët kundër Malit të Zi"
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Milojević dhe të tjerët kundër Serbisë"*

B. Parimi i interpretimit dinamik

Të drejtat e përgjithshme të garantuara nga KEDNJ-ja konsiderohen si standarde që mund të evolojnë në raport me zhvillimet shoqërore përkatëse, duke siguruar që niveli i mbrojtjes së çdo të drejte individuale të pasqyrojë në çdo kohë kushtet e sotme në shtetet anëtare. Objekti dhe qëllimi i KEDNJ-së dhe preambula e saj theksojnë synimin për t'i shërbyer "realizimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut" dhe lehtësimin e një "kuptimi uniform" të këtyre të drejtave. Kjo qasje synon krijimin e një konsensusi mbare europian, sa i përket implikimeve të një të drejte të parashikuar në KEDNJ në lidhje me një çështje specifike që lidhet me një të drejtë të caktuar. Në lidhje me këtë, Gjykata ka kërkuar angazhimin e palëve kontraktuese që të mos ndërmarrin detyrime të tjera ndërkombëtare që janë në konflikt me KEDNJ-në. Pavarësisht nga kjo, bazuar në parimin e "hapjes së përgjithshme", Gjykata herë pas here ka marrë parasysh praktikën gjyqësore të gjykatave të tjera ndërkombëtare, vendimet e gjykatave vendase që interpretojnë aktet ligjore vendase apo të drejta, norma ose standardet të përcaktuara nga organet të tjera të Këshillit të Evropës.

KEDNJ-ja është traktat ligjbërës, çfarë do të thotë se kërkohet interpretimi që është më i përshtatshëm për të realizuar qëllimin dhe për të arritur objektin e Konventës, dhe që do të kufizonte në shkallën më të madhe detyrimet e ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese (*Wemhoff kundër Gjermanisë*).[132] Kjo qasje teleologjike e ka çuar Gjykatën Europiane ta interpretojë Konventën si "instrument të gjallë", i cili duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në mënyrë që të reflektojë ndryshimin e sjelljeve të shoqërisë në shtetet anëtare. Në këtë drejtim, Gjykata Europiane udhëhiqet në interpretimin e Konventës duke u mbështetur në parashikimet e Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve (nenet 31[133] dhe 32[134]).

Shembull. ***Në çështjen "Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar"***[135] Dhoma e Madhe shpjegoi qasjen e saj teleologjike në kontekstin e një rasti që ka të bëjë me statusin ligjor të transeksualëve, në mënyrë që të justifikonte distancimin nga praktika e saj e mëparshme gjyqësore. Megjithatë, meqenëse Konventa përbën, në radhë të parë, një sistem për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Gjykata duhet të ketë parasysh kushtet në ndryshim brenda shtetit përgjegjës dhe brenda Shteteve Kontraktuese në përgjithësi dhe të përgjigjet, për shembull, për çdo konvergjencë në evoluim që shfaqet në lidhje me standardet që duhet të arrihen ... Është shumë e rëndësishme që Konventa të

[132] *Çështja nr.2122/64, vendim i datës 27 qershor 1968, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57595*

[133] *Neni 31 i KVDT-së, i cili përcakton parimet e përgjithshme për interpretimin e një traktati, në pjesët përkatëse parashikon si më poshtë:*

1. Traktati duhet të interpretohet në mirëbesim, në përputhje me kuptimin e zakonshëm që i është dhënë kushteve të traktatit në kontekstin përkatës dhe në dritën e qëllimit dhe objektit të tij.

2. Konteksti për qëllimin e interpretimit të një traktati do të përfshijë, përveç tekstit, edhe preambulën, edhe shtojcat.

[133] *Neni 32 i KVDT-së parashikon si më poshtë:*

Ndihmë mund t'u kërkohet mjeteve plotësuese të interpretimit, duke përfshirë punën përgatitore të traktatit dhe rrethanat e lidhjes së tij, me qëllim për të konfirmuar kuptimin që vjen nga zbatimi i Nenit 31, ose për të përcaktuar kuptimin kur interpretimi sipas Nenit 31:

(a) e lë kuptimin të paqartë ose të errët; ose

(b) çon në një rezultat i cili është haptazi absurd ose i paarsyeshëm.

[135] *Çështja nr.28957/95, vendim i datës 11 korrik 2002, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57974*

interpretohet dhe të zbatohet, në mënyrë të tillë që i bën të drejtat e saj praktike dhe efektive, dhe jo teorike dhe iluzive. Dështimi nga ana e Gjykatës për të ruajtur një qasje dinamike dhe evolutive do të përbënte një riskqë Gjykata të kthehej në një pengesë për reforma ose përmirësime të mëtejshme.

Shembull. ***Në çështjen "Radunović dhe të tjerët kundër Malit të Zi"***[136] Gjykata u shpreh se: "Për më tepër, Konventa duhet të interpretohet sipas rregullave të përcaktuara në Konventën e Vjenës, datë 23 maj 1969, "Mbi të drejtën e traktateve", Neni 31§3 (c) i së cilës parashikon se "Duhet të merret në konsideratë çdo rregull përkatës i së drejtës ndërkombëtareqë zbatohet në marrëdhëniet midis palëve". Konventa, duke përfshirë edhe Nenin 6 të saj, nuk mund të interpretohet në vakuum. Prandaj, Gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për karakterin e veçantë të Konventës si traktat i të drejtave të njeriut dhe duhet të marrë po ashtu parasysh rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me dhënien e imunitetit për shtetin".

1. Neni 6§1 dhe qasja teleologjike

Si rezultat i qasjes teleologjike, Gjykata Europiane, në interpretimin e Nenit 6§1, ka zhvilluar një sërë të drejtash të nënkuptuara, duke përfshirë: a) të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës; b) të drejtën për zbatimin e vendimeve; dhe c) të drejtën për përfundimin e vendimeve gjyqësore.

1. a. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate

Gjykata Europiane kupton me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës bazuar në Nenin 6 (1), duke arsyetuar se një e drejtë e tillë është thelbësore për të siguruar mbrojtjen e të drejtave procedurale të garantuara sipas Nenit 6(1) të Konventës. Gjykata Europiane ka theksuar vazhdimisht se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës duhet të jetë efektive.

Shembull. ***Çështja "Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar"***[137] ka të bëjë me një të burgosur që kërkon të kontaktojë një avokat me qëllim hapjen e proceseve gjyqësore civile për shpifje kundër një punonjësi burgu, i cili pretendon se i është mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Gjykata u shpreh në seancë plenare se: "Sipas mendimit të Gjykatës, do të ishte e pakonceptueshme që Neni 6 paragrafi 1 (Neni 6-1) të përshkruante në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve në një padi në pritje të gjykimit dhe që ajo të mos mbronte së pari atë që në fakt bën të mundur përfitimin nga garanci të tilla, pra të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Karakteristikat e proceseve ligjore, si të rregullta, publike dhe të shpejta, nuk kanë pikë vlere nëse nuk në radhë të parë nuk ka një procedurë gjyqësore".

Shembull. ***Në çështjen "Lawyer Partners A.S. kundër Sllovakisë"***[138] Gjykata përsërit se "Konventa synon të garantojë të drejta që nuk janë teorike apo iluzive, por që janë

[136] *Çështjet nr. 45197/13, 53000/13 dhe 73404/13, vendim i datës 25 janar 2017, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-167803*
[137] *Çështja nr.4451/70, vendim i datës 21 shkurt 1975, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57496*
[138] *Çështja nr .54252/07, 3274/08, 3377/08, 3505/08, 3526/08, 3741/08, 3786/08, 3807/08, 3824/08, 15055/08, 29548/08, 29551/08, 29552/08, 29555/08 dhe 29557/08), vendim i datës 6*

praktike dhe efektive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me Nenin 6§1 të Konventës, duke pasur parasysh vendin e shquar që zë në një shoqëri demokratike e drejta për proces të rregullt ligjor. Duhet gjithashtu të kihet parasysh se pengesa në lidhje me procesin e rregullt ligjor mund të bjerë në kundërshtim me Konventën, ashtu siç do të ndodhte në rastin e një pengesë ligjore (shih *Andrejeva kundër Letonisë* [GC], nr. 55707/00 / 98, KEDNJ 2009, me referenca të mëtejshme, § 51). "

Shembull. ***Në çështjen "Marini kundër Shqipërisë"***[139] Gjykata konstatoi se "paaftësia e Gjykatës Kushtetuese për të dalë me një vendim të arsyetuar vetëm për shkak se procedurat e parashikuara në Nenin 74 të ligjit "Për organizimin e MKK-ve" kërkonin shumicën absolute të një paneli prej 9 anëtarësh, e vendosi për një kohë të gjatë kërkuesin në një situatë të papërcaktuar, duke çuar në shkelje të thelbit të së drejtës së tij të aksesit për t'iu drejtuar gjykatës, sipas Nenit 6 të Konventës. Qasja e sistemit ligjor shqiptar për rregullimin e procedurave të GJK-së është mjaft e ndryshme nga rregullimi që i kanë bërë sistemet e shteteve të tjera anëtare. Në këtë drejtim, është e nevojshme të modifikohet sistemi ligjor shqiptar, me qëllim që të sigurohen procese alternative për arritjen e shumicës absolute në çdo rast".

Shembull. ***Në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë"***[140] Gjykata konstatoi se " Komisioni i Ankesave për ekzaminimet mjekësore në lidhje me aftësinë për punë nuk përbën një trup të pavarur dhe të paanshëm të ekzaminiminimit, kështu që, për rrjedhojë, vendimet e tij nuk mund të quhen *ekzekutive* dhe, si të tilla, duhet t'i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor në lidhje me të drejtën për ankimim. Refuzimi i gjykatave të brendshme për të shqyrtuar kërkesën e ankuesit kundër një vendimi të këtij Komisioni, përbën shkelje të së drejtës së aksesit të ankuesit për t'iu drejtuar gjykatës".

Shembull. ***Në çështjen "Shkalla kundër Shqipërisë"***[141] Gjykata vëren se "procedimet dhe dënimi i ankuesit janë kryer *në mungesë*. Nga të dhënat në dosjen e çështjes rezulton se ankuesi është njoftuar për dënimin e tij në mungesë vetëm më 14 qershor 2003, datë në të cilën ai iu dorëzua autoriteteve. Prandaj, Gjykata konstaton se data e fillimit të llogaritjes së afateve ligjore për parashtrimin e ankesës kushtetuese nga ana e ankuesit duhej të ishte maksimumi deri më 14 qershor 2005. Gjykata shprehet se vendimi i kundërshtuar përbën mohim të pajustifikueshëm të së drejtës së ankuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese."

1.b. E drejta për ekzekutimin e vendimeve

Gjykata Europiane është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës do të ishte "iluzive", nëse nuk do të përfshinte edhe të drejtën për ekzekutimit efektiv të urdhrit/vendimit përfundimtar të detyrueshëm të gjykatës. Pra, sipas Nenit 6 (1) të Konventës, e drejta për ekzekutimin e vendimeve është pjesë integrale e së drejtës për gjykim.

---

nëntor 2009,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-92959

[139] Çështja nr.3738/02, vendim i GJEDNJ-së(themeli dhe kompensimi i drejtë, datë 18 dhjetor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-84061

[140] Shih shënimin 93.

[141] Çështja nr.26866/05, vendim i datës 10 maj 2011, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-104710

Shembull. ***Në çështjen "Vukelić kundër Malit të Zi"***[142]Gjykata rikujton se "Neni 6§1 i Konventës, *inter alia*, mbron edhe zbatimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare, të cilat, në shtetet që funksionojnë në bazë të parimit të sundimin e ligjit, nuk mund të qëndrojnë pa vepruar në dëm të njërës palë. Prandaj, ekzekutimi i një vendimi gjyqësor nuk mund të pengohet, shfuqizohet, ose shtyhet padrejtësisht (shih, ndër autoritetet e tjera, *Hornsby k, Greqisë*, 19 mars 1997§40, raportet e aktgjykimeve dhe të vendimeve 1997 II). Shteti ka detyrimin që të organizojë një sistem efektiv për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe ajo praktike... Më tej, Gjykata vëren se, pavarësisht nëse zbatimi duhet të kryhet kundër një subjekti privat apo shtetëror, shteti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm, në kuadër të kompetencave të tij, për arritur në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe, duke vepruar kështu, për të siguruar pjesëmarrjen efektive të të gjithë aparatit të tij. Në të kundërt, shteti është në shkelje për mospërmbushje të kërkesave sipas Nenit 6§1 ... Megjithatë, moszbatimi i një vendimi, për shkak të mospagesës së debitorit, nuk mund t'i ngarkohet paaftësisë së shtetit, përveç rasteve dhe në masën që situata shkaktohet nga autoritetet vendase, siç mund të jetë, për shembull, rasti i gabimeve ose vonesës së shkaktuar prej tyre në procesin e përmbarimit ... Së fundmi, Gjykata përsërit se procedurat e ekzekutimit, nisur për nga vetë natyra e tyre, duhet të trajtohen me shpejtësi".

Shembull. ***Në çështjen "Qufaj kundër Shqipërisë"***[143]Gjykata argumentoi se: "autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me mungesën e fondeve për mospërmbushjen e një detyrimi financiar që rrjedh nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim, në rrethana të veçanta, vonesa në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet. Megjithatë, kjo vonesë nuk mund të jetë deri në atë masë sa të ushtrojë ndikim mbi thelbin e të drejtës së mbrojtur sipas Nenit 6§1 të Konventës. E drejta për proces të rregullt ligjor mbetet iluzive dhe e humbet qëllimin e saj nëse sistemi i brendshëm ligjor i lejon autoritetet vendase që të refuzojnë, të neglizhojnë ose të vonojnë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë në dëm të një pale".

Shembull. ***Në çështjen "Zyflli kundër Shqipërisë"***[144] Gjykata ka përsëritur se "rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike të përmendura në Nenin 35§1 të Konventës e detyron ankuesit që të përdorë mjete juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor. Ekzistenca e mjeteve juridike duhet të garantohet si nga pikëpamja teorike ashtu edhe në praktikë. E drejta për kompensim, brenda kuptimit të paragrafit 5, lind nëse autoritetet ose gjykatat e brendshme shkelin të paktën një ndër paragrafët e mësipërm të Nenit 5 të Konventës.

1. c. E drejta për vendime gjyqësore përfundimtare

Shembull. ***Në çështjen "Brumărescu kundër Rumanisë"***[145] Gjykata u shpreh se "e drejta për proces të rregullt ligjor pranë një gjykate, e garantuar nga Nenin 6/1 i Konventës, duhet të interpretohet në dritën e Preambulës së Konventës, e cila

[142] *Çështja nr. 58258/09, vendim i datës 4 qershor 2013, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-120064*
[143] *Shih shënimin 53.*
[144] *Çështja nr.12310/04, vendim i datës 27 shtator 2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-70629*
[145] *Çështja nr. 28342/95, vendim i datës 28 tetor 1999, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-58337*

deklaron, *inter alia*, se sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një ndër aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon, ndër të tjera, që gjykatat të vendosin përfundimisht për një çështje dhe që vendimi i tyre të mos vihet në pikëpyetje".

Shembull. Në çështjen "*Driza kundër Shqipërisë*"[146] Gjykata konstatoi se Gjykata e Lartë e kishte rrëzuar çështjen dy herë, pas 2 vjetësh dhe 7 muajsh, pas vendimi përfundimtar në favor të ankuesit, një herë përmes vendimit të dhënë në procedura paralele dhe herën tjetër me anë të ushtrimit të rekursit në interes të ligjit, gjë që ka çuar në shkelje të sigurisë juridike sipas Nenit 6§1 të Konventës. Në dritën e Nenit 6 të Konventës, garantimi i parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton respektimin e parimit *res judicata,* kërkon që vendimet e gjykatave më të ulëta për një çështje të caktuar të mos vihen në pikëpyetje më vonë nga gjykatat e juridiksioneve më të larta. Gjykatat e larta kanë të drejtë vetëm të korrigjojnë gabimet ose pasaktësitë e vendimeve përfundimtare të gjykatave më të ulëta, por asnjëherë ta gjykojnë çështjen në themel".

Shembull. Në çështjen "*Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë*"[147]Gjykata u shpreh se: "siguria juridike presupozon respektimin e parimit *res judicata*, pra, parimin e gjësë së gjykuar. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e një vendimi përfundimtar vetëm për arsyen e rigjykimit të një seance gjyqësore apo rigjykimit të cështjes në tërësi. Kompetencat e gjykatave më të larta për rishqyrtim duhet të ushtrohen për korrigjimin e gabimeve dhe të dështimeve në procesin e dhënies së drejtësisë, por jo për të realizuar një gjykim të ri të çështjes."

- **Rast studimor "Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar"**[148]

Objekti. Kërkesa u depozitua nga Handyside në vitin 1972, i cili u ankua për shkelje të Konventës, më specifikisht për shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes, në lidhje me të drejtën për pronën, duke iu referuar Nenit 10, 17, dhe P1-1.

Faktet: Richard Handyside, pronar i botimeve "Stage 1", bleu të drejtat britanike të "librit të vogël të kuq shkollor" (*little red school book*), shkruar nga Søren Hansen dhe Jesper Jensen, dhe botuar që nga viti 1976 në disa shtete. Libri kishte një përmbajtje, e cila konsiderohej as e arsyeshme, dhe as e nevojshme.[149]Handyside i dërgoi disa qindra kopje të librit, së bashku me një njoftim për shtyp, një grupi të përzgjedhur botuesish të gazetave vendase dhe lokale, si dhe në revista arsimore dhe mjekësore. Ai gjithashtu porositi disa reklama për librin. Libri u bë objekt i komenteve të gjera nga ana e shtypit, si të favorshme dhe të pafavorshme. Më 31 mars 1971, u konfiskuan përkohësisht 1.069 kopje të librit, së bashku me fletëpalosje, postera, karta informative dhe korrespondencën në lidhje me botimin dhe shitjen e librit. Më 1 prill 1971 u konfiskuan edhe 139 kopje të tjera. Nga tirazhi i 20.000 kopjeve, rreth 18.800 kopje i shpëtuan

[146] *Çështja nr. 33771/02, vendim i GJEDNJ-së(themel dhe kompensimi i drejtë), datë13 nëntor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-83245*
[147] *Çështja nr. 2141/03, vendim i datës 24 mars 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-102131*
[148] *Çështja nr.5493/72, vendim i datës 7 dhjetor 1976,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57499*
[149] *në Danimarkë, Belgjikë, Finlandë, Francë, Gjermaninë Perëndimore, Greqi, Islandë, Itali, Holandë, Norvegji, Suedi dhe Zvicër, si dhe disa vende joevropiane.*

konfiskimit dhe u shitën. Më 8 prill, një gjykatë e brendshme lëshoi dy njoftime për paraqitje kundër Handyside-it për posedim të librave të turpshëm për qëllime botimi për fitim. Handyside-i e ndërpreu shpërndarjen e librit dhe i kështilloi librarité në përputhje me rrethanat, por në atë kohë ishin rreth 17,000 kopje në qarkullim. Më 1 korrik 1971 Handyside-i u shpall fajtor për të dyja veprat, u gjobit me 25 paund për secilën akuzë dhe u urdhërua të paguante 110 paund. Ankimi i bërë më pas prej tij u rrëzua.

Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen. Komisioni konstatoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së shtetasit Handyside-it ishte e përcaktuar me ligj, pasi kishte qëllim legjitim dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, për rrjedhojë nuk ka pasur shkelje të Nenit 10 të KEDNJ-së. Komisioni vendosi unanimisht se nuk ishin shkelur të drejtat e pronësisë së Handyside-it (Neni 1 i protokollit nr. 1).

Raporti i Komisionit dhe seancat e mëvonshme pranë Gjykatës në qershor të vitit 1976 sollën në dritë diferenca të theksuara dhe të prera në lidhje me opinionet se si duhej vendosur në lidhje me "kufizimet" dhe "gjobat" aktuale të ankimuara nga ankuesi për aq sa ato mund të ishin "të domosdoshme në një shoqëri demokratike" "për mbrojtjen e moralit". Sipas qeverisë dhe shumicës së Komisionit, Gjykata duhet vetëm të vendoste nëse gjykatat angleze kishin vepruar në mënyrë të arsyeshme, në mirëbesim dhe brenda kufijve të pragut të vlerësimit që u njihet Shteteve Kontraktuese nga Neni 10, paragrafi 2.

Gjykata theksoi se mekanizmat e mbrojtjes, të krijuara nga Konventa, janë dytësore (subsidiare) në raport me sistemet vendase që mbrojnë të drejtat e njeriut. Konventa i lë secilit Shtet Kontraktues, në radhë të parë, detyrën e sigurimit të të drejtave dhe të lirive të parashikuara prej saj. Institucionet e krijuara nga sistemi i Konventës japin kontributin përkatës për këtë qëllim, por ato përfshihen vetëm përmes procedurave kontestuese dhe vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike (Neni 26) .
Këto komente zbatohen, sidomos, në Nenin 10 paragrafi 2. Në mënyrë të veçantë, nuk është e mundur që në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme kontraktuese të gjendet i njëjti koncept europian mbi moralin. Pikëpamja e përqafuar nga ligjet përkatëse të shteteve anëtare mbi kërkesat për moralin ndryshon nga njëra kohë në tjetrën, dhe nga njëri shtet në tjetrin, veçanërisht në epokën tonë, e cila karakterizohet nga një evolucion i shpejtë dhe i gjerë i opinioneve mbi këtë temë. Për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me forcat vitale të vendeve, autoritetet shtetërore në parim janë në një pozicion më të mirë sesa gjyqtari ndërkombëtar për të dhënë mendim për përmbajtjen e saktë të këtyre kërkesave, si dhe për "domosdoshmërinë" e një "kufizimi", ose "dënim" që synon përmbushjen e tyre[150]. Megjithatë, u takon autoriteteve vendase të bëjnë vlerësimin fillestar të realitetit të nevojës së ngutshme sociale që nënkuptohet nga nocioni i "domosdoshmërisë" në këtë kontekst.

Rrjedhimisht, Neni 10 paragrafi 2, u lë Shteteve Kontraktuese një prag vlerësimi. Ky prag i jepet si ligjvënësit vendas, ashtu edhe organeve, gjykatave, ndër të tjerave, të cilave u kërkohet të interpretojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi.

[150] *Gjykata vëren në këtë pikë që, edhe pse mbiemri "i nevojshëm", në kuptimin e Nenit 10 paragrafi 2, nuk është sinonim i mbiemrit "i domosdoshëm" (në Nenin 2, paragrafi 2 dhe 6 paragrafi 1) dhe "rreptësisht i domosdoshëm" në Nenin 15 paragrafi 1 (Neni 15-1), shprehja "deri në masën e kërkuar rreptësisht nga kërkesat e situatës, nuk ka fleksibilitetin e shprehjeve të tilla si" (shih tekstin në frëngjisht të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1) (P1-1), "i përshtatshëm" (shih paragrafin 3) (Neni 4-3) , "i arsyeshëm" (shih nenet 5 paragrafi 3 dhe 6 paragrafi 1) (Neni 5-3, Neni 6-1) ose "i dëshirueshëm".*

Lista e pyetjeve

- Diskutoni parimin e interpretimit dinamik në vendimin "*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar"*, dhe kriteret e zbatueshme për arsyetimin e tij.
- Diskutoni se si nocioni i "domosdoshmërisë" së një "kufizimi", ose "dënimi/gjobe", nënkupton "vlerësimin fillestar të realitetit të nevojës së ngutshme sociale" në rastin studimor.
- Diskutoni parimin e të drejtave të nënkuptuara dhe zbatimin e tij në lidhje me: 1) të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës; 2) të drejtën për zbatimin e vendimeve; 3) të drejtën për vendime gjyqësore përfundimtare.

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Radunović dhe të tjerët kundër Malit të Zi"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Marini kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Dautikundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Shkalla v. Albania"*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Vukelić kundër Malit të Zi"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Qufaj kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Zyflli kundër Shqipërisë"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Brumărescu kundër Rumanisë"*;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Driza kundër Shqipërisë*"'
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë".*

C. Parimi i balancimit të drejtë

Konventa synon arritjen e një balancimi të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit në tërësi dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Ky parim mbulon tri aspekte:

- **Aspekti substancial.** Të drejtat e mishëruara në KEDNJ kuptohen në një vështrim të gjerë, kështu që shpesh ato mund të kenë tensione me njëra-tjetrën, duke bërë të nevojshme gjetjet e një "balance" mes tyre. Kjo nënkupton që në disa situata, mbrojtja e të drejtave të një personi sjell ndërhyrje te të drejtat e një personi tjetër, ose shumë prej të drejtave të mishëruara në KEDNJ mund të krijojnë tensione në raport me interesa të ligjshme publike. Në raste të tilla, kufizimi i të drejtave mund të jetë i justifikueshëm në sistemin e brendshëm ligjor për promovimin e interesave të rëndësishëm publikë, siç janë siguria kombëtare, parandalimi i krimit, mirëqenia ekonomike e kombit, e kështu me radhë. Për shembull, KEDNJ-ja siguron kufizime legjitime të disa të drejtave në nenet 8 (2), 9 (2), 10 (2) dhe 11 (2).
- **Aspekti institucional.** Të drejtat e Konventës duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që të mos të heqin prerogativën e organeve shtetërore "të përgjegjshme dhe llogaridhënëse në mënyrë demokratike" të Shteteve të Larta Kontraktuese për të marrë vendime të rëndësishme në emër të komuniteteve përkatëse[151]. Sipas këtij parimi, shtetet kontraktuese gëzojnë një "prag vlerësimi" të caktuar, kur marrin masa legjislative, administrative ose gjyqësore në fushën e të drejtave të Konventës.
- **Aspekti procedural.** Ndërhyrja në të drejtën e KEDNJ-së, përmes çdo akti të përgjithshëm të një organi publik të një shteti kontraktues, duhet të bëhet në përputhje me parimin e sundimit të ligjit. Kjo normë dikton kërkesën e ligjshmërisë, si dhe kërkesën për drejtësi procedurale, duke iu referuar në veçanti procedurës së vendimmarrjes, e cila duhet të garantojë mbrojtje të përshtatshme kundrejt arbitraritetit.

1. Aspekti substancial (nën-parimi i parë për balancën e drejtë)

1.a. Kufizimet në të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës – testi i thelbit

Parimi i përgjithshëm që gjen zbatim për kufizimin e të drejtave të Konventës nënkupton se kur ka ndërhyrje në një të drejtë të caktuar, Shteti Kontraktues duhet të ketë një qëllim legjitim për justifikimin e ndërhyrjes dhe masa duhet të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur. GJEDNJ-ja është shprehur vazhdimisht se çdo kufizim i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës sipas Nenit 6§1 të Konventës nuk duhet të jetë i tillë "që të dëmtojë vetë thelbin e së drejtës". Megjithatë, Gjykata Europiane ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute. Përderisa kjo është një e drejtë që vetë Konventa e parashikon (shih nenet 13, 14, 17 dhe 25) (Neni 13, Neni 14, Neni 17, Neni 25), ka hapësirë për të bërë një riformulim në kuptimin e ngushtë të fjalës, për të reflektuar përveç kufizimeve në vetë përmbajtjen e së drejtës, ashtu dhe

[151] *Është pjesë e "objektit dhe qëllimit' të KEDNj-së, siç përkufizohet në preambulë, për të promovuar idealet demokratike.*

të kufizimeve që lindin për shkak të implikimit të saj (*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 38).[152]

Shembull. Në çështjen "*Marini kundër Shqipërisë*"[153] Gjykata konstatoi se "... për më tepër, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute. Ajo i nënshtrohet kufizimeve që jehohen për shkak të implikimit të saj, në veçanti kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së ankimit, pasi për vetë natyrën e saj, kjo është një çështje që kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një prag të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih "*Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*"). Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë ose zvogëlojnë të drejtën e një personi për t'iu drejtuar gjykatës, në atë mënyrë apo në atë masë që të dëmtohet vetë thelbi i së drejtës; së fundmi, kufizimet e tilla nuk janë në përputhje me Nenin 6.1 nëse ato nuk bëhen për një qëllim legjitim, ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre (shih "*Levages Prestations Services kundër Francës*").

1.b. Kategoritë e kufizimeve

Gjykata Europiane ka shqyrtuar disa nga llojet e kufizimeve ligjore vendase përsa i përket së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, me qëllim përcaktimin nëse ato e privojnë një ankues nga "thelbi" i kësaj të drejte duke përfshirë: a) periudhat e parashkrimit; b) pretendimet për imunitet; dhe c) kufizimet procedurale.

1.c. Periudhat e parashkrimit si kufizim

Gjykata Europiane ka pranuar se periudhat e parashkrimit përbëjnë tipar të zakonshëm të sistemeve ligjore vendase dhe ato në fakt përmbushin objektiva të rëndësishëm e të ligjshëm, për të "siguruar sigurinë juridike dhe vendimet përfundimtare të gjykatave, për të mbrojtur të pandehurit e mundshëm nga pretendimet e ngurta që mund të jenë të vështira për t'u kundërshtuar, dhe për të parandaluar padrejtësitë që mund të lindin nëse gjykatave u kërkohet të vendosnin për ngjarje që kanë ndodhur në të shkuarën e largët, në bazë të provave të cilat mund të jenë bërë të pasigurta dhe janë kështu të paplota për shkak të kalimit të kohës".[154]Megjithatë, ndërsa Gjykata Europiane ka pranuar se shtetet gëzojnë një prag vlerësimi për përcaktimin e afateve të parashkrimit, ajo është shprehur se i takon asaj të vendosë përfundimisht mbi mënyrën se janë respektuar kërkesat e Konventës.

Shembull. Në çështjen "*Stubbings kundër Mbretërisë së Bashkuar*"[155]Gjykata konstatoi se "ajo duhet të bindet se kufizimet e aplikuara nuk e kufizojnë ose zvogëlojnë të drejtën e një individi në atë mënyrë ose masë të tillë, që çon në dëmtimin e vetë thelbit të së drejtës. Për më tepër, kufizimi nuk është në përputhje me Nenin 6 paragrafi 1 (Neni 6-1) nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet".

[152] *Shih shënimin 138.*
[153] *Çështja nr. 3738/02, vendimi i GjEDNj-së për çështjen (themeli dhe kompensimi i drejtë, datë 18 dhjetor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-84061*
[154] *Çështja nr. 22083/93; 22095/93, vendim i datës 22 tetor 1996.*
[155] *Çështja nr.2083/93 22095/93, vendim (në themel) i datës, 22 tetor 1996, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-58079*

1.d. Pretendimet për imunitetet si kufizime

Pretendimet për imunitet për shkak të juridiksionit lindin si në kontekstin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë vendas. Në kontekstin vendas, Gjykata Europiane ka ushtruar juridiksionin e vet mbikëqyrës për të përcaktuar nëse imuniteti përbën kufizim joproporcional të së drejtës për t'iu drejtuar Gjykatës.

Shembull. Në çështjen "*Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*"[156] Dhoma e Madhe shqyrtoi vendimin e gjykatës vendase për rrëzimin e një padie për neglizhencë kundërj policisë në bazë të politikave publike dhe vërejti se zbatimi i rregullave në këtë mënyrë, pa hetim të mëtejshëm mbi praninë e aspekteve të tjera konkuruese të interesit publik, do të shërbenin vetëm për t'i dhënë imunitet të pabazuar policisë për veprimet ose mosveprimet e saj gjatë hetimit, dhe ushtrimin e presionit për zbulimin e krimit, dhe do të përbënte kufizim të pajustifikueshëm të të drejtës së një ankuesi për të pasur një vendim mbi themelin të padisë së tij kundër policisë në raste të denja.

Në kuadrin ndërkombëtar, Gjykata Europiane i ka rishikuar pretendimet për imunitet diplomatik si në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare, ashtu edhe në kuadrin e kërkesave të lidhura me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave.

Shembull. Në çështjen "*Radunović dhe të tjerët kundër Malit të Zi*"[157]u kundërshtua imuniteti shtetëror në proceset e paligjshme të shkarkimit nga puna të punonjësve të Ambasadës Amerikane në Malin e Zi: "Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata është e mendimit se, përmes refuzimit të kërkesës së ankuesve për kompensim duke u mbështetur në imunitetin e shtetit, pa dhënë arsye të qenësishme dhe të mjaftueshme, dhe pavarësisht dispozitave të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, si dhe seksionit 28 të Ligjit të Procedurës Civile dhe neneve 47 dhe 55 të Rezolutës për Konfliktin e Ligjeve dhe Rregullimin e Akteve të Shteteve të Tjera, gjykatat malazeze nuk arritën të ruanin një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Në këtë mënyrë, ato kanë cenuar thelbin e së drejtës së aksesit të ankuesve për t'iu drejtuar gjykatës.

Shembull. Në çështjen "*Vrioni kundër Shqipërisë & Italisë*"[158]Gjykata vuri në dukje se "ankuesit u ankuan për arsye të mohimit të së drejtës së aksesit për t'iu drejtuar gjykatës për shkak të pamundësisë për të paditur një mision diplomatik, konkretisht Ambasada e Republikës së Italisë në Shqipëri. Neni 6 § 1 i Konventës siguron ndaj çdokujt të drejtën për ngritur një padi në gjykatë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij/saj civile. Megjithatë, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute, pasi ajo mund të jetë objekt kufizimesh. Kufizimet lejohen me nisur nga implikimi i tyre, pasi e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, për nga vetë natyra esaj, kërkon një rregullim ligjor nga shteti. Gjykata rithekson se rregullat, gjerësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shtetit, nuk mund të konsiderohen se vendosin një kufizim disproporcional të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, siç mishërohet në Nenin 6 § 1 të Konventës. Për shkak se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është pjesë përbërëse e garancisë për proces të rregullt ligjor në këtë nen, disa kufizime mbi të drejtën për akses duhet të konsiderohen si të qenësishme. Një shëmbull i mirë do të ishin kufizimet

[156] *Çështja nr. 23452/94, vendim i datës 28 tetor.*
[157] *Çështja nr. 45197/13, 53000/13 dhe 73404/13, vendim i datës Vendim i datës25 tetor 2016, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-167803*
[158] *Çështja nr.35720/04 42832/06, Vendim i datës 29 shtator 2009,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-94452*

e pranuara gjerësisht nga komuniteti e kombeve, si pjesë e doktrinës së imunitetit të shtetit. Asgjë lidhur me këtë rast nuk justifikon shmangien ndaj këtyre konkluzioneve të pranuara. Në këto rrethana, faktet e ankimuara nuk përbëjnë një kufizim të pajustifikuar të së drejtës së ankuesve për t'iu drejtuar gjykatës".

Shembull. Në çështjen "*Treska kundër Shqipërisë & Italisë*"[159] Gjykata shprehet se "dhënia e imunitetit sovran ndaj një shteti në proceset civile ndjek qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare për të nxitur marrëdhëniet e mira dhe miqësinë midis shteteve përmes respektimit të sovranitetit të një shteti tjetër ... Gjykata kujton se Konventa duhet të interpretohet në dritën e rregullave të përcaktuara në Konventën e Vjenës, datë 23 maj 1969, "Mbi të drejtën e traktateve", dhe se Neni 31 § 3 (c) i kësaj Konvente parashikon se duhet të merret parasysh "çdo rregull përkatës i së drejtës nndërkombëtare të zbatueshme në marrëdhëniet midis palëve"... Konventa duhet të interpretohet sa më shumë të jetë e mundur në harmoni me rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare, pjesë e së cilave ajo është, duke përfshirë dhe rregullat që lidhen me dhënien e imunitetit të shtetit ... Në lidhje me këtë, Gjykata ka vendosur që masat e marra nga një Palë e Lartë Kontraktuese, të cilat pasqyrojnë rregulla të njohura të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shtetit, në përgjithësi nuk mund të konsiderohen se diktojnë një kufizim joproporcional mbi të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, siç ajo mishërohet në Nenin 6§1. Gjykata ka mbajtur po ashtu qëndrimin se, ashtu si e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është pjesë e pandarë e garancisë për proces të rregullt ligjor në këtë nen, në të njëjtën mënyrë disa kufizime të kësaj të drejte për akses duhet të konsiderohen si pjesë e pandarë e saj. Kufizimet e pranuara gjerësisht nga komuniteti e kombeve, si pjesë e doktrinës së imunitetit të shtetit, janë një shembull i këtyre kufizimeve".

Lista e pyetjeve

- Çfarë është parimi i balancës së drejtë dhe 3 nën-parimet e tij?
- Diskutoni nën-parimin e parë, aspektin pasuror lidhur me kufizimet e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, dhe kategoritë e saj (periudhat e parashtrimit dhe imuniteti).

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Marini kundër Shqipërisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Stubbings kundër Mbretërisë së Bashkuar";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Radunovic dhe të tjerët kundër Malit të Zi";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Vrioni kundër Shqipërisë & Italisë";*
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *"Treska kundër Shqipërisë & Italisë".*

[159] *Çështja nr.26937/04, vendim i datës 29 qershor 2006, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-76581*

1. Doktrina e "pragut të vlerësimit" në kuadrin e Nenit 6(1) (nën-parimi i dytë i balancës së drejtë)

*D*oktrina e pragut të vlerësimit u zhvillua fillimisht nga Gjykata Europiane në kuadrin e kufizimeve mbi të drejtat, e cila më pas është shtrirë në të gjitha nenet thelbësore të Konventës. Doktrina reflekton natyrën komplementare të mbrojtjes së ofruar nga Konventa ndaj mekanizmave vendas për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (doktrina e subsidiaritetit). "Pragu i vlerësimit" dhe doktrinat e subsidiaritetit janë parashikuar shprehimisht në Deklaratën e Brighton-it të vitit 2012, "Mbi të ardhmen e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut".[160]Protokolli nr.15 i Konventës (i cili ende nuk ka hyrë në fuqi) shton një preambulë të re në Konventë, duke referuar në mënyrë të veçantë kufijtë e pragut të vlerësimit që duhet të gëzohen nga shtetet anëtare "nën juridiksionin mbikëqyrës" të Gjykatës Europiane[161].

Sipas këtij parimi, të drejtat e KEDNJ-së nuk duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që ti heqin prerogativën organeve politike, demokratikisht llogaridhënëse në shtetet kontraktuese, për të marrë vendime të rëndësishme në emër të komuniteteve përkatëse. Është pjesë e "objektit dhe qëllimit" të KEDNJ-së, siç përcaktohet në preambulë, për të promovuar idealet demokratike. Parimi nënkupton se shtetet kontraktuese gëzojnë një "prag vlerësimi", po ashtu, se gëzimi i një pragu të tillë prej tyre është pjesë e "juridiksionit mbikëqyrës" të Gjykatës. Shtetit i lejohet një masë e caktuar diskrecioni, e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes europiane, kur ai merr masa legjislative, administrative ose gjyqësore në fushën e të drejtave të Konventës, të cilat çojnë në konceptin substancial dhe në konceptin strukturor të "pragut të vlerësimit". Koncepti substancial lidhet drejtpërdrejt me pyetjen nëse një ndërhyrje e veçantë në një të drejtë themelore të njeriut është e justifikuar. Koncepti strukturor "imponon kufizime në kompetencat për rishikim gjyqësor në sajë të faktit që KEDNJ-ja është një konventë ndërkombëtare. Parimi i subsidiaritetit do të thotë se ka një marrëdhënie midis mënyrës se si e kuptojnë rolin e tyre ndihmës gjykatat vendase dhe së ashtuquajturës "doktrinë e shkallës së katërt" së Gjykatës.

Shembull. Në çështjen "*Handyside kundër Mbretësisë së Bashkuar*"[162] Gjykata deklaroi në seancë plenare se "Pragu i vlerësimit i jepet si ligjvënësit vendas (të vendosur me ligj) dhe organeve, gjyqësore, ndërmjet të tjerave, të cilave u kërkohet të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjin në fuqi (§48). Në çështjen *Handyside*, Gjykata pranoi kufizimin për lirinë e shprehjes, parashikuar në Nenin 10§2 të Konventës, bazuar në doktrinën e pragut të vlerësimit. Masa e diskrecionit e lejuar brenda këtij pragu vlerësimi të shtetit, varet nga objekti i çështjes (*Rasmussen kundër Danimarkës*[163], *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr.1).*[164]

[160] *http://www.echr.coe.int/Documents/2012_Brighton_FinalDeclaration_ENG.pdf*
[161] *http://www.echr. coe.int/Documents/Protocol_15_ENG.pdf*
[162] *Çështja nr.5493/72, vendim i datës 7 dhjetor 1976, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57499*
[163] *Çështja nr. 8777/79, vendim i datës 28 nëntor 1984,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-72015*
[164] *Çështja nr. 6538/74, vendim i datës 26 prill 1979, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57584*

2.1. Përdorimi i doktrinës së pragut të vlerësimit në Nenin 6(1)

Interpretimi autonom i koncepteve kryesore të Nenit 6§1 nga Gjykata Europiane e kufizon në thelb pragun e vlerësimit për shtetet, bazuar në Nenin 6§1. Megjithatë, GJEDNJ-ja pranon se detyrimi pozitiv i një shteti për të siguruar të drejtën efektive për t'iu drejtuar gjykatës kërkon rregullime nga ana e shtetit, të cilat mund të ndryshojnë sipas prioriteteve dhe burimeve vendase në dizpozicion. Në këtë kontekst, shtetet gëzojnë një prag vlerësimi, sepse kufizimet e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës lejohen për shkak të implikimit të saj dhe në përputhje me vetë kërkesën thelbësore. Dhoma e Madhe ka vendosur që e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës "mund të jetë objekt i kufizimeve legjitime, të tilla si periudhat e parashkrimit, sigurimin e urdhrave të shpenzimeve, rregullimeve në lidhje me minorenët dhe personat me probleme mendore (*Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*)."[165]

Në lidhje me këtë, Gjykata Europiane është shprehur se "shtetet kontraktuese kanë më shumë hapësirë kur trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile, sesa kur trajtojnë çështjet penale" (*Dombo Beheer B.V kundër Holandës*).[166] Kjo vjen për shkak të faktit se paragrafi i dytë dhe i tretë i Nenit 6§1 të Konventës përmban dispozita të detajuara për çështjet penale, të cilat nuk kanë një ekuivalente të tyren për çështjet civile.

Sa i përket provave në çështjet civile, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme është shprehur se është pjesë e pragut të vlerësimit të shteteve dhe gjykatave vendase për të vendosur për rregullat e marrjes së provave, me kusht që ato të mos cenojnë garancitë procedurale të parashikuara në Nenin 6 të Konventës.

Shembull. Në çështjen "*Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*"[167] Gjykata përsëriti se pranueshmëria e provave është kryesisht çështje që rregullohet nga e drejta vendase dhe si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave vendase të vlerësojnë provat. Detyra e Gjykatës sipas Konventës nuk është që ajo të japë një vendim nëse deklarimet e dëshmitarëve janë pranuar siç duhet si dëshmi por të konstatojë nëse procedurat në tërësinë e tyre kanë qenë të rregullta, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë dëshmitë (§ 50).

Shembull. Në çështjen "*Radunović kundër Malit të Zi*"[168] Gjykata pohoi se: "Megjithatë, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e parashikuar në Nenin 6/1, nuk është absolute. Ajo mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat lejohen për shkak të implikimit të saj, pasi e drejta për t'iu drejtuar qjykatës, për shkak të vetë natyrës së saj, kërkon rrequllim nga shteti. Në këtë drejtim, shtetet kontraktuese qëzojnë një praq vlerësimi të caktuar, edhe pse vendimi përfundimtar lidhur me mbikqyrjen e respektimit të kërkesave të Konventës i takon Gjykatës. Gjykata duhet të jetë e bindur se kufizimet e vendosura nuk e kufizojnë ose zvoqëlojnë të drejtën e individit në mënyrë të tillë, ose në masë të tillë, sa të cenojnë thelbin e së drejtës. Për më tepër, kufizimi nuk është në

[165] *Çështja nr. 29392/95, vendim i datës 10 maj 2001, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-59455*
[166] *Çështja nr. 14448/88, vendim i datës 27 tetor 1993, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57850*
[167] *Çështja nr.21363/93 21364/93 21427/93, vendim (themeli), datë 23 prill 1997, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-58030*
[168] *Çështja nr. 45197/13, 53000/13 dhe 73404/13 , vendim i datës 25 tetor 2016, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-167803*

përputhje me Nenin 6/1 nëse nuk ndjek një qëllim leqitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (§ 62).

Shembull. Në çështjen "*Garzičić kundër Malit të Zi*"[169]Gjykata konstatoi se "megjithatë, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute. Ajo u nënshtrohet kufizimeve që lejohen për shkak të implikimit të saj, në veçanti kur bëhet fjalë për "kushtet e pranueshmërisë së ankimit", pasi për vetë natyrën e saj, kjo është një çështje që kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një prag të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë ose zvogëlojnë të drejtën e një personi për t'iu drejtuar gjykatës në atë mënyrë, ose në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i së drejtës. Për më tepër, kufizimet e tilla janë në përputhje me Nenin 6.1 vetëm nëse bëhen për një qëllim legjitim, ose nëse ekziston një raport i arsyeshëm proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre ..."

Shembull. Në çështjen "*Rramadhi kundër Shqipërsië*"[170]Gjykata ritheksoi se shtetet kanë prag të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se çfarë është në interes të publikut, veçanërisht kur bëhet fjalë për shtetëzim ose shpronësim, pasi ligjvënësi vendas gëzon një prag të gjerë vlerësimi për zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike. Megjithatë, ky prag vlerësimi nuk është i pakufizuar dhe ushtrimi i tij është objekt rishikimi nga institucionet Konventës (shih *Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*)."

Shembull. Në çështjen "*Beshiri kundër Shqipërisë*"[171]Gjykata u shpreh se "Neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet se dikton një detyrim i përgjithshëm për shtetet kontraktuese për të kthyer pronën që u është transferuar përpara ratifikimit të Konventën. As Neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk vendos ndonjë kufizim mbi lirinë e Shteteve Kontraktuese për të përcaktuar objektin e kthimit të pronës dhe për të zgjedhur kushtet mbi të cilat ata bien dakord për rikthimin e të drejtave pronësore tek ish-pronarët (shih *Jantner kundër Sllovakisë*). Në veçanti, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një prag të gjerë vlerësimi në lidhje me përjashtimin e disa kategorive ish-pronarësh nga një e drejtë e tillë. Në rastet kur kategoritë e pronarëve përjashtohen në këtë mënyrë, kërkesat e tyre për kthim të pronës nuk përbëjnë një bazë për "pritshmëri legjitime" që mund të bie nën tërheq mbrojtjen e Nenit 1 të Protokollit nr.1. Nga ana tjetër, menjëherë sapo një Shtet Kontraktues që e ka ratifikuar Konventën, përfshirë edhe Protokollin nr.1, adopton legjislacionin që parashikon rikthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar në regjimin e mëparshëm, ky legjislacion vlerësohet se gjeneron një të drejtë të re pronësie, e cila mbrohet nga Neni 1 i Protokollit nr. 1 për personat që i përmbushin kërkesat për të drejtën në fjalë. E njëjta gjë mund të zbatohet në lidhje me masat për kthimin, ose kompensimin, të përcaktuara nga legjislacioni përpara ratifikimit, nëse ky legjislacion ka mbetur në fuqi pas ratifikimit të Protokollit nr.1 nga Shteti Kontraktues (shih *Broniowski kundër Polonisë*). "

Shembull. Në çështjen "*Bajrami kundër Shqipërsië*"[172] Gjykata ritheksoi se objekti themelor i Nenit 8 është mbrojtja e individit kundër veprimeve arbitrare të autoriteteve publike. Po ashtu lindin edhe detyrime pozitive që janë pjesë e qënësishme e "respektimit" efektiv të së drejtës për familje. Në të dyja kontekstet, u duhet kushtuar

[169] *Çështja nr. 17931/07, vendim i datës 21 shtator 2010,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-100500*
[170] *Çështja nr.38222/02, vendimi i GJEDNJ-së për çështjen (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë13 nëntor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-83249*
[171] *Çështja nr.7352/03*, vendim i datës *22 gusht 2006.*
[172] *Shih shënimin 32.*

rëndësi balancimit të drejtë në mes interesave konkurrues të individit, nga njëra anë, dhe interesave të komunitetit në përgjithësi, nga ana tjetër. Dhe, në të dyja rastet, shteti gëzon një prag të caktuar vlerësimi."

Shembull. Në çështjen "*Maria Athanasius cituar në çështjen Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*"[173] Gjykata argumentoi se: "Për më tepër, çdo ndërhyrje në gëzimin e një të drejte ose lirie të njohur nga Konventa duhet të ndjekë një qëllim legjitim. Në të njëjtën linjë, në çështjet që kanë të bëjnë me detyrime pozitive, duhet të ketë një justifikim legjitim për mosveprimin e shtetit. Parimi i "balancimit të drejtë" i mishëruar në vetë Nenin 1 të Protokollit nr. 1, në vetvet prezumon ekzistencën e një interesi të përgjithshëm të komunitetit. Për shkak të njohurive të drejtpërdrejta të shoqërisë dhe nevojave të saj, autoritetet vendase, në parim, janë më mirë të pozicionuara sesa gjyqtari ndërkombëtar për të vlerësuar atë çfarë është "në interesin publik". Sipas sistemit të mbrojtjes së Konventës, u takon pikërisht autoriteteve vendase të bëjnë vlerësimin fillestar në lidhje me ekzistencën e një problemi shqetësues të natyrës publike, duke justifikuar marrjen e masave në sferën e ushtrimit të së drejtës së pronës, përfshirë privimin dhe kthimin e pronës. Në këtë kuptim, në këtë sferë ashtu si edhe në fusha të tjera në të cilat shtrihen masat mbrojtëse të Konventës, autoritetet vendase, në përputhje me rrethanat, gëzojnë një prag vlerësimi të caktuar. Për më tepër, nocioni i "interesit publik" është domosdoshmërisht i gjerë. Në veçanti, vendimet për miratimin e ligjeve për shpronësimet, ose dhënien e kompensimit të financuar nga publiku për pronën e shpronësuar, zakonisht përbëjnë vendime të natyrës politike, ekonomike dhe sociale. Duke konstatuar se është e natyrshme që pragu i vlerësimit në dispozicion të ligjvënësit për zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike të jetë i gjerë, Gjykata ka deklaruar se do të respektojë gjykimin e ligjvënësit lidhur me atë çfarë është "në interesin publik", përveç rastit kur ky gjykim është haptazi pa asnjë bazë të arsyeshme (...)."

Lista e pyetjeve

- Diskutoni rreth doktrinës së "pragut të vlerësimit".
- Si është aplikuar doktrina e pragut të vlerësimit në çështje të ndryshme?

Rekomandohet per lexim

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Radunović kundër Malit të Zi*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Garzičić kundër Malit të Zi*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Rramadhi kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Beshiri kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Bajrami kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*".

[173] *Shih shënimin 63.*

2. Kufizimet procedurale (nënparimi i tretë i balancës së drejtë)

2.1. E drejta për apelim

Shembull. Në çështjen "*Garzičić kundër Malit të Zi*"[174] Gjykata Europiane, në kuadrin e rregullimit vendas të së drejtës për apelim, përcakton qartë kriteret që zbatohen gjatë gjykimit të pajtueshmërisë së kufizimeve procedurale me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, garantuar nga Neni 6§1: "Neni 6 i Konventës nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë gjykata apeli ose kasacioni. Në rastet kur ekzistojnë gjykata të tilla, duhet të respektohen garancitë e Nenit 6, për shembull, ato duhet të ofrojnë palëve ndërgjygjëse tëdrejtën efektive për t'iu drejtuar gjykatës për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile. Megjithatë, "e drejta për t'iu drejtuar gjykatës" nuk është absolute. Ajo u nënshtrohet kufizimeve që lejohen për shkak të implikimit të saj, në veçanti kur bëhet fjalë për "kushtet e pranueshmërisë së ankimit", pasi për vetë natyrën e saj, kjo është një çështje që kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një prag të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë ose të zvogëlojnë të drejtën e një personi për t'iu drejtuar gjykatës në atë mënyrë, osenë atë masë, që të dëmtohet vetë thelbi i së drejtës. Për më tepër, kufizimet e tilla janë në përputhje me Nenin 6.1 vetëm nëse bëhen për një qëllim legjitim ose nëse ekziston një raport i arsyeshëm proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre.

2.2. Barazia e armëve

Parimi. Parimi i barazisë së armëve (ose barazia e palëve) dikton që palëve t'u sigurohen mundësi të barabarta për të përgatitur dhe për të parashtruar mbrojtjen e tyre pranë Gjykatës. Parimi përbën pjesë të detyrimit të përgjithshëm të shtetit, bazuar në Nenin 6, për sigurimin e procesit të rregullt ligjor. Ky parim lidhet me detyrimet e tjera të drejtësisë, siç është e drejta për procedura të mbështetura në parimin e kontradiktorialitetit, e cila i garanton palëve të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës dhe për të kundërshtuar mbi provat dhe materialet përkatës. Kjo pasi duhet të ketë garanci të mjaftueshme mbrojtëse procedurale, të përshtatshme për natyrën e çështjes nën shqyrtim dhe që korrespondojnë me natyrën e konfliktit ndërmjet palëve[175]. Parimi i barazisë së armëve zbatohet jo vetëm në rregullat e procedurës gjyqësore, por edhe në rregullimet institucionale, siç është roli i Avokatit të Përgjithshëm dhe Prokurorit Publik. Parimi i barazisë së armëve zbatohet si për procedurat penale, edhe në ato civile. Gjatë shqyrtimit të respektimit të parimit, Gjykata Europiane shqyrton edhe rregullsinë e të gjitha proceseve gjyqësore në tërësi.

Shembull. Në çështjen "*Dombo Beheer BV kundër Holandës*"[176] Gjykata u shpreh se: "Kërkesat e qenësishme në konceptin e "procesit të rregullt" nuk janë domosdoshmërisht të njëjta për çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile dhe për çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e një akuze penale. Kjo mbështetet nga mungesa e dispozitave të hollësishme siç janë paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 6 (Neni 6-2, Neni 6-3) që zbatohen për rastet e kategorisë së

[174] *Çështja nr. 17931/07, vendim i datës 21 shtator 2010, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-100500*
[175] *Article 6: Self-learning course, Human Rights Education for Legal Professionals, Council of Europe (2014).*
[176] *Çështja nr. 14448/88, vendim i datës 27 tetor 1993,http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-57850*

mëparshme. Pra, megjithëse këto dispozita kanë një rëndësi të caktuar jashtë kufijve striktë të ligjit penal ... Shtetet Kontraktuese kanë më shumë mundësi vlerësimi kur merren me çështjet civile në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile sesa ato kur merren me shqyrtimin e çështjeve penale. Megjithatë, parime të caktuara lidhur me nocionin e një "gjykimi të drejtë" në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile rrjedhin nga vetë jurisprudenca e Gjykatës. Më e rëndësishmja për rastin aktual është të behet e qartë se kërkesa e "barazisë së armëve", në kuptimin e "balancimit të drejtë" midis palëve, zbatohet në parim në raste të tilla, si dhe në çështjet penale ".

Shembull. ***Në çështjen "Perić kundër Kroacisë"***[177]Gjykata u shpreh se: "Megjithatë, parime të caktuara lidhur me nocionin e procesit të rregullt ligjor në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile rrjedhin nga praktika gjyqësore e Gjykatës. Më e rëndësishmja, për çështjen në fjalë, është se kërkesa për barazinë e armëve, në kuptimin e balancimit të drejtë midis palëve, zbatohet, në parim, në çështje të tilla, si edhe në çështje penale ... Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se sa u përket gjykimeve që kanë të bëjnë me interesa të kundërt privatë, barazia e armëve nënkupton që secilës palë t'i ofrohet një mundësi e arsyeshme për të mbrojtur rastin e vet,- përfshirë edhe dëshminë-, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh thelbësor kundrejt palës kundërshtare. Autoriteteve vendase u lihet në dorë të sigurojnë përmbushjen e kërkesave për proces të rregullt për çdo rast individual.

Shembull. Në çështjen ***"V kundër Mbretërisë së Bashkuar"*** **(Dhoma e Madhe)**[178] Gjykata rikujton se Neni 6§1 garanton të drejta të caktuara në lidhje me "përcaktimin e ... padive penale ...". Në çështjet penale, është e qartë që Neni 6§1 i mbulon të gjitha proceset ligjore në diskutim, përfshirë dhe proceset e apelimit dhe përcaktimin e vendimit.

Shembull. Në çështjen ***"Caka kundër Shqipërisë"*** Gjykata argumenton se: "Provat, si rregull, duhet të parashtrohen në seancë publike, në praninë e të akuzuarit, me qëllim realizimin e argumentit kundërshtues. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, paragrafi 1 dhe 3 (d) të Nenit 6 kërkojnë që të pandehurit t'i jepet një mundësi adekuate dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin që deponon kundër tij ose në momentin pas dhënies së deklaratave, ose në një fazë të mëvonshme gjatë proceseve gjyqësore. Zakonisht, i takon gjykatave vendase të vendosin nëse është e nevojshme, ose e kështillueshme, që të dëgjohet një dëshmitar i caktuar. Neni 6§3 (d) nuk kërkon pjesëmarrjen dhe shqyrtimin e çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit: qëllimi i tij thelbësor, siç tregohet përmes formulimit "nën të njëjtat kushte", është ofrimi i "barazisë së armëve" për çështjen në fjalë. Në rrethana të caktuara, mund të jetë e nevojshme që gjykatat përdorin si burim deklaratat e dhëna gjatë fazës së hetimit penal. Nëse i akuzuari ka mundësi të mjaftueshme dhe adekuate për t'i kundërshtuar këto dëshmi, në kohën e marrjes, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procesit, përdorimi i tyre nuk bie ndesh me garancitë e Nenit 6§1 dhe 3 (d). Të drejtat e mbrojtjes kufizohen në një masë të tillë që është në kundërshtim me kërkesat e Nenit 6, nëse dënimi bazohet vetëm, ose kryesisht, mbi deponimet e një dëshmitari, të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësi ta kundërshtojë, ose ta pyesë, qoftë gjatë hetimit, ose gjatë gjykimit".[179]

[177] *Çështja nr. 34499/06, vendim i datës 27 qershor 2008, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-85583*
[178] *Çështja nr. 24888/94, vendim i datës 16 dhjetor 1999.*
[179] *Çështja nr.44023/02, vendim i datës 8 dhjetor 2009*

➢ **Rast studimor "Cani kundër Shqipërisë"[180]**

Ankuesi u ankua pranë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me Nenin 6 § 3 (c), për shkak se i ishte mohuar e drejta për t'u mbrojtur në një seancë publike para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

Proceset gjyqësore pranë gjykatës së shkallës së parë. Pas disa kthimesh për rishqyrtim të çështjes kundër ankuesit dhe dy të pandehurve të tjerë, më 4 mars 2004, Gjykata e Rrethit Berat (Gjykata e Rrethit) e dënoi ankuesin për disa akuza penale të kryera në bashkëpunim me të pandehurit[181]. Gjykata e Rrethit e dënoi ankuesin me dënimin kumulativ, me burgim të përjetshëm. Gjatë proceseve gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit, ankuesi u përfaqësua kryesisht, pra, me avokat të caktuar nga gjykata. Në fazën përfundimtare të këtyre proceseve, ankuesi caktoi një avokat të zgjedhur prej tij, duke i dhënë atij fuqi, me anë të autorizimit, për përfaqësimin e tij pranë gjykatës, të nënshkruar më 18 shkurt 2004.

Proceset gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit. Më 12 mars 2004, ankuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit Vlorë (Gjykata e Apelit). Edhe pse e pranonte kryerjen e veprave penale, ai e kundërshtoi dënimin e dhënë nga gjykata. Ai pretendonte se gjykata nuk kishte marrë parasysh disa faktorë lehtësues në favor të tij, siç ishin pendimi pas kryerjes së krimit dhe dorëzimi tek autoritetet, gjendja e vështirë financiare e familjes së tij, fakti që ai kishte një fëmijë të mitur, mungesa e rekordit kriminal në të shkuarën dhe niveli i tij i ulët arsimor. Gjatë periudhës nga 4 maji i vitit 2004 deri më 18 qershor i vitit 2004, gjykata i shtyu disa herë seancat për të siguruar pjesëmarrjen e ankuesit[182]. Ankuesi nuk ishte i pranishëm në seancat dëgjimore, por ishte avokati i tij. Në fund, Gjykata e Apelit vendosi të vazhdojë me seancën në mungesë të ankuesit, pasi ai përfaqësohej nga avokati i tij, dhe e dënoi atë me dënimin kumulativ prej njëzet e pesë vitesh burgim, i reduktuar me një të tretën si rezultat i ushtrimit të procedurës së përshpejtuar.

Proceset gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë. Prokurori depozitoi një padi në Gjykatën e Lartë me arsyetimin e zbatimit të gabuar të ligjit penal. Ai deklaroi, *inter alia*, se dënimi i dhënë nga Gjykata e Apelit, e cila nuk kishte urdhëruar burgim të përjetshëm për kërkuesin, ndonëse ai kishte kryer një krim që kishte rezultuar me vdekjen e një personi, nuk korrespondonte me rrezikun serioz që paraqiste ankuesi për shoqërinë dhe

[180] Çështja nr.11006/06, vendim i datës 06 mars 2012, http://hudoc.echr.coe.int/eng/i=001-109359

[181] Gjykata e Rrethit konstatoi se ankuesi kishte vepruar në rrethana rënduese për shkak se kishte kryer një vepër penale, e cila kishin çuar në vdekjen e një personi, ndërsa të pandehurit e tjerë e kishin ndihmuar për realizimin e kësaj vepre penale. Sa i përket veprave të tjera penale, Gjykata e Rrethit i shpalli fajtor edhe të pandehuriet e tjerë lidhur me akuzën .

[182]Më 4 maj 2004 u realizua një seancë, e cila u shty për 26 maj 2004 me qëllim thirrjen e ankuesit për t'u paraqitur përpara gjykatës. Në të njëjtën datë, Gjykata e Apelit i dërgoi një letër Komisariatit të Policisë dhe autoriteteve lokale të burgjeve, ku u kërkonte këtyre autoriteteve që ta shoqëronin ankuesin në seancën e caktuar për datën 26 maj 2004. Ankuesi nuk mori pjesë as në seancën dëgjimore të datës 26 maj 2004. Gjykata urdhëroi shtyrje të seancës deri më 4 qershor 2004. Përfaqësuesi i ankuesit ishte i pranishëm në seancë. Më 27 maj 2004, Gjykata e Apelit i dërgoi një letër Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe autoriteteve lokale të burgjeve duke kërkuar shoqërimin e ankuesit në seancën dëgjimore më 4 qershor 2004, pasi ai kishte shprehur dëshirën për të marrë pjesë në të. Ankuesi nuk u paraqit as në seancën e 4 qershorit 2004. Gjykata urdhëroi shtyrje tjetër të seancës deri më 18 qershor 2004. Më 7 qershor 2004, Gjykata e Apelit i dërgoi një letër Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe autoriteteve lokale të burgjeve ku kërkonte shoqërimin e kërkuesit në seancën dëgjimore të 18 qershorit 2004, pasi ai kishte shprehur dëshirën të ishte i pranishëm në seancë.

pasojat serioze penale të veprës penale. Më 15 qershor 2005, vëllai i ankuesit, caktoi A.K.-në për të përfaqësuar ankuesin pranë Gjykatës së Lartë. Në seancën dëgjimore të datës 15 qershori 2005 në Gjykatën e Lartë, ankuesi u përfaqësua nga A.K.-ja, i cili i kërkoi gjykatës që të rrëzonte kërkesën e prokurorit. Më 15 qershor 2005, Gjykata e Lartë e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykata e Lartë arriti në këtë përfundim sepse zvogëlimi i dënimit nga Gjykata e Apelit për shkak se i akuzuari i kishte ardhur në ndihmë drejtësisë, duke shfaqur keqardhje për veprën e kryer dhe duke kërkuar përdorimin e procedurës së përshpejtuar, nuk është i bazuar në ligj.

Proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese. Ankuesi depozitoi një kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për të marrë pjesë në seancat e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Më 10 shkurt 2006, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën si të papranueshme, duke u shprehur se arsyet e ankesës dilnin jashtë juridiksionit të saj.

Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "Cani kundër Shqipërisë". Gjykata ritheksoi se "prania personale e të pandehurit nuk ka të njëjtën rëndësi vendimtare për një seancë dëgjimore në apel, ashtu siç mund të ketë në shkallën e parë të gjykimit. Megjithatë, mënyra e zbatimit të Nenit 6 në proceset gjyqësore pranë gjykatave të apelit, varet nga veçoritë specifike të procedurave të përfshira; duhet të merret parasysh tërësia e proceseve në rendin e brendshëm juridik dhe roli i gjykatës së apelit në të. Proceset për shqyrtimin e rivendosjes në afat dhe proceset që përfshijnë vetëm çështjet e ligjit, në krahasim me çështjet e faktit, mund të jenë në përputhje me kërkesat e Nenit 6 edhe pse ankuesit nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar personalisht nga gjykata e apelit apo kasacionit, me kusht që të ketë pasur një seancë dëgjimore publike në shkallën e parë të gjykimit. Megjithatë, në rastin prezent, arsyeja themelore është që gjykatat në fjalë nuk kanë për detyrë të vërtetojnë faktet e çështjes, por vetëm të interpretojnë rregullat ligjore të përfshira në të. Në fakt, edhe kur Gjykata e Apelit ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar çështje si lidhur me faktet, ashtu edhe me ligjin, Neni 6 nuk kërkon gjithmonë të drejtën për pjesëmarrje në seancë publike dhe të drejtën *a fortiori* për t'u paraqitur personalisht në gjykatë.

Lista e pyetjeve

- Diskutoni rreth kufizimeve procedurale mbi të drejtën për t'u vetëmbrojtur në një seancë publike në kontekstin e çështjes "Cani kundër Shqipërisë". Çfarë qasjeje duhet të ndjekë GJEDNJ-ja për zgjidhjen e kësaj çështjeje?
- Diskutoni se si është aplikuar parimi i kufizimit procedural në lidhje me të drejtën për të apeluar dhe të drejtën për barazinë e armëve.

Rekomandohet per lexim:

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Garzičić kundër Malit të Zi*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Cani kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Dombo Beheer BV kundër Holandës*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Perić kundër Kroacisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*V kundër Mbretërisë së Bashkuar*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Mulosmani kundër Shqipërisë*";
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Caka kundër Shqipërisë*".

SEKSIONI III - E DREJTA PËR GJYKIM BRENDA AFATEVE TË ARSYESHME DHE MJETET EFEKTIVE NË KËTË RESPEKT

a) Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i këtij seksioni është të sigurojë pjesëmarrësit se do të fitojnë njohuri për të kuptuar elementet e qëllimit që ndjeke drejta për gjykim të drejtë "brenda një kohe të arsyeshme", në proceset civile dhe penale. Pjesëmarrësit do të mund të përcaktojnë periudhën që duhet të merret parasysh për të vlerësuar sa e arsyeshme ka qënë kohëzgjatja e proceduravegjyqësore. Pjesëmarrësit do të njihen gjithashtu me kriteret e përdorura nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut për të vlerësuar përputhshmërinë e kohëzgjatjes me standartet e vendosura nga Neni 6 i Konventës. Gjithashtu, pjesëmarrësit në kurs do të jenë në gjendje të bëjnë dallimin midis mjeteve juridike në dispozicion, qëftë në rrafshin vendas ashtu dhe në ndërkombëtar, të cilat mund të sigurojnë adresimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Pjesëmarrësve do t'u jepet gjithashtu edhe një panoramë e praktikave në disa prej vendeve europiane.

Njohuritë gjatë këtij sesioni janë synuarpër profesionistët ligjore, të cilët në punën e tyre të përditshme mund të ndeshen me parimet dhe kriteret e mishëruara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe që kontribuojne në mënyrë aktive në zbatimin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në nivel vendas.

b) Objektivat e mësimit

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- ✓ të kuptojnë objektin e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme;
- ✓ të kuptojnë se cilat elemente duhet të merren parasysh për të përcaktuar periudhën e nevojshme për vlerësimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore;
- ✓ të kuptojnë kriteret e përdorura nga Gjykata për vlerësimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore;
- ✓ të kuptojnë rëndësinë e zbatimit të vendimeve përfundmtare të gjykatave të brendshme;
- ✓ t'i drejtohen praktikës përkatëse gjyqësore në punën e tyre të përditshme, si profesionistë së drejtës së BE.

Për ta arritur këtë qëllim, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë:

- ✓ të mësojnë rreth praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së;
- ✓ të bëjnë ushtrime për të identifikuar situata të shkeljeve të mundshme të të drejtave për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

Gjithashtu kursi është projektuar edhe:

- ✓ për të forcuar rolin individual të pjesëmarrësve që veprojnë në fushën e së drejtës, përkatësisht në fushën e proceseve penale ose civile.

c) Kohëzgjatja: 3 orë, 2 javë

d) **Vlerësimi përfundimtar:** rast studimor, portofoli, dokument për diskutim

I. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Neni 6 § 1 i Konventës parashikon që: *"[...], çdokush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet[...] brenda një afati të arsyeshme nga [një] gjykatë [...]"*

Neni 6 kërkon që proceset gjyqësore të jenë të shpejta. E drejta për proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar nga GJEDNJ-ja, nuk është një e drejtë e përgjithshme, e zbatueshme për të gjitha gjykimet, ose për çdo kënd që është i përfshirë në proceset gjyqësore. Siç formulohet në Konventë, së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund t'i drejtohemi vetëm një gjykatë që është kompetente për përcaktimin, sipas formulimit të Nenit 6, të "të drejtave dhe detyrimeve civile", ose "çdo akuze penale". Megjithatë, interpretimi dinamik i Gjykatës Europiane duket se po e ndryshon gradualisht pozicionin në lidhje me këto dy koncepte. Sot në praktikë, megjithëse Gjykata Europiane tregohet e tërhequr për të përshkruar situatën në këto terma, Neni 6 mund të zbatohet qartë për çdo proces gjyqësor, përveç sferave të caktuara që përjashtohen nga doktrina gjyqësore, për shkak se janë cilësuar si të pamundura për t'u asimiluar në çështjet civile ose penale.

Afati i arsyeshëm i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore përcaktohet nga Gjykata në dritën e rrethanave të çështjes. Gjatë përcaktimit nëse kohëzgjatja e proceseve ka qenë e arsyeshme, Gjykata merr parasysh faktorë, të tillë si:

i) kompleksitetin e çështjes;
ii) sjelljen e ankuesit;
iii) sjelljen e autoriteteve përkatëse;
iv) të drejtat që i shkelenankuesit.

Më poshtë do të analizohen kriteret për sa i përket Aspektit Penal (A) dhe Aspektit Civil (B).

A. Fusha penale

1. Objekti i së drejtës për t'u dëgjuar brenda afatit të arsyeshëm në procese me "akuza penale"

E drejta e për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, që garantohet nga GJEDNJ-ja nuk është një e drejtë e përgjithshme që gjen zbatim për të gjitha gjykimet, ose për të gjithë personat që mund të jenë përfshirë në proceset gjyqësore
Diskutimi rreth qëllimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, përbën diskutimin rreth fushës së veprimit të Nenit 6 të Konventës, si të tillë.
Siç formulohet në Konventë, e drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme mund të pretendohet vetëm nga një gjykatë e cila është përgjegjëse për përcaktimin, sipas formulimit të Nenit 6, "të të drejtave dhe detyrimeve civile", ose "çdo akuze penale".

Koncepti i çështjeve "penale" është nocion autonom, i cili është zhvilluar gjerësisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Kuptimi i tij nuk mbështetet në përkufizimet e dhëna në të drejtën e brendshme të shteteve anëtare[183]. Gjykata Europiane e ka zgjeruar sferën penale duke përfshirë dënimet administrative, si ndëshkimet disiplinore ashtu edhe taksat[184]. Pra, është vendosur që mosmarrëveshjet që lindin nga gjobat administrative të futen brenda sferës penale, në rastet kur dënime të tilla vendosen për shkak të mos zbatimit ndaj rregullave tregtare[185]. Shumica e gjobave të vendosura nga "autoritetet e pavarura administrative" bien po ashtu në fushën e Nenit 6 të Konventës[186].

Shembull. Në çështjen "**Grande Stevens dhe të tjerët kundër Italisë"**[187], ankuesit janë dy kompani, përfaqësuar nga kryetari i tyre, z. Gabetti, së bashku me z. Marrone, përfaqësuesin e autorizuar të njërës prej kompanive, dhe z. Grande Stevens, një avokat që i kishte këshilluar ata. Ata u konsultuan me Komisionin Vendas të Kompanive dhe Bursave (më poshtë Consob) për një operacion financiar të mundshëm. Në përgjigje të një pyetjeje nga Consob, ata lëshuan një njoftim për shtyp, ku thuhej se nuk ishte ndërmarrë apo analizuar asnjë iniciativë lidhur me skadimin e një marrëveshjeje të posaçme financiare, edhe pse ishin në zhvillim të negociatave me një bankë angleze. Departamenti i Konsumatorëve dhe Opinioneve i Consob-it i akuzoi ankuesit për shkelje të Nenit 187 ter § 1 të dekretit legjislativ nr. 58, datë 24 shkurt 1998, sipas të cilit "shpërndarja e informacionit, e lajmeve ose e thashethemeve të rreme apo çorientuese, duke prodhuar kështu informacione të rreme ose mashtruese në lidhje me instrumentet financiare, përbënte vepër penale". Në apel, ankuesit u urdhëruan të paguanin gjoba që shkonin nga 500,000 deri në 3,000,000 euro, ndërsa z. Gabetti, z. Grande Stevens dhe z. Marrone u pezulluan nga administrimi, menaxhimi ose mbikëqyrja e kompanive të listuara për disa muaj. Sa i përket aplikueshmërisë së Nenit 6, Gjykata shprehet si më poshtë:

"94. Gjykata thekson qëndrimin e mbajtur në praktikën e saj ekzistuese, sipas së cilës, për përcaktimin e pranisë së një "akuze penale", është e nevojshme të merren parasysh tre faktorë:

[183] Për nocionin "autonomy", ju lutem referojuni paragrafit specifik në seksionin II.
[184] Për shembull, *Bendenoun kundër Francës*, 24 shkurt 1994.
[185] *Garyfallou AEBE kundër Greqisë*, 24 shtator 1997.
[186] Vendim pranueshmërie, *Jean-Louis Didier kundër Francës*, 27 shkurt 2002.
[187] Çështjet 18640/10 18647/10 18663/10, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 04/03/2014

klasifikimi juridik i masës në fjalë në ligjin vendas, vetë natyra e masës dhe shkalla e ashpërsisë së "dënimit" (shih Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, § 82, seria A nr. 22). Për më tepër, këto kritere janë alternative dhe jokumulative: në mënyrë që të zbatohet Neni 6 në lidhje me fjalët "akuzë penale", mjafton që vepra në fjalë, sipas natyrës së saj, të jetë "penale" në pikëpamjen e Konventës, ose duhet ta ketë bërë personin në fjalë përgjegjës për një sanksion, i cili, për shkak të natyrës dhe shkallës së ashpërsisë, i përket në përgjithësi sferës "penale". Megjithatë, kjo nuk e përjashton qasjen kumulative, ku analiza e veçantë e secilit kriter nuk bën të mundur që të arrihet një përfundim i qartë për praninë e një "akuze penale" (shih Jussila kundër Finlandës [GC], nr. . 73053/01 , §§ 30 dhe 31, KEDNJ 2006-XIII, dhe Zaicevs kundër Letonisë, numër 65022/01, § 31, KEDNJ 2007-IX (ekstraktet)).

95. Në çështjen në diskutim, Gjykata, së pari, vëren se manipulimet e tregut për të cilat akuzohen ankuesit nuk përbëjnë vepër penale sipas ligjit italian. Një sjellje e tillë në fakt u dënua me një dënim, i cili klasifikohej si "administrativ" sipas Nenit 187 ter § 1 të dekretit legjislativ nr. 58 të vitit 1998 (shih paragrafin 20 më sipër). Megjithatë, kjo nuk ishte vendimtare për qëllimet e zbatueshmërisë së Nenit 6 të Konventës në fushën penale, pasi treguesit e dhënë nga ligji vendas kanë vetëm vlerë relative (shih Öztürk kundër Gjermanisë, 21 shkurt 1984, § 52, seria A nr.73 dhe Menarini Diagnostics Srl, cituar më sipër, § 39).

96. Sa i përket natyrës së veprës penale, duket se dispozitat për të cilat u akuzuan ankuesit kishin për qëllim të garantonin integritetin e tregjeve financiare dhe të ruanin besimin e publikut në sigurinë e transaksioneve. Gjykata rithekson që CONSOB, një organ i pavarur administrativ, ka për detyrë të mbrojë investitorët dhe të sigurojë efektivitetin, transparencën dhe zhvillimin e tregjeve të aksioneve (shih paragrafin 9 më sipër). Këto janë interesa të përgjithshme të shoqërisë, zakonisht të mbrojtura nga ligji penal (shih, mutatis mutandis, Menarini Diagnostics Srl, përmendur më sipër, § 40; shih gjithashtu Société Stenuit kundër Francës, raporti i Komisionit Europian për të Drejtat e Njeriut, 30 maj 1991, 62, seria A 232 A). Përveç kësaj, Gjykata është e mendimit se gjobat e caktuara ishin në thelb të destinuara për të ndëshkuar ankimuesit, jo për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve. Ato ishin bazuar në rregulla, qëllimi i të cilave ishte si parandalues, përkatësisht heqja dorë, nga ana e ankuesve e rifillimit të aktivitetit në fjalë, edhe ndëshkuese, pasi ato ndëshkonin një sjellje të paligjshme (shih, mutatis mutandis, Jussila, cituar më sipër, § 38). Me fjalë të tjera, këto masa nuk synonin, siç pretendonte Qeveria (shih paragrafin 91 më sipër), për të riparuar dëmet e një natyre financiare. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se gjobat janë përcaktuar nga CONSOB në bazë të rëndësisë së sjelljes së kundërshtuar, dhe jo të dëmit të shkaktuar ndaj investitorëve.

97. Sa i përket natyrës dhe ashpërsisë së dënimit që "ka të ngjarë të vendoset" ndaj aplikantëve (shih Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 39665/98 dhe 40086/98, § 120, KEDNJ 2003 -X), Gjykata, ashtu si Qeveria (shih paragrafin 90 më lart), vë në dukje se gjobat në fjalë nuk mund të zëvendësohen me një dënim me burgim në rast të mospagimit (shih, an contrario, Anghel kundër Rumanisë, nr. 28183/03, § 52, 4 tetor 2007). Megjithatë, gjoba për të cilën CONSOB kishte të drejtë të vendoste mund të shkonte deri në 5,000,000 euro (shih paragrafin 20 më lart) dhe kjo shumë maksimale e zakonshme mund të trefishohej ose të fiksohej në rrethana të caktuara sa dhjetë herë të ardhurat ose përfitimet e arritura (shih paragrafin 53 më lart). Imponimi i sanksioneve monetare të lartpërmendura përfshin humbjen e përkohshme të integritetit profesional të përfaqësuesve të kompanive të përfshira dhe, nëse këto të fundit janë të listuara në bursë, përfaqësuesit e tyre përkohësisht janë të ndaluar të administrojnë, menaxhojnë ose mbikëqyrin kompanitë e listuara për periudha që variojnë nga dy muaj deri në tre vjet. Gjithashtu, KONSOB mund t'i ndalojë kompanitë e listuara, shoqëritë administruese dhe kompanitë e auditimit për të angazhuar shërbimet e kompanisë së paditur për një periudhë maksimale prej tre vjetësh dhe t'u kërkojë shoqatave profesionale të pezullojnë,

në mënyrë të përkohshme, të drejtën e individit për të kryer veprimet e tij profesionale (shih paragrafin 54 më lart). Së fundi, vendosja e sanksioneve administrative financiare sjell si pasojë konfiskimin e të ardhurave ose të përfitimeve të sjelljes së paligjshme dhe të aseteve që e kanë bërë të mundur (shih paragrafin 56 më lart).

98. Është e vërtetë që në rastin prezent nuk janë vendosur gjobat maksimale; Gjykata e Apelit e Torinos ka reduktuar disa nga gjobat e vendosura nga CONSOB (shih paragrafin 30 më lart), dhe nuk është bërë asnjë konfiskim. Megjithatë, konotacioni penal i procedurave varet nga shkalla e ashpërsisë së dënimit ndaj të cilit personi i interesuar është apriori përgjegjës (shih Engel dhe të tjerët, përmendur më lart, § 82), dhe jo ashpërsia e dënimit përfundimisht e vendosur (shih Dubus SA, cituar më lart, § 37). Për më tepër, në rastin në fjalë, aplikantët kishin marrë gjoba që varionin nga 500,000 deri 3,000,000 euro dhe z. Gabetti, z. Grande Stevens dhe z. Marrone u ndaluan të administronin, të menaxhonin ose të mbikëqyrnin kompanitë e listuara për periudha nga dy deri në katër muaj (shih paragrafët 25-26 dhe 30-31 më lart). Ky dënim i fundit ishte i tillë që të kompromotonte integritetin e personave në fjalë (shih, mutatis mutandis, Dubus SA, cit.) Dhe, duke pasur parasysh shumën, gjobat ishin të ashpra të pamohueshme dhe kishin implikime të rëndësishme financiare për ankuesit .

99. Në vështrim të sa më sipër, dhe duke marrë parasysh ashpërsinë e gjobave të diktuara dhe të atyre gjobave që kërkuesve iu desh të paguanin në fund të proceseve, Gjykata është e mendimit se dënimet në fjalë, për shkak të ashpërsisë së tyre ishin penale (shih, mutatis mutandis, Öztürk, cituar më sipër, § 54, dhe, për një këndvështrim ndryshe, Inocêncio kundër Portugalisë (vendim), nr. 43862/98, ECHR 2001 I).

100. Për më tepër, Gjykata përsëriti gjithashtu se, në lidhje me autoritetet e caktuara administrative franceze, të cilat kanë juridiksion në të drejtën ekonomike dhe financiare dhe të cilat gëzojnë kompetenca dënuese, ajo ka vendosur që pjesa penale e Nenit 6 të aplikohet në veçanti në lidhje me Gjykatën e Kundërvajtjeve (Buxhetore dhe Financiare) (Guisset kundër Francës, nr. 33933/96, § 59, KEDNJ 2000 IX), Bordin e Tregjeve Financiare (Didier kundër Francës (vendim), nr. 58188/00, 27 gusht 2002), Komisionin e Konkurrencës (Lilly France SA kundër Francës (Vendim), nr. 53892/00, 3 dhjetor 2002), Komisionin e Sanksioneve të Autoriteteve Mbikëqyrëse të Tregut Financiar (Messier kundër Francës (vendim), nr. 25041/07, 19 maj 2009) dhe Komisioni Bankar (Dubus SA, cituar më lart, § 38). I njëjti konstatim u bë në lidhje me autoritetin rregullator italian përgjegjës për konkurrencën dhe tregun (AGCM - Autorità Garante della Concorrenza e Mercato, shih Menarini Diagnostics S.r.l., cituar më sipër, § 44).

101. Pasi shqyrtoi dhe i kushtoi rëndësi aspekteve të ndryshme të çështjes, Gjykata vendosi që gjobat e vëna ndaj ankuesve kanë natyrë penale, pra Neni 6 § 1 është i zbatueshëm për këtë çështje nën sferën e tij penal (shih , mutatis mutandis, Menarini Diagnostics Srl, loc. ult. cit.).

Gjobat tatimore mund ta përfshijnë ligjin tatimore brenda objektit të Nenit 6, për shkak të madhësisë së tyre, pasi, për shembull, disa gjoba tatimore janë thelbësisht penguese dhe ndëshkuese në qëllimin që ndjekin.[188] Neni 6 zbatohet edhe mbi rregulloret disiplinore, si në ushtri, apo edhe në burg. Mund të arrihet në përfundimin se proceset gjyqësore që nuk përfshihen brenda fushës së Nenit 6, nën sferën penale të tij, janë shumë të rralla.

[188] *Bendenoun kundër Francës*, 24 shkurt 1994, §§46-47; *A.P., M.P. dhe T.P. kundër Zvicrës*, 29 Aug. 1997, §39.

2. Përcaktimi i kohëzgjatjes së proceseve

Në çështjet penale, qëllimi i Nenit 6 § 1, sipas të cilit çdokush ka të drejtën të dëgjohet brenda një kohe të arsyeshme, është të sigurojë që personat e akuzuar të mos qëndrojnë nën akuzë për një kohë të gjatë dhe mbi akuzën të dilet me vendim.[189]Për shembull, në çështjen "***Kart kundër Turqisë***" [GC][190], Gjykata deklaroi se *"personat e akuzuar nuk duhet të qëndrojnë shumë gjatë në një gjendje pasigurie, sa i përket rezultatit të akuzave penale të ngritura kundër tyre".*

Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka përcaktuar pikën e fillimite fillimit dhe të funditpër periudhës që duhet të merret parasysh për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave dhe përputhjen e saj me standartet e vendosura nga Neni 6 Konventës.

a) Pika e fillimit të periudhës që duhet të merret parasysh:

Periudha që duhet të merret parasysh fillon në ditën kur "akuzohet"[191] **personi**. Kjo do të thotë që pika e fillimite fillimit starton nga momenti kur gjendja e të **akuzuarit "ndikohet në mënyrë substanciale"***[192]*. "Koha e arsyeshme" mund të fillojë përpara se çështja të vijë përpara gjykatës së juridiksionit*[193]*.Më së shumti, koha mund të fillojë nga momenti i arrestimittë personit*[194]*. Ajo mund të fillojë edhe nga momenti kur dënohet*[195]* personi. Llogaritjet për të përcaktuar nëse proceset janë kryer brenda një kohe të arsyeshme, mund të fillojnë që nga koha kur ka filluar punë institucioni i ndjekjes penale*[196]*.

Shembull. Në çështjen ***Malkov kundër Estonisë****[197]*, ankuesi u dënua për vrasjen e një shoferi taksie në vitin 2008. Hetimi penal kishte filluar më 6 gusht 1998. Ankuesi u ankua për tejzgjatjen e procesit. GJEDN-ja përsëriti se, në çështjet penale, koha fillon të llogaritet që në momentin kur personi "akuzohet", moment i cili mund të përkojë me periudhën përpara se çështja të depozitohet para një gjykate. Termi "akuzë" korrespondon me testimin që i bëhet situatës për të kuptuar nëse gjendja e të dyshuarit është afektuar në mënyrë substanciale. Gjykata mori datën 17 gusht 2001 si datën e fillimit të procesit, pra ditën kur hetuesi i policisë kishte ngritur akuza kundër ankuesit dhe kishte shpallur arrestin e tij në mungesë. Data e fundit e periudhës është marrë data 22 prill 2009, kur Gjykata e Lartë e kishte refuzuar ankesën e ankuesit. Në total, proceset kishin zgjatur shtatë vjet dhe tetë muaj në tre nivele juridiksioni. Duke marrë parasysh rrethanat, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se proceset kanë zgjatur për një kohë tejet të gjatë, duke shkelur Nenin 6 (1) të KEDNJ-së. Kjo situatë u adresua duke zvogëluarmasën e dënimit të ankuesit.

[189] *Wemhoff k. Gjemanisë, § 18*

[190] *Kart k. Turqisë [GC], § 68,*

191 Për qëllim të Nenit 6 § 1 "akuza" mund të përkufizohet si "njoftimi zyrtar që i jepet një individi nga organi kompetent për një pretendim se ai/ajo ka kryer një vepër penale" (Deweer kundër Belgjikës, § 46), përkufizim i cili përkon gjithashtu me testin nëse situate e të dyshuarit është "prekur thelbësisht" (po aty.; Neumeister kundër Austrisë, § 13; Eckle kundër Gjermanisë, § 73; McFarlane kundër Irelandës wGCç, § 143)).

192 Tychko kundër Rusisë, nr. 56097/07, 11 qershor 2015, paragrafi 63.

193 Deweer kundër Belgjikës § 42.

194 Wemhoff kundër Gjermanisë, § 19

195Neumeister kundër Austrisë, § 18.

196Ringeisen kundër Austrisë, § 110.

197 Çështja nr. 31407/07, vendim i datës 4 shkurt 2010.

b) Pika e fundit e periudhës

Gjykata ka vendosur që në **çështjet penale periudha për të cilën zbatohet Neni 6 mbulon tërë proceset** në fjalë[198], **duke përfshirë dhe proceset e apelit**[199]. Neni 6 § 1, për më tepër, tregon si pikë të fundit të peridhës së kohëzgjatjes së procedurave, vendimin e formës së prerë që përcakton akuzën. Ky mund të jetë një vendim i dhënë nga një gjykatë apeli kur ajo shprehet mbi themelin e akuzës[200]. **Periudha që duhet të merret parasysh zgjat të paktën deri në momentin e shpalljes së fajësisë, ose të pafajësisë**[201]. **Ekzekutimi i një vendimi** të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e gjykimit për qëllimet e Nenit 6 të Konventës. Në çështjen *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, Gjykata nënvizoi sa më poshtë: "Garancitë e ofruara nga Neni 6 i Konventës do të ishin iluzive nëse sistemi ligjor ose administrativ i një Shteti Kontraktues e lejon që një vendim gjyqësor përfundimtar, i detyrueshëm për tu zbatuar, për shpalljen e pafajësisë vazhdon të mbetet jo-operativ në dëm të personit të shpallur të pafajshëm. Procedurat penale janë pjesë e procesit si i tërë dhe mbrojtja e ofruar nga Neni 6 nuk pushon me vendimin për lirimin e personit të akuzuar. Nëse autoritetet administrative shtetërore refuzojnë, ose dështojnë të përmbushin një vendim për lirimin e një të pandehuri, ose edhe nëse e vonojnë këtë proces, garancitë e Nenit 6 të gëzuara më parë nga i pandehuri gjatë fazës së gjykimit do të mbeteshin pjesërisht iluzive[202].

- **Rasti studimor nr. 1**

Faktet.Ankuesi ka lindur në vitin 1977. Ai ishte i ndaluar kur u depozitua kërkesa përpara GJEDNJ-së dhe ishte ende në burg në momentin e dhënies së vendimit nga Gjykata.

A. Proceset penale. Më 5 dhjetor 2006, ankuesi u arrestua dhe u vendos në paraburgim në Austri, në bazë të një urdhër arresti ndërkombëtar. Më 20 dhjetor 2006, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë (*Министарство правде Републике Србије*; "Ministria e Drejtësisë") kërkoi ekstradimin e ankuesit për realizimin e disa llojeve të proceseve penale kundër tij, që nuk lidheshin me çështjen në fjalë. Më 11 janar 2007, gjyqtari hetues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beogradit (Gjykata e Qarkut) hapi një hetim kundër ankuesit, i cili dyshohej të kishte marrë pjesë në një vrasje me pasoja rënduese për shkak të përdorimit të paautorizuar të automjetit të dikujt tjetër dhe falsifikimit. Ndërkohë, më 16 prill 2007 gjykata kompetente në Austri e deklaroi ankuesin fajtor për posedim të një arme zjarri të palicencuar, e cila i ishte gjetur me vete në momentin e arrestimit dhe e dënoi atë me burgim prej shtatë muajsh. Më 6 korrik 2007, ankuesi u ekstradua në Serbi.

14. Më 31 dhjetor 2007, prokurori publik lëshoi një aktakuzë kundër ankuesit dhe dy personave të tjerë. Më 7 maj 2008, u mbajt seanca e parë Gjykatës së Rrethit, ku u vendos që V.S. dhe B.A. do të gjykoheshin në mungesë. Më pas, u caktuan dyzet e një seanca gjyqësore, nga të cilat nëntëmbëdhjetë u shtynë: katër me kërkesë të avokatit të ankuesit dhe pesëmbëdhjetë për arsye të ndryshme procedurale, si, për shembull,

198König v. Germany, § 98
199Delcourt v. Belgium, §§ 25-26; König v. Germany, § 98; V. v. the United Kingdom [GC], § 109
200Neumeister v. Austria, § 19
201 Eckle v. Germany, § 77; Ringeisen v. Austria, § 110; V. v. the United Kingdom [GC], § 109
202 Assanidze v. Georgia [GC], § 181.

mungesa e mbrojtësit të të bashkakuzuarit, mungesa e dëshmitarëve të thirrur dhe/ose ekspertëve, dërgimi i thirrjeve në adresa të gabuara dhe vonesat në lidhje me vlerësimin e ekspertëve. Për më tepër, gjykimi u desh të fillonte nga fillimi gjashtë herë, për shkak të ndryshimit të gjyqtarit kryesues dhe/ose përbërjes së trupit gjykues. Nga marsi i vitit 2010, pas një reforme të sistemit gjyqësor të brendshëm, çështja iu kalua Gjykatës së Lartë të Beogradit (Gjykata e Lartë). Më 1 prill 2014, Gjykata e Lartë e shpalli ankuesin fajtor për bashkëpunim në vrasje të rëndë, përdorim të paautorizuar të automjetit të një personi tjetër dhe falsifikim. Ajo e dënoi ankuesin me njëzet vjet burg. Më 4 dhe 17 korrik 2014, përkatësisht, ankuesi dhe prokurori publik u ankuan kundër vendimit të Gjykatës së Lartë. Më 31 tetor 2014, Gjykata e Apelit e Beogradit (Gjykata e Apelit) e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 1 prill 2014 dhe e ktheu çështjen për rigjykim.

B. Ndalimi i ankuesit. Më 11 janar 2007, gjyqtari hetues lëshoi një urdhër ndalimi kundër ankuesit, në mungesë, për arsyet e mëposhtme: 1. rrezikun e fshehjes; 2. rrezikun e pengimit të drejtësisë përmes ushtrimit të presionit mbi dëshmitarët dhe të bashkakuzuarin tjetër; 3. rrezikun e recidivizmit; dhe 4. rëndësinë e veprave penale për të cilat ai akuzohet dhe dënimin që mund t'i caktohet. Pas ekstradimit në Serbi më 6 korrik 2007, ankuesi u arrestua në bazë të urdhrit të mësipërm. Përkatësisht, më 6 gusht dhe 4 tetor 2007, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Lartë e Serbisë (Gjykata e Lartë) e zgjatën më tej paraburgimin e ankuesit, duke u mbështetur në të njëjtat arsye sa më sipër. Ata vunë në dukje në veçanti se ankuesi ishte fshehur dhe ishte arrestuar në bazë të një urdhër-arresti ndërkombëtar. Që prej këtij momenti, paraburgimi i ankuesit u shqyrtua rregullisht dhe u zgjat çdo dy muaj nga Gjykata e Rrethit, Gjykata e Lartë dhe, si rezultat i një reforme në sistemin gjyqësor vendas, u shqyrtua nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit. Përveç këtyre shqyrtimeve automatike, ankuesi e kundërshtoi në mënyrë të përsëritur paraburgimin e tij. Më 31 tetor 2014, me anë të një vendimi që shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Lartë, të datës 1 prill 2014 dhe e ktheu çështjen për rigjykim (shih paragrafin 19 më sipër), Gjykata e Apelit urdhëroi ndalimin e ankuesit me arsyetimin se ai mund të fshihej dhe mund të behej recidivist.

B. Proceset gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese

Më 29 dhjetor 2011, ankuesi depozitoi një kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese, ku ankohej se paraburgimi i tij ishte i paligjshëm dhe kohëzgjatja e tij ishte e tepërt. Ai u ankua gjithashtu për kohëzgjatjen e procedurës penale dhe pretendoi se i ishte shkelur e drejta për prezumim pafajësie. Më 26 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën e ankuesit. Sa i përket ankesës për kohëzgjatjen e procesit penal, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se rasti në fjalë ishte i ndërlikuar. Dosja e lëndës përmbante më shumë se një mijë faqe dhe dokumentacion të gjerë fotografik. Për më tepër, kishte qenë e nevojshme që proceset gjyqësore të niseshin disa herë nga e para për shkak të ndryshimeve të kryetarit të trupit gjykues. Ajo sqaron më tej se janë ndërmarrë shumë hapa proceduralë, janë dëgjuar shumë dëshmitarë dhe janë thirrur shumë ekspertë për të dëshmuar. Së fundi, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën e ankuesit edhe lidhur me prezumimin e pafajësisë si të pabazuar.
Ankesat e mëpasshme kushtetuese të ankuesit, në thelb lidhur me të njëjtat pretendime, u refuzuan përkatësisht më 26 dhe 27 shtator, dhe 10 tetor 2012 dhe 20

nëntor 2013 për të njëjtat arsye si më parë.

Pyetje

1. *Nëse mundet të tregoni se cila është pika e fillimit që duhet të merret parasysh për vlerësimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore?*
2. *A mendoni se procedura e përshkuar është në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor brenda një kohe të arsyeshme? Pse?*
3. *Çfarë rrethanash duhet të shqyrtoni për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore?*

Vlerësimi i Gjykatës. Për çështjen nën shqyrtim (GRUJOVIĆ kundër SERBISË), Gjykata arriti në përfundimin e mëposhtëm.

"60. Gjykata rithekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së ankuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe të asaj që rrezikon ankuesi në mosmarrëveshje (shih, midis shumë çështjeve të tjera, *Sürmeli kundër Gjermanisë* [GC], nr. 75529/01, § 128, KEDNJ 2006-VII). Në çështjet penale Neni 6 synon të sigurojë që personi i akuzuar të mos mbetet për shumë kohë në gjendje pasigurie për fatin e tij (shih *Nakhmanovich kundër Rusisë*, nr. 55669/00, § 89, 2 mars 2006, dhe *Veliyev v. Rusia*, nr. 24202/05, § 173, 24 qershor 2010). Gjykata u shpreh se për ankuesin në çështjen nën shqyrtim viheshin shumë aspekte në pikëpyetje, duke pasur parasysh se ai rrezikonte burgimin, se ishte mbajtur i ndaluar gjatë gjithë proceseve gjyqësore dhe se ai ishte ende i ndaluar në pritje të procedurës së rigjykimit.

61. Gjykata vëren se periudha në shqyrtim për këtë çështje ka filluar më 6 korrik 2007, datë kur ankuesi u ekstradua në Serbi (shih *Nedyalkov*, cituar më sipër, § 86, dhe *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, § 65 , 27 maj 2010). Proceset gjyqësore filluan më 7 maj 2008 dhe përfunduan më 1 prill 2014. Ata u pasuan me proceset në apel, të cilat përfunduan më 31 tetor 2014, kur Gjykata e Apelit e riktheu çështjen për rigjykim. Nga informacionet e disponueshme, duket se proceset gjyqësore janë ende pezull në pritje të gjykimit para gjykatës së juridiksionit. Rezulton që proceset penale kundër ankuesit, deri tani kanë zgjatur pothuajse tetë vjet për të dyja nivelet e juridiksionit.

62. Siç është theksuar nga Gjykata në paragrafët e mësipërm në lidhje me Nenin 5 § 3, çështja në fjalë nuk ka të bëjë me cështje komplekse ligjore apo faktike që e justifikojnë një tejzgjatje të tillë të proceseve gjyqësore, po ashtu nuk ka të bëjë me krimin e organizuar.

63. Sa i përket sjelljes së ankuesit, Gjykata përsërit se nuk mund ti kërkohet një ankuesi që të bashkëpunojë në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore, po ashtu ai nuk mund të kritikohet për arsyen se i ka përdorur plotësisht mjetet juridike në dispozicion, në bazë të ligjit, në mbrojtje të interesave të tij (shih, ndër të tjera, *Rokhlina kundër Rusisë*, nr. 54071/00, § 88, 7 prill 2005).

64. Sa i përket sjelljes së autoriteteve përkatëse, Gjykata vëren se gjykata e juridiksionit kishte planifikuar gjithsej dyzet e dy seanca dëgjimore, nga të cilat nëntëmbëdhjetë ishin shtyrë, kryesisht për arsye të ndryshme procedurale, të cilat nuk i ishin ngarkuar ankuesit (shih paragrafin 16 më sipër). Për më tepër, gjykimi duhej të fillonte përsëri

nga e para gjashtë herë, sepse gjyqtari kryesues dhe/ose përbërja e trupit gjykues kishin ndryshuan. Qeveria nuk ofroi ndonjë shpjegim për këto ndryshime.

65. Ankuesi mbeti në paraburgim gjatë gjithë proceseve gjyqësore kundër tij dhe vazhdon të jetë ende i ndaluar. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që personat e mbajtur në paraburgim në pritje të gjykimit kanë të drejtë për "kujdes të veçantë" nga ana e autoriteteve. Rrjedhimisht, në rastet kur një person është i ndaluar në pritje të caktimit të një akuze penale kundër tij, fakti i paraburgimit të tij është në vetvet një faktor që duhet të merret parasysh në vlerësimin nëse vendimi mbi themelin është arritur brenda një afati të arsyeshëm shih, për shembull, *Abdoella kundër Holandës*, 25 nëntor 1992, § 24, seria A nr. 248-A, *Jabłoński kundër Polonisë*, nr. 33492/96, § 102, 21 dhjetor 2000, *Mõtsnik kundër Estonisë*, nr. 50533/99, § 40, 29 prill 2003, dhe *Bąk kundër Polonisë*, nr. 7870/04, § 81, 16 janar 2007).

66. Autoriteteve vendase u është kërkuar të organizojnë gjykim efikas dhe të sigurojnë respektim të plotë të garantive të Konventës në proceset gjyqësore. Megjithatë, në rrethanat e çështjes, Gjykata nuk është e bindur se sjellja e autoriteteve ishte në përputhje me balancimin e drejtë që duhet të arrihet midis aspekteve të ndryshme të kësaj kërkese themelore.

67. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe kohëzgjatjen tërësore të proceseve, Gjykata është e mendimit se kërkesa për kohëzgjatje "të arsyeshme " e Nenit 6 § 1 të Konventës nuk është respektuar. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të Konventës.

- **Rasti studimor nr. 2**

Faktet.Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitin 1992 dhe 1996 dhe jetojnë në Beograd. Më 28 dhjetor 2000, Gjykata e Tretë Bashkiake (*Treći opštinski sud*) në Beograd vendosi shkurorëzimin e prindërve të ankuesve dhe urdhëroi babanë e tyre (më poshtë "i pandehuri") që të paguante për secilin prej tyre 25% të të ardhurave të tij mujore për kujdesin e fëmijëve.

9. Më 27 qershor 2001 ky vendim mori formë të prerë. Më 2 prill 2003, nëna e ankuesve depozitoi një padi penale kundër të pandehurit, pasi pretendonte se ai nuk kishte paguar shumat e akorduara për kujdesin e fëmijëve. Më 13 maj 2003, Zyra e Prokurorit Publik të Tretë Bashkiak kërkoi hapjen e hetimit. Më 29 maj 2003, gjatë procedurës paraprake pranë Gjykatës së Tretë Bashkiake, nëna e ankuesve, duke vepruar në emër të ankuesve, kërkoi pagesën e kujdesit për fëmijën të përllogaritur në bazë të aktgjykimit të miratuar më 28 dhjetor 2000 (d.m.th. paraqiti një "ankesë të palës civile"; "*podnela predlog za ostvarivanje imovinsko-pravnog zahtjeva*"). Më 14 korrik 2003, Zyra e Prokurorisë Publik të Bashkisë së Tretë kërkoi hapjen e procesit ndaj këtij të pandehuri. Seanca e parë e caktuar në datën 9 dhjetor 2003 u shty. Në periudhën nga marsi i vitit 2004 deri në prill të vitit 2005 u organizuan dy seanca dëgjimore, ndërsa tri seanca të tjera u shtynë për arsye të ndryshme procedurale. Më 25 prill 2005, Gjykata e Tretë Bashkiake vendosi ta shqyrtojë padinë civile në themel dhe kërkoi

mendimin e ekspertëve në lidhje me shumën për kujdesin për fëmijët për periudhën nga janari i vitit 2001 deri në qershor të vitit 2005. Eksperti e paraqiti raportin më 7 korrik 2005. Në periudhën ndërmjet gushtit të vitit 2005 dhe tetorit 2006, katër seanca u shtynë ose për shkak të mosparaqitjes së avokatit të të pandehurit para gjykatës, ose për shkak të mosveprimit të gjykatës për ta thirrur atë në mënyrën e duhur. Duke pasur parasysh mundësinë e zgjidhjes së problemit me të pandehurin, përfaqësuesi ligjor i ankuesve kërkoi nga gjykata që të miratojë një shtyrje të shkurtër të seancës dëgjimore, datë 22 nëntorit, 2006. Gjykata riplanifikoi seancën për datën 8 dhjetor 2006. Në periudhën ndërmjet dhjetorit 2006 dhe tetorit 2007, u mbajtën edhe dy seanca të tjera dëgjimore, ndërsa tri seanca u shtynë për arsye procedurale, njëra prej të cilave për shkak të "angazhimeve të tjera" (*zbog sprečenosti*) të gjyqtarit kryesues. Në një letër, datë 11 shtator, 2007, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Tretë Bashkiake, ankuesit pretendonin se kryetarja e trupit gjykues kishte deklaruar vetë se ajo "nuk dinte se çfarë të bënte me çështjen" dhe do t'ia lironte me kënaqësi vendin një gjyqtari tjetër". Më 22 nëntor 2007, Gjykata e Tretë Bashkiake kërkoi një version të përditësuar të mendimit të ekspertit. Eksperti e dorëzoi raportin më 8 janar, 2008. Gjykata ia shpërndau raportin palëve në seancën e datës 8 shkurt 2008, e cila u shty për t'u lejuar palëve që të paraqesin komentet e tyre me shkrim. Seanca e caktuar për datën 6 mars 2008 u shty për shkak të mosparaqitjes së prokurorit dhe përfaqësuesit të ankuesve dhe u riplanifikua sërish për datën 1 prill 2008.

Për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit në gjykatë, gjykata e shtyu seancën e datës 1 prill 2008 dhe e planifikoi seancën e ardhshme për datën 9 korrik 2008. Edhe kjo seancë duket se është shtyrë. Më 8 tetor 2008, Gjykata e Tretë Bashkiake e shpalli të pandehurin fajtor për mospagimin e shumës për kujdesin ndaj fëmijëve dhe e dënoi atë me tre muaj burgim, të pezulluar për një vit. Gjykata më tej i këshilloi ankuesit, bazuar në Nenin 206 të Ligjit "Për procedurën penale" (shih paragrafin 35 më poshtë), që të ndiqte kërkesën për kompensim që kishin bërë gjatë proceseve penale përmes një padie të veçantë civile para gjykatave civile. U vërejt se të dhënat e mbledhura gjatë procesit penal nuk ishin të mjaftueshme për të marrë vendim mbi çështjen në kontekstin penal. U verejt gjithashtu se vendimi nuk u ishte dorëzuar përfaqësuesve të ankuesve. Më 12 shkurt 2009, Gjykata e Rrethit (*Okružni sud*) e Beogradit e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Tretë Bashkiake dhe e ktheu çështjen për rigjykim. Gjykata e Tretë Bashkiake më pas e shtyu seancën e caktuar për datën 22 qershor 2009, për shkak të mosparaqitjessë të pandehurit në gjykatë. Më 16 korrik 2009, Gjykata e Tretë Bashkiake i ndërpreu proceset gjyqësore sepse kishte mbaruar afati kohor i përcaktuar nga prokuroria. Ajo i këshilloi më tej ankuesit se ata mund ta vijonin kërkesën për dëmshpërblim përmes një padie civile të veçantë. Vendimi nuk u ankimua dhe për pasojë u be përfundimtar më 9 tetor të vitit 2009.

<u>Pyetje</u>

1. *A mund të përcaktoni nëse në rastin e mësipërm Neni 6 është i zbatueshëm në aspektin civil, apo penal?*
2. *A mendoni që procedura e përshkruar është në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm? Pse?*
3. *Çfarë rrethanash do të shqyrtoni për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore?*

***Vlerësimi i Gjykatës**. Faktet janë marrë nga çështja **Ristic kundër Serbisë**, nr. 32181/08, datë 18 janar 2011. Gjykata vëren që në fillim se ankuesit nuk ishin të akuzuar në proceset penale objekt kundërshtimi, por thjesht ishin pjesë si ttë demtuar akuzues në to. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Neni 6 nuk zbatohet për proceset penale në lidhje me të drejtën e ndjekjes ose dënimit për një vepër penale të palëve të treta. Megjithatë, Neni 6 mund të zbatohet nën "sferën civil" të proceseve penale që përfshijnë përcaktimin e pretendimeve për dëme pasurore që u janë shkaktuar palëve të dëmtuara (d.m.th. padia civile brenda procesit penal) dhe, edhe në mungesë të këtyre pretendimeve, mund të zbatohet mbi ato procese penale, përfundimi i të cilave është vendimtar për të "drejtën civile" në fjalë (shih Perez kundër Francës [GC], nr. 47287/99, §§ 57-72, ECHR 2004-I). Neni 6 është i zbatueshëm nën sferën civile në proceset penale në momentin kur viktimat bëhen pjesë e tij si palë civile, pra që në momentin kur ato ngrenë padi për dëmshpërblim si rezultat i vuajtjes së veprës penale (Atanasova kundër Bullgarisë, No. 72001/01, 2 tetor 2008, § 51; dhe Boris Stojanovski kundër "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", nr. 41916/04, 6 maj 2010, § 40), edhe në rast se kjo ndodh gjatë fazës së hetimeve paraprake të çështjes (shih Tomasi kundër Francës, 27 gusht 1992, seritë A nr. 241-A; dhe Perez kundër Francës, citуar më sipër, § 40). Në veçanti, Gjykata arriti në përfundimin e mëposhtëm.*"

45. Gjykata më tej kujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse dhe (shih, ndër të tjera, *Cocchiarella kundër Italisë* [GC], nr. 64886/01, GJEDNJ 2006-V; *Frydlender kundër Francës* [GC], nr.30979/96, CEDH 2000-VII, *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983, seria A 66, dhe *Jablonski kundër Polonisë*, nr. 33492/96, datë 21 dhjetor 2000).

46. Duke iu kthyer çështjes nën shqyrtim, ***Gjykata vëren, së pari, se Neni 6 është i zbatueshëm duke filluar që nga data 29 maj 2003, datë kur nëna e ankuesve e depozitoi çështjes në emër të tyre, pra e depozitoi padinë civile si pjesë të procesit penal, duke u dhënë kështu ankuesve statusin e palëve civile në procesin penal.*** Ankesat ishin hartuar qartazi për të siguruar një dënim i cili do t'u mundësonte ankuesve të ushtronin të drejtat e tyre civile, d.m.th. të drejtën për marrjen e shumës për kujdesin ndaj fëmijëve, siç ishte urdhëruar nga Gjykata me anë të vendimit, të datës 28 dhjetor 2000.

*47. Gjykata, së dyti, vëren se, për qëllimet e kësaj çështjeje, **procedurat e kontestuara zgjatën nga data 29 maj 2003 deri më 9 tetor 2009, kur vendimi gjyqësor, datë 16 korrik 2009, u bë i formës së prerë .** Më 3 mars 2004, data kur Konventa ka hyrë në fuqi në lidhje me Serbinë, ankuesit kishin qenë në pritje të vendimit për nëntë muaj, ndërsa pas kësaj date ata bien brenda kompetencës ratione temporis të Gjykatës për një periudhë prej pesë vjetësh dhe shtatë muajsh në dy nivele juridiksioni (shih, ndër të tjera, Styranowski kundër Polonisë, vendim i datës 30 tetor 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe aktvendimeve 1998-VIII, § 46).*

*48. **Së treti, proceset në fjalë nuk kishin ndonjë kompleksitet të veçantë,** ato përfshinin çështje me rëndësi të madhe për ankuesit dhe, për më tepër, Konventa, si dhe e drejta e brendshme përkatëse kërkojnë kujdes të jashtëzakonshëm në të gjitha çështjet që kanë të*

bëjnë me fëmijët.

*49. Së katërti, **sjellja e ankuesve nuk ka kontribuar në vonesën procedurale të ankimuar**, përveç, ndoshta, në lidhje me kërkesën e tyre për shtyrjen e seancës së caktuar për datën 22 nëntor 2006 për gjashtëmbëdhjetë ditë, në mënyrë që të përpiqeshin të arrinin një zgjidhje, dhe vetëm pjesërisht në lidhje me seancën e caktuar për datën 6 mars 2008, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të tyre, së bashku me prokurorin (shih paragrafët 19 dhe 25 më sipër). Për më tepër, raporti i dytë financiar i ekspertëve ishte i nevojshëm për të llogaritur koston e përkujdesjes, si dhe interesin ligjor, të akumuluar gjatë kohës së zhvillimit të proceseve gjyqësore.*

*50. Së pesti, **ndërsa gjykatat e brendshme duhet të mbrojnë procesin e rregullt ligjor në lidhje me të pandehurin, ato duhet të sigurojnë po ashtu edhe mbrojtje të përshtatshme për viktimat, veçanërisht në rastet kur ato mund të jenë të rinj dhe të pambrojtur.***

*51. Së gjashti, Gjykata vëren se mbrojtjes së të pandehurit i mbaroi afati i parashtruar dhe, si rezultat, u bë e **pamundur për ankuesit të merrnin një vendim për pretendimin e tyre si pjesë e proceseve penale.***

*2. Duke marrë parasysh sa më sipër, si edhe faktin se për çështjen nën shqyrtim **ka pasur disa periudha domethënëse të inaktivitetit të trupit gjyqësor të ngarkuar për këtë çështje dhe disa shtyrje të paautorizuara të seancave gjyqësore, Gjykata konstaton se karakteri i tejzgjatur i proceseve gjyqësore i ngarkohet kryesisht autoriteteve gjyqësore të shtetit të paditur.***

53. Për pasojë, Gjykata është e mendimit se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore të ankimuara nuk e përmbush kërkesën për një kohëzgjatje të arsyeshme. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës."

3. Kriteret që përcaktojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore

Gjykata është e mendimit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve penale duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të posaçme të çështjes, duke marrë parasysh kriteret e paracaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në veçanti kompleksitetin e çështjes, sjelljen e ankuesve dhe të autoriteteve përgjegjëse dhe rëndësinë e asaj që është në rrezik për ankuesin në proces.[203]

a) Kompleksiteti i çështjes

Kompleksiteti i çështjes ka të bëjë si me faktet, ashtu edhe me të drejtën. Një çështje komplekse mund të përfshijë çështje që kanë të bëjnë, për shembull, me gjendjen shëndetësore[204] të një ankuesi, me numrin e madh të personave të prekur[205], mund të

203 Shih Süßmann kundër Gjermanisë, 16 shtator 1996, § 48, raporte 1996-IV, dhe Gast dhe Popp kundër Gjermanisë, nr. 29357/95, § 70, ECHR 2000-II.
204 Yaikov kundër Rusisë, nr. 39317/05, 18 qershor 2015, paragrafi 76.
205 Papachelas kundër Greqisë, nr. 31423/96, 25 mars 1999, paragrafi 39 (kompleksiteti i fakteve).

kërkojë analizimin e një vëllimi të madh provash[206], ose çështje komplekse ligjore[207], ose mund të kërkojë marrjen në pyetje të një numri të madh dëshmitarësh[208]. Disa çështje mund të jenë më komplekse për shkak të natyrës e tyre, për shembull, nëse kanë të bëjnë me të dyja, si me interesat e komunitetit, ashtu dhe me ato individuale[209]. Kompleksiteti mund të vijë si pasojë, për shembull, nga numri i lartë i akuzave, numri i personave të përfshirë në procese gjyqësore, siç janë të pandehurit dhe dëshmitarët, apo dimensioni ndërkombëtar i çështjes.

Shembull. Në çështjen ***Neumeister kundër Austrisë***[210], transaksionet objekt i shqyrtimit kishin pasoja në vende të ndryshme, çfarë kërkonte asistencën e Interpolit dhe zbatimin e traktateve për ndihmë të ndërsjellë juridike. Në to përfshiheshin 22 njerëz, disa prej të cilëve jetonin jashtë shteti. Gjykata i shqyrtoi të gjithë këta faktorë gjatë vlerësimit të kohës së arsyeshme në proceset e brendshme (dimensionin ndërkombëtar).

Një çështje mund të jetë jashtëzakonisht e ndërlikuar edhe në rastet kur dyshimet kanë të bëjnë me krimet e "bluzave të bardha", për shembull, në rastin e një mashtrimi në shkallë të gjerë, i cili përfshin disa kompani dhe transaksione komplekse, të projektuara për t'i shpëtuar shqyrtimit të autoriteteve hetimore dhe që kërkojnë ekspertizë[211] të konsiderueshme në fushën e kontabilitet dhe atë financiare.

Edhe pse një çështje mund të konsiderohet disi komplekse, Gjykata nuk mund t'i konsiderojë periudhat e gjata të inaktivitetit që nuk shpjegohen për ndonjë arsye specifike, si "të arsyeshme".

Shembull. Në çështjen ***Adiletta kundër Italisë***[212], çështja kishte zgjatur për një periudhë të përgjithshme prej trembëdhjetë vjetësh dhe pesë muajsh, përfshirë edhe një vonesë prej pesë vjetësh, ndërmjet referimit të çështjes tek gjyqtari hetues dhe marrjes në pyetje të të akuzuarve dhe dëshmitarëve, si dhe kishte pasur një vonesë prej një viti dhe nëntë muajsh ndërmjet kohës kur çështja iu kthye gjyqtarit hetues dhe ridërgimit të ankuesve për gjykim. Çështja ishte komplekse, veçanërisht në fazën e hetimit paraprak. Përveç kësaj, vetë ankuesit kishin shkaktuar vonesa përmes disa kërkesave për shtyrje seancash. Megjithatë, Gjykata u shpreh se në rastin konkret nuk mund të konsiderohet "e arsyeshme" kohëzgjatja prej trembëdhjetë vjetësh dhe pesë muajsh (kompleksiteti i hetimeve paraprake)

Shembull. Në çështjen ***Matoń kundër Polonisë***,[213] ankuesi ishte akuzuar për trafik droge, posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit dhe anëtarësim në një grup kriminal të organizuar. Çështja përfshinte 36 të pandehur dhe 147 dëshmitarë. Ankuesi u dënua në vitin 2008. Ai u ankua në gjykatën rajonale, e cila ende nuk kishte marrë vendim mbi ankimin e tij në kohën e shqyrtimit të çështjes nga GJEDNJ-ja.

206 Eckle kundër Gjermanisë, nr. 8130/78, 15 korrik 1982.
207 Breinesberger dhe Wenzelhuemer kundër Austrisë, nr. 46601/07, 27 nëntor 2012, paragrafët 30–33.
208 Mitev kundër Bullgarisë, nr. 40063/98, 22 dhjetor 2004, paragrafi 99.
209 Wiesinger kundër Austrisë, Nr. 11796/85, 30 tetor 1991, paragrafi 55.
210 Neumeister kundër Austrisë, § 20.
211 C.P. dhe të tjerët kundër Francës, § 30.
212 Adiletta kundër Italisë, § 17.
213 Matoń kundër Polonisë, 483, më 19 qershor 2000.

Gjithashtu, ai depozitoi një padi edhe në Gjykatën e Apelit, ku pretendonte shkelje të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Kjo gjykatë e rrëzoi kërkesën e tij. GJEDNJ-ja pranoi se çështja ishte shumë komplekse, pasi përfshinte shumë të pandehur dhe dëshmitarë. Megjithatë, ajo deklaroi se kjo nuk mund ta justifikonte kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurës penale. Edhe po të merren parasysh vështirësitë e mëdha me të cilat ballafaqohen autoritetet e brendshme, atyre u kërkohet ta organizojnë gjyqin në mënyrë efikase dhe të sigurojnë respektimin e garancive të GJEDNJ-së. Sipas Gjykatës, proceset penale, të cilat zgjatën mbi tetë vjet, nuk e respektonin kërkesën për kohëzgjatje të arsyeshme. Pra, në këtë çështje ka pasur shkelje të Nenit 6 të KEDNJ-së (numri i madh i personave të prekur dhe vëllimi i lartë i provave).

b) Sjellja e ankuesit

Sjellja e ankuesit përbën tipar objektiv të proceseve gjyqësore, prandaj duhet të merret parasysh kur përcaktohet nëse është tejkaluar ose jo periudha e arsyeshme e gjykimit[214].

Dy shembujt e mëposhtëm tregojnë rastet se kur duhet të merret parasysh sjellja e një ankuesi.

Shembull. Në çështjen **Eckle kundër Gjermanisë**, ankuesit ndërmernin gjithnjë e më shumë veprime që kishin gjasa të vononin proceset gjyqësore, si, për shembull, e kundërshtonin në mënyrë sistematike gjyqtarin. Disa prej këtyre veprimeve mund të vlerësoheshin dhe qëllimisht frenuese. Shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për vonesa të lidhura me sjelljen e ankuesit[215].

Shembull. Në çështjen **I.A. kundër Francës**, ankuesi, ndër të tjera, priti të informohej se transmetimi i dosjes tek prokurori publik ishte i menjëhershëm, përpara se të kërkonte disa masa[216] shtesë hetimore.

Megjithatë, sjellja e ankuesit nuk duhet të përdoret për të justifikuar periudhat e inaktivitetit nga autoritetet.

Shembull. Në çështjen ***Veliyev kundër Rusisë***, ankuesi u arrestua dhe u ndalua më 26 shkurt 2004 me dyshimin për pjesëmarrje në shumë grabitje të armatosura të organizuara. Vendimi i shkallës së parë ishte dhënë më 21 qershor 2006. Dënimi u pranua në apel. Qeveria argumentoi se procedurat ishin zgjatur për shkak të akteve të qëllimshme të të bashkakuzuarit, përkthimit nga gjuha ruse në atë azere, dhe sëmundjeve të rastësishme të ankuesit, të bashkakuzuesit, dhe avokatët. GJEDNJ-ja përsëriti se një ankues nuk mund të jetë i detyruar të bashkëpunojë në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore dhe nuk mund të kritikohet për përdorimin e plotë të mjeteve të brendshme në dispozicion të tij. Në këtë rast, ankuesi nuk ka kontribuar në mënyrë domethënëse në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe se disa vonesa

214 Wiesinger kundër Austrisë, nr. 11796/85, 30 tetor 1991, paragrafi 57.
215 Eckle v. Gjermanisë, § 82
216 I.A. v. France, § 121

mund t'i atribuohen autoriteteve të brendshme. Neni 6 kërkon që proceset gjyqësore të jenë të shpejta, por përcakton gjithashtu edhe parimin e përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet e brendshme nuk kishin gjetur një balancim të drejtë midis aspekteve të ndryshme të kësaj kërkese themelore, duke shkelur kështu Nenin 6 të KEDNJ-së[217].

c) Sjellja e autoriteteve përkatëse

Gjatë vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme proceseve, Gjykata mer në vlerësim vonesat që i atribuohen shtetit[218]. Neni 6 § 1 i imponon Shteteve Kontraktuese detyrimin për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat përkatëse të plotësojnë secilën prej kërkesave të Konventës.[219]

Shtetet duhet të kërkojnë mënyra për t'u siguruar që sistemet e tyre gjyqësore nuk krijojnë vonesa në procese gjyqësore. Shtetet duhet t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për t'u mundësuar gjykatave të tyre që të garantojnë të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme[220]. Megjithatë, përgjegjësia kryesore për përgatitjen e çështjes dhe për kryerjen e shpejtë të një gjykimi u takon gjyqtarëve[221]. GJEDNJ-ja ka konstatuar se ndryshimet e përsëritura të gjyqtarëve "nuk mund ta zhveshin shtetin nga përgjegjësia, pasi ai është përgjegjës për të siguruar që administrimi i drejtësisë është organizuar siç duhet.[222]. Ashtu sikurse një"mbingarkesa kronike" e gjykatave me çështje nuk i justifikon proceset e tejzgjatura[223].

Shembull. Në çështjen ***Sociedade de Construções Martins & Vieira, Lda. dhe të tjerët kundër Portugalisë***, autoritetet hetuese të Portos kishin hapur më 17 shtator 1999 një hetim mbi aktivitetet fiskale të ankuesve në të shkuarën. Më pas, u çelën dy padi të veçanta penale para gjykatave penale të Portos dhe Barcelonës. Në kohën e shqyrtimit të çështjes para GJEDNJ-së, të dyja çështjet penale ishin ende pezull. GJEDNJ-ja vuri në dukje se proceset i kishin kaluar 14 vjet. Po ashtu ato kishin qëndruar pezull për gati katër vjet në periudhën ndërmjet dhjetorit të vitit 1999, kur ankuesit u bënë të pandehur, dhe prillit dhe nëntorit të vitit 2003, kur u ngrit padia penale kundër ankuesve. Ajo u pasua me një vonesë tjetër prej dy vjetësh në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2005, kur u caktua data e gjykimit. Kjo tregon se, që prej fillimit, gjykatat vendase nuk kishin treguar kujdesin e duhur lidhur me trajtimin e çështjeve kundër ankuesve. Gjykata deklaroi se pavarësisht faktit se duket mëse e arsyeshme për gjykatat vendase të presin rezultatin e proceseve gjyqësore paralele në funksion të efikasitetit procedural, kjo gjithsesi duhet të jetë proporcionale, pasi, do sillte si pasojë

217 Veliyev k. Rusisë.

218 Buchholz k. Gjermanisë, Nr. 7759/77, 6 maj 1981, para. 49; Yagtzilar dhe të tjerët k. Greqisë, Nr. 41727/98, 6 dhjetor 2001.

219 Abdoella k. Holandës, § 24; Dobbertin k. Francës, § 44

220 Cocchiarella k. Italisë, Nr. 64886/01, 29 mars 2006, para. 119; për cështje penale, shih Dobbertin k. Francës, Nr. 13089/87, 25 shkurt 1993, para. 44.

221 Capuano k. Italisë, Nr. 9381/81, 25 qershor 1987, paragrafët 30-31).

222 Lechner dhe Hess k. Austrisë, Nr. 9316/81, 23 prill 1987, para. 58.

223 Probstmeier k. Gjermanisë, Nr. 20950/92, 1 korrik 1997, para. 64.

mbajtjen për një kohë të gjatë të të akuzuarit në gjendje pasigurie. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6 të KEDNJ-së[224].

Shembull.Në çështjen "***Kaciu dhe Kotori kundër Shqipërisë***", Gjykata u shpreh se "problemi kryesor në çështjen konkrete [...] ka të bëjë me kthimin e shpeshtë për rigjykim të çështjes nga gjykatat më të larta në gjykatat më të ulëta (*shih Marini kundër Shqipërisë*). Gjykata vëren në veçanti se pas dëgjimit të çështjes nga Gjykata e Lartë më 15 janar 2003, ajo u dërgua për rigjykim në Gjykatën e Rrethit. Në proceset e reja, gjykatae faktit nuk iu ishte përmbajtur udhëzimeve tëdhëna nga Gjykata e Lartë dhe kjo sjellje kishte çuar në hapjen e një tjetër procesi, i cili zgjati rreth dy vjet deri në vendimin e Gjykatës së Apelit, datë 15 tetor 2004, si rezultat i të cilit u ruajt në fuqi dënimii ankuesve. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave vendase[225]".

d) Çfarë është me risk për ankuesin

Rëndësia e asaj çfarë riskon ankuesi është një tjetër kriter që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore. Për shembull, kur një person mbahet në paraburgim, ky është faktor që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse akuza është përcaktuar brenda një kohe të arsyeshme, apo jo, pasi në këtë rast proceset duhet të jenë veçanërisht të shpejta.

Shembull. Në çështjen ***Abdoella kundër Holandës***,[226] rezultoi se përcjellja e dokumentevenë Gjykatën e Lartë në dy raste kishte zgjatur21 muaj nga 52 muaj që ishte koha për zgjidhjen e cështjes në tërësi.. Sipas Gjykatës, një zvarritje e tillë me pasojë në inaktivitetin e trupit gjykuesishte e papranueshme, duke pasur në vëmënjde veçanërisht faktin se i akuzuari ishte në paraburgim.

Kërkesa për respektimin e standartit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurva e gjyqësore, behet më rigoroze në vëmëndje të faktit se i akuzuari ishte në paraburgim, raste në të cilat autoriteteve u kërkohet vecanërisht të tregojnë "kujdesin e duhur" me qëllim që të sigurohet një kohëzgjatje e arsyeshme e procedurave. Për shembull, në çështjen *Jablonski kundër Polonisë*, Gjykata rikujton se në shumë raste, në kuadrin e Nenit 5 § 3, personat që mbahen në paraburgim në pritje të gjykimit, kanë të drejtë për "kujdes të veçantë" nga ana e autoriteteve. Rrjedhimisht, në rastet kur personi është i ndaluar në pritje të përcaktimit të një akuze penale kundër tij, paraburgimi në vetvete përbën një faktor nxitës për përmbushjen e kërkesës[227] që të dilet me një vendim themeli brenda një afati të arsyeshëm.
Raste të ngjashme që meritojnë shqyrtim më të shpejtë[228] janë ato që kanë lidhje me fëmijët ose sëmundje kërcënuese për jetën. Për shembull, në një kërkesë për kthimin e

224 Sociedade de Construções Martins & Vieira, Lda. dhe të tjerët kundër Portugalisë,498
225 Shih referencën e përmendur më sipër.
226 Abdoella kundër Holandsë, § 24.
227 Jablonski kundër Polonisë, nr. 33492/96, 21 dhjetor 2000, paragrafi 102; Chudun kundër Rusisë, nr. 20641/04, 21 qershor 2011, paragrafi 112.
228 Hokkanen kundër Finlandës, nr. 19823/92, 23 shtator 1994, paragrafi 72 (është "e domosdoshme" që çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijës të trajtohen me shpejtësi"; X kundër Francës, nr. 18020/91,

fëmijëve në Norvegji në bazë të Konventës Ndërkombëtare kundër Rrëmbimit të Fëmijëve, GJEDNJ-ja theksoi "rëndësinë kritike" që merte skadimi i afateve në këto lloje procesesh gjyqësore, ku vonesat mund të përcaktojnë efektivisht rezultatin[229]e çështjes. Gjithashtu, kujdes i veçantë u duhet kushtuar proceseve gjyqësore që kanë për objekt kompensimin për viktimat e aksidenteve[230] të trafikut rrugor dhe kompensimin në mosmarrëveshjet e lidhur me punësimin.

Shembull. Në çështjen ***Mikulić kundër Kroacisë***, ankuesja dhe nëna e saj paraqitën padi për njohjen e atësisë kundër H.P. Kjo çoi në 15 seanca të planifikuara, gjashtë prej të cilave u shtynë për shkak se H.P. nuk u paraqit. Ai, po ashtu, vazhdimisht nuk paraqitej për testin e ADN-së. Në momentin kur çështja përfundoi në GJEDNJ, proceset gjyqësore kishin katër vjet që kishin filluar, dhe ende ishin në vijim. Çështja kishte të bënte me pretendimin për shkelje të Nenit 8, dhe GJEDNJ-ja kishte theksuar se çështjet që lidhen me statusin dhe kapacitetin civil u duhet kushtuar rëndësi e veçantë. Në vëmëndje të asaj çfarë ishte në risk për ankuesin në rastin në fjalë, nisur nga e drejta e saj për njohjen e atësisë në raport me të paditurin, Neni 6 u kërkon autoritetet kompetente vendase të veprojnë me kujdes të posaçëm për të evituar pasigurinë lidhur me identitetin e babait të saj biologjik,. Për këtë çështje Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të Nenit 6 (1) të KEDNJ-së.

- **Rasti studimor nr. 3**

Faktet

A. Proceset penale në ngarkim tëankuesit. Ankuesi u arrestua më 2 qershor 2005 për dyshime për keqpërdorim të eksplozivëve. Më 11 maj 2007, Prokuroria Qendrore e Hetimeve e paditi ankuesin në Gjykatën Rajonale të Qarkut të Pestit për akuzën për nxitje të vrasjes në rrethana rënduese dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit dhe të eksplozivëve. Seanca e parë në këtë çështje u zhvillua para Gjykatës Rajonale të Qarkut të Pestit më 17 dhjetor 2007. Deri më 10 mars 2009 gjyqtarja e çështjes, znj. K.B.H., organizoi 24 seanca dëgjimore. Më vonë, ankuesi u akuzua nga Kryeprokurori i Budapestit për grabitje me armë. Dy setet e proceseve penale u bashkuan nga Gjykata Rajonale e Qarkut të Pestit më 22 qershor 2009. Ankuesi u ankua për anshmëri të gjyqtares së çështjes, kërkesë e cila u rrëzua. Pas një ankese të dytë të ankuesit, gjyqtarja e çështjes u tërhoq nga gjykimi. Çështja iu caktua një gjyqtareje tjetër, znj. Gy.Sz., e cila organizoi 11 seanca dëgjimore në periudhën nga qershori deri në dhjetor të vitit 2009. Më pas kjo gjyqtare u vetëdeklarua e njëanshme dhe çështja iu caktua një gjyqtareje tjetër, Znj. A.F., e cila zhvilloi 23 seanca dëgjimore nga shtatori i vitit 2010 deri në prill të vitit 2011. Ndërkohë, më 25 tetor 2010, ankuesi u padit nga Prokuroria Rajonale e Komárom-Esztergom për vrasje në rrethana rënduese. Çështja e re iu bashkua proceseve penale në vazhdim, të nisura më 28 janar 2011 nga Gjykata Rajonale e Qarkut të Pestit. Më 17 prill 2011, ankuesi paraqiti ankim për anësi kundër znj. A.F. Më 24 qershor 2011, Gjykata e Apelit e Budapestit e hodhi poshtë ankimin. Ajo vuri në dukje se gjyqtarja ishte vetëdeklaruar e paanshme, së bashku me të katër gjyqtarët e tjerë të çështjes të Gjykatës Rajonale të Qarkut Pest. Pavarësisht vendimit të Gjykatës së Apelit, gjyqtarja u tërhoq, pasi, sipas mendimit të saj, letrat e ankuesit drejtuar Gjykatës Rajonale i kishin shkelur dinjitetin. Më pas, në korrik të vitit 2011,

31 mars 1992, para. 45, çështja duhej të shqyrtohej si çështje urgjence, për shkak të jetëgjatësisë së personave të përfshirë.

229 Hoholm kundër Sllovakisë, nr. 35632/13, 13 janar 2015, paragrafi 51.

230 Martins Moreira kundër Portugalisë, nr. 11371/85, 26 tetor 1988.

çështja iu caktua një gjyqtari tjetër në Gjykatën Rajonale të qarkut të Pestit, z. S.P., i cili nuk realizoi asnjë seancë. Më 25 janar 2012, edhe ai u tërhoq nga gjykimi pas kërkesave të ndryshme të ankuesit, të cilat, me sa duket përmbanin insinuata të ndryshme. Tre gjyqtarët e mbetur të Gjykatës Rajonale të Qarkut Pestit u shpallën të njëanshëm. Më 31 janar 2012, Gjykata e Apelit e Budapestit caktoi Gjykatën e Lartë të Budapestit për të gjykuar çështjen. Gjyqtari drejtues i çështjes në Gjykatën e Lartë organizoi seancën e parë më 7 maj 2012. Më 28 shkurt 2014, ankuesi u deklarua fajtor dhe u dënua me burgim të përjetshëm, me mundësinë e lirimit me kusht pas 30 vjetësh. Më 2 korrik 2015, gjykata e shkallës së dytë e anuloi vendimin dhe e ktheu çështjen mbrapsht për rigjykim në shkallën e parë. Çështja është aktualisht në pritje të gjykimit.

A. Paraburgimi dhe arresti i shtëpisë për ankuesin. Në kuadrin e proceseve të përmendura më sipër, më 4 qershor 2005 Gjykata e Rrethit Kaposvár e ktheu ankuesin në paraburgim. Paraburgimi u zgjat vazhdimisht në intervalet statutore deri më 30 maj 2008, kohë kur Gjykata e Apelit e Budapestit e pezulloi ndalimin dhe urdhëroi vuajtjen me burg të dënimin, i cili ishte bërë i detyrueshëm në lidhje me proceset e tjera penale që nuk ishin të lidhura me çështjen në fjalë. Më 21 maj 2010, në lidhje me akuzat e reja për vrasje në rrethana rënduese nga Prokuroria Rajonale e Komárom-Esztergom-it, Gjykata e Rrethit Tatabánya e ktheu përsëri ankuesin në paraburgim. Vendimi u pranua në apel nga Gjykata Rajonale e Komárom-Esztergom më 1 qershor 2010. Në fakt, ankuesi u vu sërish në paraburgim më 2 shkurt 2011, pasi kishte vuajtur dënimin me burg. Ai parashtroi se sipas ligjit, paraburgimi duhej të ishte shqyrtuar brenda gjashtë muajve, domethënë më 2 gusht 2011, por kjo gjë nuk kishte ndodhur. Më 10 shkurt 2011, ankuesi paraqiti para Gjykatës Rajonale të Qarkut Pest një kërkesë për lirim të menjëhershëm dhe vendosjen në arrest shtëpie. Gjykata e hodhi poshtë kërkesën në të njëjtën ditë. Ankuesi e ankimoi vendimin, por pa sukses. Kërkesat e tij të mëtejshme për lirim ose për masa më pak shtrënguese nuk u morën parasysh. Më 21 nëntor 2011, Prokuroria Publike e Apelit e Budapestit kërkoi nga Gjykata e Apelit e Budapestit që të shqyrtonte paraburgimin e ankuesit sipas Nenit 132 (2) të Kodit të Procedurës Penale. Më 5 dhjetor 2011, ndalimi u zgjat deri në përcjelljen e vendimit të shkallës së parë, në përputhje me Nenin 129 (1) (b) dhe (d) të Kodit të Procedurës Penale (rreziqet për fshehjen ndaj drejtësisë dhe recidivizëm). Gjykata e Apelit e Budapestit konstatoi se ekzistonte rreziku i largimit të ankuesit duke pasur parasysh ashpërsinë e akuzave kundër tij dhe natyrën e dënimit, si edhe shtoi se ekzistonte rreziku për përsëritje të veprave penale, duke pasur parasysh se ankimuesi ishte recidivist i shumëfishtë dhe ishte akuzuar për shumë vepra penale. Kúria e miratoi këtë vendim më 6 janar 2012, duke u shprehur se dënimi i ashpër e justifikonte rrezikun e fshehjes, për shkak të së cilës nuk mund të sigurohej prania e ankuesit në proceset penale. Ajo vuri po ashtu në dukje se vepra e fundit ishte kryer nga ankuesi gjatë lirimit me kusht pas burgimit për nëntë vjet, kështu që ekzistonte një rrezik real për përsëritjen e veprave penale. Gjykata i hodhi poshtë argumentet e parashtruara nga ankuesi lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, të pacaktuar, dhe arriti në përfundimin se kushtet personale të tij nuk e justifikonin një masë më pak të ashpër. Paraburgimi i ankuesit arriti afatin e parashkrimit prej katër vjetësh më 2 shkurt 2012. Më 23 janar 2012, Gjykata e Lartë e Rrethit të Budapestit e vendosi ankuesin në arrest shtëpie në banesën e znj. I.T., një e njohur e aplikantit, arrest që do të kryhej me mbikëqyrje të vazhdueshme policore. Ankuesit i lejohej të largohej nga banesa çdo të mërkurë të dytë të muajit, nga ora 8 deri në orën 16:00. Gjykata vërejti se arsyet për paraburgimin e ankuesit ishin ende të vlefshme dhe masa më pak kufizuese ishte zbatuar vetëm për shkak të kalimit të afatit ligjor katërvjeçar të paraburgimit. Gjykata e rrëzoi kërkesën e ankuesit për leje, duke e urdhëruar që të mos largohej nga vendi i banimit. Sipas gjykatës, argumenti i ankuesit lidhur me shëndetin e nënës së tij dhe situatën modeste financiare të personit që e

kishte marrë në banesë nuk mund të shërbenin si bazë për zbatimin e një mase më pak të rreptë. Më 8 shkurt 2012, Gjykata e Lartë e Budapestit e zgjati masën e arrestit në shtëpi të ankuesit deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë. Ajo vuri në dukje se parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për një vepër penale të dënueshme nga 10 deri në 15 vjet heqje lirie, ose me burgim të përjetshëm, i cili në vetvete tregon se ka rrezik fshehjeje. Ajo u mbështet po ashtu edhe tek sjellja e mëparshme kriminale e aplikantit dhe numrin e veprave penale për të cilat akuzohej ankuesi për të arsyetuar praninë e rrezikut të recividizmit. Më 5 mars 2012, Gjykata e Lartë e Budapestit e miratoi kërkesën e ankuesit për leje për datën 21 mars 2012, për të vizituar nënën e tij në spital, në periudhën ndërmjet orës 8 dhe 12 dhe për të shkuar te dentisti. Më 8 mars 2012, ankuesi kërkoi heqjen e tij nga arresti në shtëpi, duke theksuar se nuk kishte të ardhura vetjake dhe donte të punonte. Ai parashtroi edhe një ofertë për punë nga në një kompani. Kërkesa u rrëzua më 14 mars 2012 nga Gjykata e Lartë e Budapestit, me arsyetimin se nuk kishte rrethana të reja për të ndryshuar masën e dënimit. Më 16 prill 2012, ankuesit iu dha leje e posaçme nga arresti i shtëpisë për çdo të premte të fundit të muajit nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 3 pasdite për të vizituar nënën e shtruar në spital. Pjesa tjetër e kërkesës së ankuesit, e lidhur me lejen për të dalë dy herë në javë nga shtëpia, u hodh poshtë. Kërkesa e mëtejshme për leje të posaçme për të vizituar nënën për pesë orë më 21 qershor 2012 dhe për të studiuar dosjen e çështjeve kundër tij në mjediset e një organizate joqeveritare u pranua më 18 qershor 2012. Më 16 korrik 2012, ankuesit iu dha leje për të vizituar të atin në qytetin Papa më 28 korrik 2012, nga ora 6 e mëngjesit deri në orën 6 pasdite. Kërkesa e mëtejshme e ankuesit për leje për arsye mjekësore u pranua më 18 korrik 2012. Megjithatë, Gjykata e Lartë e Budapestit e rrëzoi kërkesën për leje për t'u kujdesur për nënën e tij çdo ditë, në veçanti për ta ndihmuar atë me injeksionet e insulinën. Gjykata arsyetoi se këtë gjë mund ta bënte në vend të tij znj. I.T., e njohur e ankimuesit dhe e pandehur në proceset penale, e cila jetonte në banesën e nënës së ankuesit. Gjykata deklaroi po ashtu se largimi i gjatë, i përditshëm do të ishte i papajtueshëm me arrestin në shtëpi. Kërkesat e mëtejshme të ankuesit për leje për të shoqëruar të ëmën në ekzaminimet mjekësore u miratuan përkatësisht më 20 korrik dhe 1 gusht 2012, për datën 23 korrik (nga ora 3 pasdite deri në orën 10 pasdite) dhe 3 dhe 15 gusht 2012. Ankuesi paraqiti kërkesa të tjera për leje në qusht të vitit 2012 për të vizituar dy herë në muaj babanë e sëmurë me sëmundje të përhershme në Pápa, për të marrë nënën në shtëpi pas shtrimit në spitali, dhe për të bërë ca veprime me bankën dhe vendin e punës së të ëmës, pasi ajo ishte nën procedura kujdestarie. Me anë të vendimit të datës 14 gusht 2012, Gjykata e Lartë e Budapestit, i dha leje ankuesit ta vizitonte të atin çdo të shtunë të katërt nga ora 6 e mëngjesit deri në orën 6 të pasdites dhe ta shoqëronte nënën që do të dilte nga spitali më 22 gusht, nga ora 7 paradite deri në orën 10 paradite. Kërkesa për të vizituar institucionin financiar dhe vendin e punës së të ëmës u rrëzua, pasi ai nuk kishte dhënë asnjë adresë, ndërsa sipas Nenit 138 (1) të Kodit të Procedurës Penale, leja mund të jepet vetëm për një kohë dhe destinacion të caktuar. Sa i përket kërkesës për vizita më të shpeshta tek i ati, gjykata vuri në dukje se leja e rregullt dhe afatgjatë nga arresti në shtëpi cenonte qëllimin e saj për të siguruar praninë e ankuesit gjatë gjithë procedurës. Ankuesi u ankua duke argumentuar se periudha që i ishte lënë për të ndihmuar të ëmën ishte shumë e shkurtër, se shëndeti i babait të tij po përkeqësohej shpejt, gjë që kërkonte vizita më të shpeshta, d.m.th. çdo dy javë dhe se ai i kishte dhënë detajet e kontaktit të institucionit financiar dhe vendit të punës së të ëmës. Më 1 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Budapestit, duke vepruar si gjykatë e shkallës së dytë, konstatoi se kërkesa e ankuesit lidhur me kohën e kufizuar për të ndihmuar të ëmën ishte e pabazuar dhe pa vend sepse ajo tashmë kishte dalë nga spitali. Pjesa tjetër e ankimit të ankuesit u rrëzua. Kërkesat e mëtejshme të aplikantit për leje për të vizituar babanë e sëmurë, të parashtruara më 14 gusht dhe 2 shtator 2012, nuk u pranuan. Babai i aplikantit vdiq më 8 tetor 2012. Më 10 tetor 2012, gjykata i dha leje ankuesit për

periudhën 15-17 tetor 2012 për të organizuar funeralin e të atit. Më 3 dhjetor 2012, Gjykata e Lartë e Budapestit e liroi ankuesin nga arresti në shtëpi me kushtin që të mos largohej nga vendi i banimit. Gjykata vërejti se nuk kishte arsye për të besuar se ankuesi do t'i fshihej drejtësisë ose do të kryente vepra të tjera. Megjithatë, sipas mendimit të saj, ai ishte akuzuar për një vepër të rëndë që kërkonte masa shtrënguese. Në apel, Gjykata e Apelit e Budapestit e rrëzoi vendimin e shkallës së parë dhe e vendosi ankuesin në masën e arrestit në shtëpi më 20 dhjetor 2012. Ajo vuri në dukje se duke pasur parasysh ashpërsinë e veprës, rreziku i fshehjes ndaj drejtësisë ishte i pranishëm, ashtu si edhe mundësia për recidivizëm, duke pasur parasysh dënimet e mëparshme të shumëfishta. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e Lartë e Budapestit hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për leje për të marrë pjesë në meshë çdo të diel nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 11, si edhe kërkesat e tij të mëtejshme për leje më datë 27 dhe 28 dhjetor 2012, dhe 2 dhe 4 janar 2013. Gjykata vuri në dukje se ankuesi, duke qenë mësues feje në profesion, nuk kufizohej në mënyrë joproporcionale nga ushtrimi i bindjeve fetare. Ky vendim u pranua në apel më 24 janar 2013. Gjykata e Apelit u shpreh se bindja fetare e ankuesit nuk e justifikonte dhënien e lejeve nga arresti në shtëpi dhe se këto leje normalisht reflektonin një ndryshim ndërhyrës në rrethanat personale të të ndaluarit. Gjykata vuri në dukje se një kërkesë e tillë mund të pranohej vetëm nëse kishte të bënte me një vend dhe qëllim specifik. Ndërkohë, znj. I.T., mikpritësja e ankuesit, u ankua në disa raste përpara autoriteteve të ndryshme se oficerët e policisë që e vëzhgonin ankuesin, ndërhynin në jetën e saj private. Ajo parashtroi gjithashtu se, siç kishte thënë që nga fillimi i arrestit në shtëpi, ajo nuk i kishte mjetet e nevojshme financiare për të përballuar shpenzimet e ankuesit. Më 7 janar 2013 znj. I.T. depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë të Budapestit ku kërkonte që ankuesi të largohej nga banesa e saj, për shkak se ajo nuk mund ta mbante më. Në të njëjtën ditë, ankuesi i kërkoi qjykatës që të ndryshonte vendin e arrestit në shtëpi në një vend kampimi në Nagyteve. Ai u informua nga gjykata se, sipas informacionit të marrë nga autoritetet përkatëse, vendi i kampingut nuk ishte i përshtatshëm për qëndrim gjatë dimrit. Pavarësisht nga ky informacion, ankuesi vijoj me kërkesën. Gjyqtari hetues lëshoi një vendim të ri më 8 janar 2013, duke përcaktuar kampin Nagyteve si vendin e ndalimit të ankuesit në arrest shtëpie. Më 8 janar 2013 Departamenti i Policisë i Pápa-s dha një raport mbi praninë e ankuesit në kamp, duke theksuar se "kushtet e këqija të motit, mungesa e furnizimit me ushqim dhe kushtet e këqija higjienike" vinin në rrezik shëndetin e ankuesit. Më 9 janar 2013, Departamenti i Përgjithshëm i Policisë në Qarkun e Veszprém-it depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë të Budapestit për të ndryshuar vendimin e saj të datës 8 janar 2013, pasi kampi ishte i papërshtatshëm për qëndrim afatgjatë. Më 14 janar 2013, ankuesi kërkoi sërish ndërprerjen e arrestit në shtëpi. Kërkesa i tij u rrëzua më 16 janar 2013 nga Gjykata e Lartë e Budapestit, e cila deklaroi se nuk kishte asnjë arsye për ta anuluar vendimin datë 20 dhjetor 2012, dhe se ankuesi ishte në dijeni të kushteve të kampit përpara se të kërkonte të zhvendosej atje. Më 18 janar 2013, mjekja e përgjithshme e zonës vendosi që ankuesi të pranohej në spitalin e zonës. Ekzaminimet e kryera në spital nuk konstatuan ndonjë sëmundje të tillë që të justifikonte trajtimin e mëtejshëm të aplikantit, prandaj ai u lirua të njëjtën ditë dhe u vendos në një institucion kujdesi social në Papa. Më 21 janar 2013, Gjykata e Lartë e Budapestit e ndryshoi vendimin e datës 8 janar 2013 dhe urdhëroi që vendi i vuajtjes së arrestit në shtëpi për ankuesit të ishte sërish banesa e znj. I.T.. C. Ankesa e ankuesit kundër këtij vendimi nuk u mor fare parasysh. Në vendimin datë 26 shkurt 2013, Gjykata e Apelit e Budapestit përsëriti se ankuesi ishte autor i disa veprave penale, i akuzuar për krime të rënda, kështu për të rreziku i fshehjes ndaj drejtësisë dhe përsëritjes së veprave penale ishte i dukshëm. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se nëse nuk do të kishte përfunduar afati ligjor për mbajtje në paraburgim, nuk do të ishte zbatuar kjo masë kufizimi.

Më tutje ajo argumentoi se masa nuk ishte disproporcionale, pasi zgjatja e proceseve ishte kompensuar nga ndërprerja ligjore e paraburgimit të ankuesit. Gjykata rrëzoi edhe argumentin e ankuesit se disa të pandehur të tjerë ishin liruar nga arresti në shtëpi. Më 10 korrik 2013, Gjykata e Lartë e Budapestit vlerësoi masën e arrestit në shtëpi të ankuesit dhe, në të njëjtën kohë, vendosi mbi kërkesën e ankuesit për lirim. Gjatë seancës gjyqësore, gjyqtari i paraqiti ankuesit dhe prokurorit një letër që pretendohej të ishte shkruar nga një prej shokëve të qelisë së ankuesit. Shkruesi i letrës e njoftonte gjykatën se ankuesi kishte për qëllim të pengonte proceset penale me anë të kërcënimit fizik të gjyqtarit hetues dhe më pas përmes kërkesës për përjashtimin e tij për anësi, dhe përmes fillimit të proceseve penale kundër gjyqtarit të çështjes për gabime gjyqësore, duke u fshehur vetë, por duke e nxitur të bashkakuzuarin tjetër për t'i ndërmarrë këto veprime. Ankuesi kërkoi të kishte akses të drejtpërdrejtë në dokument, duke argumentuar se nëse nuk e dinte kush ishte autori i letrës, ai nuk ishte në gjendje të gjykonte mbi motivimin e këtij të fundit dhe kredibilitetin e përmbajtjes së saj. Mbështetur në mbrojtjen e të dhënave personale të autorit, siç parashihet në Nenin 60 (1) të Kodit të Procedurës Penale, gjykata e hodhi poshtë kërkesën e ankuesit. Gjykata la në fuqi arrestin në shtëpi për ankuesin për shkak të rrezikut për përsëritje të veprës penale dhe fshehje nga drejtësia, siç parashikohet në Nenin 129 (2) (b) dhe (d) të Kodit të Procedurës Penale. Në vendimin e saj, gjykata u mbështet në ashpërsinë e krimeve dhe në shkallën e lartë të dënimit që pritej, duke u shprehur se kishte gjasa që ankuesi të largohej. Gjithashtu, ajo konstatoi se duke pasur parasysh faktin se ankuesi ishte përsëritës, ekziston rreziku i kryerjes së veprave të tjera prej tij. Në vendimin e marrë, gjykata e përmendi letrën si një ndër elementet faktikë që duhej marrë parasysh. Më 22 korrik 2013, Gjykata e Lartë e Budapestit e autorizoi ankuesit të largohej nga shtëpia për të kryer fizioterapi një herë në dy javë, në periudhën nga 22 korrik deri më 15 gusht 2013. Më 8 gusht 2013 kërkesa e ankuesit për leje për t'u punësuar dhe për t'u kujdesur për të ëmën e sëmurë çdo ditë u rrëzua nga Gjykata e Lartë e Budapestit, e cila u shpreh se një leje e tillë e përditshme binte ndesh me qëllimin e arrestit në shtëpi. Më 12 shtator 2013, ankuesi u caktua si kujdestar i nënës së tij. Ankuesi ka qëndruar në arrest në shtëpi deri më 8 nëntor 2013, kur u vendos në paraburgim në lidhje me proceset penale në lidhje me një vepër tjetër. Që nga 2 korriku i vitit 2015, ankuesi vazhdon ende të jetë në paraburgim pas vendimit të gjykatës së shkallës së dytë për ta shfuqizuar dënimin kundër tij dhe për ta kthyer çështjen për rishqyrtim në shkallën e parë.

Pyetje

1. *A ishte kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit në kundërshtim me kërkesën e "kohëzgjatjes së arsyeshme" të parashikuar në Nenin 5 § 3 të Konventës? Në veçanti, a bënë një vlerësim të individualizuar të situatës së tij autoritetet ndërsa e zgjasnin vazhdimisht masën?*
2. *A është kohëzgjatja e proceseve penale kundër aplikantit në përputhje me kërkesën për kohëzgjatje të arsyeshme të parashikuar nga Neni 6 § 1 i Konventës?*

Vlerësimi i Gjykatës. Faktet janë marrë nga çështja "*Süveges kundër Hungarisë*", nr. 50255/12, § 77, 5 janar 2016. Gjykata ka arritur në përfundimin e mëposhtëm.

88. Gjykata theksoi se çështja nëse periudha e kaluar në paraburgim është e arsyeshme, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Për të vlerësuar nëse është e arsyeshme që një i akuzuar të qëndrojë në paraburgim për një periudhë të caktuar kohe, duhet të vlerësohen faktet e çdo çështje në shqyrtim, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike. Ndalimi i vazhdueshëm në paraburgim mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm nëse ekzistojnë tregues reale për një nevojë të qenësishme për mbprjtjen e interesit publik, i cili, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, e tejkalon të drejtën e respektimit të lirive individuale të përcaktuar në Nenin 5 të Konventës (shih, ndër të tjera, Kudla, cituar më lart, §§ 110 et seq.).

*89. Prania e vazhdueshme e një dyshimi të arsyeshëm se personi i arrestuar ka kryer një vepër penale është kusht **sine qua non** për ligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit. Megjithatë, pas një periudhe të caktuar kohe, ku kusht nuk është i mjaftueshëm. Në raste të tilla, Gjykata duhet të përcaktojë nëse arsyet e tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë ende të justifikojnë heqjen e lirisë. Kur këto arsye janë "të përshtatshme" dhe "të mjaftueshme", Gjykata gjithashtu duhet të konstatojë nëse autoritetet kompetente vendase shfaqin "kujdes të veçantë" gjatë zhvillimit të procedurës (shih Labita kundër Italisë [GC], nr. 26772/95, §§ 152 dhe 153, KEDNJ 2000 IV). Arsyetimi për çdo periudhë paraburgimi, sado e shkurtër, duhet të justifikohet bindshëm nga autoritetet (shih Shishkov kundër Bullgarisë, nr 38822/97, § 66, KEDNJ 2003 I (ekstrakte)). Kur vendoset nëse një person duhet të lirohet ose të ndalohet, autoritetet janë të detyruara të marrin parasysh masat alternative për të siguruar paraqitjen e tij në gjykim (shih Jabłonski kundër Polonisë, nr.33492/96, § 83, 21 dhjetor 2000).*

90. Përgjegjësia bie, në radhë të parë, mbi autoritetet gjyqësore vendase që të sigurojnë se në një rast të caktuar, paraburgimi i një personi të akuzuar nuk e kalon pragun e një kohëzgjatjeje të arsyeshme. Për këtë qëllim, ato duhet të shqyrtojnë të gjitha argumentet pro dhe kundër pranisë së nevojës për mbrojten e një interesi publik që justifikon mospërmbushjen e rregullit në Nenit 5, duke i kushtuar vëmendje parimit të prezumimit të pafajësisë, dhe duhet t'i pasqyrojnë ato në vendimet për zgjidhjen e kërkesës për lirim. Kryesisht, në bazë të arsyeve të dhëna në këto vendime dhe fakteve të vërtetuara të paraqitura nga ankuesi në ankimin e tij, Gjykatës i kërkohet të vendosë nëse ka pasur shkelje të Nenit 5 § 3 (shih, për shembull, "McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar" [GC], nr.543/03, § 43, KEDNJ 2006 X).

(ii) Parimet e përgjithshme që gjejnë zbatim për çështjen nën shqyrtim

91. Gjykata vëren se gjatë periudhës nën shqyrtim, gjykatat vendase kanë shqyrtuar në disa raste arsyet për vazhdimin e paraburgimit të ankuesit (shih paragrafët 20-21, 25, 37-38, 43 dhe 46-47 më sipër). Sa herë që autoritetet e brendshme kanë vënë në dukje se paraburgimi i ankuesit është shtyrë në pajtim me rregullat e procedurës penale, ato i janë referuar nëse ka pasur një dyshim të arsyeshëm ndaj ankuesit dhe rreziqeve të fshehjes nga drejtësia apo përsëritjes së veprave. Përsa i përket shkakut të parë, ata i referoheshin peshës së akuzave, dhe në lidhje me shkakun e fundit, i referohen rrezikut për përsëritje të veprave penale për shkak të dënimeve të mëparshme.

92. Për sa i përket pranisë së rrezikut të fshehjes, Gjykata rikujton se një rrezik i tillë nuk mund të matet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit. Ky rrezik duhet të vlerësohet duke shqyrtuar edhe një sërë faktorësh të tjerë të rëndësishëm që mund të mbështesin ekzistencën e rrezikut të fshehjes, ose ta bëjnë atë të duket kaq i lehtë, saqë nuk mund ta justifikojë ndalimin në paraburgim në pritje të gjykimit (shih Panchenko kundër Rusisë, nr. 45100/98, § 106, 8 shkurt 2005). Rreziku i largimit duhet të vlerësohet në dritën e faktorëve që lidhen me karakterin e personit, moralin e tij, shtëpinë, profesionin, pasuritë, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet me vendin në të cilin ai ndiqet (shih Becciev kundër Moldavisë, numër 9190/03, § 58, 4 tetor 2005).

93. Në çështjen në fjalë Gjykata pranon se, për shkak të ashpërsisë të akuzave kundër ankuesit, autoritetet mund të kishin justifikuar praninë e rrezikut fillestar të ikjes (shih Ilijkov kundër Bullgarisë, nr. 33977/96, §§ 80-81, 26 korrik 2001). Megjithatë, gjatë periudhës në shqyrtim, ashpërsia e akuzave mbetej faktori i vetëm për vlerësimin e mundësisë së ankuesit për t'u arratisur. Në veçanti, në vendimin e apelit, datë 6 janar 2012, Kúria konstatoi se ashpërsia e akuzave ishte vendimtare në krahasim me rrethanat specifike që shoqëronin favorizimin e lirimit të ankuesit, siç ishte gjendja e tij shëndetësore (shih paragrafin 23 më sipër).

94. Në lidhje me këtë, Gjykata nuk mund ta anashkalojë faktin se ankuesit iu dha leje për të vizituar prindërit e tij në disa raste, edhe në një qytet tjetër, e, megjithatë ai nuk u arratis. Megjithatë, autoritetet e zgjatën paraburgimin dhe arrestin në shtëpi mbi arsyetimin se kjo ishte mënyra e vetme për ta penguar atë për të mos u fshehur. Për Gjykatën, mbetet e pazgjidhur kontradikta e dukshme midis faktit që ankuesi kishte respektuar rregullat e vendosura nga gjykatat nga njëra anë dhe nga ana tjetër autoritetet vazhdonin të kërkëngulnin për praninë e rrezikut të fshehjes, ose të largimit. Dhe, për më tepër arsyetimi i autoriteteve justifikohej vetëm në shakllën e ashpërsisë së dënimit,çfarë nuk mund të konsiderohej emjaftueshme, për justifikimin e paraburgimit pasikishin kaluar afatetkohore.

95. Sa i përket rrezikut të përsëritjes së veprave penale, Gjykata thekson se dënimet e mëparshme mund të shërbenin si shkak për të pasur një arsye të bazuar se i akuzuari mund të kryente një vepër të re penale (shih Selçuk kundër Turqisë, nr. 21768/02, § 64, 10 Janar 2006).

96. Gjykata vëren se vendimet marrin parasysh natyrën e shkeljeve të mëparshme dhe numrin e dënimeve të dhëna për to, megjithëse ato ndryshonin deri në një farë mase nga njëri-tjetri në lidhje me pikën e fundit të periudhës së kohëzgjatjes (shih paragrafët 25, 38 dhe 47 më sipër). Vërehet se vepra e fundit që përbënte pjesë të akuzave ishte kryer nga ankuesi gjatë lirimit me kusht nga periudha e burgimit prej nëntë vjetësh (shih paragrafin 23 më sipër).

97. Gjykata është e mendimit se autoritetet vendase kanë pasur një arsye të bazuar frikë në rrethanat e çështjes dhe në veçanti për shkak të rekordit kriminal të ankuesit dhe personalitetit të tij (shih "Clooth kundër Belgjikës", 12 dhjetor 1991, § 40, seria A jo 225, dhe "A.J.P kundër Francës", nr. 17020/05, § 71, datë 29 tetor 2009) se ankuesi mund të kryejë vepra të reja dhe kjo arsye, të paktën fillimisht, ishte "e rëndësishme" dhe "e mjaftueshme".

98. Megjithatë, Gjykata shprehet se këto lloj faktorësh nuk u japin autoriteteve fuqi të pakufizuara për ta zgjatur masës parandaluese. Me kalimin e kohës, shkaqet fillestare të paraburgimit bëhen gjithnjë e më pak të rëndësishme, kështu që gjykatat vendase duhet të mbështeten në shkaqe të tjera "të përshtatshme" dhe "të mjaftueshme" për të justifikuar heqjen e lirisë (shih, "Labita kundër Italisë" [GC] , nr. 26772/95, § 153, KEDNJ 2000 IV). Për më tepër, Gjykata nuk mund të harrojë faktin se ankuesi ishte i privuar nga liria në pritje të gjyqit për dy vjet e nëntë muaj, dhe më parë kishte vuajtur një periudhë tjetër paraburgimi trevjeçar. Për Gjykatën, kur paraburgimi në pritje të gjykimit shtrihet përtej periudhës përgjithësisht të pranuar sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, madje edhe në rrethanat specifike të çështjes, nevojiten arsye veçanërisht të forta për të justifikuar shtyrjen e paraburgimit.

99. Sidoqoftë, në çështjen në fjalë, vendimet për zgjatjen e heqjes së lirisë së ankuesit janë formuluar në një formë tepër stereotipike dhe përmbledhëse, duke mos u përshtatur në ecurinë e tyre për të reflektuar situatën në zhvillim. Ndërkohë që është e vërtetë se as rreziku i fshehjes, as ai i përsëritjes së veprës penale nuk mund të mohohen krejtësisht pavarësisht kalimit të kohës, autoritetet vendase nuk arritën të vlerësojnë nëse pas kalimit të kësaj kohe tejet të gjatë në paraburgim dhe në arrest shtëpie, arsyet e paraburgimit ishin ende të mjaftueshme dhe e tejkalonin të drejtën e ankuesit për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, ose për t'u liruar në pritje të gjykimit.

100. Sa i përket kujdesit të treguar nga autoritetet, Gjykata vëren se padia kundër ankuesit është paraqitur në gjykatë më 11 maj 2007, ndërsa seanca e parë u zhvillua më 17 dhjetor 2007 (shih paragrafët 7-8 më sipër). Paraburgimi i ankuesit vazhdoi në këtë periudhë e në periudhën pasuese dhe vendimi i shkallës së parë u mor vetëm pas më shumë se gjashtë vjetësh, më 28 shkurt 2014 (shih paragrafin 14 më sipër).

101. Gjatë ecurisë së proceseve në periudhën ndërmjet korrikut të vitit 2011 dhe majit 2012,nuk kishin avancuar procedurat pasi gjykata nuk kishtezhvilluar asnjë seancë gjatë kësaj periudhe. Deri në atë kohë, ankuesi ishte mbajtur në paraburgim për një periudhë të gjatë kohe dhe për Gjykatën kjo periudhë pasiviteti krijon shqetësime të mëtejshme lidhur me arsyeshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të ankuesit (shih "Dragin kundër Kroacisë", nr. 75068/12/12, § 118, 24 korrik 2014). Gjykatat e brendshme duhet të kishin shqyrtuar nëse ai mund të lirohej përkohësisht në pritje të gjykimit, siç kërkohet sipas Nenit 5 § 3 të Konventës (shih "Vlasov kundër Rusisë", nr. 78146/01, § 104, 12 qershor 2008).

102. Duke pasur parasysh këto vonesa në proceset gjyqësore dhe faktin që ankuesi është mbajtur në paraburgim për një periudhë të gjatë, Gjykata arrin në përfundimin që gjykata e juridiksionit nuk i ka kushtuar kujdes të posaçëm çështjes së ankuesit gjatë zhvillimit të gjykimit.

103. Për pasojë, Gjykata arrin në përfundimin se kohëzgjatja e ndalimit të ankuesit nuk mund të konsiderohet e arsyeshme. Për pasojë, ka pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës.

B. Fusha Civile

1. Fusha e veprimit të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme lidhur me "të drejtat dhe detyrimet civile"

Koncepti i një rasti civil interpretohet shumë gjerë. Ai mbulon "të gjitha proceset, rezultati i të cilave është vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private" dhe përfshin të gjithë atë çfarë e drejta kontinentale e përcakton si e drejtë private, pavarësisht nga ligji që rregullon një çështje të caktuar, qofshin civile, tregtare, administrative etj., apo nga autoriteti me juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si për shembull gjykatat civile apo gjykatat penale, gjykatat administrative, gjykatat kushtetuese, gjykatat profesionale apo edhe organet administrative. Pra, çështjet civile përfshijnë mosmarrëveshjet në lidhje me statusin e individëve, të drejtën familjare, pronën private etj.

Në përgjithësi, faktori përcaktues për kufizimin e qëllimit që ndjek Nenit 6 është vlerësimi nëse veprimi i ankuesit ka implikime pasurore apo jo. Nëse po, procesi konsiderohet si çështje civile. Pra, sfera e proceseve që kanë të bëjnë me "të drejtat dhe detyrimet civile" është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, duke mbuluar një gamë të larmishme mosmarrëveshjesh. Natyra pasurore e një mosmarrëveshjeje, për shembull, e ka bërë të mundur futjen në kategorinë e procesit civil, çfarë sipas legjislacionin të brendshëm do ti përkiste kategorisë tësë drejtës publike. Në këtë mënyrë, Neni 6 zbatohet për mosmarrëveshjet ndërmjet individëve privatë dhe autoritetit publik, pavarësisht nëse ky i fundit vepron si individ privat, ose është depozituesi i autoritetit publik.[231]

Megjithatë, ka disa çështje që bien jashtë fushës së veprimit të Nenit 6, të tilla si mosmarrëveshjet që përfshijnë taksapaguesit, mosmarrëveshjet lidhur me masat e kontrollit të migracionit, mosmarrëveshjet rreth përfaqësimit politik dhe mosmarrëveshjet në lidhje me kategori të caktuara të nëpunësve publikë.

2 . Përcaktimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve civile sipas qëllimit që ndjek Nenit 6 § 1 vlerësohet nga Gjykata sipas rrethanave të çështjes,[232]kritereve të përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore, siç janë: periudha e saktë që duhet marrë parasysh, shkalla e kompleksitetit të çështjes, sjellja e palëve, etj. Megjithatë, është e mundur që disa çështje të kërkojnë një vlerësim global, për shembull në çështjen *Obermaier kundër Austrisë*, lidhur me një punonjës të pezulluar nga punëdhënësi i tij, Gjykata vlerësoi se një punonjës i cili konsideron se është pezulluar gabimisht nga punëdhënësi, ka interes të rëndësishëm personal për pasur një gjykim të menjëhershëm për daljen me një vendim gjyqësor për ligjshmërinë e masës dhe Gjykata, pa analizuar në detaje kritere të ndryshme, arriti në përfundimin se periudha prej nëntë vjetësh e gjykimit duke mos

[231] Shih kreun përkatës në seksionin II.

232 Frydlender kundër Francës [GC], § 43

arritur të dilej me një vendim përfundimtar, e tejkalon kërkesën për një kohë të arsyeshme[233].

Për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve[234] gjyqësore meret në vlerësim i gjithë procesi në tërësinë e tij. . Ndërkohë që disa lloje vonesash mund të mos çojnë në krijimin e ndonjë problemi të caktuar, në rast se vlerësohen në mënyrë kumulative, ato mund të rezultojnë në një tejzgjtaje [235] të kohës së arsyeshme. Një vonesë gjatë një faze të caktuar të proceseve gjyqësore mund të lejohet me kusht që të mos teprohet[236] me kohëzgjatjen e përgjithshme të proceseve penale, megjithatë, në çështjen"*Beaumartin kundër Francës"*[237], Gjykata theksoi se "periudhat e gjata gjatë të cilave procedurat [...]qëndrojnë pezull] [...]", pa ndonjë shpjegim, nuk janë të pranueshme.

Sa i përket akumulimit të një numri të konsiderueshëm çështjesh të prapambetura, Gjykata shprehet si në vijim: "Përderisa i takon shteteve anëtare që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që të garantojnë të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, mbingarkesa punës për shkak të numrit të çështjeve nuk mund të justifikojë tejzgjatjen e procedurave (*Vocaturo kundër Italisë*, § 17, *Cappello kundër Italisë*, § 17). Megjithatë, çështjet e prapambeturapërkohësisht nuk e ngarkojnë shtetin me përgjegjësinëse nga ana e tij janë ndrërmarë masa të menjëhershme , dhe të arsyeshme për zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji (*Buchholz kundër Gjermanisë*, § 51). Metodat që mund të nxisin përshpejtimin përkohësisht janë atë kur për gjykimin e çështjeve nuk ndiqet radha e përcaktuar sipas datës së depozitimit të tyre, por edhe nisur nga nivelii urgjencës dhe rëndësisë së tyre dhe, në veçanti, sipas vlerësimit të asaj që riskohet për personat në fjalë. Megjithatë, nëse një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje, dhe situata kthehet në një çështje të organizimit strukturor, atëherë këto metoda nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efektive (*Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, § 29, *Guincho kundër Portugalisë*, § 40). Fakti që numri i lartë i çështjeve të tilla të prapambetura është bërë i zakonshëm, nuk e justifikon tejzagjatjen e proceseve gjyqësore (*Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, § 40)[238].

Do të merren parasysh për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së proceseve civile edhe procedurat paraprake, vetëm nëse ato, përmbushin disa kushte. Në çështjen "*Micallef kundër Maltës"*[239], Gjykata rikujtoi se "aspekti" civil i Nenit 6 zbatohet vetëm për procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile, pasi jo të gjitha masat e ndërmjetme çojnë në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tilla, dhe se zbatueshmëria e Nenit 6 do të varet nga fakti nëse janë përmbushur fillimisht disa kushte. Së pari, ajo cfarë e riskon pozitën e palës si në procesin kryesor, ashtu edhe në procesin e ndërmjetëm, duhet të jetë "civile" brenda kuptimit autonom të këtij nocioni

233 Obermeier kundër Austrisë, 11761/85, 28 qershor 1990, § 72; Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GCç, § 234 König kundër Gjermanisë, § 98
235 Deumeland kundër Gjermanisë, § 90
236 Pretto dhe të tjerët kundër Italisë, § 37
237 Beaumartin kundër Francës, § 33.
238 Par. 295
239 Micallef kunër Maltës [GC], 17056/06, 15 tetor 2009, §§ 83-86,

sipas Nenit 6 të Konventës[240]. Së dyti, duhet të shqyrtohet natyra e masës së ndërmjetme, objekti dhe qëllimi i saj, si dhe efektet që ajo ka mbi të drejtën në fjalë. Gjithashtu, Neni 6 gjen zbatim sa herë që për të përcaktuar në mënyrë efektive një të drejtë ose detyrim civil kërkohet marja e një masë të ndërmjetme pavarësisht kohës gjatë së cilës ajo është në fuqi..

Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme Gjykata pranon se, mund të mos jetë e mundur që të përmbushen menjëherë të gjitha kërkesat e Nenit 6, kur, për shembull, efektiviteti i masës së kërkuar varet nga një proces i shpejtë vendimmarrës.. Pra, në çështje të tilla të veçanta, disa garanci procedurale mund të zbatohen vetëm në masën që përputhet me natyrën dhe qëllimin e masës së përkohshme në fjalë, krahasuar me garanci të tjera më të domosdoshme dhe më urgjente siç është pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës ose gjyqtarit. . Në çdo proces të mëvonshëm në Gjykatë, i takon qeverisë që të përcaktojë se një ose më shumë masa mbrojtëse procedurale të veçanta nuk mund të zbatohen, gjithmonë pa cenuar padrejtësisht arritjen e objektivave të kërkuara nga masa e ndërmjetme në fjalë.

Proceset para Gjykatës Kushtetuese merren parasysh në përllogaritjen e përgjithshme të periudhës së kohëzgjatjes së arsyeshme, kur, edhe pse gjykata nuk ka juridiksion për të vendosur mbi themelin e çështjes, vendimi i saj është i aftë të ndryshojë rezultatin e vendimit të marë nga në gjykatat e zakonshme[241]. Megjithatë, në çështjen "*Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*", Gjykata theksoi se detyrimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm nuk mund të interpretohet në të njëjtën mënyrë si për një gjykatë të zakonshme, për shkak të rolit të Gjykatës Kushtetuese si gardian i Kushtetutës, i cili ndonjëherë e bën veçanërisht të domosdoshme që ajo të marrë parasysh aspekte të tjera, të ndryshme nga rendi kronologjik sipas të cilit futen çështjet në listë, të tilla si natyra e një çështjeje dhe rëndësia e saj në aspektin politik dhe social, si edhe roli i saj si gardian i Kushtetutës.[242]

Sa i përket ndërhyrjes së palëve të treta në procesin civil, në çështjen *Scordino kundër Italisë*, Gjykata vëren se në praktikën gjyqësore lidhur me ndërhyrjen e palëve të treta në proceset civile, ajo bën dallimin në vijim: kur ankuesi ka ndërhyrë në proceset e brendshme vetëm në çështjen vetëm në mbojtje të interesave të veta personale, periudha që do të merret parasysh fillon të llogaritet që nga ajo datë, ndërsa nëse ankuesi ka deklaruar qëllimin e tij për të vazhduar proceset si trashëgimtar, atëherë ai mund të ankohet për kohëzgjatjen e proceseve në tërësinë e tyre. Prandaj, në rast të ndërhyrjes së palëve të tretë, periudha që duhet marrë parasysh mund të ndryshojë[243].

Sa i takon procedurës në lidhje me referimin e një çështjeje në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJEDNJ), në çështjen "*Pafitis dhe të tjerët kundër Greqisë*"[244], Gjykata vlerësoi se sa i përket procesit gjyqësor para Gjykatës së Drejtësisë, edhe pse ai

240 Shih, ndër të tjera, Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, 9 dhjetor 1994, § 39, seritë A nr. 301-B; König kundër Gjermanisë, 28 qershor 1978, §§ 89-90, seritë A nr. 27; Ferrazzini kundër Italisë[GC], nr. 44759/98, §§ 24-31, GJEDNJ 2001-VII; dhe Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 32555/96, § 119, GJEDNJ 2005-X.

241 Deumeland kundër Gjermanisë, § 77; Pammel kundër Gjermanisë, §§ 51-57; Süßmann kundër Gjermanisë [GC], § 39.

242 Oršuš dhe të tjerë kundër Kroacisë [GC], 15766/03, 16 mars 2010, § 109.

243 Scordino kundër Italisë (nr. 1) [GC], 36813/97, 29 mars 2006, § 220.

244 Pafitis dhe të tjerët kundër Greqisë, 20323/92, 26 shkurt 1998, par. 95.

zgjati dy vjet, shtatë muaj dhe nëntë ditë, kjo kohëzgjatje nuk mund të merret parasysh në vlerësimin për kohëzgjatjen e çdo seti të caktuar procesesh. Gjykata theksoi se megjithëse në vështrim të parë kohëzgjatja duket relativisht e gjatë, marrja parasysh e saj do të ndikonte negativisht në sistemin e krijuar nga e drejta e BE-së. Prandaj, proceset për vendime paraprake në GJEDNJ nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së proceseve.

a) Pika e fillimit e periudhës që duhet të merret parasysh

Sa i përket pikës së fillimit të periudhës përkatëse, koha normalisht fillon të llogaritet që nga momenti i fillimit të veprimit para gjykatës së juridiksionit,[245]përveç rastit kur kërkesa para një autoriteti administrativ është parakusht për çeljen e proceseve gjyqësore, rast në të cilin periudha mund të përfshijë procedurën administrative.[246] Në disa rrethana të caktuara, koha e arsyeshme mund të fillojë të llogaritet edhe para lëshimit të urdhrit gjyqësor që autorizon nisjen e procesit para gjykatës ku ankuesi e ka paraqitur kërkesën.[247]Megjithatë, kjo ndodh në raste përjashtimore dhe është pranuar vetëm kur, për shembull, inicimi i hapaveparaprakë përbën një fazë hyrëse të domosdoshme për proceset[248].

Neni 6 § 1 mund të zbatohet po ashtu edhe në procese të caktuara, të cilat, megjithëse jo tërësisht juridike në natyrë, lidhen ngushtë me mbikëqyrjen që kryehet nga një organ gjyqësor. Në çështjen "*Siegel kundër Francës*",[249]për shembull, që ka të bëjë me një procedurë për ndarjen e një pasurie, të zhvilluar pa kontestime përpara dy noterëve, por që ishte urdhëruar dhe miratuar nga gjykata, Gjykata mori parasysh kohëzgjatjen e procedurës përpara noterëve për llogaritjen e kohës së arsyeshme.

Megjithatë, kur paarsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve ka të bëjë me procesin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, periudha e fillimit të kohëzgjatjes nis që nga datakur vendimi që nuk është ekzekutuar ka marrë formë të prerë.

Shembull. Në çështjen "***Shehu kundër Shqipërisë"***[250] "Gjykata vëren se periudha që duhet marrë parasysh ka filluar në një datë të paspecifikuar në vitin 1996, kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Tepelenë, datë 21 qershor 1996, mori formë të prerë [...] dhe ka përfunduar më 8 dhjetor 2009, kur vendimi u zbatua plotësisht. Pra, procedurat e përmbarimit kanë zgjatur trembëdhjetë vjet dhe thuajse gjashtë muaj. Vendimipërfundimtar i datës 25 prill 2008, ka akumuluar në përllogaritjen e dëmit edhe interesin e munguar si rezultat i moszbatimit të vendimit, datë 21 qershor 1996, dhe

245 Poiss kundër Austrisë, § 50; Bock kundër Gjermanisë, § 35.

246 Königk k. Gjermanisë, § 98; X kundër Francës, § 31; Kress kundër Francës [GC], § 90.

247 Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 32; Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë, § 64; Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës [GC], § 65.

248 Blake kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 40.

249Siegel kundër Francës, §§ 33-38.

250 Çështja, nr. 33704/09, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 06 tetor 2016, paragrafi 18,19,21; Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në çështjet civile që ngrenë çështje të ngjashme me çështjet e ngritura në çështjen në fjalë (shih Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, datë 1 prill 2014; dhe Gjyli, të cituara më sipër, §§ 43-47).

me tej u zbatua pas një viti e gjashtë muajsh. Gjykata vijon më tej duke thënë se Qeveria nuk dha ndonjë shpjegim bindës për këtë periudhë të tejzgjatur pasiviteti dhe vonese në zbatimin e vendimit përfundimtar, datë 21 qershor 1996. Në të vërtetë, bazuar në parashtresat e tyre (shih paragrafin 16 më sipër), vonesat në proceset e ekzekutimit duket se janë shkaktuar nga sjellja e autoriteteve, jo nga fakti se ankuesi nuk kishte paguar taksën përmbarimore në kohën e duhur. Nuk ka asnjë indicie se pasiviteti dhe vonesa janë shkaktuar nga kompleksiteti i çështjes ose sjellja e ankuesit. Përkundrazi, në shumë raste, ankuesja kërkoi ekzekutimin e vendimit përfundimtar në favor të saj. [...]. Në vëmëndje të gjithë sa është paraqitur, Gjykata shprehet se Qeveria nuk ka paraqitur asnjë fakt, apo argument bindës, për të arritur në një përfundim të ndryshëm në çështjen në fjalë. Duke pasur parasysh praktikën gjyqësore mbi këtë temë, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e proceseve të përmbarimit në lidhje me vendimin përfundimtar, datë 21 qershor 1996, ishte e tejzgjatur dhe, për rrjedhojë, qeveria nuk kishte arritur të përmbushte kërkesat për një "kohë të arsyeshme". Rrjedhimisht ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës."

Gjykata mund të vendosë që periudha që duhet të merret parasysh lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore nis nga data e hyrjes në fuqi të së drejtës për ankim individual, në rastet kur ankesa për tejzgjatje të disa proceseve gjyqësore është paraqitur në një datë të paspecifikuar dhe përpara njohjes të së drejtës së kërkesës individuale nga shteti..

Shembull. Në çështjen "***Marini kundër Shqipërisë"*** Gjykata vëren se ankuesi u ankua për tejzgjatjen të pesë seteve paralele të proceseve gjyqësore. Grupi i parë filloi në një datë të paspecifikuar në vitin 1993, kur ankuesi depozitoi një ankim para Komisionit Shtetëror të Arbitrazhit. Ai vijoi me proceset gjyqësore për zbatimin e vendimit në favor të ankuesit dhe përfundoi më 20 nëntor 2003, kur kompania "Marini-Albplastik" u mbyll, duke i bërë proceset e tjera të diskutueshme. Grupi i dytë filloi në një datë të paspecifikuar në janar të vitit 1997, kur ankuesi kundërshtoi në gjykatë vlefshmërinë e vendimit me objekt privatizimin e fabrikës. Ai vijoi me proceset gjyqësore për zbatimin e vendimit përfundimtar në favor të ankuesit dhe përfundoi më 13 prill 2006. Grupi i tretë i proceseve (në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes së parë të qirasë) filloi në vitin 2000 dhe përfundoi me vendimin përfundimtar, datë 23 dhjetor 2002. Grupi i katërt i proceseve filloi në vitin 2001, kur ankuesi kundërshtoi para gjykatave vlefshmërinë e marrëveshjes së dytë së qirasë, dhe përfundoi në 27 janar 2006. Grupi i pestë i proceseve filloi në vitin 2003 dhe përfundoi më 27 prill 2005, kur kërkesa e ankuesit u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese.

Pavarësisht sa më sipër, në vështrim të rrethanave specifike në këtë rast, periudha që duhet të merret parasysh për llogaritjen e kohëzgjatjes tërësore të 5 proceseve në lidhje me tërësinë e ankesave fillon më 2 tetor të vitit 1996, kur ka hyrë në fuqi njohja nga Shqipëria e së drejtës për ankim individual.[251]

251Çështja nr. 3738/02, vendim (themeli dhe dëmshpërblimi i drejtë), 18 dhjetor 2007 Marini kundër Shqipërisë, paragrafi 138-140.

b) Përfundimi i periudhës që duhet të merret parasysh

Sa i takon përfundimit të periudhës, në çështjen "*Estima Jorge kundër Portugalisë*", Gjykata ka vendosur që kohëzgjatja nuk përfundon derisa e drejta e deklaruar në proces të jetë bërë efektive.[252]Periudha që duhet të merret parasysh zakonisht mbulon të tërë proceset në fjalë, duke përfshirë edhe proceset në apel,[253]dhe shtrihet deri në zbatimin e vendimit që e zgjidh mosmarrëveshjen tërësisht.[254]Prandaj, kërkesa për kohëzgjatje të arsyeshme zbatohet në të gjitha fazat e proceseve ligjore që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke mos përjashtuar fazat pas gjykimit mbi themelin.[255]Pra, ekzekutimi i një vendimi konsiderohet si pjesë përbërëse e procesit për qëllimin e llogaritjes së periudhës përkatëse.[256]

Për shembull, në çështjen "*Shehu kundër Shqipërisë*",[257]përmendur më sipër, Gjykata vëren se periudha që duhej marrë parasysh përfundoi më 8 dhjetor 2009, atëherë kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Tepelenë, datë 21 qershor 1996, u zbatua plotësisht.

- **Rast studimor 1**

Faktet. Ankuesit kishin në pronësi një ngastër toke që u bë objekt i kërkesës për shpronësim nga Fondi i Ndërtimit Publik në Podgoricë për ndërtimin e një rruge. Më 14 shtator 1995, ankuesit kërkuan që të shpronësohej edhe shtëpia, edhe pjesa tjetër e mbetur tokës që kishin në pronësi. Më 11 tetor 1996, Zyra e Pasurive të Patundshme në Podgoricë (REOP) shpronësoi vetëm ngastrën e përcaktuar fillimisht, pa marrë parasysh kërkesën e ankuesve në lidhje me pjesën e mbetur të tokës. Më 29 tetor 1996 ankuesit e apeluan vendimin, por ankesa u rrëzua. Më 5 shkurt 1998 Gjykata e Lartë i pushoi vendimet e mësipërme. Më 18 shkurt 2005, ankuesit kërkuan inspektimin (*supervekcijski nadzor*) e proceseve në fjalë. Më 16 mars 2005 Ministria e Drejtësisë konstatoi "parregullsi" në procedurë dhe urdhëroi ndreqjen e këtyre parregullsive (*otklanjanje utvrđenih nepravilnosti*). Më 28 mars 2005, REOP-i i pranoi të dyja kërkesat për shpronësim të ankuesve dhe vendimi u konfirmua më 1 shtator 2005. Në periudhën nga 6 qershori 2006 deri më 16 dhjetor 2008 vendimet e REOP-it u bënë objekt procesesh para Gjykatës Administrative dhe Ministrisë së Financave. Që nga maji i vitit 2010, proceset ishin ende pezull para Gjykatës Administrative.

Pyetje

1. *A mund të identifikoni kohën e nisjes dhe të përfundimit të periudhës që duhet të merret parasysh për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në vështrim të fakteve dhe rrethanave sa më sipër?*
2. *A mendoni se procedura ishte e shpejtë në këtë çështje?*
3. *Çfarë kriteresh mund të gjejnë zbatim në vlerësimin tuaj mbigarantimin e të drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme?*

252Estima Jorge kundër Portugalisë, §§ 36-38

253 König kundër Gjermanisë, § 98.

254 Poiss kundër Austrisë, § 50

255 Robins kundër Mbretërisë së Madhe, §§ 28-29

256 Martins Moreira kundër Portugalisë, § 44; Silva Pontes kundër Portugalisë, § 33; Di Pede kundër Italisë, § 24.

257 Çështja, nr. 33704/09, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 06 tetor 2016, paragrafi 18.

Vlerësimi i Gjykatës. Faktet janë marrë nga çështja "*Živalevic kundër Malit të Zi*" (çështja nr. 17229/04), vendim i datës 8 mars 2011, (§§5-25). Në vendimin e saj, Gjykata u shpreh si më poshtë.

"Gjykata rithekson se arsyeshmëria i kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së ankuesve dhe autoriteteve përkatëse dhe asaj që është në risk për ankuesin (shih, ndër të tjera, "Frydlender kundër Francës" [GC], nr. 30979/96, § 43, KEDNJ 2000-VII).

73. Gjykata theksoi gjithashtu se, për të përcaktuar arsyetimin e vonesës në fjalë, duhet të merret parasysh se në çfarë faze të gjykimit ka qenë çështja në datën e ratifikimit (shih, mutatis mutandis, "Styranowski kundër Polonisë", vendim i datës 30 tetor 1998, raportet e aktgjykimeve dhe aktvendimeve 1998-VIII).

74. Duhet të theksohet më tej se rishqyrtimi i përsëritur i një çështjeje të vetme pas kthimit për rigjykim, në vetvete, mund të zbulojë një mangësi serioze në sistemin gjyqësor të një shteti të caktuar (shih "Pavlyulynets kundër Ukrainës", nr. 70767/01, § 51, 6 shtator 2005).

75. Vërehet se periudha që duhet marrë parasysh filloi më 29 tetor 1996, datë kur ankuesit parashtruan ankimin e tyre kundër vendimit të marrë në shkallë të parë (shih, mutatis mutandis, "Počuča kundër Kroacisë", nr. 38550/02, § 30, 29 qershor 2006). Gjykata vëren se proceset vazhdojnë të mbetenende pezull para Gjykatës Administrative (shih paragrafin 25 më sipër). Meqenëse Konventa në lidhje me Malin e Zi ka hyrë në fuqi më 3 mars 2004 (shih Bijelić kundër Malit të Zi dhe Serbisë, 11890/05, § 69, datë 28 prill 2009), proceset në fjalë kanë qenë ratione temporis në kompetencë të Gjykatës për një periudhë prej më shumë se gjashtë vjetësh dhe njëmbëdhjetë muajsh. Përveç kësaj, ato kishin qënë pezull më parë për më shumë se shtatë vjet dhe katër muaj para kësaj date.

76. Gjykata vëren se çështja në fjalë ka të bëjë me shpronësimin e shtëpisë dhe të tokës së ankuesve. Ndërsa mund të pranohet se disa çështje shpronësimi mund të jenë më komplekse se të tjerat, Gjykata nuk është e mendimit se çështja në fjalë ka një kompleksitet të tillë, që mund të justifikojë një tejzgjatje të kësaj natyre.

77. Më tej, legjislacioni i brendshëm përcakton periudhat brenda të cilave organet administrative duhet të japin vendimet përkatëse. Këto periudha janë një muaj ose dy muaj në një nivel juridiksioni (shih paragrafët 33-36 më sipër). Gjykata vëren se kërkesa për kujdes të posaçëm ka rëndësi të veçantë në lidhje me shtetet ku ligji i brendshëm parashikon se çështjet duhet të përfundohen me urgjencë të veçantë (shih, mutatis mutandis, "Stevanović kundër Serbisë", nr. 26642/05, §§ 53 dhe 55, 9 tetor 2007). Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se, pas ratifikimit më 3 mars 2004 të Konventës nga shteti i paditur, vendimi i parë ishte dhënë më 28 mars 2005, pra diçka më tepër nga kalimi i 1 viti pas ratifikimit. Pas rrëzimit të këtij vendimi më 3 tetor 2006, më pas u desh më shumë se një vit për marrjen e një vendimi nga shkalla e parë, më 3 nëntor 2007. Së fundmi, çështja ka qëndruar pezull në pritje në vendimit përpara Gjykatës Administrative që nga data 16 dhjetor 2008, pra për më shumë se dy vjet dhe një muaj. Nuk ka asnjë të dhënë në dosjen e çështjes që të sugjerojë se kjo situatë është shkaktuar nga sjellja e ankuesve, por është e qartë që ajo është shkaktuar nga dështimi i autoriteteve për të vepruar në përputhje me

ligjin dhe afatet kohore të parashikuara aty (shih paragrafët 33-36 më sipër) .

78. Duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore dhe faktet e çështjes në fjalë, Gjykata është e mendimit se kohëzgjatja e procedurës së ankimuar nuk ka arritur të përmbushë kërkesën e standartit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.'

Për diskutim, mund të jetë mirë që t'i drejtoheni *mutatis mutandis* edhe çështjes Počuča kundër Kroacisë, Nr. 38550/02, §, datë 30, 29 qershor 2006), si edhe çështjes Stanka Mirković dhe të tjerët kundër Malit të Zi (Nr. 33781/15, 33785/15,34369/15 dhe 34371/15) lidhur me kohëzgjatjen e proceseve administrative.

3. Kriteret që përcaktojnë arsyetimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore

Si në proceset penale, arsyetimi i kohëzgjatjes së proceseve civile duhet të vlerësohet në dritën e kritereve të mëposhtme të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës: kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve përkatëse dhe ajo çfarë riskon pozitën e ankuesin në mosmarrëveshje.[258]

Për shembull, në çështjen "*Mishgjoni kundër Shqipërisë*" Gjykata përsërit se arsyetimi i kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kompleksitetit të çështjes, sjelljes së ankuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe se çfarë është në rrezik për ankuesin në mosmarrëveshje.[259]

a) Kompleksiteti i çështjes

Gjykata ka theksuar se, në kërkesën për gjykimin e çështjeve brenda një "afati të arsyeshëm", Konventa nënvizon rëndësinë e administrimit të drejtësisë pa vonesa, i cili, nëse nuk menaxhohet siç duhet, mund të vërë në rrezik efektivitetin dhe besueshmërinë e saj. Megjithatë, në rrethana të caktuara, kompleksiteti i proceseve të brendshme mund të justifikojë tejzhatjenjashtë normave të proceseve gjyqësore.[260]

Kompleksiteti i një çështjeje mund të lidhet si me faktet, ashtu edhe me ligjin. Për shembull, në çështjen "*Papachelas kundër Greqisë*",[261] [GC]që ka të bëjë me shpronësimin e më shumë se 150 pronave, disa prej të cilave i përkisninankuesit dhe përfshinin një sipërfaqe prej 8,402 metrash katrorë, pjesë e një parcele më të madhe toke, Gjykata konstatoi se çështja ishte relativisht komplekse, veçanërisht për shkak të numrit të pronave të shpronësuara me anë të të njëjtit vendimi ministror, dhe arriti në përfundimin se, në dritën e fakteve të çështjes, kohëzgjatja e proceseve nuk ishte e paarsyeshme. Në çështjen "*Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*"[262], në lidhje me

258 Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GC]; Frydlender kundër Francës [GC], § 43; Sürmeli kundër Germanisë [GC], § 128.

259 Çështja nr. 18381/05 Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 07 dhjetor 2010, paragrafi 44; shih po ashtu Gjonbocari dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr. 10508/02, § 61, 23 tetor 2007.

260 Tierce kundër San Marino, çështja nr. 69700/01, 17 qershor 2003, § 31.

261 Papachelas kundër Greqisë[GC], çështja nr. 31423/96, 25 mars 1999, § 39.

262 Katte Klitsche de la Grange, çështja nr. 12539/86, 27 tetor 1994.

proceset e brendshme që kishin të bënin me planifikimin e qytetit dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat kanë pasur impakt të madh nëpraktikën gjyqësore italiane, lidhur me dallimin midis një të drejte dhe një interesi legjitim, Gjykata u shpreh se të paktën tri periudha të proceseve ishin të parregullta, megjithatë, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, kompleksitetin e fakteve dhe çështjeve ligjore të përfshira, nuk mund të arrihej në përfundimin se ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të procedurave.

Kompleksiteti i çështjes mund të lidhet po ashtu edhe me **përfshirjen e disa palëve në të njëjtën çështje, apo në të njëjtët artikuj të provave që duhet të merren**. Për shembull, në çështjen "*H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*"[263], Gjykata u shpreh se proceset ishin komplekse, për shkak se në to kishte shumë palë, përkatësisht ankuesja, burri i saj, të birësuarit e mundshëm, avokati zyrtar në kapacitetin e tij si rojtar *ad litem* dhe Këshilli, dhe se duhej të mblidheshin shumë prova, vlerësimi i të cilave ishte detyrë tepër e vështirë.

b) Sjellja e ankuesit

Sjellja e ankuesve përbën një faktor objektiv, që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është kaluar[264] apo jo koha e arsyeshme sipas kërkesave tëNenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 1 nuk u kërkon ankuesve të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore. Po ashtu, ankuesit as nuk mund të fajësohen për përdorimin e plotë të mjeteve efektive të disponueshme për ta në bazë të legjislacionit të brendshëm.[265]Personit në fjalë i kërkohet vetëm t'i kushtojë rëndësinë e duhur realizimit të hapave proceduralë lidhur me çështjen, si dhe të përmbahet nga përdorimi i taktikave të vonesave dhe të vetëofrohet për përshpejtimin e procedurave[266] sipas parashikimeve përkatëse të legjislacionit të brendshëm.

Megjithëse autoritetet e brendshme nuk mund të mbajnë përgjegjësi për sjelljen e ankuesve, sjellja e tyre nuk mund të shërbejë si justifikim për periudhat e pasivitetit të autoriteteve. Në çështjen *Mincheva kundër Bullgarisë,*[267] Gjykata ka nënvizuar se taktikat e bëra nga njëra nga palët për shtyrjen e procedurave, nuk i zhveshin autoritetet nga detyrimi i tyre për të siguruar që proceset të kryhen brenda një kohe të arsyeshme.

c) Sjellja e autoriteteve kompetente

Shteti është përgjegjës për vonesat në procedura, kur ato shkaktohen nga sjellja[268] e tij, megjithatë përpjekjet e bëra nga shteti për të reduktuar çdo vonesë në procedura merret parasysh për të vlerësuar nëse është përmbushur kërkesa sipasNenit 6 të Konventës.[269]U takon shteteve kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore

263 H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 9580/81, 08 korrik 1987, § 72.
264Poiss kundër Austria, § 57; Wiesinger v. Austria, § 57; Humen v. Poland [GC], § 66
265 Erkner and Hofauer v. Austria, § 68
266 Unión Alimentaria Sanders S.A. v. Spain, § 35
267Mincheva v. Bulgaria, § 68.
268 Buchholz v. Germany, § 49; Papageorgiou v. Greece, § 40; Humen v. Poland ëGCç, § 66).
269 Papageorgiou v. Greece, § 47.

në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e çdokujt për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohe të arsyeshme.[270]

Edhe në sistemet ligjore që zbatojnë parimin se iniciativa për fillimin e procedurave i takonpalëve, qëndrimi i këtyre të fundit nuk i zhvesh gjykatat nga detyrimi për të siguruar gjykim të shpejtë, siç kërkohet nga Neni 6§1.[271]E njëjta gjë vlen edhe kur gjatë proceseve gjyqësore nevojitet bashkëpunimi i një eksperti: përgjegjësia për përgatitjen e çështjes dhe dërgimin e çështjes sa më shpejt për gjykim i takon gjyqtarit.[272]

Kur ndryshimet e përsëritura të gjyqtarëve çojnë në ngadalësimin e proceseve, për shkak të së drejtës së tyre për njohje me dosjen e çështjes, kjo nuk mund ta zhveshë shtetin nga detyrimet e tij lidhur me garantimin e kërkesës për zhvillimin e gjykimeve brënda njëkohe të arsyeshme, pasi, siç është theksuar më sipër, i takon shtetit që të garantojë administrimin e duhur të drejtësisë. (*Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, § 58).

Mbingarkesa kronike e gjykatave me numër të lartë çështjesh nuk mund të justifikojë tejzgjatjen e proceseve.[273]Megjithatë, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk çon në përgjegjësinë e shtetit, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime që synojnë përmirësimin e situatësnë mënyrë të arsyeshme dhe zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme të këtij lloji[274].

Shteti mund të konsiderohet si përgjegjës për mosrespektimin e kërkesës për kohë të arsyeshme në çështjet kur ka një ngarkesë të tepërt me veprimtari gjyqësore. Për shembull, në çështjen "*Bock kundër Gjermanisë*", shumë aktivitete gjyqësore po fokusoheshintek gjendja mendore e ankuesit, ndërkohë që gjykatat e brendshme vazhdonin të kishin dyshime në lidhje me këtë, pavarësisht pranisë së pesë raporteve që provonin mbi shëndetin mendor të ankuesit dhe rrëzimin e dy kërkesave për kujdestari. Për më tepër, procesi gjyqësor zgjati për më shumë se nëntë vjet.[275]

Shembull. Në çështjen "**Gjonbocari kundër Shqipërisë"**, Gjykata vë̈ren në̈ lidhje me sjelljen e autoriteteve, se gjykimi përfshinte tri instancat gjyqësore. Gjykatat e brendshme mund të̈ thuhet se kanë qenë aktive. Megjithatë, janë dashur shtatë vjet për të̈ vendosur mbi titullin e ankuesve në lidhje me pronën dhe se kjo çështje nuk është̈ vendosur akoma. Një situatë e tillë e çoi Gjykatën në vlerësimin se ka pasur shkelje të̈ Nenit 6 § 1 në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të̈ datës 6 mars 2003 [...] Për më̈ tepër, duke pasur në vë̈mendje procedurat e shumta, gjykata vlerësoi administrimin e secilit set të procedurave gjyqësore nga ana e gjykatave. Të̈ tri setet e procedurave lidhen me çështjen e vlefshmërisë së̈ titullit të̈ ankuesve mbi pronën respektivisht. Autoritetet ia dhanë këtë pronë fillimisht ankuesve, më̈ pas A.L. në̈përmjet një kontrate qiraje dhe në fund në̈në̈s së̈ A.L. Për më̈ tej, duket sikur inicimi i procedurave të̈ ndara kishte për qëllim shmangien nga pë̈rfundimet e më̈parshme të̈ gjykatave. Gjykatat e brendshme ishin të̈ veteë̈dijshme për procedurat paralele, për̈derisa ato i referoheshin atyre shpeshherë [...]. Ajo çfarë është̈ më e rë̈ndësishme

270 Scordino v. Italy (no. 1) ëGCç, § 183
271 Pafitis and Others v. Greece, § 93; Tierce v. San Marino, § 31; Sürmeli v. Germany ëGCç, § 129.
272 Capuano v. Italy, §§ 30-31; Versini v. France, § 29; Sürmeli v. Germany ëGCç, § 12.
273 Probstmeier kundër Gjermanisë, § 64; Vocaturo kundër Italisë, § 17; Cappello kundër Italisë, § 17.
274 Buchholz kundër Gjermanisë, § 51.
275Bock kundër Gjermanisë, § 47.

është se do të kishte qenë ligjërisht korrekte nëse të gjitha procedurat do të bashkoheshin. Gjykata vlerëson se një menaxhim më i mirë i të gjitha procedurave paralelisht të ndërlidhura me njëra tjetrën mund të kishte ndikuar pozitivisht në përshpejtimin e zgjidhjes së titullit të ankuesve. Sipas Gjykatës, vlerësimi nëse kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave ishte e arsyeshme, kërkon marjen parasysh të faktit mbi praninë e disa procedurave paralele me të njëjtin objekt, si një rrethanë ligjore me ndikim të vecantë. Bazuar në këtë fakt, Gjykata rikujton se, sipas Nenit 6 të Konventës, çdo njeri ka të drejtën e një vendimi gjyqësor përfundimtar, brenda një kohe të arsyeshme, për gjykimin e çështjeve mbi të drejtat dhe detyrimet civile. Shtetet palë janë të detyruara të modifikojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat të përshtasin praktikën e tyre sipas kësaj kërkese të Konventës (*shih Union Alimentaria Sanders S.A, kundër Spanjës*, vendimi i 7 korrikut 1989, seria A, nr.157, pp.14- 15, &38). Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave vendase identifikimi i procedimeve relevante dhe, kur është e nevojshme, bashkimi i tyre, pezullimi ose refuzimi për të iniciuar procedura të reja të mëvonshme mbi të njëjtën çështje. Duke pasur në vëmendje kohëzgjatjen e të gjitha procedimeve në tërësi, vendimin e Agjencisë për t'i pezulluar procedurat [...] dhe dështimin e autoriteteve gjyqësore për bashkimin e procedurave me të njëjtin objekt, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave nuk është konform me kërkesat e Nenit 6 të Konventës. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me këtë aspekt.[276]

Në përputhje me argumentimin e dhënë më sipër për çështjen "Gjonbocari", në çështjen "Marini kundër Shqipërisë", Gjykata u shpreh se "Sa i përket grupit të dytë të proceseve, Gjykata vëren se çështja është kthyer disa herë për rishqyrtim. Ajo vë në dukje se në çështje të ngjashme, kur tejzgjatja e proceseve shkaktohet në masë të madhe nga rishqyrtimi disa herë i të njëjtës çështje, ajo ka konstatuar se, për shkak se kthimi për rigjykim ka ardhur si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta, përsëritja e urdhrave të tillë brenda të njëjtit grup procesesh nxjerr në pah një mangësi serioze në sistemin gjyqësor (shih, "*Wierciszewska kundër Polonisë*"). Pra, Gjykata shprehet se përmes dhënies së disa vendimeve kontradiktore në nivelet e juridiksionit, autoritetet shqiptare demonstrojnë mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin ato janë përgjegjëse.[277]"

Në çështjen "Topallaj kundër Shqipërisë" dhe "*Luli & të tjerët kundër Shqipërisë"* Gjykata u shpreh se gjykatat e brendshme kanë kontribuar për tejzgjatjen e proceseve duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në mënyrë të përsëritur tek gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, u shpreh Gjykata, e drejta për shqyrtimin e një çështjeje brenda një kohe të arsyeshme nuk ka kuptim nëse gjykatat e brendshme e gjykojnë të njëjtën çështje disa herë duke e kaluar për gjykim nga një gjykatë në tjetrën, edhe pse në fund kohëzgjatja e proceseve në secilin rast nuk duket veçanërisht e tepruar. Gjykata rithekson që është e detyrueshme për shtetet përgjegjëse që ato t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin kërkesat e Nenit 6 të Konventës, përfshirë edhe detyrimin për gjykimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme[278].

276 Çështja nr. 10508/02, vendim (themeli dhe kompesnimi i drejtë) date 23 tetor 2007, paragrafët 65-68.
277 Çështja nr. 3738/02, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 18 dhjetor 2007 Marini, paragrafi 138-140.
278 Shih referencën e përmendur më sipër.

d) Çfarë është me risk në mosmarrëveshje

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase.

Në çështjen "*Mikulić kundër Kroacisë*", Gjykata ka theksuar se kërkohet kujdes i veçantë në çështjet ***që kanë të bëjnë me statusin dhe kapacitetin civil***. Në vëmëndje të asaj çfarë ishte me risk për ankuesen në çështjen "Mikulić", pra të drejtën e saj për njohjen ose jo të atësisë dhe, në këtë mënyrë, heqjen e cdo pasigurie në lidhje me identitetin e të atit biologjik të ankueses, Gjykata shprehet se autoriteteve kompetente vendase u kërkohet nga Neni 6 § 1 të veprojnë me kujdes të veçantë për sigurimin e realizimit të procedurave gjyqësore.[279]

Në çështjen "*Niederböster kundër Gjermanisë*", Gjykata përsëriti se vlerësimi i kohëzgjatjes së proceseve duhet të përcaktohet duke iu referuar kritereve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në veçanti kompleksitetit të çështjes dhe sjelljes së palëve dhe të autoriteteve. Në pikën e fundit, duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën risk për pozitën e ankuesit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore që çështjet që kanë të bëjnë ***me kujdestarinë,*** të trajtohen me shpejtësi të veçantë.[280]

Në çështjen "*Laino kundër Italisë*", Gjykata shprehet se, duke pasur parasysh atë çfarë përbënte risk për pozitën e ankuesit (***përgjegjësia prindërore dhe të drejtat e kontaktit***), gjykatat vendase nuk vepruan me kujdes të veçantë, siç kërkohet nga Neni 6 § 1 i Konventës për situata të tilla. Prandaj Gjykata arriti në përfundimin se pasiviteti në periudha të ndryshme i shtetit nuk përmbush kërkesat për një "kohëzgjatje të arsyeshme."[281]

Gjykata ka rritur në përfundimin se duhet të trajtohen me shpejtësi të veçantë nga juridiksionet e brendshme edhe çështjet që kanë të bëjnë me **mosmarrëveshjet e punësimit,**[282] çështjet e **ankuesve me "sëmundje të pashërueshme" dhe "jetëgjatësi më të shkurtër."**[283].

Shembull. Në çështjen "***Mishgjoni kundër Shqipërisë***" Gjykata është e mendimit se proceset që lidhen me paqat e munquara, përqjatë periudhës që prej datës 10 prill 2003 e deri më 3 korrik 2007, përbëjnë një kohëzgjatje dicka më tepër se katër vjete për katër nivelet e gjykimit. Duke pasur parasysh numrin e niveleve të gjykimit, Gjykata është e mendimit se kohëzgjatja e proceseve në lidhje me paqat e munquara është e arsyeshme, nisur dhe se çfarë e riskonte ankuesin (shih për shembull, çështjen "*Gjonbocari dhe të Tjerë*", përmendur më sipër, § 62. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se një punonjës i cili konsideron se ai ose ajo është pezulluar ose shkarkuar nga punëdhënësi i tij ose saj, përbën një interes që meriton një kujdes të veçantë për të

279 Mikulić kundër Kroacisë, çështja nr.53176/99, vendim, datë 7 shkurt 2012; shih po ashtu Bock kundër Gjermanisë, çështja nr. 11118/84, vendim i datës 29 mars 1989, § 49, Laino kundër Italisë [GC], çështja nr. 33158/96, vendim i datës 18 shkurt 1999, § 18

280 Niederböster kundër Gjermanisë, § 39, shih po ashtu Glaser § 93; Nuutinen kundër Finlandës, nr. 32842/96, § 110, GjEDNj 2000-VIII; dhe Mark kundër Gjermanisë (vendim), nr. 45989/99, 31 maj 2001, Hokkanen k. Finlandës, § 72; Tsikakis k. Gjermanisë, §§ 64 dhe 68).

281 Shih Maciariello dhe Paulsen-Medalen dhe Svensson, vendime të cituara më sipër, f. 10 dhe 142, §§ 18 dhe 39, Paulsen-Medalen dhe Svensson k. Suedisë, § 39; Laino k. Italisë [GC], § 22;

282 Vocaturo kundër Italisë, § 17; Thlimmenos kundër Greqisë [GC], §§ 60 dhe 62

283 X kundër Francës, § 47; A. dhe të Tjerët kundër Danimarkës, §§ 78-81

siguruar gjykimin e menjëhershëm dhe daljen me një vendim gjyqësor. Natyra e çështjes kërkon marrjen e një vendimi të shpejtë, duke pasur parasysh atë çfarë përbën risk për pozitën e personin në fjalë, i cili përmes shkarkimit humb mjetet e jetesës (shih "*Frydlender kundër Francës"*). Për më tepër, Gjykata rikujton se u takon shteteve kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin kërkesat e Nenit 6 të Konventës, duke përfshirë edhe detyrimin për gjykimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme (shih *Makarova kundër Rusisë*). Gjykata shprehet se vonesa e përgjithshme prej gati katër vjetësh nga KLD-ja për ta rishqyrtuar çështjen e ankuesit nuk është e justifikueshme dhe nuk përmbush kërkesat e gjykimit brënda një "kohe të arsyeshme" sipas Konventës.

- **Rasti studimor 2**

Faktet.

A. Grup i parë i proceseve. Ankuesi ka lindur në vitin 1950 dhe jeton në Beograd, Serbi. Faktet përkatëse të çështjes, siç paraqiten nga palët, mund të përmblidhen si më poshtë. A. Grupi i parë i proceseve. Më 18 shtator 1995, ankuesja dhe anëtarët e familjes së saj ngritën një padi para Gjykatës së Shkallës së Parë (*Osnovni sud*) në Herceg Novi, me anë të së cilën kërkonin ndarjen e pronës së tyre të përbashkët. Më 5 maj 1997, Gjykata e Shkallës së Parë në Herceg Novi e ndërpreu procesin gjyqësor dhe i udhëzoi palët që të të ngrinin një padi të veçantë civile për shkak të disa elementeve të diskutueshme.

B. Grupi i dytë i proceseve. Më 8 shtator 1997, kushërinjtë e ankueses ngritën një padi kundër saj dhe prindërve të saj para Gjykatës së Shkallës së Parë në Herceg Novi. Më 30 dhjetor 1997, kushërinjtë e ankueses ngritën një tjetër padi lidhur me të njëjtën çështje. Të dyja paditë u bashkuan dhe u shqyrtuan në të njëjtin proces civil. Më 1 tetor 2002, Gjykata e Shkallës së Parë në Herceg Novi vendosi kundër aplikantes dhe prindërve të saj. Më 25 qershor 2004, Gjykata e Lartë (Viši sud) në Podgoricë e pranoi këtë vendim në apel. Vendimi, në këtë mënyrë, u bë përfundimtar. Ai iu dorëzua ankueses më 15 korrik 2004. Më 17 gusht 2004, ankuesja depozitoi një padi lidhur me zbatimin e ligjit (revizija) para Gjykatës së Lartë të Malit të Zi. Padia nuk gjendej deri më 20 janar 2006, kohë kur avokatët e ankueses ndërhynë dhe i kërkuan autoriteteve që ta gjenin atë sa më shpejt. Më 12 janar 2007, aplikantja e ndryshoi padinë në lidhje me ligjshmërinë e gjykimit. Më 14 shkurt 2008, Gjykata e Lartë e Malit të Zi e refuzoi ankesën e ankueses në lidhje me ligjin e zbatueshëm si të pabazuar. Ky vendim iu dorëzua kërkuesit më 6 mars 2008.

Pyetje:
A mund të identifikoni periudhën e fillimit dhe të mbarimit që duhet marrë parasysh për vlerësimin e arsyeshmërisë në dritën e procedurave?

1. *A mendoni se procedura ishte e shpejtë në këtë rast?*
2. *Cilat kritere mund të merrni parasysh për të vlerësuar përputhshmërinë me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme?*

Vlerësimi i Gjykatës. Faktet janë marrë nga çështja "Svorcan kundër Malit të Zi", nr. 1253/08), vendim i datës 13 qershor 2017**.**

Gjykata arrin në përfundimin e mëposhtëm**:**

"24. Proceset në fjalë u zhvilluan në periudhën nga 18 shtatori 1995 deri më 6 mars 2008. Pra, proceset janë zhvilluar për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë vjetësh e pesë muajsh në të tria nivelet e juridiksionit.

25. Megjithatë, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm periudhën ndërmjet 3 marsit 2004, kur ka hyrë në fuqi Konventa në lidhje me Malin e Zi, dhe 6 marsit 2008, kur vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua ankuesit, pra për pak më shumë se katër vjet për dy nivele juridiksioni.

26. Gjykata rithekson që arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së ankuesit dhe të autoriteteve përkatëse, dhe atë çfarë përbën rrezik për ankuesin në fjalë (shih, ndër të tjera, "Frydlender kundër Francës" [GC], nr. 30979/96, § 43, KEDNJ 2000-VII).

27. Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së procedurës vetëm në lidhje me gjykimin në një shkalle ose nivel juridiksioni (shih, ndër të tjera, "Bunkate kundër Hollandës", 26 maj 1993, § 23 , seria A 248 B dhe "Kudła kundër Polonisë" [GC], nr. 30210/96, § 130, KEDNJ 2000 XI).

28. Pas shqyrtimit të gjithë materialit të paraqitur, Gjykata është e mendimit se Qeveria nuk ka parashtruar ndonjë fakt apo argument që mund ta bindë atë për të arritur një përfundim tjetër në çështjen në fjalë. Vonesa e paarsyeshme para Gjykatës së Lartë, që arriti pothuajse tre vjet e shtatë muaj, si dhe mungesa e ndonjë shpjegimi që e justifikon një vonesë të tillë, tregojnë se autoritetet vendase nuk kanë vepruar me kujdesin e kërkuar sipas Nenit 6 § 1 të Konventës. Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës".

3. Vonesat për zbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm

Neni 6 § 1 mbron zbatimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare dhe të detyrueshme (gjë e cila është e ndryshme nga zbatimi i vendimeve që mund të shqyrtohen nga një gjykatë më e lartë) (*Ouzounis dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 21). 93. E drejta për ekzekutimin e vendimeve të tilla, të dhëna nga çdo gjykatë, është pjesë përbërëse e "së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës" ("*Hornsby kundër Greqisë*", § 40, "*Scordino kundër Italisë*"(nr.1) [GC], § 196). Përndryshe, dispozitat e Nenit 6 § 1 do të zhvisheshin nga çdo efekti i dobishëm ("*Burdov kundër Rusisë*", §§ 34 dhe 37).

Kjo ka rëndësi edhe më të madhe në kuadrin e proceseve administrative. Përmes parashtrimit të një kërkesë për rishikim gjyqësor në gjykatën më të lartë administrative të shtetit, pala kundërshtuese kërkon jo vetëm anulimin e vendimit të kundërshtuar, por edhe, dhe mbi të gjitha, heqjen e efekteve të saj.

Prandaj mbrojtja efektive e palës ndërgjyqëse dhe rivendosja e ligjshmërisë presupozojnë detyrimin e autoriteteve administrative për të përmbushur vendimin ("*Hornsby kundër Greqisë*", § 41, "*Kyrtatos kundër Greqisë*", §§ 31-32).

Në këtë mënyrë, ndërkohë që disa vonesa në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohen në rrethana të veçanta, vonesa nuk mund të jetë e tillë që të dëmtojë të drejtën e palëve për zbatimin e vendimit ("*Burdov kundër Rusisë*", §§ 35-37).

I kuptuar në këtë mënyrë, ekzekutimi duhet të jetë i plotë dhe shterues dhe jo vetëm i pjesshëm ("*Matheus kundër Francës*", § 58, "*Sabin Popescu kundër Rumanisë*", §§ 68-76), dhe nuk mund të parandalohet, shfuqizohet ose vonohet padrejtësisht (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GCç, § 74].

Refuzimi i një autoriteti për të marrë parasysh një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë, duke çuar potencialisht në një sërë vendimesh në kuadrin e së njëjtës procedurë, duke lënë mënjanë vendimet e marra në mënyrë të përsëritur, është po ashtu në kundërshtim me Nenin 6 § 1 (*Turczanik kundër Polonisë*, §§ 49-51).

Një vonesë e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi të detyrueshëm mund të jetë në shkelje të Konventës. Arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet të përcaktohet duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e procedurës së përmbarimit, sjelljen e vetë aplikuesit dhe të autoriteteve kompetente, si dhe shumën dhe natyrën e vendimit gjyqësor ("*Raylyan kundër Rusisë*", § 31) .

Për shembull, Gjykata është shprehur se, duke mos bërë asgjë për më shumë se pesë vjet nga marrja e masave të nevojshme për të përmbushur një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të zbatueshëm, autoritetet vendase i kanë hequr dispozitave të Nenit 6 § 1 të gjitha efektet e dobishme ("*Hornsby kundër Greqisë*", § 45).

Në një çështje tjetër, periudha e përgjithshme prej nëntë muajsh nga autoritetet për të zbatuar një vendim u konstatua si e paarsyeshme në lidhje me rrethanat ("*Moroko kundër Rusisë*", §§ 43-45).

Gjykata ka gjetur se e drejta për proces të rregullt ligjor sipas Nenit 6 § 1 është shkelur për shkak të refuzimit të autoriteteve, për një periudhë prej rreth katër vjetësh, për të përdorur ndihmën e policisë sa i takon zbatimit të urdhrit të pronësisë kundrejt një qiramarrësit ("*Lunari kundër Italisë*", §§ 38-42), dhe për shkak të pezullimit të ekzekutimit, për më shumë se gjashtë vjet, shkaktuar nga ndërhyrja e legjislativit duke vënë në pikëpyetje urdhrin e gjykatës për dëbimin e qiramarrësit, urdhër që ishte zhveshur nga çdo efekt i dobishëm me anë të dispozitave ligjore të kontestueshme ("*Immobiliare Saffi kundër Italisë*" [GC], §§ 70 dhe 74).

Një person i cili disponon një vendim në disfavor të shtetit, nuk mund të pritet që në fund të proceseve ligjore të iniciojë një procedurëtë veçantë për ekzekutimin e vendimit ("*Burdov kundër Rusisë*" (nr. 2), § 68). Barra për sigurimin e zbatimit të plotë të një vendimi kundër shtetit u takon autoritetet shtetërore (*Yavorivskaya kundër Rusisë*, § 25), duke filluar nga data kur vendimi bëhet i detyrueshëm dhe i zbatueshëm (*Burdov kundër Rusisë* (Nr. 2), § 69).

Një pale të suksesshme ndërgjygjëse mund t'i kërkohet të ndërmarrë hapa të caktuar proceduralë për të lejuar ose përshpejtuar ekzekutimin e një vendimi. Megjithatë, kërkesa për bashkëpunimin e kreditorit nuk duhet të tejkalojë atë që është rreptësisht e nevojshme dhe nuk i zhvesh autoritetet nga detyrimet e tyre (po aty).

Rezulton se pagesa e vonuar, në zbatim të veprimeve përmbarimore, të shumave që i takojnë ankuesit, nuk mund të justifikojë mungesën e vazhdueshme të bashkëpunimit të autoriteteve vendase për të zbatuar një vendim dhe nuk ofron një adresim të drejtë të situatës (*Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [GC] , § 198).

Një pale ndërgjyqëse nuk mund t'i privohet përfitimi i dëmshpërblimit për dëmin e pësuar apo strehimit brenda një afati të arsyeshëm, në zbatim të një vendimi përfundimtar të gjykatës ("*Burdov kundër Rusisë*", § 35), pavarësisht kompleksitetit të proceseve përmbarimore, apo sistemit buxhetor të shtetit. Nuk është e denjë që një autoritet shtetëror të justifikohet me anë të mungesës së fondeve, ose burimeve të tjera për mosrespektimin e një vendimi përfundimtar për kthimin e një borxhi (*Burdov kundër Rusisë*, § 35, *Amat-G Ltd dhe Mebaghishvili kundër Gjeorgjisë*, § 47, *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [GC], § 199]. Ashtu si dhe nuk mund të justifikohet me mungesë të formave alternative të strehimit për mosrespektimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar (*Prodan kundër Moldavisë*, § 53).

Duhet të bëhet dallimi midis borxheve që *duhet të paguajë shteti* (*Burdov kundër Rusisë* (nr.2), §§ 68-69, 72 et seq.), dhe borxheve që *duhet të paguhen nga një individ*: shteti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për shkak të mospagimit të një borxhi si rezultat i falimentimit të një debitori "privat" (*Sanglier kundër Francës, § 39, Ciprová kundër Republikës Çeke* (vendim), *Cubanit kundër Rumanisë* (vendim)). Megjithatë, shteti ka detyrimin pozitiv që të organizojë një sistem efektiv përmbarimi si në ligj, dhe në praktikë sa i takon ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në mosmarrëveshjet ndërmjet personave privatë (*Fuklev kundër Ukrainës,* § 84). Prandaj, përgjegjësia e shtetit mund të futet në lojë nëse autoritetet publike të përfshira në procedurat e përmbarimit dështojnë të tregojnë kujdesin e duhur, apo edhe të parandalojnë vonesat e ekzekutimit(po aty, § 67). Masat e marra nga autoritetet vendase për të siguruar ekzekutimine vendimit duhet të jenë adekuate dhe të mjaftueshme për këtë qëllim (*Ruianu kundër Rumanisë*, § 66), duke pasur parasysh detyrimet përkatëse në çështjen e ekzekutimit, pasi janë po këto autoritete që ushtrojnë autoritetin publik (po aty. , §§ 72-73).

- **Rasti studimor 3**

Faktet. Ankuesi ka lindur në vitin 1936 dhe jeton në Sofie.

A. Ankuesit i jepet dëmshpërblim. Në vitin 1997 hyri në fuqi ligji "Për kompensimin e pronarëve të pronave të patundshme të privatizuara ("ligji i kompensimit i vitit 1997"). Ligji rregullonte dhënien e dëmshpërblimeve për pronën e marrë sipas disa ligjeve me natyrë ndëshkuese, ose rishpërndarëse, të cilat nuk mund të ktheheshin fizikisht. Më 27 nëntor 1997, ankuesi kërkoi nga guvernatori rajonal të Sofjes dëmshpërblim për një apartament që i përkiste paraardhësve të tij në kohën e shtetëzimit, në vitin 1949. Pasi nuk mori asnjë përgjigje, dikur gjatë vitit 1998 ankuesi e kundërshtoi qëndrimin e

guvernatorit në gjyq. Gjykata e Rrethit Sofje e kundërshtoi refuzimin në heshtje të guvernatorit më 18 qershor 1999 dhe u shpreh se ankuesi duhej të dëmshpërblehej me "obligacionet për kompensimin e strehimit" (жилищни компенсаторни записи) pasi kthimi i pronës nuk ishte i mundur. Ankuesi e apeloi këtë vendim, duke kundërshtuar llojin e kompensimit të dhënë. Më 9 prill 2001, Gjykata e Lartë Administrative mbështeti vendimin e gjykatës më të ulët dhe ia ktheu sërish atë gjykatës për të përcaktuar shumën e dëmshpërblimit. Në vend që të vendoste mbi dëmshpërblimin, Gjykata e Rrethit Sofje e arkivoi çështjen. Pas ankimit të ankuesit, çështja e tij u fut në listën e çështjeve më 5 korrik 2002.. Gjykata e Rrethit Sofje, e mbledhur në seksionin administrativ, e dha vendimin më 19 korrik 2005. Ajo vendosi që shuma e dëmshpërblimit total në lidhje me pronën në fjalë ishte 23,604 BGN dhe se për dëmshpërblimin ishte përgjegjës guvernatori rajonal. Gjykata vijoi më tej duke thënë se ankuesi duhej ta merrte dëmshpërblimin në trajtën e "bonove të kompensimit për strehimin", në përputhje me pjesën e tij si trashëgimtar i pronës. Gjykata vijoi duke thënë se, siç dëshmohet nga certifikata e trashëgimisë, lëshuar në vitin 1994, dhe e paraqitur gjatë proceseve gjyqësore, trashëgimtarët e pronës së konfiskuar janë ankuesi dhe vëllai i tij. Për pasojë, pjesa e trashëgimisë që i përket ankuesit rrjedh drejtpërdrejt nga ligji, sipas të cilit fëmijët e të ndjerit përfitonin pjesë të barabarta të pronësisë. Vendimi u bë i zbatueshëm më 6 shtator 2005.

B. Kërkesa e ankuesit për ekzekutim nga guvernatori rajonal. Më 26 qershor 2006, ankuesi i transmetoi guvernatorit rajonal një kopje të vendimit përfundimtar të gjykatës, datë 19 korrik 2005, duke kërkuar zbatimin e vendimit. Për të njëjtin qëllim ai dërgoi një kërkesë tjetër më 8 gusht 2006. Zëvendës/guvernatori rajonal u përgjigj me shkrim më 14 shkurt 2007 duke specifikuar se ankuesi duhej të paraqiste një kopje të vërtetuar të vendimit të gjykatës, një certifikatë që vërtetonte statusin e tij si trashëgimtar, dhe një deklaratë të vërtetuar nga noteri. Më 19 shkurt 2007, ankuesi paraqiti një kopje të vërtetuar të vendimit të gjykatës të datës 19 korrik 2005. Ai nënvizoi se zbatimi vazhdonte të mos realizohej dhe theksoi se ai i kishte paraqitur që më parë guvernatorit rajonal një certifikatë që vërtetonte statusin e tij si trashëgimtar i apartamentit, së bashku me kërkesën fillestare për dëmshpërblim të datës 27 nëntor 1997 (shih paragrafin 7 më sipër). Ai vuri po ashtu në dukje se nga vendimi gjyqësor dilte qartë se trashëgimtarët e pronës në fjalë ishin dy, ai dhe vëllai i tij; në pajtim me Nenin 5 (1) të ligjit të trashëgimisë të vitit 1949, ai kishte të drejtë të merrte gjysmën e trashëgimisë dhe, për këtë arsye, edhe gjysmën e dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata. Ai kërkoi sqarime në lidhje me deklaratën e kërkuar nga guvernatori. Zëvendës/guvernatori u përgjigj më 5 mars 2007 se deklarata ishte e nevojshme sipas Nenit 5 të urdhrit nr. 9 të vitit 1998. Ky i fundit trajtonte kushtet dhe rregullat për pagimin e ekspertëve, të përfshirë në listën sipas pikës §4 të ligjit të kompensimit të vitit 1997.

C. Proceset përmbarimore të detyrueshme. Ndërkohë, më 19 janar 2007, ankuesi kërkoi që të lëshohej një urdhër ekzekutimi në bazë të vendimit datë 19 korrik 2005 dhe, më saktë, në lidhje me pjesën e shumës së dëmshpërblimit dhe pjesën që i takonte atij. Më 16 mars 2007 atij iu lëshua një urdhër ekzekutimi në lidhje me dëmshpërblimin që i takonte. Më 30 mars 2007 ai i kërkoi përmbaruesit të fillonte procedurat e detyrueshme të përmbarimit dhe t'i jepte kostot dhe shpenzimet përkatëse. Më 3 prill 2007, përmbaruesi i

dërgoi guvernatorit një ftesë për respektim vullnetar të vendimit, duke i sinjalizuar se mosveprimi për respektimin e vendimit, datë 19 korrik 2005, çonte në një sanksion monetar. Zëvendësi i guvernatorit rajonal u përgjigj më 20 prill 2007 duke thënë se nuk ishin plotësuar proceset e nevojshme për realizimin e dëmshpërblimit, për shkak të mosparaqitjes së deklaratës së kërkuar nga noteri ana e ankuesit (shih paragrafët 11 dhe 13 më sipër). Ai shtoi gjithashtu se nevojitej një urdhër origjinal ekzekutimi, në mënyrë që zyra e tij të paguante kostot dhe shpenzimet. Më 25 prill 2007, ankuesi i shkroi guvernatorit rajonal duke i shpjeguar se urdhri i referuar prej tij nuk zbatohej për çështjen e tij, pasi ai kishte të bënte vetëm me situatat kur shuma e dëmshpërblimit përcaktohej nga vetë organi administrativ. Në çështjen në fjalë, kjo shumë ishte përcaktuar nga gjykata, e cila kishte vendosur gjithashtu që trashëgimtarët e vetëm të pronës ishin ankuesi dhe vëllai i tij dhe se prona duhej të ndahej në mënyrë të barabartë ndërmjet të dyve. Përmbaruesi i çështjes i dërgoi një letër tjetër guvernatorit më 27 prill 2007, përmes së cilës e ftonte sërish atë të zbatonte vendimin e gjykatës. Ai përsëriti se urdhri i përmbarimit ishte lëshuar pas një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili ishte i detyrueshëm në lidhje me palët dhe në të cilën gjykata kishte vendosur të gjitha faktet përkatëse, si edhe shumën e dëmshpërblimit për ankuesin. Përmbaruesi specifikonte se kostot dhe shpenzimet që kërkoheshin të paguheshin nga guvernatori kishin të bënin me procedurat e përmbarimit, se për to nuk nevojitej një urdhër ekzekutimi, dhe se ato ishin rritur me kalimin e kohës. Përfundimisht, përmbaruesi përsëriti se në rast të moszbatimit të vendimit të gjykatës, guvernatori do të paguante një gjobë javore prej 200 BGN. Më 10 maj 2007, guvernatori rajonal i hodhi në gjykatë aktet përmbarimore. Ai pohoi se mosekzekutimi kishte ardhur tërësisht si rezultat i refuzimit të aplikantit për të paraqitur një deklaratë noteriale. Më 2 korrik 2007, Gjykata Administrative e Rrethit Sofje konstatoi se kërkesa e guvernatorit për shqyrtim gjyqësor ishte e papranueshme. Gjykata konstatoi në veçanti se ftesat e përmbaruesit drejtuar guvernatorit për pajtueshmëri vullnetare nuk ishin akte të zbatimit të detyrueshëm dhe, si të tilla, nuk i nënshtroheshin rishikimit gjyqësor. Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Lartë Administrative më 21 dhjetor 2007 në një vendim përfundimtar.

D. Vazhdimi i proceseve për zbatim të detyrueshëm. Për shkak se nuk u krye asnjë veprim i mëtejshëm nga guvernatori rajonal, në mars të vitit 2009, ankuesi i kërkoi përsëri përmbaruesit që të ekzekutonte vendimin e gjykatës, datë 19 korrik 2005. Përmbaruesi i shkroi guvernatorit më 31 mars 2009, duke kërkuar ekzekutimin e vendimit dhe e kujtoi se moszbatimi i tij mund të çojë në gjoba javore prej 1.200 BGN dhe në ndjekje penale. Zëvendës/guvernatori rajonal u përgjigj më 27 prill 2009 se procedurat e dëmshpërblimit nuk ishin plotësuar për shkak të mosparaqitjes nga ankuesi të deklaratës së kërkuar për pjesën e tij të trashëgimisë në përputhje me ligjin e trashëgimisë të viti 1949. Dy ditë më vonë vetë guvernatori rajonal e gjobiti ankuesin me BGN 1,000, shuma që do të paguheshin çdo javë. Më 11 maj 2009, ankuesi e kundërshtoi gjobën në gjykatë. Gjykata Administrative e Rrethit Sofje e hoqi gjobën më 8 janar 2010, duke u shprehur se në këtë rast guvernatori rajonal nuk kishte kompetencë për të vënë gjoba, pasi ai nuk ishte organ përmbarues, por thjesht një debitor dhe Z. Yanakiev nuk ishte debitor, por kreditor. Me anë të një letre, datë 19 gusht 2013, avokati i ankuesit e njoftoi Gjykatën se vendimi përfundimtar i gjykatës i datës 19 korrik 2005 ishte ende i pazbatuar.

Pyetje.

1. *A mendoni se respektohet e drejta për proces të rregullt ligjor sipas Nenit 6 § 1 në rast se një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe i detyrueshëm mbetet i pazbatueshëm?*
2. *Në çështjen në fjalë, ankuesi nuk kishte akses në dëmshpërblimin e njohur nga gjykata vendase. A mendoni se kjo është në përputhje me Konventën?*
3. *A ka në këtë rast shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme?*

70. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përfshin të drejtën e zbatimit të një vendimi gjyqësor pa vonesa të panevojshme (shih *Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], nr. 22774/93, § 66, GJEDNJ 1999-V). Ndërsa vonesat në zbatim mund të justifikohen në rrethana të jashtëzakonshme, justifikohen vetëm periudhat e domosdoshme për t'i mundësuar autoriteteve të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme (shih *Immobiliare Saffi* [GC], cituar më sipër, § 69, dhe *Sokur kundër Ukrainës*, nr. 29439/02, § 30, 26 prill 2005).

71. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Qytetit të Sofjes i datës 19 korrik 2005, përcaktoi shumën e dëmshpërblimit që duhej të merrte ankuesi në formën e "obligacioneve të kompensimit për strehim". Sipas procedurës përkatëse, guvernatori rajonal duhej të vepronte për të siguruar që obligacionet e kompensimit t'i jepeshin ankuesit në zbatim të vendimit. Megjithatë, guvernatori rajonal dështoi ta bënte këtë prej disa vitesh, përkatësisht nga mesi i qershorit të vitit 2006, kur ankuesi i dërgoi atij vendimin për ekzekutim, dhe të paktën deri në prill të vitit 2014 në kohën e parashtrimit të vërejtjeve të ankuesit para Gjykatës.

Vlerësimi i Gjykatës. Faktet janë nxjerrë nga çështja "***DIMITAR YANAKIEV kundër BULGARISË***" (nr. 2), nr. 50346/07, vendim i datës 31 mars 2016. Gjykata arriti në përfundimin e mëposhtëm:

69. Gjykata rithekson se e drejta për proces të rregullt sipas Nenit 6 § 1 të Konventës do të ishte iluzive nëse një sistem ligjor i brendshëm i një Shteti Kontraktues të lejonte moszbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm, në dëm të njërës palë. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e "gjykimit" për qëllimet e Nenit 6 të Konventës (shih "Hornsby kundër Greqisë", 19 mars 1997, § 40, raportet e aktgjykimeve dhe aktvendimeve 1997 -II dhe Burdov (nr. 2), cituar më sipër, § 65).

70. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përfshin të drejtën për të marrë vendim gjyqësor pa vonesa të panevojshme (shih "Immobiliare Saffi kundër Italisë" [GC], nr. 22774/93, § 66, GJEDNJ 1999-V). Ndërsa vonesat në zbatim mund të justifikohen në rrethana të jashtëzakonshme, justifikimi bëhet vetëm për periudhat e domosdoshme për t'i mundësuar autoriteteve të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme (shih Immobiliare Saffi [GC], cituar më sipër, § 69, dhe "Sokur kundër Ukrainës", nr. 29439/02 , § 30, 26 prill 2005).

71. Duke u kthyer çështjes nën shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Sofje, datës 19 korrik 2005, përcaktoi shumën e dëmshpërblimit që duhej të merrte ankuesi në formën e "obligacioneve për kompensimin e strehimit". Sipas procedurës përkatëse, guvernatori rajonal duhej të vepronte për të siguruar që obligacionet e kompensimit t'i

jepeshin ankuesit në zbatim të vendimit. Megjithatë, guvernatori rajonal nuk e ka bërë këtë gjë gjatë periudhës prej disa vitesh, përkatësisht nga mesi i qershorit 2006, kur ankuesi i dërgoi vendimin për ekzekutim, dhe të paktën deri në prill të vitit 2014 në kohën e paraqitjes së vërejtjeve të ankuesit Gjykatës. Kjo vonesë është e mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatës të arrijë në përfundimin se në çështjen në fjalë ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë në favor të tij, të garantuar nga Nenin 6 § 1 i Konventës (shih, për krahasim në lidhje me periudhën e moszbatimit, "Kravchenko dhe të tjerët (banesa ushtarake) kundër Rusisë", nr. 11609/05, 12516/05, 17393/05, 20214/05, 25724/05, 32953/05, 1953/06, 10908/06, 16101/06, 26696/06, 40417/06, 44437/06, 44977/06, 46544/06, 50835/06, 22635/07, 36662/07, 36951/07, 38501/07, 54307/07, 22723/08, 36406/08 dhe 55990/08, §§ 33-35, 16 shtator 2010; "Kalinkin dhe të Tjerët", cituar më sipër, §§ 44 dhe 48).

72. Për pasojë, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Rekomandohet per lexim

- Udhëzim i GJEDNJ-së mbi Nenin 6 (aspekti civil)
- Udhëzim i GJEDNJ-së mbi Nenin 6 (aspekti penal)
- European Union Agency for Fundamental Rights, Handbook on European law relating to access to justice, Chapter 3 - A fair and public hearing before an independent and impartial tribunal and other bodies (June 2016)
- http://fra.europa.eu/en/publication/2016/handbook-european-law-relating-access-justice
- Article 6: Self-learning course, Human Rights Education for Legal Professionals, Council of Europe (2014)
- http://help.elearning.ext.coe.int/course/info.php?id=532
- Nuala Mole and Catharina Harby, Right to a fair trial: A Guide to implementation of Article 6 of the European Convention on Human Rights, Human Rights Handbooks. No. 3 , Council of Europe (2006, 2nd edn.)
- Council of Europe, (CEPEJ) (2013), States appeal and supreme courts' lengths of proceedings;
- Article 6: Self-learning course, Council of Europe, Human Rights Education for Legal Professionals, 2014, http://help.elearning.ext.coe.int/course/info.php?id=532
- European Union Agency for Fundamental Rights, Handbook on European law relating to access to justice, Limitations on access to justice: length of proceedings (Chapter 7) (June 2016), http://fra.europa.eu/en/publication/2016/handbook-european-law-relating-access-justice

II–Mjetet efektive për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme

A. Mjetet e Konventës

1. Neni 13 i Konventës

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi vendas, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

Neni 13 kërkon që një autoritet vendase t'i sigurojnë një individi, që ka një kërkesë të bazuar lidhur me shkeljen e një prej të drejtave të tij sipas Konventës, me një ose disa mjete juridike në të drejtën vendase, të cilat sigurojnë mbrojtje efektive të këtyre të drejtave. Neni 13, së bashku me kërkesën për shterimin e mjeteve të brendshme juridike sipas Nenit 35 (1), sigurojnë bazën për doktrinën e subsidiaritetit (shih më poshtë), e cila i jep përgjegjësi parësore Shteteve Kontraktuese për të siguruar mbrojtje efektive të të drejtave të Konventës.

Parimet kryesore të Nenit 13 që rrjedhin nga praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane janë: 1. detyrimi i pavarur i Konventës; 2. doktrina e subsidiaritetit; 3. kërkesa për një "ankesë të bazuar; 4. aksesi në mjete efektive; 5. kërkesat institucionale për mjete efektive.

1.1. Parimet kryesore të Nenit 13

1.1.1. Detyrimi i pavarur i Konventës

Neni 13 i Konventës ka të bëjë me një të drejtë pasurore, të aftë për të shkaktuar shkelje të mëvetësishme, pavarësisht nëse ankuesi vërteton apo jo shkeljen e një të drejte tjetër të Konventës.

Praktika gjyqësore. *Klass kundër Gjermanisë*[284] (Gjykata në seancë plenare): "Neni 13 parashikon se çdo individi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e Konventës, duhet të ketë në dispozicion një mjet efektiv juridik për t'u mbrojtur përpara një autoriteti vendas, edhe kur "shkelja kryhet" nga persona që mbajnë funksion zyrtar. Kjo dispozitë, e lexuar fjalë për fjalë, duket se thotë se çdo person ka të drejtën e një mjeti vendas vetëm nëse ka ndodhur një "shkelje". Megjithatë, një person nuk është në gjendje ta vërtetojë "shkeljen" para një autoriteti vendas, përveç rastit kurai, pikë së pari, është në gjendje të paraqesë para një autoriteti të tillë ankesën përkatëse për këtë qëllim. Për rrjedhojë, siç deklaroi pakica në Komision, shkelja e Konventës nuk mund të jetë parakusht për zbatimin e Nenit 13. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, Neni 13 kërkon që kur një individ e konsideron veten të cenuar nga një masë që pretendohet se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të ketë një mjet juridik që mund ta ushtruar përpara një autoriteti vendas, në mënyrë që: 1) të merret një vendim mbi kërkesën e tij dhe, 2) nëse kërkesa është e drejtë, të marrë dëmshpërblim për dëmin e pësuar.

284 Çështja nr. 5029/71, vendim i datës 6 shtator 1978.

Prandaj, Neni 13 duhet të interpretohet si garanci për "mjet ligjor efektiv para një autoriteti vendas "ndaj kujtdo që pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të tij sipas Konventës. Për rrjedhojë, megjithëse Gjykata nuk ka gjetur shkelje të së drejtës së garantuar për ankuesit sipas Nenit 8, duhet të përcaktohet nëse ligji gjerman u jep ankuesve "një mjet efektiv para një autoriteti vendas" në kuptimin e Nenit 13 §§64-65.

1.1.2. Doktrina e subsidiaritetit

Neni 35(1) i Konventës parashikon si vijon: 'Gjykata mund ta trajtojë çështjen vetëm kur të jenë shteruar të¨ gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të¨ pranuara të¨ së¨ drejtës ndërkombëtare dhe brenda një¨ periudhe prej gjashtë¨muajsh nga data në¨ të¨ cilën merret vendimi i formës së¨prerë".

Parimi i subsidiaritetit pohon se është përgjegjësi kryesore e autoriteteve vendase që të sigurojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Konventa. Parimi i subsidiaritetit përfshihet në Nenin 35 (1) të Konventës dhe mbështetet në Deklaratën e Interlakenit[285] të vitit 2010 dhe Deklaratën e Brajtonit të vitit 2012 mbi "Të ardhmen e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut"[286]. Protokolli nr. 15 i Konventës (i cili ende nuk ka hyrë në fuqi) i shton një preambulë të re Konventës, duke iu referuar specifikisht parimit të subsidiaritetit, duke pohuar se shtetet kontraktuese mbajnë "përgjegjësinë kryesore për të siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive" të përcaktuara në Konventë dhe në protokollet e saj[287].

Praktika gjyqësore. *Surmeli kundër Gjermanisë* [GC][288]: " Sipas Nenit 1 të Konventës, i cili parashikon se "Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë¨ çdokujt brenda juridiksionit të¨ tyre të¨ drejtat dhe lirite¨ e përcaktuara në¨ titullin I të¨ kësaj Konvente, përgjegjësia parësore për zbatimin dhe vënien në jetë të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa u takon autoriteteve vendase. Mekanizmi i ankimit në Gjykatë është rrjedhimisht komplementues (subsidiar) ndaj sistemeve vendase që mbrojnë të drejtat e njeriut. Ky karakter plotësues artikulohet në Nenin 13 dhe Nenin 35 § 1 të Konventës [...]" § 97.

McFarlane kundër Irlandës [GC][289]: " Gjykata përsërit se, sipas Nenit 35 § 1, ajo mund të merret me një çështje vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme. Ankuesit duhet t'ju kenë ofruar gjykatave të brendshme mundësinë, të cilat në parim synohet t'iu vihen në dispozicion Shteteve Kontraktuese për të parandaluar ose për të vënë në vend shkeljet e pretenduara të së drejtës kundrejt tyre. Ky rregull bazohet në prezumimin e reflektuar në Nenin 13 të Konventës, me të cilën ai ka lidhje të ngushta, pra që ekziston një mjet efektiv në dispozicion në sistemin brendshëm në lidhje me shkeljen e pretenduar. Ajo çfarë kërkohet nga Neni 35 § 1 është shterimi i mjeteve që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar, dhe që ato të jenë të disponueshme dhe të mjaftueshme. Prania e mjeteve të tilla duhet të jetë e sigurt na

285http://www.echr.coe.int/documents/2010_interlaken_finaldeclaration_eng.pdf
286http://www.echr.coe.int/Documents/2012_Brighton_FinalDeclaration_ENG.pdf
287http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_15_ENG.pdf
288 Çështja nr. 75529/01, vendim i datës 8 qershor 2006.
289 Çështja nr. 31333/06, vendim i datës 10 shtator 2010.

baza të mjaftueshmejo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pasi në të kundërt mungesa e tyre në praktikë i bën ato të paaksesueshme dhe joefektive: i takon shtetit përgjegjës që të vërtetojë se këto kushte janë përmbushur [...]" §107 .

Siništaj dhe të tjerët kundër Malit të Zi[290] "[...] Gjykata thekson se qëllimi i Nenit 35 është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e pretenduara kundër tyre, përpara se këto pretendime të dorëzohen në institucionet e Konventës. Rrjedhimisht, shtetet përjashtohen nga llogaridhënia për veprimet e tyre para një organi ndërkombëtar, derisa të kenë pasur mundësi të kërkojnë zgjidhje për çështjet përmes sistemit të tyre ligjor, dhe ato persona që dëshirojnë të vënë në lëvizje juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës në lidhje me ankesat kundër një shteti janë të detyruar të përdorin së pari mjetet juridike të parashikuara në sistemin ligjor vendas [...] Rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike, i përmendur në Nenin 35 të Konventës, kërkon që një ankues t'i drejtohet rrugës normale të ankimit vetëm për mjetet juridike që gjejnë zbatim për shkeljet e pretenduara dhe, në të njëjtën kohë, kur këto mjete janë në dispozicion dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e mjeteve të tilla duhet të e sigurt në baza të mjaftueshme jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, në mungesë të së cilës ata nuk do të ofrojnë aksesin dhe efektivitetin e nevojshëm [...]; i takon shtetit të paditur të vendosë nëse janë përmbushur këto kushte të ndryshme [...]. Për të qenë efektiv, një mjet juridik duhet të jetë në gjendje të ofrojë adresimin e situatës së kontestuar dhe duhet të ofrojë në mënyrë të arsyeshme nje zgjidhje të suksesshme. [...]. Megjithatë, pasja e një dyshimi se ushtrimi i një mjeti të caktuar mund të shërbejë me sukses zgjidhjes së shkeljes së pretenduar, mjet i cili është hapur i dobishëm, nuk përbën arsye të vlefshme për mosshterimin e tij [...]"

1.1.3.Kërkesa për "ankesë të bazuar'

Për të plotësuar pragun për zbatimine Nenit 13, ankuesi duhet të vërtetojë se ka një pretendim "të bazuar" se ai/ajo është viktimë e shkeljes së një ose më shumë të drejtave të Konventës. Gjykata Europiane nuk ka dhënë një përkufizim abstrakt për përcaktimin nëse një kërkesë për shkelje të Konventës është e bazuar. Megjithatë, nëse një ankim shpallet i papranueshëm pasi është "shprehimisht i pabazuar" sipas Nenit 35 (3) (a) të Konventës, ky mjet ka po ashtu të ngjarë të kualifikohet si i pabazuar për qëllimet e Nenit 13.

***Praktika gjyqësore**. Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Gjykata në seancë plenare)[291]:
"Megjithatë, për aq sa duket e arsyeshme, Neni 13 nuk mund të interpretohet se imponone për çdo ankesë që mund të ketë një individ duke pretenduar se është e mbështetur në Konventë duhet të ketë një mjet juridik efektiv në të drejtën e brendshme , në cdo rast ankesa duhet të jetë e bazuar në Konventë pavarësisht sesa e paarsyeshme mund duket ankesa e tij [...]. Prandaj, Gjykata është kompetente të

290 Çështja nr. 1451/10, 7260/10 dhe 7382/10, vendim i datës 24 nëntor 2015.
291 Çështja nr. 9659/82; 9658/82, vendim i datës 27 prill 1988.

njihet mbi të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që dalin në kuadrin e ankesave që depozitohen para saj, sipas Nenit 13 (po aty), duke përfshirë edhe arsyetimin, ose jo të ankesave, për shkelje të dispozitave pasurore. Në lidhje me këtë, vendimi i Komisionit mbi pranueshmërinë e çështjes duke ofruar arsyetimin e tij, edhe pse nuk del me një qëndrim përcaktues, në vetvete mund të ofrojë elementë të rëndësishëm sa i takon bazueshmërisë së pretendimeve të ngritura duke ndjekur qëllimin e Nenit 13. Gjykata nuk mendon se duhet t'i japë një përkufizim abstrakt të nocionit të bazueshmërisë. Përkundrazi, në dritën e fakteve specifike dhe të natyrës së çështjes ose çështjeve ligjore të ngritura, duhet të përcaktohet nëse çdo pretendim specifik për shkelje që përbën bazën e një ankimisipas Nenit 13 (Neni 13) është i mbështetur dhe, nëse po, nëse kërkesat e Nenit 13 13 në lidhje me të janë përmbushur "§§52, 54-55."

Momčilović kundër Serbisë[292]."Duke iu kthyer çështjes nën shqyrtim, Gjykata vëren se ankuesi ishte plotësisht në gjendje ta paraqiste çështjen para tre shkallëve të gjykimit. Vendimet e Gjykatës së Lartë objekt shqyrtimi, janë plotësisht të mirë arsyetuara dhe asgjë në dosjen e çështjes mund të provojë se këto vendime janë arbitrare. Fakti se autoritetet gjyqësore vendase ofruan një forum për përcaktimin e një mosmarrëveshjeje private midis dy paditësve, në të cilat ankuesi ishte i pasuksesshëm, nuk kërkon domosdoshmërisht ndërhyrjen e shtetit në të drejtat pronësore sipas Nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Edhe sikur të supozojmë se "kërkesa" e ankuesit është " është e bazuar mjaftueshëmpër ekzekutim" për të gjetur zbatim garancitë e Nenit 1 të protokollit nr. 1 [...] Gjykata vëren se, duke marrë parasysh aspektet e mësipërme, ankesa e ankuesit sipas kësaj dispozite është qartazi e pabazuar në kuptim të Nenit 35 §3 të Konventës dhe duhet të refuzohet sipas Nenit 35 §4 të Konventës [...]. Së fundmi, ankuesi pretendoi se, mbështetur në Nenin 13 të Konventës,nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i takon çështjeve të parashtruara më sipër (shih paragrafët 34 dhe 35). Gjykata përsëriti se Neni 13 zbatohet vetëm në rastet kur një individ ka një "pretendim të bazuar" se është viktimë e një shkeljeje të së drejtës së Konventës (*shih Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar* ... Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se ankuesi nuk kishte një "kërkesë të bazuar" të tillë dhe, për këtë arsye, Neni 13 nuk është i zbatueshëm. Për rrjedhojë, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës. "§§ 36-37.

292 Çështja nr. 23103/07, vendim i datës 2 prill 2013.

1.1 4. Aksesi për mjetet efektive ligjore

Neni 13 garanton disponueshmërinë e një mjeti vendas për zbatimin e të drejtave dhe lirive të Konventës. Neni 13 nuk përcakton se çfarë përbën një mjet juridik dhe nuk kërkon ndonjë formë të veçantë të mjeteve juridike. Autoriteti vendas i përmendur në Nenin 13 nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një organ gjyqësor. Megjithatë, mjetet juridike duhet të jenë efektive si në praktikë, ashtu edhe në ligj.

Praktika gjyqësore. *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar* [293]: : "Gjykata rithekson që Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivel vendas të një mjeti juridik për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës, në çfarëdo mënyre që ato të sigurohen në rendin juridik të brendshëm. Pra, efekti i Nenit 13 është të kërkojë sigurimin e mjeteve juridike të brendshme për t'u marrë me thelbin e një "ankese të bazuar" sipas Konventës, dhe për të dhënë lehtësimin e duhur, edhe pse Shteteve Kontraktuese u lihet dorë e lirë lidhur me mënyrën se si ato i përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Konventa, sipas kësaj dispozite. Objekti i detyrimit sipas Nenit 13 përcaktohet në varësi të natyrës së ankesës së ankuesit, në bazë të Konventës. Megjithatë, mjeti juridik i kërkuar nga Neni 13 duhet të jetë "efektiv", si në praktikë dhe në ligj. Veçanërisht, përdorimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustifikuar nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit të paditur [...]. Duke pasur parasysh rëndësinë themelore të së drejtës për mbrojtjen e jetës, Neni 13 kërkon, përveç pagimit të kompensimit, kur del e nevojshme, edhe një hetim tërësor dhe efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe dënimin e individëve që janë përgjegjës për privimin e jetës, duke përfshirë edhe aksesin efektiv për ankuesin në procedurat hetimore [...]"§123.

McFarlane kundër Irlandës [GC][294]: "Qëllimi i detyrimeve të Palës Kontraktuese, sipas Nenit 13, ndryshon në varësi të natyrës së ankesës. Megjithatë, mjeti juridik i kërkuar nga Neni 13 duhet të jetë "efektiv", si në praktikë dhe në ligj [...] Termi "efektiv" do të thotë që mjeti juridik duhet të jetë i përshtatshëm dhe i arritshëm [...] Për shembull, një mjet efektiv për vonesat në proceset penale duhet, *inter alia*, të veprojë pa vonesa të tejzgjatura dhe të ofrojë një nivel të përshtatshëm kompensimi [...] Neni 13 i lejon gjithashtu një shteti që të zgjedhë midis një mjeti juridik që mund të përshpejtojë proceset e mbajtura pezull, apo të ushtrojë një mjet juridik *post factum* për dëmshpërblimin për vonesën e krijuar. Ndërsa preferohet opsioni i parë për shkak të efektit parandalues ndaj vonesës, mjeti juridik kompensues mund të konsiderohet si efektiv sidomos kur proceset kanë qenë tejet të gjata dhe kur nuk ekziston një mjet parandalues [...]'§108.

293 Çështja nr. 27229/95, vendim i datës 3 prill 2001.
294 Çështja nr. 31333/06, vendim i datës 10 shtator 2010.

1.1.5. Kërkesat institucionale për mjete efektive juridike

Neni 13 parashikon të drejtën për zgjidhje efektive përpara një "autoriteti vendas". Edhe pse Gjykata Europiane ka konstatuar se autoriteti i përmendur në Nenin 13 nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një autoritet gjyqësor, ankesat ndaj një organi që nuk ka kompetencë të nxjerrë vendime ligjërisht të zbatueshme, në përgjithësi nuk përbëjnë mjet efektiv për qëllimet e Nenit 13. Për të përcaktuar nëse një organ është në gjendje të ofrojë një mjet efektiv juridik, duhet të merren parasysh faktet e çështjes, natyra e së drejtës në fjalë dhe kompetencat dhe garancitë e organit përkatës[295].

Praktika gjyqësore. *Ramirez Sanchez kundër Francës* [GC][296]: "Efektiviteti" i një "mjeti juridik" brenda kuptimit të Nenit 13 nuk varet nga sigurimi i një rezultati të favorshëm për ankuesin. As "autoriteti" i përmendur në këtë dispozitë nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një autoritet gjyqësor. Nëse nuk është autoritet gjyqësor, kompetencat dhe garancitë që jep janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse mjeti juridik që ushtrohet para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm nuk i përmbush tërësisht kërkesat e Nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parashikuara në ligjin e brendshëm mund të shërbejë për këtë qëllim. *Conseil d'Etat* e ndryshoi praktikën e vet më 30 korrik 2003, duke vendosur se kërkesa për shqyrtim gjyqësor mund të bëhej edhe në lidhje me vendimet që kishin të bënin me izolimin në burg dhe vendimet e prishura, nëse ishte e përshtatshme. Gjykata vëren se ankuesi ka bërë vetëm një kërkesë në Gjykatën Administrative që nga momenti i ndryshimit të praktikës gjyqësore. Megjithëse ai vetëm se kundërshtoi ligjshmërinë e masës së dhënë kundër tij më 17 shkurt 2005, Gjykata mendon se, duke pasur parasysh pasojat serioze që ka izolimi në kushtet e paraburgimit, ekzistenca e një mjeti juridik efektiv përpara një organi gjyqësor është thelbësore. Ndryshimi i sipërpërmendur në praktikën gjyqësore, i cili kërkon zbatimin nga një auditor më i gjerë, në asnjë rast nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk mund të ketë ndikim mbi pozicionin e ankuesit. Në përputhje me rrethanat, Gjykata është e mendimit se në këtë rast ka pasur shkelje të Nenit 13 të Konventës për shkak të mungesës së një mjeti juridik në të drejtën e brendshme, i cili do t'i lejonte ankuesit të kundërshtonte vendimet për zgjatjen e izolimit të shtrirë ndërmjet periudhës nga data 15 gusht 1994 dhe 17 tetor 2002." §§ 159, 164-166.

295 Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, libërth për të Drejtën Evropiane lidhur me aksesin në drejtësi, kreu 5, E drejta për mjete efektive ligjore (qershor 2016) 99.
296 Çështja nr. 59450/00, vendim i datës 4 korrik 2006.

B. Sistemi i brendshëm shqiptar mbi të drejtën për proces të rregullt brenda kohëzgjatjes së arsyeshme

1. Detyrimi për respektim të procesit të rregullt ligjor brenda kohëzgjatjes së arsyeshme

Standardi i një procesi gjyqësor të rregullt dhe publik brenda kohëzgjatjes së arsyeshme është i detyrueshëm për Shqipërinë si Palë e Lartë Kontraktuese, në bazë të Nenit 6 të Konventës dhe Nenit 42 të Kushtetutës së Shqipërisë.

***Neni 6 i Konventës**:*

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, ose të çdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj ..."

Në këtë parashikim, Neni 6 i Konventës nënkupton se i vendosPalët e Larta Kontraktuese para detyrimit për të garantuar standartin e kohëzgjatjes së arsyeshmeduke marë masa për: 1) identifikimin e tipeve të procedurave ligjore që i nënshtrohen kërkesës për kohëzgjatje të arsyeshme; dhe 2) identifikimin e periudhës përkatëse për vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve. Këto masa janë elementare në kuadër të sigurimit të mjeteve efektive ligjore vendase nga ana e shteteve anëtare duke synuar si përshpejtimin e procedurave ashtu dhe llogaritjen e duhur të masës së kompensimit.

Kushtetuta shqiptare është në pajtim me Konventën, duke përcaktuar të njëjtat standarde në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme (Neni 42), të drejtën e individëve për kompensim në rast se interesat e tyre legjitime pengohen nga një autoritet publik (Neni 44), kufijtë për kufizimet e të drejtave të individëve, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e Konventës (Neni 17), detyrimin e organeve shtetërore për respektimin e të drejtave dhe lirive individuale (Neni 15/2).

Neni 42 - Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 44 - Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Neni 17 - Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Neni 15/2 - Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

1.1. Llojet e proceseve objekt i kërkesës për kohëzgjatje të arsyeshme

Bazuar në Nenit 42 të Kushtetutës, rezulton se objekt i kërkesës për kohëzjatje të arsyeshme janë të gjitha ato lloje procecesh që sjellin si pasojë përcaktimin e kërkesave individuale për shkelje të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, që drejtohen para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj. Për rrjedhojë, këto procese mund të jenë penale, civile dhe administrative, në varësi të natyrës së kërkesave dhe llojit të gjykatës që ka juridiksion për të vendosur mbi to.

1.2. Vlerësimi i kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve (penale, civile, administrative)

a. Proceset penale

Standardi i Konventës për proceset penale imponon se periudha e vlerësimit të kohëzgjatjes duhet të fillojë ditën kur personi *"akuzohet"*dhe përfundon kur vendimi i formës së prerë të gjykatës është ekzekutuar plotësisht. Në varësi të specifikave të çështjes objekt shqyrtimi, periudha e përgjithshme e kohëzgjatjes së proceseve duhet si rregull të përfshijë procesin e ankimimit dhe atë të rekursit në gjykatat më të larta, duke përfshirë gjithashtu dhe ankimin kushtetues[297] dhe procedurën përmbarimore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kodi i Procedurës Penale (KPP) i Shqipërisë para amendimeve më të fundit të tij, nuk përmbante afate kohore konkrete për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Ai ishte formuluar në mënyrë të tillë që e bënte të vështirë për një qytetartë parashikojë se sa do të zgjasë gjykimi i një çështje penale, duke dështuar kështu në përmbushjen e kërkesës së *parashikueshmërisë*. Neni 342 i KPP-së parashikonte se gjykimet penale duhet të përfundojnë brenda një seance dhe, nëse është e pamundur, ato duhet të finalizohen gjatë ditës pasardhëse të punës. Gjykimet mund të shtyhen deri në pesëmbëdhjetë ditë vetëm për arsye të qenësishme. KPP-ja ofronte një kuadër kohor vetëm për disa hapa të ndërmjetëm proceduralë, si p.sh. afati i fundit për lëshimin e vendimit është 5 ditë (KPP, Neni 113).

[297] *Vetëm kur ka ndikim mbi anulimin e vendimit të gjykatës.*

Tabela e afateve ligjore që lidhen me vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve penale

Regjistrimi	Seanca paraprake	Seanca	Prezantimi paraprak	Vendimi	Apeli	Rekursi	Ekzekutimi
Neni 323- 3 muaj nga data e regjistrimit të hetimit penal (jo më shumë se 2 vjet)	Neni 338- përpjekje t për pajtim	Neni 342- Gjykim me një seancë Përfundimi ditën pasardhëse, për arsye të mira	Neni 378 – nuk ka afat kohor për kundërshtimin përfundimtar	Neni 263- nxjerrja e vendimit nga data e regjistrimit 2-12 muaj	Neni 263 - Data e vendimit deri në vendimin e Gjykatës së Apelit 2-9 muaj	Neni 435. Rekursi brenda 30 ditëve	Neni 462- zbatimi menjëherë pas dënimit merr formë të prerë
Neni 248 Vlerësimi i masave të sigurisë	Neni 263- ndalimi 3-12 muaj	Ndalimi 15 ditë		Neni 415- apel brenda 15 ditësh	Neni 426 masa për gjykim paraprak 10 ditë	Neni 263 –kthim për rishqyrtim 10 muaj deri në 3 vjet	Neni 482- regjistrimi në procesin penal

b. Proceset civile

Për proceset civile periudha e përgjithshme për vlerësimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore duhet të fillojë nga data e paraqitjes së padisë civile në gjykatë dhe duhet të përfundojë kur vendimi përfundimtar i gjykatës ekzekutohet në mënyrë efektive. Kodi i Procedurës Civile (KPC), përpara ndryshimeve[298] më të fundit, nuk përmbante kufizime kohore për zgjatjen e procesit gjyqësor. Përveç kësaj, KPC-ja nuk përcaktonte asnjë kohëzgjatje maksimale ndërmjet seancave dëgjimore. Në mënyrë të ngjashme me KPP, KPC-ja përdorte një kornizë kohore vetëm për disa hapa të ndërmjetëm proceduralë, p.sh. Neni 308 vendoste një afat prej 10 ditësh për nxjerrjen e vendimeve për çështjet civile.

Tabela e afateve ligjore që lidhen me vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve

Regjistrimi	Seanca paraprake	Seanca	Prezantimi paraprak	Vendimi	Apeli	Rekursi	Ekzekutimi
Neni 158- regjistrimi i padisë	158/a &b- masa paraprake dhe pajtimi – pa afat kohor	Nenet172- 178- Nuk parashikojnë ndonjë kohëzgjatje maksimale ndërmjet seancave.	Neni 302- 5 ditë	Neni 308 – 10 ditë dhe zgjatja 5 ditë	Neni 443 - 15 ditë Neni 472- 10 ditë njoftim të datës së procesit	Neni 443- 30 ditë	Neni 510- 515 Zbatimi fillon 15 ditë nga kërkesa e kreditorit

[298] *Ligji Nr.38/2017, për ndryshimin e Kodit të Procedurës Civile.*

Neni 155- njoftimi paraprak i padisë jo më pak se 10 ditë	Neni 445 apelet jo më vonë se 1 vit

c. Proceset administrative

Periudha e përgjithshme për kohëzgjatjen e proceseve administrative si rregull duhet të fillojë nga data kur kërkuesi e ka adresuar çështjen fillimisht para autoriteteve administrative dhe duhet të përfundojë kur vendimi i formës së prerë të gjykatës eshtë ekzekutuar efektivisht. Duhet nënvizuar se Gjykata ka pohuar se kohëzgjatja e proceseve administrative duhet të përfshijë procedurën paraprake administrative që është e detyrueshme vetëm nëse shterrimi i procedurës përpara një autoritet administrativ është parakusht për çeljen e proceseve gjyqësore (*König kundër Gjermanisë).*[299]

Sipas Ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative", në Nenin 16 parashikohet se: "Shterrimi i ankimit administrativ është kusht për çeljen e një padie për një veprim administrativ para gjykatave administrative."

Për rrjedhojë, kohëzgjatja e përgjithshme e proceseve administrative përfshin si procedurat administrative para një autoriteti administrativ, ashtu edhe proceset administrative para gjykatave administrative. Brënda kësaj periudhe, përfshihet gjithashtu shqyrtimi i apelit, rekursin në kolegjin administrativ të Gjykatës së lartë si dhe shqyrtimi i kërkesës kushtetuesedhe i processit përmbarimor për vënien në ekzekutim të vendimit përfundimtar.. Kjo është arsyeja pse shteti i paditur në një çështje administrative, është tipikisht përgjegjës jo vetm për autoritetet gjyqësore që kanë ndikuar në zvarritjen e proceseve gjyqësore, , por gjithashtu dhe për të gjitha institucionet publike që janë të implikuara gjatë procedurave administrative në shkeljen e Konventës.

[299] *Çështja nr.* 6232/73, vendim (themeli), datë 28 qershor 1978, *http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57511*

Tabela e afateve ligjore që lidhen me vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve

2 faza	Regjistrimi	Seanca paraprake	Seanca	Vendimi	Apeli	Rekursi	Ekzekutimi
Procedura administrative Kodi i ProcedurësAdministrative	Neni 134 Depozitimi i ankesës Neni 130- Përputhshmëria me aspektet procedurale	Neni 69 pajtimi Nuk parashikohen afate kohore	Neni 87 Vendimi mbi datën dhe afatet kohore të procesit	Neni 91-92 Afati kohor për procesin vendimmarrës është 60 ditë	-	-	Neni 182 Nuk parashikohet afat kohor për procedurat e ekzekutimit parashikohet e drejta e shtyrjes së ekzekutimit
Procedurat gjyqësore administrative	Neni 45 ditë për depozitimin e padisë	Neni 25 7 ditë për veprimet përgatitore	Neni 27 15 ditë për veprime përgatitore	Neni 42 shtyrja 5 ditë e dhënies së vendimit 15 ditë transferimi i dosjes	Neni 48 30 ditë gjykim në nivelin e apelit 15 ditë për depozitimin e kundër rekursit	Neni 60 10 ditë transferimi i padisë 90 ditë vendim në nivelin e Gjykatës së Lartë	Neni 66 Gjyqtari vendos për afatin kohor të ekzekutimit të detyrues hëm

1.3. Praktika Gjyqësore e GJEDNJ-së lidhur me Shqipërinë sa i takon kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore

Në thuajse të gjitha vendimet e GJEDNJ-së për Shqipërinë që kanë të bëjnë me kërkesa individuale për vonesa të pajustifikuara të proceseve gjyqsëore, shkeljet e gjetura i atribuohen gjykatave të brendshme. Në këtoraste, Gjykata ka thesuar se sistemi gjyqësor i brendshëm në Shqipëri ka nevojë për menaxhim më të mirë të proceseve gjyqësore dhe organizimin më të mirë të sistemit të brendshëm juridik duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Konventës si në ligj ashtu dhe në praktikë.

Shembull: në çështjen "Gjonbocari kundër Shqipërisë"[300], Gjykata argumenton se: "Për më tepër, duke pasur parasysh procedurat e shumta, Gjykata do të vlerësojë mënyrën e organizimit të secilit set të procedurave të ndërvarura me njëra tjetrën. Të tri setet e procedurave lidhen përkatësisht me çështjen e vlefshmërisë së titullit të ankuesve mbi pronën. Autoritetet ia dhanë këtë pronë fillimisht ankuesve, më pas A.L.-së nëpërmjet një kontrate qiraje dhe në fund nënës së A.L-së. Për më tepër, duket sikur inicimi i procedurave të ndara kishte për qëllim shmangien nga përfundimet e mëparshme të gjykatave. Gjykatat e brendshme ishin të vetëdijshme për proceset paralele, përderisa ato i referoheshin atyre shpesh herë. Ajo çfarë është më e rëndësishme është se do të kishte qenë ligjërisht korrekte nëse do të bashkoheshin të gjitha proceset. Gjykata vlerëson se një menaxhim më i mirë i të gjitha procedurave paralelisht të ndërlidhura mund të kishte kontribuar pozitivisht mbi përshpejtimin e zgjidhjes së titullit të pronësisë së ankuesve. Sipas Gjykatës për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave është e arsyeshme, duhet të merret parasysh ekzistenca e proceseve të mëparshme që ngrenë të njëjtat çështje ligjore.

Shembull. Në çështjen "*Marini kundër Shqipërisë,*"[301]*Gjykata argumenton se* "Sa i përket setit të dytë të procedurave, Gjykata vëren se çështja është kthyer disa herë për rishqyrtim. Ajo vë në dukje se në çështje të ngjashme, kur tejzgjatja e proceseve shkaktohet më së shumti për shkak të rishqyrtimit disa herë të së njëjtës çështje, është konstatuar se, përsëritja e urdhrave të tillë brenda të njëjtit set procedurash paralele nxjerr në pah një mangësi serioze në sistemin gjyqësor për shkak se kthimi për rigjykim ka ardhur si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta, (shih, *Wierciszewska kundër Polonisë*). Për rrjedhojë, Gjykata shprehet se dhënia e disa vendimeve kontradiktore në disa nivele tëjuridiksionit, autoritetet shqiptare dëshmojnë se ka mangësi të sistemit gjyqësor, çfarë i bë atopërgjegjëse". Në këtë çështje ankimi kishte të bënte me 5 sete të ndryshme procesesh gjyqësore civile, ndër të cilat u gjetën shkelje të standarteve në dy setet e para të procedurave pasi ishin zgjatur përkatësisht 7 dhe 9 vjet, duke çuar kështu në shkelje të Kushtetutës.

Shembull Në çështjen "*Mishgjoni kundër Shqipërisë*"[302]Gjykata thekson se "një punonjës i cili mendon se ai ose ajo është pezulluar ose shkarkuar nga punëdhënësi i tij ose saj, ka interes të madh vetjak për të siguruar dhënien e menjëhershme të një vendim gjyqësor për ligjshmërinë e kësaj mase. Kjo pasi mosmarrëveshjet e punës, për nga vetë natyra e tyre diktojnë marrjen e një vendimi të shpejtë, duke pasur parasysh atë çfarë riskohet për personin në fjalë, i cili përmes shkarkimit, humb mjetet e jetesës (shih *Frydlender kundër Francës*). Për më tepër, Gjykata rikujton se u takon shteteve kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin kërkesat e Nenit 6 të Konventës, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme (shih *Makarova kundër Rusisë*). Gjykata shprehet se vonesa e përgjithshme prej gati katër vjetësh nga KLD-ja për ta rishqyrtuar çështjen e ankuesit nuk është e justifikuar dhe nuk përmbush kërkesat e "kohëzgjatjes së arsyeshme" sipas Konventës". Në këtë çështje, Gjykata

[300]*Çështja nr.10508/02, GJEDNJ,* vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), *datë*23 tetor 2007,*http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-82863*,

[301]*Çështja nr. 3738/02, GJEDNJ,* vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), 18 dhjetor 2007, *http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-84061*,

[302]*Çështja nr.18381/05, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*7 dhjetor 2010, ***http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-102133*,**

konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 6 dhe 13 të Konventës lidhur me kohëzgjatjen e proceseve administrative dhe gjyqësore dhe mungesën e mjeteve efektive.

Shembull. Në çështjen "Kaçiu and Kotori kundër Shqipërisë"[303] (çështje penale) Gjykata u shpreh se: "Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar edhe në një çështje të mëparshme kundër shtetit të paditur, është kthimi i shpeshtë i çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta te gjykatat më të ulëta (shih *Marini kundër Shqipërisë*). Gjykata vëren, në veçanti, se pasi çështja u dëgjua nga Gjykata e Lartë më 15 janar 2003, ajo u kthye për rigjykim në gjykatën e rrethit. Në proceset e reja gjykata nuk u pajtua me udhëzimet e bëra në vendimin e Gjykatës së Lartë çfarë çoi në inicimin e një procesi tjetër, i cili zgjati përafërsisht dy vjet deri në dhënien e vendimit të Gjykatës së Apelit, datë 15 tetor 2004, që ruante në fuqi dënimet e ankuesve. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të vendit. Në *këtë* rast procesi penal zgjati 6 vjet dhe 11 muaj, zgjatje e cila çoi në një shkelje që i atribuohet gjykatave të brendshme.

Shembull: Në çështjen "*Topallaj kundër Shqipërisë*"[304]**,** Gjykata argumentoi se: "Çështja është shqyrtuar në tri sete procedurash paralele. Ajo thekson se është me rëndësi jetike që gjykatat e brendshme të jenë garantuesi përfundimtar i sundimit të ligjit. Megjithatë, sa i takon rastit në fjalë, gjykatat e brendshme kanë kontribuar për tejzgjatjen e proceseve duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në mënyrë të përsëritur tek gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, e drejta për shqyrtimin e një çështjeje brenda një kohe të arsyeshme do të ishte pa kuptim nëse gjykatat e brendshme do ta shqyrtonin disa herë të njëjtën çështje, duke e kaluar çështjen për gjykim nga një gjykatë në tjetrën, edhe pse në fund kohëzgjatja e proceseve në secilën shkallë nuk ka qënë e tejkaluar. Gjykata rithekson se është përgjegjësi e shtetit të paditur që të organizojë sistemin juridik vendasnë mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin kërkesat e Nenit 6 të Konventës, përfshirë edhe detyrimin për gjykimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme. Duke pasur parasysh se kthimi i çështjes për rishqyrtim shpesh urdhërohet si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, përsëritja e rigjykimeve nxjerr në pah një mangësi në sistemin gjyqësor. Mangësi e cila, e vetme, e ka penguar ankuesin nga gjykimi i "të drejtave dhe detyrimeve civile", siç është rasti i çështjes nën shqyrtim, brenda një kohe të arsyeshme. Në çështjen "*Topallaj kundër Shqipërisë*", çështja kishte të bënte me një proces gjyqësor civil që zgjati 9 vjet, çfarë rezultoi në shkelje të Konventës.

Shembull: në çështjen "*Luli & të tjerët kundër Shqipërisë*"[305]**,** Gjykata kritikoi në veçanti dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhet hapjen e disa proceseve gjyqësore paralele para gjykatave të ndryshme për të njëjtën çështje dhe kthimin e përsëritur për rigjykim të një çështjeje në një nivel më të ulët juridiksioni (shkelje e Nenit 6§1). Gjykata vuri në dukje se tejzgjatja e procedurave gjyqësore po kthehej në një mangësi serioze në proceset e brendshme gjyqësore në Shqipëri dhe se

[303] *Çështja nr.33192/07 33194/07, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*25 qershor 2013, *http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-121770*,

[304] *Çështja nr.32913/03, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*21 prill 2016, *http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-162114*,

[305] *Çështja nr. 64480/09 64482/09 12874/10, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*1 prill 2014, *http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-142305*,

padyshim nevojiteshin masa të përgjithshme në nivel vendas për ekzekutimin e vendimit, në veçanti për krijimin e një mjeti juridik të brendshëm për sa i përket tejzgjatjes së pajustifikuar të proceseve.

1.4. Tejzgjatja e proceseve gjyqësore e shkaktuar nga mosekzekutimi i vendimeve përfundimtare gjyqësore ose quasi gjyqësore

Shembull. në çështjen *"Qufaj kundër Shqipërisë"*[306] **,** Gjykata përsëriti se "Neni 6§1 i siguron çdokujt të drejtën për të depozituar një kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile para një gjykate, ose tribunali; në këtë mënyrë Neni 6 mishëron "të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës", nga e cila rrjedh e drejta për akses në gjykatë, e cila përbën vetëm një aspekt të Nenit 6 §1, që është e drejta për të filluar procese para gjykatave në çështjet civile. Sidoqoftë, kjo e drejtë do të mbetej iluzive nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti Kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i detyrueshëm të mbetej i pazbatueshëm në dëm të njërës palë. Do të ishte e pakonceptueshme që Neni 6§1 të përshkruante në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve ndërgjyqëse, procese të cilat në parim janë të drejta, publike dhe të shpejta, pa marë në mbrojtje ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Duke e interpretuar Nenin 6 se mjaftohet vetëm në mbrojtjen e të drejtës për të pasur akses në gjykatë dhe në realizimin e procedurave të gjykimit, do mund të çonte në situata të papajtueshme me parimin e sundimit të ligjit, të cilin çdo Shtet Kontraktues është angazhuar ta respektojë që në momentin e ratifikimit të Konventës. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhet për rrjedhojë të konsiderohet si pjesë përbërëse e "gjykimit" për qëllimet e Nenit 6. "

Shembull. Në çështjen *"Driza kundër Shqipërisë"*[307] Gjykata argumentoi se: "i njëjtin vendim u anulua për herë të dytë përmes një vendimi të marrë në një set procedurash paralele. Gjykata rikujton se, në bazë të Nenit 1, përgjegjësia parësore për zbatimin dhe vënien në jetë të të drejtave dhe lirive të garantuara në Konventë u takon autoriteteve vendase (shih *Kudła kundër Polonisë*). Lidhur me këtë, është përgjegjësia e shtetit që ta organizojë sistemin e vet ligjor në mënyrë të tillë që të identifikojë proceset e ndërlidhura dhe, aty ku është e nevojshme, t'i bashkojë ato, ose të ndalojë çeljen e mëtejshme të proceseve të reja lidhur me të njëjtën çështje, me qëllim që të anashkalojë rishikimin e vendimeve përfundimtare çfarë përbën një apelim artificialisht të panevojshëm, në kuadër të seteve të procedurave paralele (shih *Roşca kundër Moldavisë*)."

Shembull. Në çështjen *"Rramadhi kundër Shqipërisë"*[308]Gjykata vuri në dukje se "pavarësisht nëse vendimi përfundimtar që do të ekzekutohet ka formën e një vendimi gjyqësor, ose të një vendimi të dhënë nga një autoritet administrativ, ligji i brendshëm si dhe Konventa parashikon që ai duhet të zbatohet. Kishte rezultuar se për ekzekutimin e vendimeve të Komisionit në favor të ankuesve nuk ishte ndërmarë asnjë masë . Gjykata vëren se si ligjet e pronësisë, ose ndonjë parashikim tjetër ligjor që lidhej

[306] *Çështja nr.54268/00, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*18 nëntor 2004, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-67514

[307] *Çështja nr. 33771/02, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*13 nëntor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-83245

[308] *Çështja nr.38222/02, vendim i GJEDNJ-së (themel dhe kompensimi i drejtë), datë*2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-83249

me situatën nuk rregullonte në mënyrë eksplicite ekzekutimin e vendimeve të Komisioneve. Në veçanti, ligjet e pronësisë nuk parashikojnë asnjë afat ligjor për apelimin e vendimeve të tilla para gjykatave të brendshme, as edhe ndonjë mjet ligjor të veçantë për zbatimin e tyre. Gjykata vëren më tej se ligjet e pronës ia lënë përcaktimin e formës dhe mënyrës së kompensimit Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë rregullat dhe metodat e detajuara për një kompensim të tillë. Deri tani nuk janë miratuar masa të tilla dhe Qeveria nuk ka ofruar shpjegime për këtë. Thjesht angazhimi i autoriteteve për kthimin e pronës dhe pagesën e kompensimit të duhur siç u justifikua Qeveria, , nuk ka dhënë ndonjë rezultat për ekzekutimin e vendimeve në favor të ankuesve, të cilat vazhdojnë dhe tani të mbeten të paekzekutuarapërkatësisht për 12 dhe 11 vjet. "

Nëse vështrojmë praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për tejzgjatje të procedurave, mund të kuptojmë më tepër mbi natyrën e vonesave të hasura gjatë proceseve në fushën penale, civile dhe administrative.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtuese (GjK) në çështjet civile:

Në vendimin Nr. 12/2012[309] – GjK-ja konstatoi nga dosja se rezultonte se deri në datën e shqyrtimit të kësaj kërkese në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar gjithsej 36 seanca gjyqësore, ku periudha kohore nga një seancë në tjetrën është haptazi në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor brenda kohës së arsyeshme (shih sesionet e mëposhtme të datave 30.01.2007, 14.03.2007, 27.04.2007, 01.06.2007), praktikë e cila në vlerësimin e Gjykatës është e bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim dhe dispozitat ligjore të Nenit 327 të KKK-së. Gjykata Kushtetuese konstaton se seancat janë shtyrë për shkak të paraqitjes së raportit mjekësor nga gjyqtari, mungesës së njoftimit të palëve për t'u paraqitur në gjykatë, njoftimit të palëve në mungesë, dhënies së kohës për palët për t'u njohur me aktet e çështjes, mungesës së paraqitjes së ekspertit dhe, në disa raste, nuk jepej asnjë shkak për shtyrjen e seancës.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtuese (GjK) në çështjet penale:

Në vendimin Nr. 47/2011 - GjK-ja konstaton se një numër i madh seancash janë shtyrë për arsye që i atribuohen autoritetit procedues (gjykatës dhe prokurorisë sëbashku). Duke iu referuar procesverbalit të seancave në dosjen e gjykatës, vihet re se vonesa është shkaktuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve për arsye objektive, midis të cilave renditen raportet shëndetësore, ose marrja e kohës për t'u njohur me çështjen. Po ashtu, seancat gjyqësore janë shtyrë edhe për shkak të mungesës së prokurorëve për arsye që lidhen kryesisht me zëvendësimin e tyre, ose marrjen e kohës për t'u njohur me çështjen. Përveç mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, seancat janë shtyrë edhe për shkak të mungesës së një sekretari të gjykatës. Në këto kushte, Gjykata thekson se sjellja e organit procedural në tërësi ka shkaktuar vonesa në gjykim ... sjellja e ankuesit është marrë parasysh dhe vlerësuar nga Gjykata në kompleksitetin e kritereve të tjera të vendosura nga GJEDNJ-ja. Nga procesverbalet e seancave gjyqësore vërehet se mungesa e avokatit mbrojtës të kërkuesit, ose mbrojtësit e të bashkëpandehurve të tjerë, kryesisht me motivimin e pjesëmarrjes në gjykata të tjera,

[309] *Shih po ashtu vendimin e GjK-së Nr.12/2013; Vendimi Nr. 35/2013.*

shpesh kanë qenë shkaku i shtyrjes së seancave dëgjimore. Në disa raste seancat janë shtyrë për shkak se mbrojtja nuk ka ofruar dëshmi me shkrim, ose dëshmia nuk është raportuar zyrtarisht, duke qenë kështu e parregullt. Gjykata konstaton në rastin në fjalë se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nuk ka treguar pasivitet në rastet e mungesës së të pandehurve, por ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën e Avokatëve për të ndërmarrë masa disiplinore kundër avokatëve.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në çështjet administrative:

Në Vendimin 42/2017[310] - GjK-ja theksoi se arsyetimi se numri i lartë i çështjeve në këto gjykata përbën shkakun evonesës për shqyrtimin e çështjes është i pabazuar. Tejngarkesa me punë e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë dështimin e tyre për të vepruar brenda afatit të caktuar nga ligjvënësi. Përkundrazi, është detyrë e këtyre të fundit që të marrin masat dhe të gjejnë mjetet për të ndryshuar gjendjen faktike (vonesat në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë) në mënyrë që të sigurojnë zbatimin e ligjit dhe funksionimin normal të të gjitha gjykatave në të gjitha nivelet (shih Vendimet Nr. 69, datë 17.11.2015, Nr. 59, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, pretendimi i palës së interesuar se vonesa në gjykimin e çështjes ka ardhur për shkak të numrit të madh të çështjeve të prapambetura të gjykatës është i pabazuar.

- **Rast studimor "Hozee k. Holandës"[311]**

Çështja u depozitua në Gjykatën e Holandës nga një shtetas, Z. Wilhelmus Hozee, më 14 gusht 1997, duke u bazuar në Nenin 6 § 1 të Konventës për t'u ankuar për tejzgjatjen e proceseve penale në ngarkim të tij.

Faktet: Ankuesi ishte drejtori menaxhues i agjencive të pastrimit. Autoritetet tatimore të Holandës në periudhën 1981-1984 inspektuan llogaritë e agjencive kërkuese dhe lëshuan më 31 dhjetor 1981 një tatim shtesë për to me anë të gjobës fiskale. Pas ankimit mbi tatimet suplementare nga agjencitë, në maj 1984, Sektori i Auditimit i Departamentit të Tatimit të Drejtpërdrejtë të Hagës i dorëzoi hetimin kundër agjencive të ankuesit Departamentit të Inteligjencës dhe Hetimeve Fiskale (DIHF). Në kuadër të hetimit, ankuesi ishte marrë në pyetje si i dyshuar më 14 qershor 1984. Në të njëjtin muaj, DIHF-ja i konfiskoi llogaritë e ankuesit për qëllime të hetimit. Më 8 maj 1985, ankuesi u arrestua se dyshohej për mashtrim, duke u ndaluar në paraburgim, dhe më tej u lirua me kusht më 17 qershor 1985. Më 10 maj 1985 u hap hetimi paraprak gjyqësor kundër ankuesit, gjatë së cilit gjyqtari hetues e dëgjoi ankuesin në katër raste. Gjyqtari hetues shqyrtoi më tej njëzet e pesë dëshmitarë dhe tre ekspertë, shumica e të cilëve me kërkesë të ankuesit. Hetimi paraprak gjyqësor u mbyll në janar të vitit 1989. Në një fazë të mëvonshme, ankuesi u thirr për të dalë përpara Gjykatës Rajonale të Hagës më 13 prill 1989 nën pesë akuza për mashtrim dhe një akuzë për pjesëmarrje në një organizatë kriminale.

[310] *Shih po ashtu vendimin e GjK-së Nr.14/2016; Vendimi Nr.22/2017; Vendimin Nr. 59/2016; Vendimin Nr. 26/2017, Vendimin Nr. 230/; Vendimin Nr. 32/2017.*

[311] Çështja Nr.21961/93, Vendim, (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 22 qershor 1998, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58170

Objekti i ankimit: Ankuesi i kundërshtoi (bezwaar) akuzat dhe, më 10 gusht 1989, Gjykata Rajonale e liroi atë nga akuza për pjesëmarrje në një organizatë kriminale, por e dënoi për pesë akuzat për mashtrim. Si rezultat, Gjykata e dënoi ankuesin me njëzet e katër muaj heqje lirie, gjashtë muaj nga të cilat u pezulluan si periudhë prove prej dy vjetësh, dhe me një gjobë prej 500,000 NLG. Koha që ankuesi kishte kaluar në paraburgim u zbrit nga dënimi me burg. Si ankuesi edhe prokurori publik e ankimuan këtë vendim në Gjykatën e Apelit të Hagës. Më 11 korrik 1991 Gjykata e Apelit e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rajonit, duke e dënuarankuesin vetëm për tre akuza për mashtrim dhe duke e deklaruar atë të pafajshëm për dy akuzat e tjera për mashtrim. Duke marrë parasysh një dënim tjetër që kishte ndodhur ndërkohë, siç kërkohet nga Neni 63 i Kodit Penal (Wetboek van Strafrecht - shih paragrafin 26 më poshtë), Gjykata e ka dënuar ankuesin me gjashtë muaj heqje lirie, tre muaj prej të cilave u pezulluan si periudhë prove prej 2 muajsh si dhe gjobë prej 25,000 NLG. Ankimi pasues i ankuesit për bazën ligjore u kundërshtua nga Gjykata e Lartë (Hoge Raad) më 1 dhjetor 1992.

Lista e pyetjeve:

- Diskutoni pretendimet e ankuesit për shkelje të së drejtës për përcaktimin e akuzave brenda një kohe të arsyeshme dhe çfarë vendimi duhet të marrë GJEDNJ-ja në lidhje me këtë pretendim.
- Si do ta vlerësonit në këtë çështje periudhën e përgjithshme për shqyrtimin e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme (Neni 6.1 i Konventës)?

1.5. Natyra e vonesave të proceseve gjyqësore sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dallon tri lloje arsyesh që qëndrojnë në themel të vonesave të proceseve gjyqësore: (1) arsyet jashtë sistemeve ligjore dhe gjyqësore; (2) arsye që janë të përbashkëta për të gjitha llojet e proceseve; (3) arsyet që zbatohen për një kategori të caktuar procesesh.

I. Shembull i vonesave jashtë sistemeve ligjore dhe gjyqësore:
(1) Në çështjen *Süssmann k. Gjermanisë*[312] vonesat ishin shkaktuar si rezultat i ngjarjeve të mëdha politike;
(2) në vendimin *Zouhar k. Republikës Çeke*[313], datë 11 tetor 2005, vonesat ishin shkaktuar për shkak të kalimit nga ekonomia e planifikuar në ekonominë e tregut;

II. Shembuj të arsyeve që janë të përbashkëta për të gjitha llojet e proceseve:

(1) në çështjen Union Alimentaria Sanders SA k. Spanjës[314]vonesat ishin shkaktuar për shkak të problemeve gjeografike.
(2) në çështjen Nankov k. Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë[315], vonesat ishin shkaktuar për shkak të transferimeve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe moszëvendësimit të gjyqtarëve të transferuar, ose të padisponueshëm;
(4) në çështjen Piron k. Francës[316], vonesat ishin shkaktuar si rezultat i pasivitetit të autoriteteve gjyqësore;
(6) në çështjen Roubies k. Greqisë[317]vonesat ishin shkaktuar nga mosmarrja në pyetje e palëve, dëshmitarëve, ose të pandehurve, ose nga marrja e paligjshme në pyetje
(7) në çështjen Martins Moreira k. Portugalisë[318], vonesa ishte shkaktuar për shkak tëmosdërgimit në kohëtë dosjes nga gjykata më e ulët në gjykatën e apelit, ose vonesa në ofrimin e provave.
III. Shembuj të arsyeve që aplikohen për një kategori të ndryshme procesesh:

(a) *në çështjen Martins Moreira k. Portugalisë*[319], vonesat ishin shkaktuar për shkak të problemeve lidhur me ekspertë dëshmitarë (*vonesat për caktimin e ekspertëve për shkak të inercisë gjyqësore, dështimin e ekspertëve për të respektuar mandatin e tyre, zgjatja e kohës për ta në shkallë të ekzagjeruar, dështimi për të penalizuar ekspertët për mungesë vuneti të drejtë, vështirësi për marrjen e raporteve mjekësore, etj.*).
(b) në çështjen Vaz Da Silva Girao k. Portugalisë shtyrjet e shpeshta të seancave, qoftë me vendimin e gjykatës, qoftë me kërkesë të palëve, dhe intervalet e gjata nga një seancë në tjetrën kishin shkaktuar vonesa.

[312] Çështja Nr.20024/92, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë16 shtator 1996, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57999
[313] Çështja Nr.8768/03, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë11 tetor 2005, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-70565
[314] Çështja Nr.11681/85, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datëo7 korrik 989, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57618
[315] Çështja Nr. 26541/02, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë29 nëntor 2007, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-83627
[316] Çështja Nr.36436/97, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë14 nëntor 2000, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58984
[317] Çështja Nr.22525/07, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë30 prill 2009, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-92529
[318] Çështja Nr.11371/85, Vendim (themel dhe kompensimi i drejtë), datë26 tetor 1988, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57535
[319]Po aty.

(c) në çështjen Buchholz k. Gjermanisë[320] vonesa ishte shkaktuar nga kalimi i një kohe të gjatë nga marrja e vendimit deri tek njoftimi i tij tek sekretaria gjyqësore, ose palët.

1.6. Standardet e fazave procedurale dhe periudha e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

Gjykata ka përcaktuar se standardi për kohëzgjatjen e një seti procedurash duhet të jetë më pak se 2 vjet, në mënyrë që kohëzgjatja të konsiderohet e arsyeshme.[321]

Shembull: në vendimin e çështjes *"Dostal k. Republikës Çeke"*[322]**,** Gjykata vuri në dukje sa i përket procedurës së themelit të çështjes, se nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga gjykata e rrethit që nga pranimi i raportit të ekspertit më 31 tetor 2001 deri në miratimin e vendimit datë 17 shtator 2003, megjithëse nga data 20 gusht 2002, gjykata kishte pasur prova të mjaftueshme për të vendosur mbi themelin. Po ashtu, as procedura pas vendimit datë 17 shtator 2003, nuk ka vazhduar me ritëm të qëndrueshëm, veçanërisht për shkak të nevojës për të korrigjuar gabimet në vendimin e gjykatës, gjë e cila çoi në transferimin e dosjeve disa herë.

Ndërsa në vlerësimin e pretendimeve për tejzgjatje të pajustifikuar të proceseve gjyqësore duhet të merren parasysh: (1) gjykimi i një të drejtë duhet të ezaurojë të gjitha nivelet e juridiksionit; (2) duhet të vlerësohet me vendim të gjykatës mbi praninë e një detyrimi; dhe (3) duhet të vlerësohet me vendimtë gjykatës mbi shumën që i detyrohet. Detyrimi i shtetit të paditur në këtët rast lind duke ndjekur qëllimin e Nenit 6.1 të Konventës, sipas të cilit: "një e drejtë civile nuk quhet se është zgjidhur përfundimisht, sa kohë që nuk është përcaktuarshuma për të cilën detyrohet pala e paditur."[323]Periudha e tejzgjatjes së procedurave përfshin gjykimin nga Gjykata Kushtetuese,[324] si dhe kohën që kërkohet për çdo procedurë përmbarimore.[325]

Shembull: në çështjen *"Kaçiu & Kotorri"*,[326]problemi kryesor ishte kthimi i shpeshtë i çështjeve për rishqyrtim nga gjykatat më të larta në gjykatat më të ulëta. Gjykata vuri në dukje në veçanti se, pas shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë më 15 janar 2003, çështja u dërgua për rigjykim nga e para në Gjykatën e Rrethit. Në proceset e reja, gjykata nuk u pajtua me udhëzimet e Gjykatës së Lartë dhe mospajtimi çoi në një tjetër proces që zgjati përafërsisht dy vjet deri në pranimin e vendimit nga Gjykata e Apelit, më 15 tetor 2004, i cili mbështeste dënimet e ankuesve. Gjykata shprehet se vonesa pas vendimit të Gjykatës së Lartë i atribuohet tërësisht gjykatave të brendshme. Në përgjithësi, proceset filluan më 18 prill 2000, kohë kur u arrestuan ankuesit, dhe

[320]Çështja Nr.7759/77, Vendim (themeli), datë 06 maj 1981,http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57451

[321]Nëse për më shumë se dy vjet nuk gjendet shkelje, sjellja e ankuesit. Në 12 nga 23 çështje komplekse, nuk u gjet shkelje e ndonjë të drejte; bëhet fjalë për sjelljen e ankuesit.

[322] Çështja Nr.26739/04, Vendim (themeli), datë 21 shkurt 2006, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72507

[323] Çështja Pudas k. SuesdisëNr. 10426/83, Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 27 tetor 1987.

[324]Çështja Deumeland k. Gjermanisë , Nr. 9384/81, Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 20 maj 1986.

[325]Çështja Hornsby k. Greqisë, Nr. 18357/91, Vendim (themeli), datë 19/03/1997.

[326]Shih shënimin 7.

përfunduan më 6 shkurt 2007 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pra, proceset gjyqësore zgjatën rreth 6 vjet dhe 11 muaj.

Shembuj të afateve kohore optimale sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së:

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ku kohëzgjatja e përgjithshme e proceseve është konstatuar e arsyeshme					
Lloji i proceseve	**Praktika gjyqësore**	**Shkalla e 1të**	**Apeli**	**Kasacioni**	**Totali**
çështje të thjeshta civile (mosmarrëveshje mbi bashkëpronësinë)	*Lemoine k. Francës[327] vendim, datë 29 prill 2003*	1 vit e 10 muaj	1 vit dhe 8 muaj	1 vit dhe 9 muaj	5 vjet dhe 5 muaj
çështje të thjeshta penale (mashtrim bankar)	*Guichon k. Francës[328] vendim, datë 21 mars 2000*	1 vit e 7 muaj	1 vjet dhe 9 muaj	1 vit dhe 9 muaj	*5 vjet dhe 1 muaj*
çështje komplekse (mashtrim dhe konspiracion)	*Hozee k. Holandës[329] vendim, datë 22 maj 1998*	Hetime paraprake prej 4 vjetësh dhe 7 muajsh	3 vjet dhe 10 muaj	3 years and 10 months	*8 vjet dhe 5 muaj*

Lista e pyetjeve:

- Çfarë kriteresh duhet të ketë parasysh një gjyqtar për vlerësimin e periudhës së përgjithshme të procesit penal? (*shih vendimin e GJEDNJ-së për çështjen Kaciu dhe Kotorri, Vendimin Nr. 12/2011 të Gjykatës Kushtetuese në çështjen Adriana Koliqi*);
- Çfarë kriteresh duhet të ketë parasysh një gjyqtar gjatë vlerësimit të periudhës së përgjithshme të proceseve civile? (*shih Marini kundër Shqipërisë*);
- Çfarë kriteresh duhet të ketë parasysh një gjyqtar për vlerësimin e periudhës së përgjithshme të proceseve administrative? (*shih X kundër Francës, Kress kundër Francës*);
- Cili është standardi i Konventës për kohëzgjatjen e arsyeshme të fazën procedurale (në nivelin e shkallës së parë, në apel, në nivel rekursi) - Diskutoni vendimin e çështjes *Hozee kundër Holandës*, datë 22 maj 1998;
- Çfarë faktorësh ndikojnë nëkohëzgjatjen e arsyeshme në fazën procedurale? Diskutoni gjetjen e GJEDNJ-së në çështjen *Kaçiu dhe Kotorri;* për shkak të rikthimit për rigjykim të çështjes, si rezultat i gabimeve të ligjit nga gjykatat më të ulëta, procesi u zgjat nga 15 janari 2003 deri më 15 tetor 2004? A është kohëzgjatja prej 1 viti dhe 10 muajsh në këtë set procedurash e tejkaluarnë vështrim tëstandardeve të vendosura nga Konventa? Si ndikon kjo në periudhën e përgjithshme të procedurave që zgjatën për afro 6 vjet dhe 11 muaj?

[327] Çështja Nr.26242/95, Vendim (mungesë juridiksioni), datë 01prill 1999;
[328] Çështja Nr.40491/98, Vendim (themeli), datë 21 mars 2000;
[329] Çështja Nr.21961/93, Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 22 maj 1998;

Rekomandohet për tu lexuar:

- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*"[330]
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Marini k. Shqipërisë*";
- Vendimi Nr. 12/2011 i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e Adriana Koliqit;
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*X k. Francës*"[331];
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Kress k. Francës*"[332];
- Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen "*Hozee k. Holandës*"[333];

[330] *Shih shënimin 7.*
[331] *Çështja Nr.18020/91, Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 31 mars 1992, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57801*
[332] *Çështja Nr.39594/98, Vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 07 qershor 2001, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-59511*
[333] *Shih shënimin 30.*

2. Mjetet efektive për tejzgjatjen e pajustifikuar të procedurave në sistemin e brendshëm shqiptar

Dështimi i gjykatave të brendshme për të garantuar realizimin e procedurave brenda kohës së arsyeshme çon jo vetëm në shkeljen e Nenit 6 të Konventës, por mund të çojë edhe në shkelje të Nenit 13 të Konventës, nëse sistemi i brendshëm nuk ofron mjete juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte. Më parë se Kodi i Procedurës Civile ti nënshtrohej ndryshimeve më të fundit, sistemi i brendshëm shqiptar nuk garantonte mjete specifike ligjore nëpërmjet të cilave individët të mund të kërkonin zgjidhjen e pretendimeve për tejzgjatje të pajustifikuar të proceseve gjyqësore.Mjetet ligjore në fuqi u konsideruan si të pamjaftueshme për të ofruar sigurinë e duhur, si nga pikëpamja e teorisë ashtu edhe praktikës.

Shembull: në Vendimin Nr. 47/2011, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë theksoi se "pavarësisht vonesave që i atribuohen organit hetues, për shkak të arsyeve objektive, pasi sistemi ligjor lejon rikthimin e çështjes në disa procese, ajo është e mendimit se zgjatja e procesit nuk është e justifikuar. Edhe pse munqon një mjet i posaçëm për kompensimin e dëmit që vjen si rezultat i shkeljes së standardit kushtetues për qiykim brenda një kohe të arsyeshme, qiykata nënvizon se është detyrë e autoriteteve kompetente, përfshirë edhe Prokurorinë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të parashikojnë masa që mund të qarantojnë administrimin e duhur të proceseve gjyqësore dhe të shmangin vonesat e pajustifikuara".

Shembull: në Vendimin Nr. 12/2012 Gjykata Kushtetuese rikujtoi se Neni 13 i KEDNj-së ofron një alternativë: sipas tij një mjet është "efektiv" nëse mund të përdoret ose mund të përshpejtojë dhënien e një vendimi nga një gjykatë ose tribunal për të gjykuar një çështje, ose për t'iu siguruar palëve ndërgjyqëse mjete të përshtatshme për vonesat që kanë ndodhur tashmë. Megjithatë, GJEDNJ-ja thekson se, zgjidhja më e mirë është padyshim parandalimi. Kur një sistem gjyqësor ka mangësi sa i përket kërkesës së Nenit 6/1 të Konventës lidhur me kohën e arsyeshme, zgjidhja më efektive është një mjet i projektuar për të përshpejtuar procesin, në mënyrë që të parandalohet tejzgjatja e këtij procesi. Ky lloj mjeti siguron një avantazh të padiskutueshëm krahasuar me një mjet që vetëm siguron kompensim, duke vlerësuar se një mjet i tillë kontribuon edhe në parandalimin e shkeljeve të mëvonshme të proceseve me natyrë të ngjashme dhe nuk mjaftohet vetëm me ndreqjen e një shkeljeje *a posteriori*, siç bën kompensimi. Disa vende kanë zgjedhur një kombinim të të dyja llojeve të këtyre mjeteve, njëri i projektuar për të përshpejtuar procesin, ndërsa tjetri për të siguruar kompensim. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i brendshëm nuk parashikon ndonjë mjet juridik të posaçëm që mund të përdoret nga ankimuesi për të kërkuar korrigjimin e tejzgjatjes së pajustifikuar të gjykimit.

Në lidhje me këtë, Kushtetuta e Shqipërisë parashikon në Nenin 131/f të saj të drejtën individuale të shtetasve për të kërkuar shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për proces të rregullt, pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Prandaj teorikisht, individët mund t'i drejtohen kësaj gjykate në bazë të Nenit 131/f dhe 42 të Kushtetutës për çdo shkelje në lidhje me standardin e gjykimit të drejtë. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk është konsideruar si mjet efektiv juridik në përputhje me Nenin 13 të Konventës.

Shembull: në çështjen "*Marini k. Shqipërisë*"*(2007)*,[334]Gjykata ritheksoi se Neni 13 ofron një alternativë: një mjet është "efektiv" nëse mund të përdoret ose mund të përshpejtojë dhënien e një vendimi nga një gjykatë ose tribunal për të gjykuar një

[334] *Shih shënimin 5.*

çështje, ose u jep palëve ndërgjyqëse mjete të përshtatshme për vonesat që kanë ndodhur tashmë (po aty., § 159). Gjykata vëren se përveç kërkesës kushtetuese, sistemi ligjor shqiptar nuk parashikon ndonjë mjet specifik të ngjashëm me mjetet e përmendura nga Gjykata në çështjen "*Kudła kundër Polonisë*"[335], të cilin ankuesi mund ta ushtronte për të përftuar adresim të pretendimeve për tejzgjatje të proceseve gjyqësore. Qeveria iu referua të drejtës për kërkesë individuale kushtetuese sipas Nenit 131 të Kushtetutës, e cila i lejon individët të parashtrojnë një ankesë në Gjykatën Kushtetuese nëse dhe kur pretendojnë shkelje të Nenit 6 të Konventës. Një ankesë e tillë shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese vetëm pas shterimit të mjeteve juridike në gjykatat më të ulëta, pavarësisht vonesave të mëtejshme që mund të shkaktojë kjo. Gjykata vëren më tej se, edhe po të supozojmë se në teori Gjykata Kushtetuese mund të ofrojë një dëmshpërblim të përshtatshëm për sa i takon ankesave për tejzgjatje të proceseve gjyqësore, Qeveria nuk arriti të provojë asnjë rast ku Gjykata Kushtetuese kishte vendosur për një ankesë lidhur me tejzgjatjen e pajustifikuar të procedurave.Në vështrim të sa më sipër, Gjykata është e mendimit se nuk ka prova që dëshmojnë se një ankesë e bërë sipas Nenit 131 të Kushtetutës mund të konsiderohet, me një nivel të mjaftueshme sigurie, si mjet efektiv për pretendimet e ankuesit lidhur me tekzgjatjen e pajustifikuar të procedurave.

- **Rasti studimor "Scordino k. Italisë"**

Ankuesi depozitoi një kërkesë para GJEDNJ-së për shkelje të Nenit 6 (proceset civile) dhe Nenit 6-1 (koha e arsyeshme) lidhur me ushtrimin në mënyrë jo efektive të një mjeti ligjor kompensues që u ishte vënë në dispozicion viktimave të proceseve të gjata gjyqësore, pasi kishte pasur vonesë në pagesën e dëmeve dhe shuma e caktuar si dëmshpërblimishte e pamjaftueshme.

Faktet: Ankuesi vendosi të kontestojë në vitin 1992 shumën e kompensimit të akorduar për shpronësimin e një ngastër toke të trashëguar në mars të vitit 1983 për qëllimin e ndërtimit të banesave. Ligji i ri për vlerësimin e vlerës së tregut kishte efekt prapaveprues në rastin e ankuesit. Për pasojë, kriteret e reja ushtronin ndikim mbi vlerësimin e tokës sipas vlerës së tregut, vlerë e cila kishte rënë ndjeshëm[336]. Ankuesi e kundërshtoi shumën e kompensimit para Gjykatës së Apelit (vendim, datë 17 korrik 1996) dhe, më pas, në Gjykatën e Kasacionit (7 dhjetor 1998), e cila pranoi vendimin e Gjykatës së Apelit. Më 18 prill 2002, ankuesit iu drejtuan Gjykatës së Apelit sipas "Ligjit Pinto" të 24 marsit 2001, duke kërkuar kompensim për kohëzgjatjen e proceseve ku ato kishin qenë palë. Në vendimin e datës 1 korrik 2002[337], Gjykata e Apelit konstatoi se kohëzgjatja e procesit ishte tejkaluar. Ajo e urdhëroi Ministrinë e Drejtësisë t'i paguante ankuesve shumën e përgjithshme prej 2.450 eurosh si dëm jopasuror dhe ndarjen e shpenzimeve midis palëve. **Pas shqyrtimit të çështjes, GJEDNJ-ja konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 6** duke argumentuar se mjetet juridike të paraqitura me anë të "Ligjit Pinto" ishin të aksesueshme para gjykatave të apelit. Ajo theksoi po ashtu se, duke filluar që nga shpallja e vendimit të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, datë 26 janar 2004, gjykatat e apelit duhej të përcaktonin shumat e dëmshpërblimit që do të jepeshin në procedurat "Pinto" për dëmshpërblim në raste vonesash të procedurave, duke u

[335] *Çështja Nr. 30210/96, vendim (themeli dhe kompensimi i drejtë), datë 26 tetor 2000, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58920*

[336] *Në datën e shpronësimit vlera ishte 165,755 lira italiane për meter katror, dhe sipas kompensimit të paguar në përputhje me kriteret e prodhuara nga ligji i vitit 1992, vlera ishte 82,890 për metër katror.*

[337] *E depozituar në sekretari më 27 korrik 2002.*

mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së[338]. Në lidhje me këtë, Gjykata argumentoi se periudha për ekzekutimin e vendimit të dhënë në proceset gjyqësore të tipit Pinto që synojnë korigjimin e pasojave që vijnë si rezultat i tejzgjatjes së procedurave, nuk duhet të kalojë gjashtë muaj nga data kur është bërë i zbatueshëm vendimi për dhënien e kompensimit. Gjykata theksoi se këto lloje procesesh mund të bëhen objekt i rregullave për një gjykim më të shkurtuar sesa gjykimi i çështjeve të zakonshme për kompensimet, por, në çdo rast, ato duhet të jenë në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor të garantuara nga Neni 6 i Konventës. Sipas gjykatës rregullat në lidhje me shpenzimet ligjore duhet të shmangin vendosjen e një barrë të tepërt ndaj palëve ndërgjyqëse dhe periudha katërmujore e parashikuar nga Ligji Pinto përputhet me kërkesën e gjykimit në një kohë të shkurtër që ofron shpejtësinë e nevojshme për një mjet ligjor që të konsiderohet se është efektiv. Për shembull, tarifa për regjistrimin e vendimit gjyqësor mund të pengojnë ndjeshëm përpjekjet e bëra nga ankuesit për të marrë kompensim. Megjithatë, nuk ishte caktuar një afat maksimal për ankesat në Gjykatën e Kasacionit. Përveç kësaj, mjeti kompensues duhej të shoqërohej nga një dispozitë adekuate buxhetore në mënyrë që ai të bëhej menjëherë i ekzekutueshëm brenda 6 muajve nga data e regjistrimit.

Bazuar në Nenin 46, Gjykata i kërkoi shtetit të paditur që, me anë të masave të përshtatshme ligjore, administrative dhe buxhetore, të siguronte se e drejta në fjalë isshte garantuar në mënyrë efektive dhe të shpejtë për të gjithë paditësit e prekur nga shpronësimi i pronës, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të drejtave pasurore, dhe sidomos për caktimin e kompensimit. Gjykata e ftoi shtetin e paditur të merrte të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se vendimet e gjykatave vendase të ishin në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, por edhe të ekzekutoheshin brenda gjashtë muajve nga depozitimi në sekretari.

Bazuar në Nenin 41 Gjykata vendosi për dëmshpërblim të ankuesve në sasi të ndryshme për dëm jopasuror dhe për kosto dhe shpenzime të tjera në të nënta çështjet. Gjykata vendosi edhe për dëmshpërblim lidhur me dëmin pasuror në çështjen Scordino.

Lista e pyetjeve:

a) Duke pasur parasysh çështjen, çfarë përbën zgjidhje efektive për vonesat e pajustifikuara të proceseve në përputhje me standardet e përcaktuara në Nenin 13 të Konventës?
b) Diskutoni në mënyrë kritike vendimin në çështjen "*Scordino kundër Italisë*" në lidhje me cfarë u theksua nga Gjykata për vlerësimin që i duhej bërë kërkesave për tejzgjatje procedurash sa i takon:

- përcaktimin e detyrimit;
- përshpejtimin e procedurave;
- kompensimin e dëmit;

[338] *Nga data 26 korrik 2004, ankuesit duhet ta përdornin këtë mjet për qëllim të Nenit 35 §1 të kushtetutës.*

3. Reforma në drejtësi në Shqipëri dhe mjetet e reja juridike për tejzgjatjen e proceseve gjyqësore

Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ka shërbyer si udhërrëfyese ndaj reformës në drejtësi për të ofruarzgjidhjet më të mundshme, që mund të adresojnë situatat e krijuara për shkak të vonesave të pajustifikuara në proceset gjyqësore. Disa prej këtyre zgjidhjeve janë: (1) përmirësimi i organizimit të administrimit të drejtësisë[339]; *(2)* përmirësimi i menaxhimit të gjykimit dhe proceseve gjyqësore; (3) shmangia e diskrecionit të madh të gjyqtarëve; (4) shmangia e ndryshimeve të përsëritura të gjyqtarëve; (5) përmirësimi i menaxhimit të "ngarkesës kronike" me çështje, etj. Në këtë drejtim, reforma në drejtësi në Shqipëri ka çuar në miratimin e disa ligjeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë për ofrimin e zgjidhjeve të duhura.

(1) Ligji Nr. 76/2016, datë 22/07/2016 për amendimin e Kushtetutës,në bazë të Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, të ndryshuar ;
(2) Ligji Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", miratuar më 10/06/2016;
(3) Ligji Nr. 115/2016 "Për qeverisjen e organeve të sistemit të drejtësisë", miratuar më 03/11/2016;
(4) Ligji Nr. 98/2016 "Për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i miratuar më 10/06/2016;
(5) Ligji Nr. 38/2017, datë 30.03.2017, për ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile";
(6) Ligji Nr. 35/2017, datë 30.03.2017 për ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale;
(7) Ligji Nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese";

Duke risjellë arsyetimin e Gjykatës nëvendimin "*Kudla k. Polonisë*,"[340] theksohet se mjetet në lidhje me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore janë "efektive" vetëm nëse mbulojnë të gjitha fazat e proceseve, ofrojnë dëmshpërblim të shpejtë, dhe përshpejtojnë kohëzgjatjen e procedurave në tërësi. Mekanizmi ligjor më i mirë i përmbush të dyja si (1) njohjen e shkeljes dhe, kur është e mundur, përshpejtimin e procedurave; dhe (2) ofron kompensim. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, Ligji i ri Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 "Për ndryshimet e Kodit të Procedurave Civile", ofron mjete të reja në Nenin 399/4 të KPrC-së lidhur me të drejtën e palës së interesuar për të pretenduar tejzgjatjen e pajustifikuar të procedurave, duke bërë dy kërkesa të veçanta: (1) kërkesën për vërtetimin e shkeljes dhe përshpejtimin e proceseve; dhe (2) kërkesën për kompensim të drejtë (vetëm pas shterimit të procedurës së parë). Për pasojë, dhënia e kompensimit në këtë respekt duhet të vendoset nga i njëjti autoritet që vendos për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve.

Neni 399/6, pika 2 parashikon se kërkesa për kompensim bëhet pasi është marrë një vendim që vërteton shkeljen dhe përshpejton proceset gjyqësore para gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur mbi përcaktimin e shkeljes. Kërkesa trajtohet brenda 6 muajsh nga konstatimi i shkeljes me një vendim të formës së prerë.

[339] Çështja *Lechner dhe Hess k. Austrisë* No.9316/81, datë 23 prill 1987, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57520
[340] *Shih shënimin 35.*

Neni 399/6 pika 3 parashikon që kompensimi përbëhet nga: a) njohja e veprës; (b) çdo masë përshpejtuese; (c) sasia e kompensimit. Gjykimi i kësaj kërkese përmbyllet brenda 3 muajve.

Neni 399/6, pika 3 është në përputhje me standardin e Konventës, sipas të cilit tejzgjatja e proceseve gjyqësore për qëllimin e kompensimit të dëmeve, duhet ta cilësojë shkeljen për këtë qëllim si "gabim", "akt i paligjshëm", "keqfunksionim i administrimit të drejtësisë", "mohim i drejtësisë", ose "parregullsi në realizimin e proceseve gjyqësore"[341]. Në këtë drejtim, vendimi për kompensim[342] nuk duhet të jetë vetëm i përshtatshëm, i arsyeshëm dhe i shpejtë, por edhe duhet arsyetuar dhe ekzekutuar shumë shpejt.

Neni 399.2 parashikon sa vijon: "Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas Nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

3. 1. Përcaktimi i periudhës së përgjithshme në bazë të Ligjit të ri Nr.38/2017, datë 30.03.2017

Ligji Nr. 38/2017, datë 30. 03. 2017, ofron parashikime të reja sa i takon përcaktimit të periudhës optimale të kohëzgjatjes për proceset gjyqësore (civile, penale, administrative, si dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare) dhe gjykatës përgjegjëse ku duhen drejtuar ankesat për vonesa të pajustifikuara, specifikisht në nenet 399.2 dhe 399.6/1 të KPrC-së.

Neni 399.2 i Kodit të Procedurave Civile parashikon sa më poshtë:

Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në Nenin 399/1, do të konsiderohen:

[341] *P.sh. parregullsi të një gjyqtari, ose një zyrtari tjetër të një gjykate, ngarkesën e madhe me punë të gjyqeve, një parregullsi në procese, e tillë si papërputhsmëria me një detyrim për të vepruar brenda kohës së parashkruar me ligj, ose një veprim ose mosveprim i paligjshëm.*

[342] *Në Lituani, Poloni, Sllovaki, Mbretërinë e Bashkuar "përdoren të njëjtat kritere si ato që përdoren nga Gjykata. Nuk përcaktohet sasia maksimale e kompensimit".*

a) kohëzgjatja në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, do tëjetënjë vit nga fillimi i gjykimit në secilën shkallë;

b) kohëzgjatja në gjykimin civil në shkallë të parë, në apel dhe në Gjykatën e Lartë do të zgjasë dy vite;

c) kohëzgjatja në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose te përcaktuara në kohë, do t ë jetë 1 vit duke filluar nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;
ç) afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve të veprave penale, do të rregullohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve do të jetë 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në apel gjykimi për krimet do të kryhet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, gjykimi për krimet do të kryhet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.

Neni 399/6 pika 1 e Kodit të Procedurës Civile parashikon sa më poshtë: Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative si më poshtë:
1) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, kërkesa shqyrtohet nga gjykata e apelit, në juridiksionin e të cilës ndodhet gjykata e shkallës së parë;
2) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë;
3) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegj tjetër i Gjykatës së Lartë;
4) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

3. 2. Ankesa kushtetuese në bazë të ligjit të ri

Miratimi i Ligjit Nr. 99/2016, datë 6 tetor 2016 "Për organizimin e Gjykatës Kushtetuese" solli disa ndryshime pozitive lidhur me kërkesën individuale kushtetuese bazuar në Nenin 131/f dhe Nenin 42 të Kushtetutës, të cilat ofrojnë një mjet efektiv ligjor në përputhje me Nenin 13 të Konventës. Këto ndryshime janë::

- Fusha e veprimit e GjK-se është zgjeruar; individët mund t'i drejtohen kësaj gjykate në lidhje më çdo akt të pushtetit publik (Neni 131/f i Kushtetutës, i ndryshuar[343])

[343] Neni 131/f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

- 4 muaj (më parë 2 vjet) është afati kohor për paraqitjen e kërkesës nga data e vendimit të fundit përfundimtar;

- kohëzgjatja e gjykimit përcaktohet të jetë 3 muaj;

- afati kohor për dorëzimin e vendimit (*nga dita e marrjes së vendimit përfundimtar mbi çështjen*) është 30 ditë;

- Vendimi i GjK-së është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim (*Neni 76 i ligjit të GjP-së dhe Neni 132 i Kushtetutës*);

- Vonesa e pajustifikuar e gjykimit kushtetues mbështetet në bazë të Nenit 71/c të ligjit;

- Kompensimi përcaktohet në shumën prej 100 000 lekësh për çdo vit vonese.

- Kërkesat mund të ngrihen vetëm nëse kalon më shumë se një vit nga data e gjykimit në GjK;

Duhet nënvizuar gjithashtu se kërkesakushtetuese është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm për kohëzgjatjene proceseve, vetëm nëse shfuqizon një vendim gjyqësor të fromës prerë dhe e dërgon cështjen për rigjykim në gjykatën e lartë. cek përfundimin e një vendimi të gjykatës. Në një rast të tillë, gjykimit kushtetues llogaritet si pjesë e periudhës së përgjithshme të proceseve gjyqësore. Individi ka në dispozicion mjete juridike efektive për të kërkuar dëmshpërblim për vonesat gjatëgjykimit kushtetues.

Shembull: në çështjen "*Deumeland k. Gjermanisë*",[344] pika e nisjes e periudhës në shqyrtim është 16 qershori 1970, data kur u depozituapadia në Gjykatën Sociale të Berlinit. Sa i përket periudhës së përfundimit, "koha" arsyeshmëria e së cilës duhet të analizohet mbulon në parimtërësinë e procesit gjyësor, përfshirë edhe proceset në apel. Gjykata Federale Kushtetuese duhet të merret parasysh në këtë aspekt, në kuptimin që, megjithëse nuk ka juridiksion për të vendosur për themelin, vendimi i saj ishte i aftë të ndryshonte rezultatin e pretendimit. Nga ana tjetër, koha e harxhuar nga Gjykata Sociale e Apelit e Berlinit për rishqyrtimin e kërkesës për hapjen e proceseve nuk është materiale, pasi kjo çështje kishte të bënte me hapjen e proceseve nga e para. Për pasojë, përfundimi i periudhës është data 9 shkurt 1981, datë kur Gjykata Federale Kushtetuese e rrëzoi ankesën e Z. Deumeland. Në këtë mënyrë, periudha objekt shqyrtimi zgjati për dhjetë vjet, shtatë muaj dhe tre javë.

3.3. Aspektet procedurale të vonesave të pajustifikuara të përmirësuara në ndryshimet e Kodit të Procedurave Penale

Në sferën penal, miratimi i Ligjit Nr. 35/2017, datë 30.03.2017 "Për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale" ka përmirësuar disa standarde për organizimin e administrimit të drejtësisë me ndikim në përshpejtimin e procedurës penale. Risitë e tij jepen në vijim:

[344] *Vendim i GjEDNJ-së, Çështja Nr.* 9384/81, *datë 29 maj 1986,* http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57468,

- ka shmangur kërkesat abuzive për skualifikimin e gjyqtarëve; palët do të mbajnë përgjegjësi për arsyetimin e vendimit;
- detyrimi për respektimin e afateve për parashtrimin e çështjes (Neni 133-138);
- kërkesa për rivendosje në afat do të shqyrtohet nga një Dhomë Këshillimi, çfarë forcon mekanizmat e filtrimit (Neni 147);
- kërkesa për shtyrjen e seancës mund të bëhet vetëm gjatë seancës paraprake (Neni 354);
- mosparaqitja e palëve (përfshirë dëshmitarët, ekspertët, viktimat etj.), i jep arsye gjykatës për vendosje gjobe;
- mosparaqitja e avokatit mbrojtës i jep gjykatës arsye për vendosjen e një gjobe nga 5000 100 000 lek, plus mbulimin e shpenzimeve (nenet 49, 350);
- mosparaqitja e të pandehurit nuk e pengon vazhdimin e seancës gjyqësore (Neni 192);
- futja e "urdhrit penal" të prokurorit dhe "marrëveshjes së pranimit të fajësisë" do të zbatohet për herë të parë në praktikën gjyqësore.

Shënim: Urdhri Penal është një procedurë e re që e autorizon prokurorin të vendosë për veprat penale të kundërvajtjes, për të cilat zbatohet vetëm dënim me gjobë. Ky vendim duhet të merret brenda 3 muajve nga data e regjistrimit të të pandehurit. Prokurori në këtë rast vendos për masën e dënimit dhe kërkon direkt miratimin e gjykatës nga gjyqtari i caktuar për gjykim. Për dërgimin e çështjes për vendim direkt në gjykatë nuk është e nevojshme që të merret pëlqimi i të pandehurit.

Shënim: 'Marrëveshja për pranimin e fajësisë' është një formë e re gjykimi, synimi i së cilës është të ulë kostot dhe të përshpejtojë proceset gjyqësore. Në këtë rast, kërkesa mund të propozohet nga të gjitha palët në procese paraprake. Ajo lejohet vetëm për vepra penale për të cilat parashikohet asë dënimi deri në 7 vjet dhe vendimi duhet të miratohet në seancë plenare, e cila vendos brenda 30 ditësh nga depozitimi i propozimit (Neni 406).

3.3. Avokati i Popullit

Në çështjen Qufaj sh.p.k k. Shqipërisë[345], Gjykata u shpreh në lidhje me mundësinë e depozitimit të ankesës para Avokatit të Popullit se, Avokati i Popullit nuk mund të marrë vendime të ekekutueshe vis a vis në me autoritetet shtetërore edhe pse është një organ i pavarur nga ekzekutivi. Për pasojë, ankesa e dorëzuar para Avokatit të Popullit nuk mund të konsiderohet si mjet efektiv që i përmbush kërkesat e Nenit 35.1. Gjykata thekson se Neni 35.1 i Konventës kërkon shterimin e mjeteve efektive të brendshme, por nuk ka asnjë detyrim bazuar në këtë dispozitë për të pasur rekurs në mjete efektive të cilat nuk janë të përshtatshme. Ndërsa në çështjen "*Egmez k. Qipro*", Gjykata konstatoi se Avokati i Popullit ishte mjeti i vetëm efektiv në dispozicion për ankuesin, i cili, nuk ishte i mjaftueshëm për shterimin e pretendimeve të tij, çfarë kishte çuar në shkelje të Nenit 13 të Konventës lidhur me të drejtën për mjete efektive.

[345] *Shih shënimin 10.*

Institucioni i Avokatit të Popullit është organ kushtetues i krijuar në bazë të neneve 60 deri në 63[346] të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilët përcaktojnë funksionin, parimet e aktivitetit, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, ndërsa Neni 134, germa "dh" përcakton të drejtën e Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.[347].Në bazë të Ligjit Nr. 9094 dt. 03.07.2003 "Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit çnjerëzor dhe Degradues (OPCAT)", Avokati i Popullit është identifikuar si institucioni i duhur për të përfaqësuar Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Në pajtim me Nenin 60 të Kushtetutës dhe Nenin 2 të ligjit përkatës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, ose të palëve të treta që veprojnë në emër të tij. Juridiksioni i tij përfshin qeverinë, ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe ato vendore.. Avokati i Popullit në Shqipëri shqyrton ankesat e qytetarëve, ose kërkesat kundër organeve të administratës qendrore, qeverisjes lokale dhe palëve të treta që veprojnë në emër të tyre, në polici, shërbime sekrete, burgje, forca të armatosura dhe në gjyqësor, bashkëpunon me organizatat joqeveritare dhe bën studime në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Njësia e Parandalimit të Torturës merret me inspektime dhe vizita në mjediset ku individët vuajnë dënimet përkatëse, me qëllim parandalimin e rasteve të torturës, ose dënimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese.

Diskutoni: a është roli i Avokatit të Popullit në përputhje me standardin e një mjeti efektiv duke pasur parasysh vendimet e Gjykatës në çështjen "*Qufaj kundër Shqipërisë*" dhe "*Egmez kundër Qipros*"?

Situatë hipotetike:

Kazusi 1: Ankuesi X kishtendjekur një padi me objekt mbrojtjen e të drejtave të tij civile në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Proceset para kësaj gjykate zgjatën mbi 2 vjet e gjysmë. Ankuesi paraqet kërkesë para Gjykatës së Apelit për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt ligjor brenda një kohe të arsyeshme. Nëse do të ishit gjyqtari që do të vendoste mbi këtë çështje, çfarë vendimi do të merrnit? Diskutoni mbi përdorimin e dispozitave të reja të ndryshuara në Kodin e Procedurave Civile. Në rast se vendimi për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm nuk merret në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, atëherë ku duhet ta parashtrojë ankuesi X kërkesën përkatëse në lidhje me dëmshpërblimin përkatës? Nëse do të ishit gjyqtari që do të vendoste mbi kompensimin, si do ta arsyetonit vendimin e marrë?

[346]Neni 63 § 3 "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga autoritetet publike.

*347 Neni 25. Personat dhe aktet jashtë juridisktionit të Avokatit të Popullit "Sa më poshtë bie po ashtu jashtë juridiksionkit të Avokatit të Popullit (a) statutet dhe aktet e tjera ligjore; (b) urdhërat ushtarakë të Forcave të Armatosura; (c) vendimet e gjykatës. Pa cenuar germën (c) të këtij Neni, Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa, ose njoftime lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut që dalin nga administrimi i gjyqësorit dhe procedurave gjyqësore. Hetimet e Avokatit të Popullit nuk cenojnë pavarësinë e gjyqësorit në vendimmarrjen për**çështjet**."*

Kazusi 2: Ankuesi Y akuzohet për vepra penale para Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Gjykimi i lidhur me të në Gjykatën e Apelit ka zgjatur rreth 1 vit e 8 muaj. Ku duhet ta paraqesë ankuesi ankesën lidhur me vonesat e pajustifikuara të proceseve? Çfarë vendimi do të jepnit nëse do të ishin personi që do të vendoste për kërkesën? Cili është qëllimi i vendimit në këtë drejtim? Çfarë ndodh nëse vonesa vazhdon, edhe pas vendimit të marrë për konstatimin e shkeljes? Çfarë hapash të tjerë duhet të ndjekë ankuesi? Kur quhet se ankuesi merr kompensim të plotë për shkeljen e pretenduar?

Kazusi 3: Më 25 gusht 2015, ankuesi Z fitoi të drejtat në bazë të një vendimi të formës së prerë të Gjykatës për t'u kompensuar në një shumë të caktuar për shkak të shkeljes së një kontrate me një kompani ndërtimi. Ai filloi procesin e përmbarimit dhe e parashtroi kërkesën më 15 shtator 2015. Kompania refuzoi të zbatonte vendimin. I gjetur në këto kushte, ankuesi vendosi të paraqiste një kërkesë për ekzekutimin e vendimit më 1 janar 2017. Kujt duhet t'ia paraqesë ankuesi Z këtë kërkesë? Nëse do të ishit gjyqtari që do të vendoste mbi këtë kërkesë, si do ta arsyetonit vendimin mbi këtë objekt kërkimi?

Lista e pyetjeve:

a) Nëse jeni gjyqtari që duhet të marrë vendim mbi një kërkesë për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, çfarë vendimi do të merrnit në bazë të dispozitave të reja të KPrC-së, përkatësisht në proceset civile, penale dhe administrative?
b) Nëse kërkesa për përcaktimin e detyrimit për përshpejtimin e procesit gjyqësor konfirmohet nga gjykata e shkallës së parë, çfarë hapash duhet të ndiqen më pas në të dy skenarët, kur Gjykata vazhdon t'i vonojë proceset? Kur gjykata arrin të ndalojë vonesën dhe të zbatojë vendimin e gjykatës në kohë me sukses? A ka të drejtë ankuesi të kërkojë kompensim në këtë rast?

Rekomandohet per lexim:

- Vendimi i GJEDNJ-së në çështjen "Deumeland k. Gjermanisë;"
- Ligji Kushtetues Nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar me Ligjin Nr. 76/2016, datë 22/07/2016
- Ligji Nr. 96/2016 "Për statutin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", miratuar më 10/06/2016;
- Ligji Nr. 115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë", miratuar më 03/11/2016;
- Ligji Nr. 98/2016 "Për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", miratuar më 10/06/2016;
- Ligji Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 për ndryshimin e Kodit të Procedurave Civile;
- Ligji Nr. 35/2017, datë 30.03.2017 për ndryshmin e Kodit të Procedurave Penale;
- Ligji Nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

C. Mjetet e brendshme juridike për proceset e tejzgjatura në mënyrë të paarsyeshme: praktikat europiane

Tejzgjatja e proceseve penale është problem i madh në pjesën më të madhe të vendeve europiane. Gjykatat duhet të shqyrtojnë ngarkesën e punës *brenda një kohe të arsyeshme*, siç deklarohet nga Nenit 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.[348]

Që prej vitit 2000, pas vendimit të rëndësishëm, *Kudła k. Polonisë*, miratuar më 26 tetor 2000, shtetet europiane janë detyruar të krijojnë mjete efektive ligjore brenda autoriteteve vendase për pretendimet për vonesa gjyqësore. Në këtë vendim, Gjykata përqafoi pozicionin e mëposhtëm:

"Sipas pikëpamjes së Gjykatës ka ardhur koha për të rishikuar praktikën gjyqësore në dritën e akumulimit të vazhdueshëm të çështjeve të depozituara para saj, në të cilat pretendimi i vetëm, ose kryesor, është dështimi i sigurimit të proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të Nenit 6 paragrafi 1. Shpeshtësia në rritje e shkeljeve të konstatuara në këtë drejtim, e ka bërë Gjykatën, që kohët e fundit t'i kushtojë vëmendje "rrezikut të rëndësishëm" që ekziston për shtetin ligjor brenda rendeve të brendshme juridike kur ndodhin "vonesa të tejzgjatura në administrimin e drejtësisë, lidhur me të cilat palët ndërgjygjëse nuk kanë mjete efektive juridike".
[...]

"Neni 13, duke i dhënë shprehje të drejtpërdrejtë detyrimit të shtetit për të mbrojtur së pari dhe mbi të gjitha të drejtat e njeriut brenda sistemit përkatës juridik, përcakton një garanci shtesë për individin, për t'u siguruar që ai ose ajo i gëzon efektivisht këto të drejta. Objekti i Nenit 13, siç del nga *travaux préparatoires* [...], është që të ofrojë mjete përmes së cilave individët mund të marrin dëmshpërblim në nivelin vendas për shkeljet e të drejtave që u takojnë në bazë të Konventës, përpara se të vënë në lëvizje mekanizmin ndërkombëtar të ankimit përpara Gjykatës. Nga kjo perspektivë, e drejta e individit për gjykim brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efektive në rast se nuk ka asnjë mundësi që, së pari, pretendimi për shkelje të Konventës t'i dërgohet një autoriteti vendas; dhe kërkesat e Nenit 13 duhet të shihen si përforcuese të kërkesave të parashikuara në Nenin 6§1.'
[...]
Në kuadër të aspekteve të përmendura më sipër, Gjykata është e mendimit se interpretimi i saktë i Nenit 13 është që kjo dispozitë të garantojë një mjet efektiv ligjor përpara një autoriteti vendas lidhur me pretendimet për shkelje të kërkesës së parashikuar në Nenin 6§1, përkatësisht për gjykimin e një çështjeje brenda një kohe të arsyeshme.[349]

Për rrjedhojë, nëse një mjet i tillë nuk është i disponueshëm, Gjykata do të gjejë shkelje të Nenit 13, ose pa vendosur për Nenin 6§1, ose plus një vendimi kundër shtetit në bazë të Nenit 6§1.

Shembull. Në çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*[350] "Gjykata vëren se mungesa e efektivitetit të mjeteve të brendshme po ngrihet gjithnjë e më shumë përpara kësaj Gjykate, në çështjet që kanë të bëjnë me dështimin për të ekzekutuar, ose për vonesat në

348 CEPEJ-SATURN (2015)2, Udhëzimet e Saturnit për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore, komente dhe shembuj zbatimi; CEPEJ, Raport 2012, Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës bazuar në praktikën gjyqësore".
349 Kudła k. Polonisë, 26 tetor 2000, §148-152-156.
350 Çështja 32907/07, Vendim (themeli), 29/09/2009, paragrafi 49 dhe 55-61.

ekekutimet e vendimeve të brendshme të formës së prerë. Për rrjedhojë, ajo ka vendosur me iniciativën e vet, ta shqyrtojë çështjen bazuar në Nenin 13 të Konventës (shih, për shembull, Burdov k. Rusisë (Nr. 2), Nr. 33509/04, §§ 89-117, 15 janar 2009; Beshiri dhe të tjerët k. Shqipërisë, Nr. 7352/03, 22 gusht 2006; dhe Qufaj Co. Sh.p.k. k. Shqipërisë, Nr. 54268/00, 18 nëntor 2004).[...]

Gjykata vëren se në sistemin ligjor shqiptar, çdokush që mendon se i është shkelur e drejta për proces të rregullt, mundet, nëse i ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, të depozitojë një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese bazuar në Nenin 131 (f) të Kushtetutës. Në vendimin për çështjen *Qufaj Co. Sh.p.k.*, (cituar më sipër, § 42), Gjykata konstatoi se: "Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për të trajtuar ankesën e kompanisë së ankuesit lidhur me papërputhshmërinë me një vendim të formës së prerë, si pjesë e juridiksionit të vet për të siguruar të drejtën për proces të rregullt". Ky element i të drejtës për proces të rregullt është mishëruar për herë të parë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.. 6/06, dhe është përsëritur më pas në vendimet pasuese Nr. 43/07, 1/09 dhe 6/09. Megjithatë, në çështjet nën shqyrtim, Gjykata vëren se ankuesi nuk bëri ankim para Gjykatës Kushtetuese lidhur me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës, datë 27 shtator 2005. Gjykata duhet të përcaktojë nëse mjetet e përmendura më sipër do të kishin qenë "efektive" në kuptimin e eliminimit, ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar, ose të vazhdimësisë së saj, ose për ofrimin e kompensimit të përshtatshëm për shkeljet e ndodhura. Gjykata vëren se vendimet e Gjykatës Kushtetuese [...] kanë deklaruar se ka pasur një shkelje të së drejtës së ankuesit lidhur me aksesin në gjykatë për llogari të moszbatimit të vendimeve të gjykatave vendasvendase. Megjithatë, konstatimet ishin thjesht deklarative, për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë kompensim të përshtatshëm. Në veçanti, ajo nuk dha dëmshpërblime pasurore ose jo-pasurore, dhe as nuk mundi të ofronte një perspektivë të qartë për parandalimin e shkeljes së pretenduar, ose për vazhdimësinë e saj. Për më tej, Gjykata vëren se veprimet e përmbaruesit nuk ishin efektive në çështjen në fjalë. Gjithashtu, qeveria nuk dëshmoi për praninë e ndonjë mjeti tjetër alternativ parandalues, ku, në vëmëndje të rrethanave të çështjes në fjalë, mund të ishte ushtruar nga ankuesi. Për pasojë, Gjykata arrin në përfundimin që ka shkelje të Nenit 13 në lidhje me Nenin 6 § 1 të Konventës. Mbi këtë bazë, rrëzohet kundërshtimi paraprak i qeverisë mbështetur në mosshterimin e mjeteve të brendshme juridike."

Pas vendimit për çështjen *Kudla*, disa shtete kanë prezantuar rregullime për t'u bërë të mundur qytetarëve të cilët kanë vuajtur nga procese të tejzgjatura, ose që janë ende në pritje të përfundimit të një etape të caktuar të gjykimit, të përshpejtojnë shqyrtimin e çështjeve.

Siç është deklaruar në vendimin për çështjen *Kudła*, "Shteteve Kontraktuese u është dhënë një farë diskrecioni lidhur me mënyrën në të cilën ata e ofrojnë lehtësimin që kërkohet nga Neni 13 dhe i përmbushin detyrimet e Konventës nën këtë dispozitë". Pra, në këtë mënyrë, Gjykata u lejon shteteve kontraktuese një shkallë lirie në lidhje me llojin e mjeteve efektive që ato mund të prezantojnë. Megjithatë, Gjykata kujton në mënyrë të rregullt se "zgjidhja më efektive" është zgjidhja që synohet për të përshpejtuar procedurat, "*pasi ajo parandalon po ashtu dhe konstatimin e shkeljeve pasuese në lidhje me të njëjtin grup procesesh, dhe nuk bën thjesht korrigjimin e shkeljes a posteriori [...]"* (p.sh. Vendim i Dhomës së Madhe për çështjen *Scordino k. Italisë* (Nr. 1), datë 29 mars 2006, §§ 183 dhe 184).

Duke u lejuar shteteve të përzgjedhin ndërmjet dëmshpërblimit të dëmeve të shkaktuara nga proceset tejet të zgjatura, ose mundësia e përshpejtimit të proceseve, Gjykata ka krijuar mundësinë e mjeteve të reja. Për pasojë, në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ekzistojnë lloje të ndryshme mjetesh efektive për proceset gjyqësore të tejzgjatura.[351] Në paragrafët më poshtë do të jepen disa shembuj.

Sa i takon **Italisë**, pas vendimit *Kudła*, në vend u miratua Ligji Nr. 89, datë 24 mars 2001, i njohur ndryshe si "Ligji Pinto", i cili prezantoi një mjet të brendshëm që u ofronte viktimave të proceseve të gjata në mënyrë të paarsyeshme mundësinë që të dëmshpërbleheshin. Ky mjet u konsiderua efektiv në çështjen *Brusco*, vendim pilot ku Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ftoi ankuesit që e kishin referuar çështjen mbi bazën e kohës së arsyeshme ta tërhiqnin çështjen, ose, në të kundërt, të përballeshin me rrezikun e vendimit të papranueshmërisë për qëllim të mospërmbushjes së kushtit për shterimin e mjeteve të brendshme.

Në mënyrë logjike, ankuesit kërkohen që të shterojnë mjetet e brendshme në dispozicion në kohën kur ata e depozitojnë çështjen para Gjykatës Europiane, por jo mjetet efektive të krijuara më pas. Ka vetëm një përjashtim për këtë rregull. Përjashtimi është kur shteti prezanton një mjet të brendshëm në përgjigje të një dështimi organizativ në sistemin e vet gjyqësor: në këtë rast ankuesit i kërkohet që ta rikanalizojë çështjen para autoritetit të ri vendas, pavarësisht faktit se mjeti i brendshëm u bë i disponueshëm pasi ai/ajo aplikoi para Gjykatës Europiane.

Në vendimin e pranueshmërinë në çështjen *Brusco k. Italisë,* datë 6 shtator 2001, të ndjekura nga shumë vendime të tjera të së njëjtës linjë, Gjykata vendosi se: "duke pasur parasysh natyrën e Ligjit Pinto dhe kontekstin në të cilin është miratuar ai, ka arsye për të anashkaluar parimin e përgjithshëm se kërkesa për shterim duhet të vlerësohet duke iu referuar kohës së depozitimit të ankesës. [...]

Gjykata është shprehur se ankuesit në çështjet kundër Italisë, të cilat kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e proceseve, duhet të ushtrojnë mjetet e prezantuara në "Ligjin Pinto", pavarësisht faktit që akti ishte miratuar pas parashtrimit të çështjes para gjykatës.

Një vendim i ngjashëm është marrë dhe në lidhje me çështjet e prezantuara kundër Kroacisë, pas hyrjes në fuqi të një ndryshimi kushtetues që e lejonte Gjykatën Kushtutuese të ofronte dëmshpërblim si të natyrës parandaluese, edhe të natyrës kompensuese për personat që ankoheshin për vonesa të pajustifikuara në proceset

351 Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut ka ofruar një vështrim të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e Rekomandimit Rec (2004) 6 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për përmirësimin e mjeteve të brendshme jurisike; CDDH (2006) 008 E (reforma e GJEDNJ-së), Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut; Raporti i Komisionit të Venecias, "Mjetet efektive vendasvendase në lidhje me tejzgjatjen e proceseve" (Studimi Nr. 316/2004, CDL (2005) 092, vetëm në versionin në anglisht, i kufizuar, 8 dhjetor 2005) dhe raportet e prezantuara në seminarin e organziuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke, në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, mbi kufijtë e analizës kushtetuese të vendimeve të gjykatave të zakonshme në proceset për ankesat kushtetuese (14-15 nëntor 2005, Brno, CDL-JU (2005) 059-61 dhe 67-68, vetëm në versionin në anglisht)) dhe raporti i Komisionit Evropian për Efikasitetin në Drejtësi (CEPEJ), "Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, mbështetur në prakikën gjyqësore", 2012.

gjyqësore[352]. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka ndjekur të njëjtën linjë me Sllovakinë dhe Poloninë.[353]

Gjykata ka pasur mundësinë të shqyrtojë nëse masa kompensuese e prezantuar nga Ligji Pinto mund të konstatohet se ofron dëmshpërblim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Sa i takon kërkesës për dëmshpërblim të duhur dhe të mjaftueshëm, në çështjen *Scordino k. Italisë,* datë 29 mars 2006, Gjykata deklaroi si më poshtë: "Gjykata ka thënë më parë që edhe nëse një mjet është "efektiv", në kuptimin që ai lejon një gjykim të menjëhershëm të çështjes, ose kur i lejon palës së prekur të marrë dëmshpërblimet përkatëse për vonesat që kanë ndodhur, cfarë vlen vetëm e kushtin nëse mjeti për kërkimin e dëmshpërbliitnë vetvete mbetet një mjet efektiv, adekuat dhe i aksesueshëm sa i takon kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore.[354]Megjithatë, Gjykata shtoi se mjetet e prezantuara në Itali përmes Ligjit Pinto nuk i përmbushin këto kritere, për shkak, nga njëra anë, të vonesave të tepërta në proceset kompensuese dhe, nga ana tjetër, masës së ulët të dëmshpërblimit. Këto dy aspekte e bëjnë mjetin ligjor jo efektiv, të papërshtatshëm dhe të pamjaftueshëm. Në vendimin *Scordino* dhe në tetë vendime të tjera të marra të njëjtën ditë, Gjykata qartësoi kërkesat që duhet të përmbushen nga mjetet e brendshme ligjore për adresimin e vonesave gjyqësore dhe, më specifikisht, për caktimin e masës për dëmshpërblime: duhet të paguhet një shumë e arsyeshme kompensimi brenda një periudhe kohe, e cila në vetvete është e arsyeshme.

Gjykata deklaroi gjithashtu se: "[...] nuk mund të përjashtohet që vonesat e procedurave në kërkiin e një padie për kompensim e bëjnë atë mjet jo adekuat." Në raste të ndryshme të paraqitura para Gjykatës, kjo e fundit është shprehur se është shumë "e papranueshme" që ankuesit të duhej të prisnin për periudha që varionin nga njëmbëdhjetë muaj deri në tre vjet dhe, ndonjëherë edhe të nisnin proceset e ekzekutimit para se të kishin marrë kompensimin përkatës.[355]Gjykata mund të pranojë që autoritetet kanë nevojë për kohë për të bërë pagesën. Megjithatë, në lidhje me një mjet kompensues të projektuar për të korrigjuar pasojat e vonesave për shkak të procedurave tepër të gjata, kjo periudhë nuk duhet të kalojë përgjithësisht gjashtë muaj nga data kur vendimi për dhënien e kompensimit bëhet i ekzekutueshëm. Përtej periudhës gjashtëmujore, faza e ekzekutimit të një vendimi që jep kompensimin do të ishte e paarsyeshme dhe do të çonte në privimin e efektivitetit të mjetit kompensues.[356]

Në çështjen Scordino, Gjykata u shpreh se shumat e dhëna nga gjykatat italiane për ankues të ndryshëm si kompensim për vonesat në sistemin gjyqësor ishin të pamjaftueshme. Duke vërejtur shumat e paguara për secilin prej ankuesve për këto

352 Vendim pranueshmërie, Rocco Colacrai k. Italisë, 29 nëntor 2001, "E drejta", §1; shih po ashtu, Giacometti dhe të tjerët k. Italisë (vendim), Nr. 34939/97l.

353 Vendim pranueshmërie, Andrášik dhe të tjerët k. Sllovakisë, Nr. 57984/00, 57984/00, 60237/00, 60242/00, 60679/00, 60680/00, 68563/01 dhe 60226/00. Vendim pranueshmërie nëçështjen Charzyński k. Polonisë, Nr. 15212/03.

354 Scordino k. Italisë, 29 Mars 2006, §195

355 Riccardi Pizzati: më shumë se 22 muaj (§99); Musci: 23 muaj (§101); Giuseppe Mostacciuolo (Nr. 1): më shumë se 14 muaj (§98); Giuseppe Mostacciuolo (Nr. 2): më shumë se 14 muaj (§98); Cocchiarella: më shumë se 3 vjet (§100); Apicella: 11 muaj (§98); Ernestina Zullo: 23 muaj (§102); Giuseppina dhe Orestina Procaccini: më shumë se 3 vjet (§98).

356 Scordino k. Italisë, 29 mars 2006, §198.

çështje të ndryshme, "Gjykata vëren se kjo shumë është përafërsisht [nga 8% deri në 27%] e shumës që jepet përgjithësisht në çështje të ngjashme italiane nga Gjykata në Strasburg. Ky faktor në vetvete çon në një rezultat që është dukshëm i paarsyeshëm duke pasur parasysh jurisprudencën e saj. "Pra, shtetet janë të detyruara t'u ofrojnë viktimave të vonesës gjyqësore kompensim të arsyeshëm, të krahasueshëm me shumat e dhëna zakonisht nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Përndryshe, shkelja e së drejtës së garantuar nga Neni 6§1 nuk korrigjohet mjaftueshëm dhe mjeti i brendshëm i përmendur në Nenin 35§1 dhe i përdorur nga ankuesi nuk do të ketë efekt. Rrjedhimisht, ankuesi mund të vijojë të pretendojë se është viktimë e shkeljes në fjalë dhe të ketë të drejtë të ankohet për situatën para autoriteteve të Strasburgut. Siç vuri në dukje vetë në çështjet e përmendura më sipër 'Gjykata ka patur raste të tregojë që statusi i viktimës së një aplikanti mund të varet nga niveli i kompensimit të dhënë në nivel vendas në bazë të fakteve për të cilat ai ose ajo ankohet para Gjykatës[357]".

Sa i takon çështjes së kompensimit që duhet paguar, Gjykata ka specifikuar kërkesat. Për dëmin financiar, gjykatat vendase janë qartë në pozitë më të mirë për të përcaktuar ekzistencën dhe sasinë e kompensimit. Për më tepër, kjo pikë nuk është kontestuar nga palët apo ndërhyrësit. Për sa i përket dëmit jopasuror, Gjykata, ashtu si Gjykata Italiane e Kasacionit, supozon se ekziston një prezumim i fortë, por i kundërshtueshëm, që proceset tepër të gjata shkaktojnë dëme jo-pasurore. Po ashtu, ajo pranon që, në disa raste, kohëzgjatja e proceseve mund të çojë vetëm në një dëm minimal jopasuror, ose në asnjë dëm të tillë. Gjykatat e brendshme do të duhet ta arsyetojnë vendimin e tyre duke dhënë arsye të mjaftueshme. Së dyti, lidhur me masën e kompensimit, Gjykata ka dhënë udhëzimet e mëposhtme. Niveli i kompensimit varet nga karakteristikat dhe efektiviteti i mjeteve juridike të brendshme. Gjykata mund të pranojë pa problem se një shtet, i cili ka prezantuar disa mjete juridike, njëri prej të cilëve është projektuar për të përshpejtuar proceset dhe një për të ofruar kompensim, do të japë shuma, të cilat, ndonëse më të ulëta se ato të dhëna nga Gjykata, nuk janë të paarsyeshme, me kusht që vendimet përkatëse, të cilat duhet të jenë në pajtim me traditën ligjore dhe standardin e jetesës në vendin në fjalë, të jenë të shpejta, të arsyetuara dhe të ekzekutuara shumë shpejt.

Megjithatë, kur mjeti i brendshëm nuk i plotëson të gjitha kërkesat e mësipërme, është e mundur që të jetë më i lartë pragu i shumës që e lejon paditësin të pretendojë të jetë "viktimë". Është e kuptueshme edhe që gjykata që përcakton shumën e kompensimit ta njohë vonesën e saj dhe, që, në përputhje me rrethanat dhe me qëllimin, dhe për të mos e penalizuar më vonë ankuesin, do të japë një shumë të lartë kompensimi për t'i dalë përpara vonesave të mëtejshme.

Lidhur me **Republikën Çeke**, reformat janë realizuar pas vendimit *Hartman*, datë 10 korrik 2003, ku Gjykata Europiane konstatoi se ankesat në Gjykatën Kushtetuese, të cilat u mundësonin individëve të kundërshtonin çdo vendim përfundimtar të një organi tjetër, administrativ apo gjyqësor, nuk ishin efektive. Sipas Rezolutës përkatëse të Komitetit të Ministrave, Republika Çeke ka marrë masa të rëndësishme me qëllim që puna e sistemit të drejtësisë të bëhet më efektive dhe që të përshpejtohen proceset gjyqësore. Ndryshimi i gjerë i rregullave të Procedurës Civile, e miratuar përmes Ligjit

357 Scordino k. Italisë, 29 mars 2006, §202.

Nr. 7/2009, që nga 1 korriku 2009 ka reduktuar vonesat në proceset gjyqësore duke thjeshtuar procedurën (për shembull, përmes regjistrimit të seancave gjyqësore, uljes së shkallës së arsyetimit për disa lloje vendimesh të gjykatave), duke futur konceptin e "seancës përgatitore" dhe, para së gjithash, duke futur një metodë të re efektive për ofrimin e dokumentacionit ("adresa e detyrueshme për njoftimin" për palët në proces); përveç kësaj, së bashku me Aktin Nr. 300/2008 "Mbi veprimet elektronike dhe konvertimin e dokumenteve të autorizuara", Republika Çeke ka paraqitur, si metodë parësore të procesit të njoftimit, dorëzimin elektronik në kutitë e postës së të dhënave. Ligji Nr. 192/2003 ka shtuar një dispozitë në Aktit Nr. 6/2002 për gjykatat dhe gjyqtarët, sipas së cilit, nga data 1 korrik 2004, është e mundur të kërkohet një mjet efektiv për vonesat e tejzgjatura në proceset gjyqësore duke aplikuar për përcaktimin e një afati kohor për përfundimin e një faze, apo formaliteti të caktuar procedural. Ndryshimet në metodën e punës së gjykatave, të tilla si mini ekipet e gjykatave dhe zgjerimi i kompetencave të nëpunësve të drejtësisë, të cilat i lehtësojnë gjyqtarët nga barra e panevojshme, ndihmojnë po ashtu në përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Në këtë aspekt, baza ligjore është Ligji Nr. 121/2008, "Mbi përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe nëpunësve të Prokurorisë Publike", i cili ka hyrë në fuqi që nga 1 korriku 2008 dhe përcakton rishtazi fushëveprimin e detyrave që deri në atë kohë janë kryer nga gjyqtarët dhe prokurorët publikë dhe transferon një pjesë të këtyre detyrave nëpunësve të drejtësisë dhe nëpunësve të prokurorisë.

Më 1 tetor 2008 hyri në fuqi një ndryshim në sistemin e procedurave për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, që ka për qëllim të lejojë vendimmarrje të pavarur dhe objektive për shkeljet disiplinore, ku përfshihen edhe vonesa të pajustifikuara në trajtimin e çështjeve të caktuara për gjyqtarët. Një hap i madh përpara është digjitalizimi i gjere i sistemit të drejtësisë (për shembull, projekti ePodatelna [ose projektet e-MailRoom], ePlatební rozkaz [e-CourtOrderToPay], [infoSoud] dhe infoJednání [infoHearing]. Një ndryshim i gjerë i Rregullave të Ekzekutimit (shpallur si Akti 286/2009), hyri në fuqi më 1 nëntor 2009. Ky ndryshim e transferon axhendën administrative nga gjykatat tek përmbaruesit/zyrtarët përmbarimor, dhe lidhet me kompetencat e reja për përmbaruesit/oficerët e zbatimit. Ashtu si në rastet e mësipërme, qëllimi është përshpejtimi i tërë procesit. Tani kërkesa për urdhërimin e përmbarimit i drejtohet drejtpërdrejt përmbaruesit/zyrtarit të përmbarimit, jo gjykatës përmbarimore. Është pikërisht përmbaruesi/zyrtari i përmbarimit personi i cili shqyrton nëse kërkesa e personit të autorizuar i përmban të gjitha hollësitë thelbësore të nevojshme dhe vetëm atëherë ai ia dërgon kërkesën gjykatës përmbarimore. Përpjekja për të zvogëluar kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe për të lehtësuar barrën në gjykatat e zakonshme vazhdon, thotë Qeveria në raportin drejtuar Komitetit të Ministrive. Vëmendja kryesore aktualisht është drejtuar tek ligji i ndërmjetësimit, për të ndihmuar shkurtimin e proceseve civile, ndryshimi i ligjit të arbitrazhit, i cili së bashku me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë çon në më shumë transparencë dhe në thjeshtim më të madh të proceseve. Vëmendje po i kushtohet edhe një ndryshimi në Kodin e Drejtësisë Administrative, qëllimi i të cilit është përshpejtimi i proceseve para gjykatave administrative. Ndryshimi sjell kryesisht ndryshime në proceset për ankesat e kasacionit, të cilat do të transferohen tërësisht tek Gjykata e Lartë

Administrative.[358]Puna për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë vazhdon. Qëllimi është të prezantohet dosja elektronike (e njohur si *eSpis* [eFile]) për të gjitha llojet e proceseve gjyqësore.

Në **Kroaci**, pas vendimit të Gjykatës Europiane në çështjen *Horvat*, u ndryshua ligji kushtetues mbi Gjykatën Kushtetuese të vitit 1999. Neni i ri 63, është në fuqi që nga data 15 marsi 2002. KEDNJ-ja ka vënë në dukje në shumë raste se kjo dispozitë e re përbënte mjet efektiv në lidhje me tejzgjatjen e proceseve ligjore (shih çështjen *Radoš* dhe të tjerët kundër Kroacisë (07/11/2002) dhe vendimet mbi pranueshmërinë në çështjen Slaviček (vendim, datë 04/07/2002), çështjen *Nogolica* (vendim, datë 05/09/2002), *Plaftak dhe të tjerët* (vendim, datë 03/10/2002), çështjen *Jeftić* (vendim, datë 03/10/2002) dhe çështjen *Sahini* (vendim, datë 11/10/2002)). Efektiviteti i këtij mjeti të ri u konfirmua më pas nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe, në veçanti, përmes efektit të drejtpërdrejtë të dhënë në vendimet e Gjykatës Europiane në interpretimin e së drejtës kroate. Pas reformës legjislative të vitit 2002, vendimet e Gjykatës Europiane u konsideruan me efekt të drejtpërdrejtë në rast të tejzgjatjes së proceseve ligjore, përfshirë procedurat e ekzekutimit. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje disa shkelje të së drejtës së paditësve sipas kushteve të Nenit 29 paragrafi 1 të Kushtetutës për shkak të tejzgjatjes së proceseve ligjore. Rrjedhimisht, ajo i urdhëroi gjykatat përkatëse ta jepnin vendime brenda ca kohëve të caktuara dhe të jepnin dëmshpërblim për vonesat e ndodhura.

Në **Gjermani** pas çështjes *Sürmeli kundër Gjermanisë*, 8 qershor 2006, dhe *Rumpf kundër Gjermanisë*, shërbyen si reforma për të përmirësuar legjislacionin e brendshëm. Me ndryshimet në ligjin e datës 14 nëntor 2011, për mbrojtjen e të drejtave të individëve në rast të tejzgjatjes së paarsyeshme të procedurës, personi i cili pretendon se është viktimë e proceseve joefikase, mund të paraqesë një kërkesë në të njëjtën gjykatë ku ka ngecur çështja. Nëse kjo gjykatë nuk vijon me procesin, atëherë ankuesi mund të paraqesë kërkesë në gjykatën e apelit. Procesi ka dy faza: njëra është e natyra *parandaluese*, ku pala pretendon për përshpejtimin e procesit; dhe tjetra është faza e *kompensimit*, ku procesi është jashtë kufijve të kohëgjatjes së arsyeshme dhe viktima kërkon dëmshpërblim. Ky ligj përfshin dëmshpërblim ligjor për tejzgjatjen e proceseve gjyqësore, hapjen e çështjes penale, të drejtuarit e çështjes para Gjykatës Kushtetuese Federale, si edhe legjislacioneve të tjera të cilat krijojnë mundësinë e ngritjes së padive për procese të tejzgjatura, të tilla si: noteri, avokati dhe gjykatat financiare[359].

E drejta portugeze parashikon afate kohore maksimale për secilin hap të proceseve penale. Në rast se këto afate kohore nuk përmbushen, personi në fjalë mund të ngrejë padi për përshpejtim të proceseve gjyqësore, e cila, nëse pranohet mund të çojë, për shembull, në një vendim që përcakton afatet e shqyrtimit të çështjes që duhet të respektohen nga gjykata, ose nga prokurori në hapa të caktuar proceduralë, të tilla si mbyllja e hetimit, ose fiksimi i datës për seancat dëgjimore. Gjykata e ka njohur efektin e kësaj mase në pranueshmërinë e çështjes *Tomé Mota k. Portugalisë,* datë 2 dhjetor 1999. Në çështjen e fundit, ankuesi, Z. Cesário Manuel Tomé Mota, është shtetas

[358] Shih Rekomandimin për Ekzekutimin e vendimit Hartman, datë 29 maj 2013, http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-122060

359 Kohëzgjatja e procese gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, CEPEJ - seanca e 8të plenare, Strasburg, 6-8 dhjetor 2006,

portugez, lindur në vitin 1952. Në kohën kur Gjykata e mori vendimin, ankuesi mbahej në Burgun Linhó në Portugali. Ankuesi ishte arrestuar më 31 gusht 1991. Ai dyshohej se kishte përdorur disa çeqe të vjedhura, pasi i kishte nënshkruar me nënshkrimet përkatëse që u përkonin mbajtësve të ligjshëm të tyre, duke e ngarkuar kështu veten me përgjegjësi për përdorimin e objekteve të vjedhura, mashtrim dhe falsifikim. Këto fakte çuan në disa grupe procesesh penale kundër ankuesit, të cilat zgjatën për shumë vite. Gjykata u shpreh se "në dritën e legjislacionit të brendshëm dhe informacionit që i ishte dhënë qeverisë, të cilin ankuesi nuk e kishte kundërshtuar, në Portugali, një person që pretendon që proceset penale kundër tij janë të tejzgjatura, për shembull, kur janë tejkaluar afatet e parashtruara për çdo hap të procesit, ai mund të aplikojë para Avokatit të Përgjithshëm, ose Komisionit të Shërbimit Gjyqësor për përshpejtimin e proceseve kundër tij, në bazë të neneve 108 dhe 109 të Kodit të Procedurës Penale. Nëse ky ankim rezulton i suksesshëm, ndërmjet efekteve të tjera, ai mund të çojë në një vendim për tërheqjen e vëmendjes së prokurorit përgjegjës për hetimin për mbylljen e proceseve, ose, nëse del e nevojshme, në kërkesën para gjyqtarit për të marrë masat e nevojshme, të tilla si caktimi i datës për seancën, ose mbylljen e hetimeve gjyqësore. Për pasojë, këto dispozita janë të ndryshme nga dispozitat e Nenit 192, 337 dhe 338 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, të cilat ishin probleme shqetësuese në çështjen Moreira de Azevedo, për të cilat Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut u shpreh se nuk jepnin mjete efektive brenda kuptimit të shih Nenit 26 (aktualisht Neni 35 § 1) të Konventës (shih çështjen Nr. 11296/84, *Moreira de Azevedo k. Portugalisë*, vendim, datë 14 prill 1998, DR 56, f. 115). Për pasojë, Gjykata vëren se nenet 108 dhe 109 të Kodit të ri të Procedurës Penale, siç tregohet nga vendimet e parashtruara nga qeveria, përbëjnë një mjet real juridik që i bëjnë të mundur individëve të ankohen për tejzgjatjen e proceseve penale në Portugali (*Gonzalez Marin k. Spanjës* (Vendimi), Nr. 39521/98, KEDNJ 1999-VII, dhe çështja Nr. 17553/90, Prieto Rodriguez k. Spanjës, vendim, datë 6 korrik 1993, DR 75, f. 128). Duhet të kujtohet se, mjeti efektiv në fjalë u krijua si përgjigje ndaj kërkesës për shqyrtimin pa vonesë të proceseve, e garantuar nga Konventa.Siç tregohet nga preambula e Kodit të ri të Procedurës Penale, mjeti duhet të jetë mjaftueshmërisht i aksesueshëm dhe efektiv dhe, në veçanti, ushtrimi i tij të mos çojë në zgjatjen e proceseve në diskutim duke pasur parasysh afatet kohore strikte që u ngarkohen institucioneve përgjegjëse për të marrë vendime. Duke qenë kështu, në mungesë të rrethanave të posaçme, të cilat nuk pretendohen, të tilla si zhveshja e ankimuesit nga një detyrim i tillë, ankimuesi duhet ta përdorë këtë mjet para Komisionit përgjegjës për tejzgjatjen e proceseve penale. Për pasojë, Gjykata e deklaroi ankimin të papranueshëm.

Në mënyrë të ngjashme, **e drejta austriake** parashikon që në proceset penale, organi kompetent, përveç kur parashikohet ndryshe, duhet të marrë vendim brenda gjashtë muajve pas marrjes së kërkesë të palës. Nëse nuk respektohet vendosja në afat, pala mund të depozitojë një kërkesë para Gjykatës Administrative bazuar në Nenin 132 të Kushtetutës Federale. Nëse konsiderohet e pranueshme, ajo çon urdhërimin e autoritetit për të dhënë vendim brenda tri muajsh, afat kohor i cili mund të shtyhet vetëm një herë. Gjykata njohu efektivitetin e mjeteve austriake në vendimin për çështjen *Basic k. Austrisë,* datë 30 janar 2001, me arsyetimin e mëposhtëm:

"Gjykata konstaton se nuk ka dallime thelbësore që do ta dallonin kërkesën e bërë në bazë të Nenit 132 të Kushtetutës Federale Austriake, objekt shqyrtimi në çështjen në

fjalë, nga mjeti juridik i diskutuar në çështjen *Tomé Mota*, përmendur më sipër. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se sipas ligjit austriak autoritetet administrative, si rregull i përgjithshëm, janë të detyruara të vendosin për kërkesën e një pale brenda gjashtë muajve dhe duke vërejtur se përdorimi i kërkesës sipas Nenit 132 të Kushtetutës Federale zakonisht nuk çon në një vonesë të mëtejshme në proces, Gjykata arriti në përfundimin se kjo kërkesë përbën mjet juridik efektiv në lidhje me një ankesë që ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurës.

Në Francë njohja e përgjegjësisë së shtetit për vonesën gjyqësore ka ardhur si rezultat i zhvillimeve të praktikës gjyqësore në lidhje me interpretimin e përgjegjësisë së gjykatave të zakonshme dhe administrative. Në vendimin për çështjen *Bolle-Laroche*, datë 23 shkurt 2003, i cili konfirmoi tendencën e nisur nga gjykatat e mëposhtme, Gjykata Franceze e Kasacionit e ripërcaktoi konceptin e neglizhencës së rëndë të gjykatave të zakonshme për të cilat mban përgjegjësi si "çdo mangësi të përcaktuar përmes një akti, ose serie aktesh që pasqyrojnë paaftësinë e sistemit publik të drejtësisë për përmbushjen e qëllimit të tij". Në vendimin e pranueshmërisë për çështjen *Giummarra dhe të tjerët kundër Francës,* datë 12 qershor 2001, Gjykata Europiane iu referua një interpretimi më fleksibël të Nenit L. 781-1 të Kodit të Organizimit Gjyqësor, i cili rregullon veprimet për dëmet për mosfunksionimin e sistemit të drejtësisë, dhe vuri në dukje se kishte një numër të mjaftueshëm të vendimeve të brendshme kundër shtetit për ta konsideruar masën si "mjet efektiv" në kuptimin e Nenit 13 të Konventës.

Për pasojë, Gjykata vendosi që parashtrimi i një kërkese në bazë të Nenit L. 781-1, tashmë kishte fituar "shkallën e nevojshme të sigurisë juridike" për të përbërë mjet "efektiv" brenda kuptimit të Nenit 35§1 të Konventës dhe se ankuesi duhet ta përdorë atë përpara se të çojë kërkesë para Gjykatës Europiane, pavarësisht fazës së arritur në proceset e brendshme, nëse ato kishin përfunduar, ose ishin ende pezull. Në të njëjtën mënyrë, në vendimin për çështjen *Magiera,* datë 28 qershor 2002, *Conseil d'État* i Francës pranoi se, në përputhje me Nenin 6§1 të Konventës dhe parimet e përgjithshme që rregullojnë funksionimin e gjykatave administrative, palët ndërgjygjëse kanë të drejtë të marrin një vendim brenda një kohe të arsyeshme dhe, nëse shkelje e kësaj të drejte u ka shkaktuar atyre dëm, ata mund të sigurojnë kompensim duke i ngarkuar shtetit përgjegjësinë për "keqfunksionimin e sistemit publik të drejtësisë", pa nevojën e vërtetimit të neglizhencës së madhe në ushtrimin e kompetencave gjyqësore, siç ka ndodhur bazuar në jurisprudencën e mëparshme. Në dritën e këtij zhvillimi, Gjykata Europiane, në vendimin e çështjes *Broca dhe Texier-Micault k. Francës,* vendim, datë 21 tetor 2003, pranoi efektivitetin e padisë për dëmshpërblim.